



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/____

**PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT
TË TERRORIZMIT¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, nëpërmjet përcaktimit të masave parandaluese, rregullave për transparencën, shkëmbimin e informacionit dhe mekanizmave të

¹ Ky ligj transponon plotësisht Direktivën (BE) 2024/1640 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 31 maj 2024, “Mbi mekanizmat që duhet të vendosen nga Shtetet Anëtare për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, që ndryshon Direktivën (BE) 2019/1937 dhe që ndryshon dhe shfuqizon Direktivën (BE) 2015/849” (CELEX: 32024L1640);

Ky ligj harmonizohet plotësisht me:

Rregulloren (BE) 2024/1624 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 31 majit 2024 “Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit (CELEX: 32024R1624);

Rregulloren (BE) 2023/1113 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 31 Majit 2023 “Mbi informacionin që shoqëron transfertat e fondeve dhe disa krypto-aseteve dhe që ndryshon Direktivën (BE) 2015/849” (CELEX: 32023R1113);

Rregulloren (BE) 2018/1672 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 23 tetor 2018, “Mbi kontrollet e mjeteve monetare që hyjnë ose dalin nga Bashkimi dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) nr. 1889/2005 (Tekst i konsoliduar) (CELEX: 32018R1672).

kontrollit.

Neni 2

Struktura e ligjit

Ky ligj përbëhet nga katër pjesë që rregullojnë:

- a) masat dhe mekanizmat kombëtarë për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë;
- b) masat që zbatohen nga subjektet e detyruara për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë;
- c) informacionin që shoqëron transfertat e fondeve dhe të krypto-aseteve të caktuara;
- d) kontrollin e mjeteve monetare që hyjnë ose dalin nga Republika e Shqipërisë.

PJESA I

MASAT DHE MEKANIZMAT PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE, FINANCIMIT TË TERRORIZMIT DHE FINANCIMIT TË PËRHAPJES SË ARMËVE TË DËMTIMIT NË MASË

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Seksioni 1

OBJEKTI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 3

Objekti

Pjesa I e këtij ligji përcakton rregullat që lidhen me:

- a) masat që zbatohen, në nivel kombëtar, ndaj sektorëve të ekspozuar ndaj pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë;
- b) kërkesat në lidhje me regjistrimin, identifikimin dhe verifikimin e drejtuesve të lartë dhe pronarëve përfitues të subjekteve të detyruara;
- c) identifikimin e rreziqeve të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, në nivel kombëtar;
- d) ngritjen e sistemit të aksesit në të dhënat për pasuritë e paluajtshme dhe të drejtën e aksesit në këtë sistem;
- e) përgjegjësitë, funksionet dhe detyrat e Agjencisë së Inteligjencës Financiare;
- f) përgjegjësitë, funksionet dhe detyrat e autoriteteve të ngarkuara me mbikëqyrjen e subjekteve të detyruara;
- g) bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente, autoriteteve të shteteve anëtare dhe vendeve të treta.

Neni 4

Përkufizime

Për qëllime të zbatimit të Pjesës I të këtij ligji, zbatohen përkufizimet e përcaktuara në Pjesën II, Pjesën III dhe Pjesën IV të këtij ligji, si dhe përkufizimet e mëposhtme:

1. “autoritet përgjegjës” është Agjencia e Inteligjencës Financiare (AIF), institucion në varësi të ministrit përgjegjës për financat, i cili vepron si njësi e inteligjencës financiare e Republikës së Shqipërisë dhe gëzon pavarësi operationale në ushtrimin e kompetencave të saj;
2. “autoritet kompetent” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 85, pika 1, të këtij ligji;
3. “autoritet mbikëqyrës” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 85, pika 3, të këtij ligji;
4. “autoritete doganore” janë autoritetet publike përgjegjëse për administrimin dhe kontrollin doganor, si dhe autoritetet kompetente për kontrollin e lëvizjes ndërkufitare të mjeteve monetare, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi për doganat;
5. “AMLA” është Autoriteti Evropian për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
6. “mbikëqyrës” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 85, pika 2;
7. “mbikëqyrës financiar” është autoriteti publik përgjegjës për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin sektorial në fuqi;
8. “mbikëqyrës jo financiar” është autoriteti publik përgjegjës për mbikëqyrjen e subjekteve të sektorit jo financiar, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin sektorial në fuqi;
9. “financim i përhapjes së armëve të dëmtimit në masë” është ofrimi i fondeve apo shërbimeve financiare që përdoren për prodhimin, përvetësimin, posedimin, zhvillimin, eksportin, transportin, transportin ndërmjetësues, ndërmjetësimin, transferimin, grumbullimin apo përdorimin e armëve kimike, biologjike, radiologjike ose bërthamore, mjeteve të dorëzimit të tyre dhe materialeve të lidhura me to;
10. “Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF)” është një organ ndërqeveritar, përgjegjësia e të cilit është të përcaktojë standardet e të nxisë zbatimin efektiv të masave ligjore, rregullatore dhe operationale për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, si dhe për kërcënime të tjera që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar;
11. “kolegj mbikëqyrës për PPP/FT” është një strukturë e përhershme bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni për qëllime të mbikëqyrjes së një grupi ose subjekti që operon në një shtet anëtar pritës ose në një vend të tretë;
12. “llogari e titujve” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi që rregullon tregjet e kapitalit;
13. “njësi homologe e inteligjencës financiare” nënkupton njësinë e inteligjencës financiare të një shteti anëtar apo vendi të tretë që vepron në përputhje me standardet ndërkombëtare të FATF dhe parimet e Grupit Egmont;
14. “mjet virtual” nënkupton një pasqyrim digjital të një vlere ose të një të drejte që mund të depozitohet, të tregtohet apo të transferohet në formë digjitale dhe ruhet elektronikisht duke përdorur teknologjinë e regjistrimit të shpërndarë (DLT) ose teknologji të ngjashme, si dhe që mund të përdoret për qëllime pagesash ose investimesh, apo si mjet shkëmbimi, duke përfshirë por pa u kufizuar te krypto-asetet. Në këtë përkufizim nuk përfshihen pasqyrimet digjitale të monedhave të njohura zyrtarisht si të nxjerra ose të garantuara nga bankat qendrore ose një autoritet publik, të letrave me vlerë dhe mjeteve të tjera financiare që janë parashikuar

nga legjislacioni sektorial në fuqi;

15. “ofrues i shërbimeve të mjeteve virtuale” nënkupton çdo person fizik ose juridik, i cili kryen, për ose në emër të një personi tjetër fizik ose juridik, një ose më shumë nga këto aktivitete:

- i) shkëmbimin ndërmjet mjeteve virtuale dhe monedhave të njohura zyrtarisht;
- ii) shkëmbimin ndërmjet mjeteve virtuale dhe pasurive të çdo lloji me vlerë mbi 1 000 000 (një milion) lekë;
- iii) shkëmbimin ndërmjet një ose më shumë formave të mjeteve virtuale;
- iv) transferimin e mjeteve virtuale;
- v) ruajtjen dhe/ose administrimin e mjeteve virtuale ose instrumenteve që mundësojnë kontroll mbi mjetet virtuale;
- vi) pjesëmarrjen në dhe ofrimin e shërbimeve financiare që lidhen me ofertën dhe/ose shitjen e një mjeti virtual nga një emetues.

Në kuptim të kësaj pike, transferimi nënkupton kryerjen e një transaksioni për llogari të një personi tjetër fizik ose juridik, që lëviz mjetin virtual nga adresa e mjetit virtual ose llogaria e një personi tjetër;

16. “organ vetërregullues” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 85, pika 4, e këtij ligji;

17. “projekt masë kombëtare” është teksti i një akti, pavarësisht formës së tij, i cili ndodhet në fazë përgatitore dhe që pas miratimit prodhon efekte juridike, ndërkohë që në këtë fazë janë ende të mundshme ndryshime thelbësore në përmbajtjen e tij;

18. “PPP/FT” ka kuptimin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

19. “PPP/FT/FADM” ka kuptimin e parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë;

20. “Pjesa I” nënkupton pjesën e parë të ligjit, që përcakton masat dhe mekanizmat kombëtarë për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, nga neni 3 deri në nenin 83 të këtij ligji;

21. “Pjesa II” nënkupton pjesën e dytë të ligjit, që përcakton masat që zbatohen nga subjektet e detyruara për parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, nga neni 84 deri në nenin 147 të këtij ligji;

22. “Pjesa III” nënkupton pjesën e tretë të ligjit, që përcakton informacionin që shoqëron transfertat e fondeve dhe të krypto-aseteve të caktuara, nga neni 148 deri në nenin 183 të këtij ligji;

23. “Pjesa IV” nënkupton pjesën e katërt të ligjit, që përcakton kontrollin e mjeteve monetare që hyjnë ose dalin nga Republika e Shqipërisë, nga neni 184 deri në nenin 199 të këtij ligji;

24. “sektor jo financiar” janë subjektet e detyruara të përcaktuara në nenin 86, pika 3 e këtij ligji;

25. “subjekt i detyruar” është çdo person fizik apo person juridik, i përcaktuar në nenin 86 të këtij ligji, që i nënshtrohet detyrimeve për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, përveç rasteve të përjashtuara shprehimisht sipas këtij ligji në përputhje me nenet 87, 88 dhe 89;

26. “shteti anëtar i origjinës” është shteti anëtar ku ndodhet selia e regjistruar e subjektit të detyruar ose, nëse subjekti i detyruar nuk ka seli të regjistruar, shteti anëtar në të cilin ndodhet

selia e tij qendrore.

27. “shteti anëtar pritës” është një shtet anëtar, përveç shtetit anëtar të origjinës, në të cilin subjekti i detyruar operon përmes vendosjes së veprimtarisë, siç është një filial ose një degë, ose ku subjekti i detyruar operon sipas lirisë për të ofruar shërbime pa formë pranë ose vendosje fizike;

28. “shtet anëtar” është çdo shtet që sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian në fuqi, ka statusin e shtetit anëtar të Bashkimit Evropian;

29. “tituj” janë instrumentet financiare, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi që rregullon tregjet e kapitalit;

30. “vend i tretë” është çdo shtet ose juridiksion sipas përcaktimeve në nenin 85, pika 70 e këtij ligji.

Seksioni 2

Masat kombëtare për sektorët e ekspozuar ndaj rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Neni 5

Identifikimi i sektorëve të ekspozuar në nivel kombëtar

1. Në rastet kur autoritetet kompetente identifikojnë, në bazë të vlerësimit kombëtar të rrezikut, analizave sektoriale, gjetjeve të autoriteteve mbikëqyrëse ose informacioneve të tjera të disponueshme, se subjekte ose sektorë të tjerë, përveç subjekteve të detyruara, janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, ato përgatisin analizën e parashikuar në pikën 2 të këtij neni dhe i propozojnë Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave zbatimin e masave kombëtare ndaj këtyre subjekteve ose sektorëve, duke përcaktuar zbatimin e të gjitha ose të një pjese të masave të parashikuara në Pjesën II të këtij ligji.

2. Për qëllimet e zbatimit të pikës 1 të këtij neni, autoritetet kompetente përgatisin një analizë të posaçme dhe të arsyetuar, e cila përfshin:

a) arsyetimin që mbështet konstatimin se rreziqet e identifikuara kërkojnë zbatimin e masave edhe ndaj subjekteve dhe sektorëve shtesë;

b) vlerësimin e ndikimit që zbatimi i masave do të ketë mbi ofrimin e shërbimeve brenda tregut të brendshëm;

c) masat e Pjesës II të këtij ligji që propozohen të zbatohen ndaj këtyre subjekteve ose sektorëve shtesë;

d) tekstin e projektmasave kombëtare, si dhe çdo ndryshim thelbësor të tyre që lidhet me fushën e zbatimit, përmbajtjen ose mënyrën e zbatimit.

3. Propozimi për zbatimin e masave kombëtare i nënshtrohet një vlerësimi të posaçëm nga autoritetet kompetente që janë pjesë e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse përkatëse, me qëllim përcaktimin nëse:

a) masat e propozuara janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për adresimin e rreziqeve të identifikuara, veçanërisht kur këto rreziqe lidhen me tregun e brendshëm;

b) masat e propozuara mund të krijojnë pengesa për lëvizjen e lirë të shërbimeve ose

kapitalit ose për lirinë e vendosjes së ofruesve të shërbimeve brenda tregut të brendshëm, të cilat nuk janë proporcionale me rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që këto masa synojnë të zbusin.

Në përfundim të vlerësimit hartohet një analizë e arsyetuar, e cila i paraqitet Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave dhe merret në konsideratë përpara marrjes së vendimit mbi propozimin e masave.

4. Marrja e vendimit nga Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave mbi propozimin e masave kombëtare mund të shtyhet për një periudhë gjashtëmujore nga data e paraqitjes së propozimit sipas pikës 1 të këtij neni.

Afati i parashikuar në paragrafin e parë të kësaj pike nuk zbatohet kur masat kombëtare synojnë adresimin e një rreziku serioz dhe të menjëhershëm të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit ose financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë. Në këtë rast, vendimi i Komitetit shoqërohet me një arsyetim të posaçëm që justifikon moszbatimin e periudhës së shtyrjes.

5. Kur, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, legjislacioni në fuqi ka parashikuar zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit edhe ndaj subjekteve ose sektorëve të tjerë, përveç subjekteve të detyruara të përcaktuara në këtë ligj, këto masa vijojnë të zbatohen edhe ndaj tyre.

Vijimi i zbatimit të këtyre masave bazohet në një vlerësim të përditësuar dhe të arsyetuar të rrezikut, i cili justifikon ekspozimin e subjekteve ose sektorëve përkatës ndaj rreziqeve të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit ose financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë. Masat e zbatuara sipas kësaj pike i nënshtrohen vlerësimit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

6. Masat kombëtare të parashikuara në këtë nen miratohen me ligj, i cili përcakton në mënyrë të qartë subjektet ose sektorët ndaj të cilëve zbatohen këto masa.

Neni 6

Kërkesat që lidhen me disa ofrues shërbimesh

1. Zyrat e këmbimit valutor, si dhe ofruesit e shërbimit të arkëtimit të çeqeve, duhet të jenë të regjistruar ose të licencuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të identifikohen nga autoritetet mbikëqyrëse dhe t'i nënshtrohen mbikëqyrjes së tyre.

2. Ofruesit e shërbimeve për truste ose shoqëri tregtare duhet të jenë të regjistruar ose të licencuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të identifikohen nga autoritetet mbikëqyrëse dhe t'i nënshtrohen mbikëqyrjes së tyre.

3. Ofruesit e shërbimeve të lojërave të fatit duhet të jenë të rregulluar, regjistruar ose të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi, të identifikohen nga autoritetet mbikëqyrëse dhe t'i nënshtrohen mbikëqyrjes së tyre.

4. Subjektet e detyruara, përveç atyre të parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, i nënshtrohen kërkesave minimale për regjistrim, të cilat u mundësojnë mbikëqyrësve identifikimin dhe ushtrimin e mbikëqyrjes ndaj tyre.

5. Kërkesat minimale për regjistrim, sipas pikës 4 të këtij neni, nuk zbatohen për subjektet e detyruara që i nënshtrohen kërkesave për licencim ose regjistrim, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon ushtrimin e veprimtarisë ose profesionit përkatës, kur këto

kërkesa u mundësojnë mbikëqyrësve identifikimin dhe ushtrimin e mbikëqyrjes së tyre.

Neni 7

Zbatimi i masave që lidhen me dhënien e të drejtave të qëndrimit në këmbim të investimeve

1. Autoriteti kompetent përgjegjës për dhënien e të drejtave të qëndrimit, në rastet kur legjislacioni në fuqi parashikon mundësinë e dhënies së këtyre të drejtave në këmbim të investimit, përfshirë, ndër të tjera, transferimin e kapitalit, blerjen ose marrjen me qira të pasurisë së paluajtshme, investimin në tituj të borxhit publik, investimin në shoqëri tregtare, dhurimin ose financimin e aktiviteteve me interes publik, krijimin e një fondi për një veprimtari që kontribuon në të mirën publike, si dhe kontributet në buxhetin e shtetit, zbaton masat e nevojshme për parandalimin dhe zbutjen e rreziqeve të pastrimit të parave dhe të veprave penale që lidhen me të, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, të cilat përfshijnë të paktën:

a) procesin e menaxhimit të rrezikut, i cili përfshin identifikimin, klasifikimin dhe zbutjen e rreziqeve dhe koordinohet nga autoriteti kompetent përgjegjës për dhënien e të drejtave të qëndrimit;

b) masat për zbutjen e rreziqeve të pastrimit të parave dhe të veprave penale që lidhen me të, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, të lidhura me aplikantët për dhënien e të drejtave të qëndrimit në këmbim të investimeve, të cilat përfshijnë, ndër të tjera:

i. verifikimin e profilit të aplikantit nga autoriteti kompetent përgjegjës për dhënien e të drejtave të qëndrimit, duke përfshirë marrjen e informacionit mbi burimin e fondeve dhe burimin e pasurisë së aplikantit;

ii. verifikimin e informacionit mbi aplikantët kundrejt informacionit të mbajtur nga autoritetet kompetente, sipas përcaktimeve në nenin 85, pika 1, germa “a” dhe “c” të këtij ligji, në përputhje me legjislacionin procedural penal në fuqi;

iii. verifikimin kundrejt listave të personave dhe subjekteve të shpallura që i nënshtrohen masave shtrënguese financiare, sipas legjislacionit në fuqi;

iv. shqyrtimin periodik të aplikantëve të vlerësuar me rrezik të mesëm dhe të lartë.

2. Zbatimi i procesit të menaxhimit të rrezikut të parashikuar në pikën 1, germa “a” e këtij neni i nënshtrohet monitorimit të vazhdueshëm dhe vlerësohet të paktën një herë në vit.

3. Masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni zbatohen në përputhje me rreziqet e identifikuar në kuadër të vlerësimit kombëtar të rrezikut të kryer në përputhje me nenin 10 të këtij ligji.

4. Autoriteti kompetent përgjegjës për dhënien e të drejtave të qëndrimit, publikon çdo vit një raport mbi rreziqet e pastrimit të parave dhe të veprave penale që lidhen me të, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, që lidhen me dhënien e të drejtave të qëndrimit në këmbim të investimeve. Raporti bëhet publik dhe përmban, ndër të tjera, të dhëna lidhur me:

a) numrin e aplikimeve të pranuar dhe shtetet e origjinës së aplikantëve;

b) numrin e lejeve të qëndrimit të dhëna ose të refuzuara, si dhe arsyet e refuzimit të tyre;

c) çdo zhvillim ose ndryshim të konstatuar në rreziqet e pastrimit të parave dhe të veprave penale që lidhen me të, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë që lidhen me dhënien e të drejtave të qëndrimit në këmbim të investimeve.

5. Këshilli i Ministrave, me propozim të autoritetit kompetent përgjegjës për dhënien e të drejtave të qëndrimit, vendos rregullat dhe procedurat për përcaktimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e masave të parashikuara në këtë nen.

Neni 8

Verifikimi i integritetit dhe përshtatshmërisë së drejtuesve të lartë dhe pronarëve përfitues të disa kategorive të subjekteve të detyruara

1. Mbikëqyrësit në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin sektorial në fuqi, verifikojnë integritetin dhe përshtatshmërinë e anëtarëve të funksioneve të larta drejtuese dhe të pronarëve përfitues të subjekteve të detyruara të parashikuara në nenin 6, pikat 1, 2 dhe 3 të këtij ligji, si dhe të shoqërive kontrolluese me veprimtari të përzier financiare, duke siguruar që:

a) këta persona gëzojnë reputacion të mirë dhe veprojnë me ndershmëri dhe integritet;
b) anëtarët e funksioneve të larta drejtuese zotërojnë njohuritë dhe përvojën e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre.

2. Për subjektet e detyruara të parashikuara në nenin 86, pikat 3, germa “a”, “b”, “d”, “e”, “f” dhe “h” deri tek germa “o”, mbikëqyrësit marrin masat e nevojshme administrative dhe mbikëqyrëse për të parandaluar që personat e dënuar për veprën penale të pastrimit të parave dhe të veprave penale që lidhen me të, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, si dhe personat e lidhur me ta, të njohur si bashkëpunëtorë të ngushtë:

a) të regjistroheshin, të licencohen ose të pajisen me autorizim përkatës, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

b) të ushtrojnë funksione të larta drejtuese;

c) të jenë pronarë përfitues të këtyre subjekteve të detyruara.

3. Mbikëqyrësit verifikojnë, në mënyrë të vazhdueshme dhe në përputhje me mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, nëse kërkesat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni vazhdojnë të përmbushen.

Në veçanti, mbikëqyrësit verifikojnë integritetin dhe përshtatshmërinë e drejtuesve të lartë të subjekteve të detyruara të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, për sa i përket reputacionit, ndershmërisë, integritetit, si dhe njohurive dhe përvojës së nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se pastrimi i parave, financimi i terrorizmit apo financimi i përhapjes së armëve të dëmtimit në masë është kryer, është duke u kryer ose është tentuar të kryhet, ose kur konstatohet rrezik i shtuar për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë në subjektin e detyruar.

4. Mbikëqyrësit kanë kompetencën të kërkojnë largimin nga funksionet e larta drejtuese të çdo personi të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprën penale të pastrimit të parave dhe të veprave penale që lidhen me të, për financimin e terrorizmit apo financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, për subjektet e detyruara të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Mbikëqyrësit kanë gjithashtu kompetencën të urdhërojnë largimin ose të vendosin ndalim të përkohshëm ndaj anëtarëve të drejtimit të lartë të subjekteve të detyruara të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kur këta nuk konsiderohen të përshtatshëm, për shkak se:

- a) nuk gëzojnë reputacion të mirë;
- b) nuk veprojnë me ndershmëri dhe integritet; apo
- c) nuk zotërojnë njohuritë dhe përvojën e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre.

5. Mbikëqyrësit kanë kompetencë të kërkojnë largimin nga subjektet e detyruara të personave të dënuar për pastrim parash dhe të veprave penale që lidhen me të, financim të terrorizmit apo financim të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, të cilët janë pronarë përfutues të subjektit të detyruar siç përmendet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, duke përfshirë edhe kompetencën për të kërkuar heqjen dorë nga zotërimi i këtyre pronarëve përfutues në subjektet e detyruara.

6. Për qëllimet e këtij neni, mbikëqyrësit, si dhe çdo autoritet tjetër kompetent në nivel kombëtar për vlerësimin e përmbushjes së kërkesave të zbatueshme ndaj personave të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, verifikojnë, në përputhje me legjislacionin në fuqi:

a) ekzistencën e të dhënave në regjistrat dhe bazat kombëtare të informacionit dhe të dhënave që administrohen nga autoritetet kompetente, për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë; dhe

b) nëse ndaj personit përkatës ekziston një dënim penal i regjistruar në regjistrin e gjendjes gjyqësore.

Shkëmbimi i informacionit për këto qëllime kryhet në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, procedurën penale dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, si dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

7. Vendimet e marra nga mbikëqyrësit në zbatim të këtij neni i nënshtrohen procedurave efektive të ankimimit administrativ dhe gjyqësor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Kompetencat e mbikëqyrësve të parashikuara në këtë nen ushtrohen në përputhje me këtë ligj, ligjet sektoriale që rregullojnë organizimin, funksionimin dhe kompetencat e secilit autoritet mbikëqyrës, të cilat përcaktojnë procedurat dhe masat konkrete për zbatimin e tyre.

9. Për qëllimet e zbatimit të këtij neni, ministri përgjegjës për financat, me propozimin e autoritetit përgjegjës, brenda gjashtë muajve nga nxjerrja e udhëzimeve nga AMLA, nxjerr udhëzime sipas specifikave të secilit sektor të subjekteve të detyruara, mbi:

a) kriteret për të vlerësuar reputacionin e mirë, ndershmërinë dhe integritetin siç përmenden në pikën 1 të këtij neni;

b) kriteret për të vlerësuar njohuritë dhe përvojën siç përmenden në pikën 1 të këtij neni;

c) zbatimin e njëtrajtshëm të kompetencave të parashikuara në këtë nen nga mbikëqyrësit e subjekteve të detyruara.

10. Kërkesat e parashikuara në këtë nen zbatohen edhe ndaj subjekteve të detyruara të përcaktuara në nenin 86, pika 3, germa “n” dhe “o”, duke filluar nga data 10 korrik 2029.

Seksioni 3

Mekanizmat kombëtarë dhe vlerësimet e rrezikut

Neni 9

Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave

1. Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave është përgjegjës për përcaktimin e drejtimeve të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, si dhe për sigurimin e mekanizmave efektivë të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe masave në këto fusha.

2. Komiteti drejtohet nga Kryeministri dhe në përbërje të tij ka ministrin përgjegjës për financat, ministrin përgjegjës për punët e jashtme, ministrin përgjegjës për çështjet e mbrojtjes, ministrin përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministrin përgjegjës për çështjet e drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit, Inspektorin e Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

3. Komiteti mbledhet të paktën një herë në vit për të shqyrtuar dhe analizuar raportet për veprimtaritë e kryera nga autoritetet kompetente, si dhe raportet dhe dokumentet e përgatitura nga institucionet dhe organizmat ndërkombëtarë, të cilat ushtrojnë veprimtaritë e tyre të vlerësimit në nivel vendi në fushën e luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë. Drejtori i përgjithshëm i autoritetit përgjegjës vepron si këshilltar në mbledhjet e Komitetit.

4. Në mbledhjet e Komitetit mund të ftohen për të marrë pjesë ministra, deputetë, drejtues ose përfaqësues të institucioneve dhe ekspertë në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

5. Komiteti mund të krijojë grupe pune teknike dhe/ose operacionale për të ndihmuar në ushtrimin e funksioneve të tij, si dhe për studimin e tipologjive e të teknikave të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, dhe për të siguruar shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin ndërmjet autoriteteve kompetente në zbatim të këtij ligji.

6. Rregullat e funksionimit të Komitetit përcaktohen në rregulloren e brendshme, të miratuar nga ky Komitet.

Neni 10

Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut

1. Institucionet anëtare të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, kontribuojnë në mënyrë periodike në kryerjen e Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut, me qëllim identifikimin, vlerësimin, kuptimin dhe zbutjen e rreziqeve të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, si dhe të rreziqeve që lidhen me moszbatimin dhe shmangien e masave shtrënguese financiare.

Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut shoqërohet me planin përkatës të veprimit për adresimin e rreziqeve të identifikuar.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare, në cilësinë e autoritetit përgjegjës, koordinon dhe bashkërendon procesin e hartimit të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut dhe të planit përkatës të veprimit. Për këtë qëllim, Agjencia e Inteligjencës Financiare ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë statistika, të dhëna dhe informacione nga:

- a) subjektet e detyruara;
- b) autoritetet mbikëqyrëse;
- c) organet e administratës shtetërore dhe bazat përkatëse të të dhënave shtetërore;
- d) autoritetet e tjera kompetente të përfshira në parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

3. Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut dhe plani përkatës i veprimit, të hartuar sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, u paraqiten për miratim Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave nga Agjencia e Inteligjencës Financiare.

4. Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut rishikohet jo më pak se çdo 4 vjet. Në varësi të situatës së rrezikut të identifikuar, autoritetet kompetente mund ta rishikojnë Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut më shpesh se afati i parashikuar, ose të kryejnë vlerësime sektoriale të posaçme të rrezikut.

5. Institucionet sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, për kryerjen e Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut, gjatë procesit të vlerësimit dhe përditësimit të tij, përdorin ndër të tjera, si burim referimi raportet dhe vlerësimet përkatëse të hartuara në nivel të Bashkimit Evropian, si dhe standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, veçanërisht ato që identifikojnë sektorët, produktet dhe rreziqet kryesore, si dhe rekomandimet dhe gjetjet që burojnë prej tyre.

6. Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut shërben si bazë për:

a) përmirësimin e sistemit kombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, në veçanti duke identifikuar fushat ku subjektet e detyruara duhet të zbatojnë masa të përforcuara në përputhje me mbikëqyrjen e bazuar në rrezik dhe, sipas rastit, duke specifikuar masat që duhen ndërmarrë;

b) identifikimin, sipas rastit, të sektorëve, veprimtarive ose fushave që paraqesin nivel më të lartë ose më të ulët rreziku për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë;

c) vlerësimin e rreziqeve të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, që lidhen me çdo kategori personash juridikë të themeluar në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe me çdo formë organizimi ligjor që vepron apo administrohet në territorin e saj, ose kur administratorët, kujdestarët ose personat me funksione të barasvlershme në organizime të tilla ligjore kanë vendbanimin në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe kuptimin e nivelit të ekspozimit ndaj rreziqeve që burojnë nga personat juridikë të huaj dhe organizimet ligjore të huaja;

d) ndarjen dhe prioritizimin e burimeve institucionale për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, si dhe për parandalimin e moszbatimit dhe të shmangies të masave

shtrënguese financiare;

e) hartimin dhe përditësimin e rregullave dhe kërkesave të përshtatshme për çdo sektor ose fushë veprimtarie, në përputhje me rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë;

f) vënien menjëherë në dispozicion të informacionit të duhur autoriteteve kompetente dhe subjekteve të detyruara, me qëllim lehtësimin e kryerjes së vlerësimeve të tyre të rrezikut për pastrimin e parave, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, si dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me moszbatimin dhe shmangien e masave shtrënguese financiare sipas përcaktimeve të nenit 92 të këtij ligji.

Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut duhet të përshkruajë gjithashtu strukturën institucionale dhe procedurat e përgjithshme të sistemit kombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, duke përfshirë Agjencinë e Inteligjencës Financiare, autoritetet tatimore dhe organet e ndjekjes penale, mekanizmat e bashkëpunimit me autoritetet homologe të shteteve anëtare ose të vendeve të treta, si dhe burimet njerëzore dhe financiare të vëna në dispozicion, në masën që ky informacion është i disponueshëm.

7. Në procesin e hartimit dhe përditësimit të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut, sigurohet përfshirja dhe pjesëmarrja e duhur e autoriteteve kompetente dhe, sipas rastit, e palëve të interesuara përkatëse, në përputhje me kompetencat dhe rolin e tyre në sistemin kombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

8. Rezultatet e Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut, përfshirë përditësimet dhe rishikimet e tij, u vihen në dispozicion autoriteteve kompetente, autoriteteve mbikëqyrëse dhe subjekteve të detyruara për ushtrimin e funksioneve dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore. Ky informacion u vihet gjithashtu në dispozicion autoriteteve dhe organizmave ndërkombëtare përkatëse, përfshirë AMLA, si dhe autoriteteve homologe të shteteve anëtare dhe vendeve të treta partnere, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, kuadrin ligjor në fuqi dhe detyrimet që burojnë nga ky ligj.

9. Agjencia e Inteligjencës Financiare mund, sipas rastit, t'i ofrojë autoritetit të shtetit anëtar që kryen vlerësimin kombëtar të rrezikut informacion shtesë përkatës, kur është e përshtatshme.

10. Një përmbledhje e gjetjeve kryesore të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut bëhet publike. Kjo përmbledhje nuk përmban informacion të klasifikuar, të dhëna personale ose informacion që lejon identifikimin e personave fizikë apo personave juridikë.

Neni 11 Statistikat

1. Autoritetet kompetente, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, mbajnë dhe përditësojnë statistika të plota dhe të përbashkëta mbi çështjet që lidhen me funksionimin dhe zbatimin e sistemit kombëtar për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, me qëllim vlerësimin dhe rishikimin e efektivitetit të këtij sistemi.

2. Statistikat e përmendura në pikën 1 të këtij neni përfshijnë, ndër të tjera:

a) të dhëna që pasqyrojnë madhësinë dhe rëndësinë e sektorëve të ndryshëm që i

nënshtrohen kuadrit ligjor për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, përfshirë numrin e personave fizikë dhe juridikë, si dhe peshën ekonomike të secilit sektor;

b) të dhëna që pasqyrojnë fazat e raportimit, hetimit dhe ndjekjes gjyqësore në kuadër të sistemit kombëtar për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë numrin e raportimeve të aktivitetit të dyshimtë të paraqitura pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare dhe ndjekjen e tyre, informacionin mbi deklaratimet e transportit ndërkufitar të mjeteve monetare, të raportuara sipas Pjesës IV të këtij ligji, si dhe masat e marra në vijim, si dhe, në bazë vjetore, numrin e çështjeve të hetuara, numrin e personave të ndjekur penalisht dhe të dënuar për veprat penale të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, si dhe kategoritë e veprave penale që lidhen me to, kur ky informacion është i disponueshëm, si dhe vlerën, të shprehur në shumë monetare, të pasurive të ngrira, të bllokuara, të sekuestruara ose të konfiskuara;

c) numrin dhe përqindjen e raportimeve të aktivitetit të dyshimtë që rezultojnë në shpërndarje të informacionit pranë autoriteteve të tjera kompetente, si dhe, kur ky informacion është i disponueshëm, numrin dhe përqindjen e raportimeve që çojnë në hetime të mëtejshme, së bashku me raportin vjetor të hartuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare sipas nenit 29 të këtij ligji;

d) të dhëna mbi numrin e kërkesave të bashkëpunimit ndërkombëtar për shkëmbim informacioni të paraqitura, të marra, të refuzuara, si dhe të trajtuara pjesërisht ose plotësisht nga Agjencia e Inteligjencës Financiare, të ndara sipas shtetit homolog përkatës;

e) të dhëna mbi numrin e kërkesave për ndihmë juridike ose kërkesave të tjera ndërkombëtare për shkëmbim informacioni që lidhen me pronësinë përfituese dhe informacionin mbi regjistrin e centralizuar të llogarive bankare sipas legjislacionit në fuqi, të marra apo të dërguara pranë autoriteteve kompetente homologe të shteteve anëtare apo vendeve të treta, të ndara sipas autoritetit dhe shtetit homolog përkatës;

f) të dhëna mbi burimet njerëzore në dispozicion të autoriteteve mbikëqyrëse, si dhe burimet njerëzore të vëna në dispozicion të Agjencisë së Inteligjencës Financiare për përmbushjen e detyrave të saj ligjore;

g) të dhëna mbi numrin e veprimeve mbikëqyrëse të kryera në vend dhe jashtë vendit të ushtrimit të veprimtarisë të subjekteve të detyruara, numrin e shkeljeve të konstatuara në bazë të këtyre veprimeve, si dhe numrin e masave administrative, gjobave apo gjobave periodike të vendosura nga autoritetet mbikëqyrëse dhe organet vetërregulluese, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin sektorial në fuqi;

h) të dhëna mbi numrin dhe llojin e shkeljeve të konstatuara në lidhje me detyrimet për transparencën e pronësisë përfituese dhe aksesin në informacionin përkatës, si dhe gjobat administrative apo masat e tjera administrative të zbatuara për këto shkelje; numrin e mospërputhjeve të raportuara në regjistrin qendror të pronësisë përfituese, si dhe numrin e kontrolleve të kryera nga autoriteti përgjegjës për administrimin e këtij regjistri ose nga autoritete të tjera të autorizuar;

i) informacionin mbi zbatimin e rregullave për aksesin në të dhënat e pronësisë përfituese të parashikuara në ligjin për regjistrimin e pronarëve përfitues ku ndër të tjera, përfshihet:

i. numrin e kërkesave për akses në informacionin e pronësisë përfituese të mbajtur në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas kategorive të subjekteve të përcaktuara në legjislacionin

në fuqi;

ii. përqindjen e kërkesave për akses në informacionin e pronësisë përfituese që janë refuzuar, të ndara sipas kategorive të subjekteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;

iii. një përmbledhje të kategorive të personave ose subjekteve të cilëve u është dhënë akses në informacionin e pronësisë përfituese, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

j) të dhëna mbi numrin e kërtimeve të kryera nga autoritetet kompetente në regjistrin e centralizuar të llogarive bankare ose në mekanizmat përkatës të marrjes së të dhënave, të ndara sipas kategorive të autoriteteve kompetente, si dhe numrin e kërtimeve të kryera nga Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe autoritetet mbikëqyrëse në mekanizmat e ndërlidhjes së regjistrave të llogarive bankare;

k) informacion mbi zbatimin e masave shtrënguese financiare, përfshirë:

i. vlerën e fondeve ose pasurive të tjera të bllokuara, të ndara sipas llojit të pasurisë;

ii. të dhëna mbi burimet njerëzore në dispozicion të autoriteteve kompetente përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e masave shtrënguese financiare.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare koordinon mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore sipas këtij neni.

Agjencia e Inteligjencës Financiare kryen këtë proces nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstitucional me autoritetet kompetente, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e secilit autoritet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Autoritetet kompetente mbajnë dhe i raportojnë të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni Agjencisë së Inteligjencës Financiare, në përputhje me afatet dhe formën e përcaktuar sipas pikës 6 të këtij neni.

4. Agjencia e Inteligjencës Financiare siguron mbledhjen dhe transmetimin, në baza vjetore, pranë Komisionit Evropian të statistikave të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni. Statistikat e përcaktuara në germa "a", "c", "d" dhe "f" të pikës 2 të këtij neni i transmetohen gjithashtu AMLA-s, në përputhje me përcaktimet e lejuara në këtë ligj.

5. Statistikat e mbledhura sipas këtij neni përpunohen dhe raportohen në mënyrë periodike, të paktën një herë në vit, pranë Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

Agjencia e Inteligjencës Financiare publikon, në faqen zyrtare të internetit, çdo dy vjet, një raport përmbledhës dhe shpjegues mbi statistikat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

6. Metodologjia, periodiciteti, forma dhe mënyra e raportimit të këtyre të dhënave nga autoritetet kompetente përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Seksioni 4

Sistemi i aksesit në të dhënat për pasuritë e paluajtshme

Neni 12

Akresi dhe sistemi i aksesit në të dhënat për pasuritë e paluajtshme

1. Autoritetet kompetente, për qëllime të parandalimit, zbulimit, ndjekjes dhe hetimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, kanë akses të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë, pa pagesë, në informacionin dhe të dhënat që mundësojnë identifikimin në kohë të:

a) çdo pasurie të paluajtshme, të drejtave reale të lidhura me të, si dhe interesave të tjera juridike të regjistruara mbi ose në lidhje me të;

b) personave fizikë ose juridikë, si dhe organizimeve ligjore, që zotërojnë këto pasuri;

c) transaksioneve që lidhen me pasuritë e paluajtshme, për qëllime të identifikimit dhe analizës.

2. Aksesit i parashikuar në pikën 1 të këtij neni sigurohet nëpërmjet një sistemi të vetëm aksesit të krijuar në nivel kombëtar, i cili u mundëson autoriteteve kompetente aksesin, nëpërmjet mjeteve elektronike, në informacion në format digjital, i cili, kur është e mundur, duhet të jetë në format të strukturuar, i lexueshëm dhe i përpunueshëm në mënyrë automatike.

3. AMLA gëzon akses sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, me të njëjtat kushte dhe modalitete si autoritetet kompetente, për qëllime të kryerjes së analizave të përbashkëta, në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara për këtë autoritet, në përputhje me aktet përkatëse të Bashkimit Evropian dhe me përcaktimet e lejuara në këtë ligj.

Neni 13

Përmbajtja e informacionit dhe funksionimi i sistemit të aksesit në të dhënat për pasuritë e paluajtshme

1. Përmes sistemit të vetëm të aksesit, sipas nenit 12 të këtij ligji, bëhet i disponueshëm të paktën informacioni i mëposhtëm:

a) informacion mbi pasurinë, përfshirë:

i. parcelën kadastrale dhe referencën kadastrale;

ii. vendndodhjen gjeografike, përfshirë adresën e pasurisë;

iii. sipërfaqen ose madhësinë e pasurisë;

iv. llojin e pasurisë, duke përfshirë nëse është pronë e ndërtuar ose e pandërtuar, si dhe destinacionin e përdorimit të saj;

b) informacion mbi pronësinë, përfshirë:

i. emrin e pronarit dhe të çdo personi që vepron në emër të tij apo që pretendohet se vepron në emër të tij;

ii. kur pronari është person juridik, emrin dhe formën ligjore, si dhe numrin unik të identifikimit dhe numrin e identifikimit tatimor (NIPT);

iii. kur pronari është organizim ligjor, emrin e organizimit ligjor dhe numrin e identifikimit tatimor;

iv. çmimin me të cilin është fituar pasuria;

v. të drejtat, kufizimet ose detyrimet që lidhen me pasurinë, kur është e aplikueshme;

c) informacion mbi barrët dhe kufizimet mbi pasurinë, përfshirë:

i. hipotekat dhe të drejtat e të tretëve mbi pasurinë;

ii. kufizimet gjyqësore apo çdo akt tjetër që ndryshon regjimin juridik të pasurisë apo krijon të drejta dhe detyrime mbi pasurinë;

iii. barrët dhe të drejtat reale mbi pasurinë;

iv. garancitë e tjera, nëse ka;

d) historikun e të drejtave të pronësisë mbi pasurinë, çmimin e saj dhe barrët ose kufizimet që rëndojnë mbi të;

e) dokumentacionin përkatës.

Kur një parcelë kadastrale përfshin më shumë se një pasuri, informacioni i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni vihet në dispozicion për secilën pasuri të përfshirë në atë parcelë kadastrale.

Informacioni historik sipas pikës 1, germës “d”, të këtij neni, duhet të mbulojë të paktën periudhën duke filluar nga data 8 korrik 2019.

2. Autoriteti përgjegjës për krijimin, administrimin dhe funksionimin e sistemit të aksesit, në bashkëpunim me autoritetet që administrojnë burimet e informacionit, përcakton mekanizma organizativë dhe proceduralë për garantimin e përditësimit dhe saktësisë së informacionit që bëhet i disponueshëm përmes këtij sistemi.

3. Autoritetet që administrojnë burimet e informacionit që furnizojnë sistemin e vetëm të aksesit me informacionin mbi pasuritë e paluajtshme përcaktojnë masa organizative dhe procedurale për t’ia vënë menjëherë në dispozicion autoritetit kompetent kërkesë informacionin e disponueshëm në format elektronik.

Në rastet kur informacioni nuk administrohet në format elektronik, ai vihet në dispozicion, pa pagesë, brenda një afati të arsyeshëm dhe në një mënyrë që nuk pengon ushtrimin e funksioneve ligjore të autoritetit kompetent kërkesë.

4. Autoriteti përgjegjës për ngritjen e sistemit të aksesit, autoritetet përgjegjëse për burimet e informacionit, autoritetet kompetente që përfitojnë akses, si dhe rregullat e bashkërendimit ndërinstitucional, procedurat e aksesit, të përditësimit dhe të kontrollit të cilësisë së të dhënave përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II

ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE KOMPETENCAT E AUTORITETIT PËRGJEGJËS

Neni 14

Organizimi dhe funksionimi i autoritetit përgjegjës

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare organizohet si drejtori e përgjithshme në varësi të ministrit përgjegjës për financat, ushtron funksionet e autoritetit përgjegjës sipas këtij ligji dhe shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë brenda fushës së saj të përgjegjësisë.

2. Marrëdhëniet e punës të drejtorit të përgjithshëm, nëpunësve dhe punonjësve administrativë rregullohen në bazë të Kodit të Punës.

3. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës Financiare emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat. Vendimi për lirimin ose shkarkimin nga detyra duhet të jetë i arsyetuar dhe i njoftohet drejtorit të përgjithshëm.

4. Rekrutimi, pranimi, vlerësimi, ngritja në detyrë, lëvizja, transferimi, llojet e masave disiplinore dhe procedurat e shqyrtimit të tyre, si dhe përfundimi i marrëdhënies së punës për nëpunësit dhe punonjësit e autoritetit përgjegjës kryhen sipas procedurave të posaçme, të cilat garantojnë përzgjedhje dhe trajtim mbi bazën e meritës, integritetit, profesionalizmit, paanësisë politike, ruajtjes së konfidencialitetit dhe përshtatshmërisë për akses në informacionin e

klasifikuar. Këto procedura përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me Kodin e Punës, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe të këtij ligji.

Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të autoritetit përgjegjës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Autoriteti përgjegjës është njësi e vetme qendrore kombëtare përgjegjëse për marrjen dhe analizimin e raportimeve të paraqitura nga subjektet e detyruara në përputhje me këtë ligj, si dhe të çdo informacioni tjetër që lidhet me pastrimin e parave dhe veprat penale që lidhen me të, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

Autoriteti përgjegjës merr dhe analizon, ndër të tjera, informacionin e transmetuar nga autoritetet doganore në lidhje me transportin ndërkufitar të mjeteve monetare, sipas përcaktimeve të Pjesës IV të këtij ligji, si dhe informacionin e përcjellë nga autoritetet mbikëqyrëse ose autoritete të tjera kompetente, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

6. Agjencia e Inteligjencës Financiare është përgjegjëse për shpërndarjen e rezultateve të analizave të saj, si dhe të çdo informacioni tjetër shtesë të nevojshëm, pranë autoriteteve kompetente përkatëse, kur ka baza për të dyshuar për pastrimin e parave dhe veprat penale që lidhen me të, financimin e terrorizmit apo financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë. Për ushtrimin e këtyre funksioneve, Agjencia e Inteligjencës Financiare ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë informacion shtesë nga subjektet e detyruara, në përputhje me këtë ligj.

7. Agjencia e Inteligjencës Financiare ushtron funksionin e analizës financiare, i cili përbëhet si më poshtë:

a) analiza operacionale, e cila përqendrohet në raste individuale dhe objektiva specifike ose në informacione të përzgjedhura në mënyrë të përshtatshme, të renditura sipas përparësisë në bazë të rrezikut, llojit dhe vëllimit të raportimeve të marra nga subjektet e detyruara, si dhe përdorimit të pritshëm të informacionit pas shpërndarjes;

b) analiza strategjike, e cila trajton tendencat, modelet dhe zhvillimet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

8. Agjencia e Inteligjencës Financiare ushtron kompetencat e saj në mënyrë të pavarur dhe autonome. Në ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë ligj, ka autoritetin dhe kapacitetin e plotë për të kryer funksionet e saj lirisht, duke përfshirë të drejtën për të marrë vendime të pavarura apo autonome lidhur me analizimin, kërkimin dhe shpërndarjen e informacionit, në përputhje me pikën 6 të këtij neni.

Varësia administrative e Agjencisë së Inteligjencës Financiare nuk cenon pavarësinë e saj operacionale. Në ushtrimin e funksioneve të marrjes, kërkimit, aksesimit, administrimit, analizimit dhe shpërndarjes së informacionit, si dhe në vendimmarrjen për masat e parashikuara në këtë ligj, Agjencia e Inteligjencës Financiare vepron në mënyrë të pavarur dhe autonome.

Ndalohet çdo formë ndikimi ose ndërhyrjeje e papërshtatshme politike, qeveritare ose nga sektorë industrialë apo ekonomikë, në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të Agjencisë së Inteligjencës Financiare. Gjithashtu, asnjë organ publik, funksionar, subjekt privat apo person tjetër nuk mund të japë urdhra, udhëzime, orientime apo të ushtrojë ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi autoritetin përgjegjës në lidhje me një rast konkret, analizë konkrete, kërkesë për informacion, vendim për shpërndarje informacioni, vendim për bllokim, monitorim, kontroll apo inspektim të parashikuar nga ky ligj.

9. Agjencisë së Inteligjencës Financiare i garantohen burime financiare, njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për ushtrimin efektiv të funksioneve dhe kompetencave të parashikuara

në këtë ligj.

Agjencia e Inteligjencës Financiare administron dhe përdor në mënyrë autonome burimet e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Nëpunësit dhe punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës Financiare i nënshtrohen detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional, në nivel të barasvlershëm me kërkesat e parashikuara në nenin 80 të këtij ligji dhe në legjislacionin përkatës në fuqi.

Agjencia e Inteligjencës Financiare siguron që punonjësit e saj të përmbushin standarde të larta profesionale, përfshirë standarde të larta për mbrojtjen e të dhënave, integritetin profesional dhe aftësitë e nevojshme për trajtimin etik dhe të sigurt të vëllimeve të mëdha të të dhënave.

Agjencia e Inteligjencës Financiare vendos dhe zbaton procedura të brendshme për parandalimin, identifikimin dhe administrimin e konflikteve të interesit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Kriteret, procedurat dhe masat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit.

11. Agjencia e Inteligjencës Financiare vendos dhe zbaton rregulla të posaçme për garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të informacionit që administron, përfshirë informacionin e klasifikuar dhe të dhënat personale, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar.

12. Në funksion të ruajtjes së konfidencialitetit për fushën e veprimtarisë së vet, sigurisë së nëpunësve dhe punonjësve, apo sistemeve në përdorim, Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të vendosë kufizime për të dhënat e kërkuara në funksion të së drejtës për informim, nëse kufizimi është i domosdoshëm dhe proporcional. Agjencia e Inteligjencës Financiare duhet të arsyetojë kufizimin rast pas rasti.

13. Agjencia e Inteligjencës Financiare siguron vendosjen dhe funksionimin e kanaleve të sigurta dhe të mbrojtura për komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit me anë të mjeteve elektronike me autoritetet kompetente dhe subjektet e detyruara. Këto kanale komunikimi garantojnë integritetin, konfidencialitetin dhe gjurmueshmërinë e informacionit të shkëmbyer dhe përputhshmërinë me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e informacionit.

Rregullat teknike dhe procedurale për krijimin, përdorimin dhe administrimin e këtyre kanaleve përcaktohen në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura ndërmjet autoriteteve dhe në aktet e brendshme të autoritetit përgjegjës.

14. Agjencia e Inteligjencës Financiare, në ushtrim të funksioneve të saj sipas këtij ligji, shkëmben informacion me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Policinë e Shtetit, Byroën Kombëtare të Hetimit, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe autoritetet e tjera kompetente në zbatim të ligjit apo të inteligjencës, për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, veprat penale ose veprimtaritë kriminale që gjenerojnë produkte të veprës penale, financimin e terrorizmit apo financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, si dhe mund të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe ose shumëpalëshe me to, në përputhje me kompetencat e secilit autoritet dhe me legjislacionin në fuqi.

15. Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të lidhë marrëveshje me çdo agjenci homologe të huaj, apo organizma të tjerë jashtë vendit, që i nënshtrohen detyrimeve të

ngjashme të konfidencialitetit.

16. Agjencia e Inteligjencës Financiare, kryesisht, mbi bazë të një vendimi të Këshillit të Ministrave, apo për rastet e kërkuara nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar ose nga organizma të tjerë ndërkombëtarë, nga të cilët lindin detyrime për Republikën e Shqipërisë, nxjerr listë të vendeve për kufizimin dhe/ose kontrollin e transaksioneve apo marrëdhënieve të biznesit të subjekteve, proporcionalisht me rreziqet e evidentuara, vendime këto të detyrueshme për zbatim nga subjektet e detyruara dhe autoritetet shtetërore që kanë detyrime sipas këtij ligji.

17. Ministri përgjegjës për financat, me propozimin e autoritetit përgjegjës, brenda 6 muajve nga aktet e nxjerra nga AMLA, nxjerr me udhëzim:

a) masat që duhet të merren për të ruajtur autonominë dhe pavarësinë operationale të autoritetit përgjegjës, duke përfshirë masat për të parandaluar që konfliktet e interesit të ndikojnë në autonominë dhe pavarësinë e saj operationale;

b) natyrën, veçoritë dhe objektivat e analizës operationale dhe strategjike;

c) mjetet dhe metodat për përdorimin dhe verifikimin e kryqëzuar të informacionit financiar, administrativ dhe të zbatimit të ligjit në të cilin autoriteti përgjegjës ka akses; dhe

d) praktikat dhe procedurat për pezullimin ose mosdhënien e pëlqimit për kryerjen e transaksionit dhe pezullimin ose monitorimin e një llogarie ose marrëdhënie biznesi në përputhje me nenet 26 dhe 27 të këtij ligji.

Neni 15

Strukturat dhe sistemet TIK

Agjencia e Inteligjencës Financiare, për sa i përket strukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) që ka në përdorim, ka kompetencat e mëposhtme:

a) ngre, mirëmban dhe administron sistemet, aplikacionet dhe infrastrukturën TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si “sekret shtetëror”;

b) administron strukturën përkatëse të punonjësve të teknologjisë së informacionit në institucion;

c) administron kodin përkatës të çdo sistemi që përdoret për qëllime të funksionimit të institucionit;

d) përdor, aq sa është e mundur, shkëmbimin e të dhënave në mënyrë elektronike me bazat e të dhënave të ndërlidhura në platformën qeveritare të ndërveprimit;

dh) bashkëpunon me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit:

i. duke bashkërenduar projektet në fushën e shoqërisë së informacionit;

ii. duke përdorur standardet shqiptare në fushën e TIK, të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare;

iii. për të garantuar një nivel të lartë të sigurisë kibernetike dhe zgjidhjen e incidenteve të sigurisë kompjuterike.

Neni 16

Përgjegjësi për të drejtat themelore

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare cakton një person përgjegjës për të drejtat themelore, i cili ushtron funksionin e tij si mekanizëm i brendshëm këshillimor dhe mbikëqyrës për garantimin e respektimit të të drejtave themelore në veprimtarinë e institucionit.

Funksioni i përgjegjësit për të drejtat themelore ushtrohet nga një prej nëpunësve apo punonjësve ekzistues të Agjencisë së Inteligjencës Financiare.

2. Përgjegjësi për të drejtat themelore kryen detyrat e mëposhtme:

a) këshillon nëpunësit dhe punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës Financiare për veprimtaritë e saj, kur e vlerëson të nevojshme ose me kërkesë të nëpunësve apo punonjësve, pa penguar ose vonuar ushtrimin e këtyre veprimtarive;

b) nxit dhe mbikëqyr përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës Financiare me të drejtat themelore;

c) jep opinione këshillimore, jodetyruese, mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Agjencisë së Inteligjencës Financiare me të drejtat themelore;

d) informon drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë së Inteligjencës Financiare për çdo rrezik ose rast të mundshëm të shkeljes së të drejtave themelore gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

3. Përgjegjësi për të drejtat themelore ushtron funksionet e tij në mënyrë të pavarur dhe nuk merr udhëzime në lidhje me ushtrimin e këtyre funksioneve.

4. Mënyra e caktimit, statusi funksional, kriteret dhe procedurat e ushtrimit të kompetencave të përgjegjësit për të drejtat themelore përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit.

Neni 17

Aksesi në informacion

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare, pavarësisht nga forma e organizimit të saj, ka akses në informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të saj, duke përfshirë informacionin financiar, informacionin administrativ dhe informacionin që disponohet nga autoritetet kompetente dhe ato ligjzbatuese.

Agjencia e Inteligjencës Financiare ka akses, përfshirë, por pa u kufizuar në, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

a) akses të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë në informacionin financiar si më poshtë:

i. informacionin që administrohet në mekanizmat kombëtarë të automatizuar dhe të centralizuar të mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave financiare sipas përcaktimeve të ligjit në fuqi për regjistrin qendror të llogarive bankare;

ii. informacionin nga subjektet e detyruara, duke përfshirë informacionin mbi transfertat e fondeve, sipas përcaktimeve të nenit 150, pika 7, të këtij ligji dhe transfertat e krypto-aseteve, sipas përcaktimeve të nenit 150, pika 13, të këtij ligji;

iii. informacionin mbi huatë, kreditë, përfshirë kreditë hipotekare, si dhe informacionin mbi hipotekat e regjistruara që lidhen me to;

iv. informacionin që mbahet në bazat kombëtare të të dhënave për transaksionet valutore dhe të këmbimit valutor;

v. informacionin mbi titujt financiarë dhe transaksionet e lidhura me to;

b) akses të menjëhershëm dhe të drejtpërdrejtë në informacionin administrativ si më poshtë:

i. të dhëna fiskale, përfshirë të dhënat e administruara nga autoritetet tatimore dhe autoritetet e tjera përgjegjëse për administrimin e të ardhurave publike, si dhe të dhëna fiskale

të marra në kuadër të shkëmbimit automatik të informacionit për qëllime tatimore me autoritete homologe të huaja, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ii. informacionin mbi procedurat e prokurimit publik për mallra ose shërbime, si dhe mbi kontratat koncesionare ose format e tjera të partneritetit publik-privat, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi;

iii. informacionin nga BARIS, sipas përcaktimeve të ligjit në fuqi për regjistrin qendror të llogarive bankare, si dhe informacionin në regjistrat kombëtarë të pasurive të paluajtshme ose në sistemet elektronike të aksesit të të dhënave dhe regjistrat e tokës apo regjistrat kadastralë;

iv. informacionin në regjistrat kombëtarë të gjendjes civile, përfshirë regjistrat për shtetasit e huaj;

v. informacionin në regjistrat kombëtarë të pasaportave dhe vizave;

vi. informacionin në bazat e të dhënave për udhëtimet ndërkufitare, përfshirë hyrje-daljet në kufi;

vii. informacionin në bazat e të dhënave tregtare, përfshirë regjistrat e biznesit dhe të shoqërive tregtare, si dhe bazat e të dhënave për personat e ekspozuar politikisht;

viii. informacionin në regjistrat kombëtarë të mjeteve motorike, të mjeteve ajrore dhe të mjeteve lundruese;

ix. informacionin në regjistrat kombëtarë të sigurimeve shoqërore;

x. të dhëna doganore, përfshirë informacionin mbi transfertat ndërkufitare të mjeteve monetare;

xi. informacionin në regjistrat kombëtarë të armëve dhe municioneve;

xii. informacionin në regjistrin kombëtar të pronarëve përfitues;

xiii. të dhëna të disponueshme përmes mekanizmave të ndërlidhjes së regjistrave qendrorë kombëtarë të vendeve anëtare, në përputhje me përcaktimet e ligjit në fuqi për regjistrin e pronarëve përfitues;

xiv. informacionin në regjistrat e organizatave jofitimprurëse;

xv. informacionin e mbajtur nga mbikëqyrësit financiarë dhe rregullatorët financiarë, në përputhje me nenin 74 dhe nenin 80, pika 2, të këtij ligji;

xvi. informacionin në bazat e të dhënave që ruajnë të dhëna për tregtimin e emetimeve të dioksidit të karbonit (CO₂), të krijuara dhe të administruara sipas legjislacionit në fuqi;

xvii. informacion mbi pasqyrat financiare vjetore të shoqërive tregtare;

xviii. informacionin në regjistrat kombëtarë të migracionit dhe imigracionit;

xix. informacionin e disponuar nga gjykatat kompetente për çështjet tregtare dhe ekonomike;

xx. informacionin në regjistrat dhe bazat e të dhënave për procedurat e falimentimit, si dhe informacionin e mbajtur nga administratori i falimentit sipas legjislacionit në fuqi për falimentimin;

xxi. informacionin mbi fondet dhe pasuritë e tjera të ngrira ose të bllokuara në zbatim të masave shtrënguese financiare.

c) akses të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në regjistrat dhe informacionin e mbajtur nga autoritetet ligjzbatuese, si më poshtë:

i. çdo lloj informacioni ose të dhënash që mbahen nga autoritetet kompetente në kuadër të parandalimit, zbulimit, hetimit ose ndjekjes penale të veprave penale;

ii. çdo lloj informacioni ose të dhënash që mbahen nga autoritetet publike ose nga subjektet private në kuadër të parandalimit, zbulimit, hetimit ose ndjekjes penale të veprave penale dhe që janë në dispozicion të autoriteteve kompetente pa qenë e nevojshme kryerja e veprimeve procedurale ose hetimore me karakter shtrëngues, sipas legjislacionit procedural penal në fuqi. Për qëllime të kësaj pike, “masa me karakter shtrëngues” janë veprimet procedurale ose hetimore që kërkojnë autorizim gjyqësor apo të prokurorisë, sipas legjislacionit procedural penal në fuqi.

Informacioni i parashikuar, në pikën 1, germa “c”, të këtij neni duhet të përfshijë të dhëna nga regjistrat penalë, informacion mbi hetimet dhe procedimet penale, informacion mbi masat e bllokimit ose sekuestrimit të pasurive, informacion mbi masa të tjera hetimore ose masa të përkohshme procedurale dhe informacion mbi vendimet penale mbi dënimet dhe konfiskimet.

Autoritetet kompetente mund të kufizojnë, rast pas rasti, aksesin e Agjencisë së Inteligjencës Financiare sipas përcaktimeve të pikës 1, germës “c”, të këtij neni, kur vënia në dispozicion e këtij informacioni rrezikon të cenohet zhvillimin e një hetimi penal në proces.

2. Aksesin në informacionin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni është i drejtpërdrejtë, i menjëhershëm dhe pa pagesë, kur informacioni mbahet në një bazë të dhënash TIK, regjistër ose sistem të marrjes së të dhënave, nga i cili Agjencia e Inteligjencës Financiare mund ta marrë informacionin pa ndonjë hap të ndërmjetëm, ose kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) subjektet ose autoritetet që mbajnë informacionin ia vënë në dispozicion menjëherë Agjencisë së Inteligjencës Financiare; dhe

b) asnjë autoritet, subjekt ose palë e tretë nuk është në gjendje të ndërhyjë në të dhënat e kërkuara ose informacionin që do të ofrohet.

3. Autoritetet publike sigurojnë që, sa herë që është e mundur, Agjencisë së Inteligjencës Financiare i garantohet akses i drejtpërdrejtë dhe pa pagesë në informacionin e parashikuar në pikën 1, germën “c”, të këtij neni.

Në rastet kur Agjencisë së Inteligjencës Financiare i jepet akses i tërthortë në këtë informacion, autoriteti ose subjekti që mban informacionin e kërkuar duhet ta vërë në dispozicion atë në kohën e duhur dhe pa vonesë të pajustificuar.

4. Agjencia e Inteligjencës Financiare, në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve të saj në përputhje me këtë ligj, ka të drejtë të kërkojë, të marrë dhe të përdorë informacionin nga çdo subjekt i detyruar, me qëllim përmbushjen e detyrave të saj ligjore sipas përcaktimeve të nenit 14, pikave 6 dhe 7, të këtij ligji, edhe nëse nuk është paraqitur asnjë raportim në përputhje me nenin 132, pika 1, germa “a” ose nenin 133, pika 1, të këtij ligji.

Subjektet e detyruara u përgjigjen kërkesave të Agjencisë së Inteligjencës Financiare pa vonesë dhe, në çdo rast, brenda 10 ditëve kalendarike, përveç rasteve urgjente kur kërkohet përgjigje brenda një afati më të shkurtër.

Subjektet e detyruara nuk janë të detyruara të përmbushin kërkesat për informacion në përputhje me këtë pikë, kur ato kanë të bëjnë me informacion të marrë në situatat e përmendura në nenin 133, pika 2, të këtij ligji.

5. Në rastet kur ofrimi i informacionit sigurohet nëpërmjet një sistemi qendror, pike qendrore kontakti ose mekanizmi të përqendruar, ky mekanizëm lejohet vetëm kur garanton dhënien e informacionit në mënyrë të plotë, të pafiltruar, prioritare, të sigurt dhe pa vonesa të pajustificuara. Kur ky mekanizëm nuk i garanton këto kushte, ose kur Agjencia e Inteligjencës Financiare e vlerëson se është i nevojshëm kontroll i plotë, krahasim i të dhënave ose verifikim

në burimin parësor të të dhënave, autoriteti, institucioni ose subjekti që administron informacionin i jep agjencisë akses të drejtpërdrejtë dhe pa pagesë në bazën e të dhënave, regjistrin ose sistemin përkatës, sipas nevojave dhe kërkesave të saj.

Kur për dhënien e aksesit të drejtpërdrejtë kërkohet konfigurim teknik ose autorizim administrativ, ai përfundon pa vonesë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë pune nga paraqitja e kërkesës së Agjencisë së Inteligjencës Financiare. Në raste urgjente, kur informacioni lidhet me një analizë financiare në vijim, bllokim ose mosdhënie të pëlqimit për transaksion, rrezik të zhdukjes së fondeve, rrezik të cenimit të analizës ose kërkesë të njëjësive homologe të inteligjencës financiare, informacioni ose aksesit jepet pa pagesë dhe jo më vonë se 24 orë nga paraqitja e kërkesës.

6. Për zbatimin e këtij neni, Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet publike dhe subjektet përgjegjëse që disponojnë informacionin përkatës, me qëllim përcaktimin e modaliteteve teknike dhe procedurale të dhënies së aksesit, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 18

Detyrimi për dhënien e informacionit autoritetit përgjegjës

1. Subjektet e detyruara, autoritetet publike, personat juridikë publikë ose privatë dhe çdo person tjetër që mban ose administron informacion të nevojshëm për Agjencinë e Inteligjencës Financiare nuk mund të refuzojnë dhënien e informacionit, aksesin ose dokumentacionin e kërkuar, duke u mbështetur në sekretin profesional, bankar, tregtar, tatimor, administrativ ose në detyrime të tjera të konfidencialitetit, përveç rasteve kur kufizimi parashikohet shprehimisht me ligj, përfshirë privilegjin ligjor dhe përjashtimet e parashikuara në nenin 133 të këtij ligji.

2. Subjektet e detyruara, autoritetet publike, personat juridikë publikë ose privatë dhe çdo person tjetër i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni janë të detyruar t'u përgjigjen kërkesave për informacion të Agjencisë së Inteligjencës Financiare dhe të vënë në dispozicion të saj të dhënat, informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar, pa vonesë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga marrja e kërkesës.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare, në raste urgjente, mund të kërkojë informacion, të dhëna dhe dokumentacion të nevojshëm edhe brenda një afati më të shkurtër sesa ai i parashikuar në pikën 2 të këtij neni, dhe subjektet e detyruara, autoritetet publike apo çdo person tjetër janë të detyruar t'i japin këto të dhëna, informacion dhe dokumentacion.

Neni 19

Raportimi i autoriteteve doganore

1. Autoritetet doganore i raportojnë Agjencisë së Inteligjencës Financiare menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 72 orë nga konstatimi, çdo dyshim, informacion ose të dhënë që ka lidhje me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit ose financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, në lidhje me veprimtaritë nën juridiksionin e tyre dhe në përputhje me përcaktimet e Pjesës IV të këtij ligji.

2. Autoritetet doganore zbatojnë kërkesat e përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat, lidhur me zbatimin e pikës 1 të këtij neni.

Neni 20

Raportimi i organeve tatimore

1. Organet tatimore i raportojnë Agjencisë së Inteligjencës Financiare menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 72 orë nga regjistrimi i veprimit, çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë që ka të bëjë me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit ose financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, në lidhje me veprimtaritë nën juridiksionin e tyre.

2. Organet tatimore zbatojnë kërkesat e përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat, lidhur me zbatimin e pikës 1 të këtij neni.

Neni 21

Raportimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

1. Agjencia Shtetërore e Kadastrës i raporton Agjencisë së Inteligjencës Financiare, brenda 72 orëve nga regjistrimi, çdo kontratë tjetërsimi të pronës me vlerë të barabartë ose më të madhe se 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë, ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja.

2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës i raporton Agjencisë së Inteligjencës Financiare menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 72 orë nga konstatimi, çdo dyshim, informacion ose të dhënë që ka lidhje me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit ose financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, në lidhje me veprimtaritë nën juridiksionin e saj.

3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës zbaton kërkesat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, lidhur me zbatimin e pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 22

Detyrimi për raportim pranë autoritetit përgjegjës

1. Subjektet e detyruara duhet të raportojnë pranë autoritetit përgjegjës, menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë, në përputhje me përcaktimet e nenit 132 të këtij ligji, rastet për të cilat kanë dijeni, dyshojnë ose kanë baza të arsyeshme për të dyshuar se po kryhet, është kryer ose tentohet të kryhet pastrimi i parave dhe veprat penale të lidhura me të, financimi i terrorizmit ose se fondet apo aktivitetet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale.

2. Subjektet e detyruara duhet të raportojnë pranë autoritetit përgjegjës, brenda ditës pasardhëse të punës, të gjitha transaksionet për mallrat me vlerë të lartë, sipas pragjeve të përcaktuara në nenin 137 të këtij ligji, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën. Nga ky detyrim përjashtohen transaksionet që kryhen nga organet apo institucionet publike.

3. Subjektet e detyruara duhet të raportojnë pranë autoritetit përgjegjës, brenda ditës pasardhëse të punës, në përputhje me përcaktimet e nenit 143, pika 4, të këtij ligji, të gjitha transaksionet në para fizike për mallra ose shërbime, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën. Nga ky detyrim përjashtohen transaksionet që kryhen nga organet apo institucionet publike.

4. Mënyra e raportimit nga subjektet e detyruara, si për dërgimin, ashtu edhe për marrjen e informacionit, përcaktohet sipas standardeve teknike të kërkuara nga autoriteti përgjegjës.

5. Ministri përgjegjës për financat, me propozim të autoritetit përgjegjës, nxjerr rregulla të hollësishme për mënyrën dhe procedurat e raportimit nga subjektet e detyruara, sipas përcaktimeve të këtij neni.

Neni 23

Përdorimi i të dhënave

Çdo informacion ose e dhënë e dërguar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare organeve të zbatimit të ligjit i nënshtrohet legjislacionit për informacionin e klasifikuar dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale, Kodit të Procedurës Civile ose legjislacionit procedural administrativ.

Neni 24

Përgjigjja ndaj kërkesave për informacion

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare i përgjigjet, brenda një afati të arsyeshëm, por jo më vonë se 15 ditë pune, kërkesave të arsyetuara për informacion të paraqitura nga autoritetet kompetente të përcaktuara në nenin 85, pika 1, germa “c” dhe “d”, të bazuara në dyshime që lidhen me pastrimin e parave dhe veprat penale të lidhura me të, financimin e terrorizmit apo financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, kur informacioni i kërkuar disponohet tashmë nga Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe është i nevojshëm rast pas rasti.

Vendimi për dhënien ose shpërndarjen e informacionit mbetet në kompetencën e Agjencisë së Inteligjencës Financiare.

Kur nga rrethanat objektive rezulton se dhënia e informacionit të kërkuar do të kishte ndikim negativ në hetimet ose analizat në vijim ose, në rrethana të jashtëzakonshme, kur dhënia e këtij informacioni do të ishte qartazi joproporcionale në raport me interesat legjitime të një personi fizik ose juridik, ose e parëndësishme për qëllimin për të cilin është kërkuar, Agjencia e Inteligjencës Financiare nuk është e detyruar t’i përgjigjet kërkesës për informacion. Në këto raste, Agjencia e Inteligjencës Financiare është e detyruar ta njoftojë me shkrim autoritetin kërkuar për arsyet e refuzimit të dhënies së informacionit.

2. Autoritetet kompetente informojnë Agjencinë e Inteligjencës Financiare për përdorimin dhe dobishmërinë e informacionit të vënë në dispozicion sipas këtij neni dhe nenit 14, pika 6, të këtij ligji, si dhe për rezultatet e veprimeve dhe të hetimeve të kryera mbi bazën e këtij informacioni.

Ky informacion jepet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe, në çdo rast, në formë të përmbledhur, të paktën një herë në vit, në mënyrë që t’i mundësojë Agjencisë së Inteligjencës Financiare përmirësimin e funksionit të saj të analizës operative.

Neni 25

Dhënia e informacionit për mbikëqyrësit

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare i jep mbikëqyrësve, në mënyrë spontane ose me kërkesë, informacione që mund të jenë të rëndësishme për ushtrimin e funksioneve të tyre mbikëqyrëse në përputhje me Kreun III të Pjesës I të këtij ligji, duke përfshirë të paktën:

a) cilësinë dhe sasinë e raporteve të aktiviteteve apo transaksioneve të dyshimta të

dërguara nga subjektet e detyruara;

b) cilësinë dhe respektimin e afateve të përgjigjeve të dhëna nga subjektet e detyruara ndaj kërkesave të Agjencisë së Inteligjencës Financiare në përputhje me nenin 132, pika 1, germa “b”, të këtij ligji;

c) rezultatet e analizave strategjike të kryera në përputhje me nenin 14, pika 7, germa “b”, të këtij ligji, si dhe çdo informacion të rëndësishëm mbi tendencat dhe metodat e pastrimit të parave, të veprave penale të lidhura me të, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, duke përfshirë rreziqet gjeografike, ndërkufitare dhe ato në zhvillim.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare duhet të njoftojë mbikëqyrësit sa herë që informacioni në dispozicion të saj tregon për shkelje të mundshme të detyrimeve nga subjektet e detyruara, të përcaktuara në Pjesën II dhe Pjesën III të këtij ligji.

3. Me përjashtim të rasteve kur kjo është absolutisht e nevojshme për qëllimet e pikës 2 të këtij neni, informacioni i vënë në dispozicion nga Agjencia e Inteligjencës Financiare sipas këtij neni nuk përmban të dhëna mbi persona të caktuar fizikë ose juridikë, as të dhëna mbi raste konkrete që përfshijnë persona fizikë ose juridikë që janë objekt i një analize ose i një hetimi penal në vijim, ose që mund të çojnë në identifikimin e tyre.

Neni 26

Bllokimi ose mosdhënia e pëlqimit

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare ka kompetencë të marrë masa urgjente, drejtpërdrejt ose tërthorazi, kur ekziston dyshimi se një transaksion lidhet me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, për të bllokuar transaksionin ose për të mos dhënë pëlqimin për kryerjen e tij.

Në rastet kur nevoja për të bllokuar ose për të mos dhënë pëlqimin për kryerjen e një transaksioni përcaktohet në bazë të një dyshimi të raportuar në përputhje me nenin 132 të këtij ligji, bllokimi ose mosdhënia e pëlqimit vendoset ndaj subjektit të detyruar brenda periudhës së përmendur në nenin 134 të këtij ligji.

Kur nevoja për të bllokuar një transaksion bazohet në punën analitike të Agjencisë së Inteligjencës Financiare, pavarësisht nëse është paraqitur një raportim paraprak nga subjekti i detyruar, bllokimi vendoset sa më shpejt të jetë e mundur nga Agjencia e Inteligjencës Financiare.

Bllokimi ose mosdhënia e pëlqimit për kryerjen e një transaksioni vendoset nga Agjencia e Inteligjencës Financiare me qëllim ruajtjen e fondeve, kryerjen e analizave të saj, duke përfshirë analizën e transaksionit, vlerësimin nëse dyshimi është konfirmuar dhe, nëse po, shpërndarjen e rezultateve të analizave të autoritetet kompetente përkatëse për të lejuar miratimin e masave të përshtatshme.

Periudha e bllokimit ose e mosdhënies së pëlqimit për kryerjen e transaksionit, në funksion të punës analitike të Agjencisë së Inteligjencës Financiare, nuk duhet të kalojë 10 ditë pune. Agjencia e Inteligjencës Financiare është e autorizuar të heqë në çdo kohë bllokimin ose mosdhënien e pëlqimit për kryerjen e një transaksioni, kur konstaton se kjo masë nuk është më e nevojshme për arritjen e qëllimeve të parashikuara në këtë pikë të këtij neni.

Agjencia e Inteligjencës Financiare ka kompetencë të bllokojë ose të mos japë pëlqimin për kryerjen e një transaksioni, sipas këtij neni, me kërkesë të një njësie homologe të

inteligjencës financiare të një shteti anëtar apo të një vendi të tretë.

2. Kur ekziston dyshimi se një llogari bankare ose llogari pagese, një llogari kriptosetesh ose një marrëdhënie biznesi lidhet me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, Agjencia e Inteligjencës Financiare ka kompetencë të marrë masa urgjente, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për të bllokuar përdorimin e kësaj llogarie ose për të bllokuar marrëdhënien e biznesit, me qëllim ruajtjen e fondeve, kryerjen e analizave financiare, vlerësimin nëse dyshimi është konfirmuar dhe, në rast konfirmimi, shpërndarjen e rezultateve të analizave të autoritetet kompetente përkatëse, me qëllim marrjen e masave të përshtatshme.

Periodha e bllokimit të përdorimit të një llogarie apo të një marrëdhënieje biznesi, sipas kësaj pike, në funksion të punës analitike të Agjencisë së Inteligjencës Financiare, nuk duhet të kalojë 5 ditë pune.

Agjencia e Inteligjencës Financiare është e autorizuar të heqë në çdo kohë bllokimin, kur konstaton se kjo masë nuk është më e nevojshme për arritjen e qëllimeve të parashikuara në këtë pikë të këtij neni.

Agjencia e Inteligjencës Financiare ka kompetencë të bllokojë përdorimin e një llogarie ose të bllokojë një marrëdhënie biznesi, sipas kësaj pike, me kërkesë të një njësie homologe të inteligjencës financiare të një shteti anëtar apo të një vendi të tretë.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare, në funksion të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, në rastet kur vëren elemente të veprës penale, dërgon informacion në prokurori, së bashku me një kopje të urdhrin për bllokimin e përkohshëm ose për mosdhënien e pëlqimit për kryerjen e transaksionit dhe dokumentacionin përkatës.

Nga momenti i marrjes së informacionit, urdhrin dhe dokumentacionit përkatës nga prokuroria, masa e vendosur nga Agjencia e Inteligjencës Financiare vijon të prodhojë efekte për një periudhë jo më të gjatë se 72 orë. Në mungesë të një vendimi për sekuestrim ose të një mase tjetër kufizuese të vendosur nga prokuroria ose gjykata kompetente, brenda këtij afati, urdhri i Agjencisë së Inteligjencës Financiare pushon së prodhuari efekte juridike.

Afati 72-orësh i parashikuar në këtë pikë zbatohet vetëm pas dërgimit të informacionit, urdhrin dhe dokumentacionit përkatës në prokurori dhe nuk cenon kompetencën e Agjencisë së Inteligjencës Financiare për vendosjen dhe heqjen e masave, për qëllime të punës së saj analitike, brenda afateve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Vendosja e bllokimit ose mosdhënia e pëlqimit për kryerjen e transaksionit sipas këtij neni nuk ngarkon me asnjë lloj përgjegjësie civile, administrative apo penale Agjencinë e Inteligjencës Financiare, drejtorët, nëpunësit apo punonjësit e saj.

Neni 27

Monitorimi i transaksioneve apo veprimtarive

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare urdhëron subjektet e detyruara që, për një periudhë kohore të përcaktuar prej saj, të monitorojnë transaksionet apo veprimtaritë që kryhen nëpërmjet një ose më shumë llogarive bankare, llogarive të pagesave, llogarive të kriptoseteshve ose marrëdhënieve të tjera të biznesit të administruara prej tyre, për persona që paraqesin rrezik të konsiderueshëm për pastrimin e parave, veprat penale të lidhura me të, financimin e terrorizmit apo financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare urdhëron subjektet e detyruara të raportojnë rezultatet e monitorimit të kryer, sipas pikës 1 të këtij neni, brenda afateve dhe sipas

periodicitetit të përcaktuar prej saj.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare urdhëron masa monitorimi sipas këtij neni edhe me kërkesë të një njësie homologe të inteligjencës financiare të një shteti anëtar apo të një vendi të tretë.

Neni 28

Njoftimi i subjekteve të detyruara për rreziqet

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare ka kompetencë të njoftojë subjektet e detyruara për informacionin që është i rëndësishëm për përmbushjen e detyrimeve ligjore për zbatimin e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit, sipas Kreut III të Pjesës II të këtij ligji.

Ky informacion përfshin:

a) llojet e transaksioneve ose veprimtarive që paraqesin rrezik të konsiderueshëm për pastrimin e parave, veprat penale të lidhura me të, financimin e terrorizmit apo financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë;

b) personat e caktuar që paraqesin rrezik të konsiderueshëm për pastrimin e parave, veprat penale të lidhura me të, financimin e terrorizmit apo financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë;

c) zonat specifike gjeografike që paraqesin rrezik të konsiderueshëm për pastrimin e parave, veprat penale të lidhura me të, financimin e terrorizmit apo financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

2. Njoftimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni është i vlefshëm për një periudhë të përcaktuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare, në përputhje me përcaktimet e dhëna në këtë ligj, e cila nuk mund të tejkalojë 6 muaj.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare i vë në dispozicion subjekteve të detyruara, të paktën një herë në vit, informacion apo analiza strategjike mbi tipologjitë, treguesit e rrezikut dhe tendencat në fushën e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

Neni 29

Raporti vjetor

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare publikon, jo më vonë se data 30 qershor e çdo viti, raportin vjetor për vitin pararendës mbi veprimtarinë e saj.

Raporti vjetor, ndër të tjera, duhet të përmbajë të dhëna statistikore për:

a) ndjekjen dhe trajtimin nga Agjencia e Inteligjencës Financiare të raporteve për transaksione dhe veprimtari të dyshimta të raportuara sipas këtij ligji;

b) raportet për transaksionet dhe veprimtaritë e dyshimta të raportuara nga subjektet e detyruara;

c) njoftimet ose informacionet e dërguara nga autoritetet mbikëqyrëse, si dhe informacionin e siguruar nga regjistrat qendrorë;

d) rastet e dërguara pranë autoriteteve kompetente dhe ndjekjen e mëtejshme të tyre;

e) kërkesat e paraqitura pranë dhe të marra nga njësitë homologe të inteligjencës financiare;

f) kërkesat e paraqitura pranë dhe të marra nga autoritetet kompetente të përcaktuara në

nenin 85, pika 1, germa “c”, të këtij ligji;

g) burimet njerëzore të vëna në dispozicion;

h) të dhënat mbi kalimet ndërkufitare të mjeteve monetare, të transmetuara nga autoritetet doganore sipas Pjesës IV të këtij ligji.

2. Raporti vjetor përmban informacion edhe mbi tendencat dhe tipologjitë e identifikuar në rastet për të cilat është dërguar informacion pranë autoriteteve të tjera kompetente.

Informacioni i përfshirë në raport nuk duhet të lejojë identifikimin e asnjë personi fizik apo juridik.

Neni 30

Vlerësimi i cilësisë së raportimeve

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare siguron vlerësimin e cilësisë së raportimeve të paraqitura nga subjektet e detyruara në lidhje me raportimet e dyshimeve sipas përcaktimeve në nenin 132 të këtij ligji. Ky vlerësim përfshin, të paktën, respektimin e afateve të raportimit, përshkrimin e dyshimit dhe dokumentacionin e paraqitur në momentin e raportimit.

2. Vlerësimi i cilësisë së raportimeve sipas këtij neni nuk nënkupton vlerësimin e çdo raporti individual të paraqitur nga subjektet e detyruara.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare komunikon vlerësimin e cilësisë së raportimeve, të paktën një herë në vit, subjekteve të detyruara individualisht ose grupeve apo kategorive të subjekteve të detyruara, duke marrë në konsideratë numrin e përgjithshëm të raporteve për transaksione të dyshimta të paraqitura nga subjektet e detyruara.

4. Vlerësimi i cilësisë së raportimeve vihet gjithashtu në dispozicion të autoriteteve mbikëqyrëse, për t'u mundësuar atyre ushtrimin e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik në përputhje me nenin 48 të këtij ligji.

5. Agjencia e Inteligjencës Financiare raporton çdo vit pranë AMLA-s, sipas përcaktimeve të lejuara nga ky ligj, mbi vlerësimin e cilësisë së raportimeve nga subjektet e detyruara në përputhje me këtë nen, dhe ofron statistika mbi numrin e raportimeve të transaksioneve të dyshimta të paraqitura nga kategoritë e subjekteve të detyruara.

6. Vlerësimi i cilësisë së raportimeve nuk duhet të cenojë punën analitike të vazhdueshme të kryer nga Agjencia e Inteligjencës Financiare, as hetimet apo veprimet administrative që pasojnë dërgimin e informacionit, si dhe nuk ndikon në zbatimin e kërkesave për mbrojtjen e të dhënave dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

7. Agjencia e Inteligjencës Financiare siguron dhënien e vlerësimit, të paktën një herë në vit, autoriteteve doganore, mbi efektivitetin dhe ndjekjen e mëtejshme të raportimeve të dërguara, në përputhje me nenin 192 të Pjesës IV të këtij ligji.

Neni 31

Funksionet mbikëqyrëse të Agjencisë së Inteligjencës Financiare

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare, në përputhje me përcaktimet e Kreut III të Pjesës I të këtij ligji, kryen inspektime në vend ose në distancë ndaj subjekteve të detyruara, në masën e nevojshme për verifikimin e përmbushjes së detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, që lidhen me:

- a) raportimin e transaksioneve ose aktiviteve të dyshimta;
- b) raportimin e transaksioneve në para fizike, si dhe të transaksioneve sipas pragjeve të raportimit të përcaktuara në këtë ligj;
- c) dhënien e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar nga Agjencia e Inteligjencës Financiare;
- d) zbatimin e urdhrave të Agjencisë së Inteligjencës Financiare për bllokim, mosdhënie pëlqimi ose monitorim;
- e) cilësinë e raportimeve, si dhe funksionimin e mekanizmave të brendshëm për identifikimin dhe raportimin e dyshimeve.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare ushtron funksionet mbikëqyrëse edhe ndaj subjekteve të detyruara për të cilat nuk është përcaktuar një autoritet tjetër mbikëqyrës sipas këtij ligji.

3. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni dhe në përmbushje të përcaktimeve të Kreut III të Pjesës I të këtij ligji, Agjencia e Inteligjencës Financiare ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë dokumente, regjistra, të dhëna elektronike, dosje klientësh, të dhëna për transaksionet, sinjalizime, analiza të brendshme, vendimmarrje për mosraportim, shpjegime me shkrim dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për objektin e inspektimit, si dhe të marrë kopje fizike ose elektronike të tyre.

4. Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të kryejë inspektime vetëm ose në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës përkatës. Kur gjatë inspektimit konstatohen shkelje që janë në kompetencën e autoritetit mbikëqyrës përkatës, Agjencia e Inteligjencës Financiare ia përcjell gjetjet këtij autoriteti për veprimet e mëtejshme.

5. Subjekti i detyruar është i detyruar të bashkëpunojë me Agjencinë e Inteligjencës Financiare, të mos pengojë ushtrimin e kontrollit ose kryerjen e inspektimit, të ruajë të dhënat dhe të mos njoftojë klientin ose palët e treta për veprimet e Agjencisë së Inteligjencës Financiare, përveç rasteve kur kjo lejohet shprehimisht me ligj.

6. Kur shkeljet lidhen me mosraportimin e transaksioneve ose aktiviteve të dyshimta, mosdhënien e informacionit, pengimin e aksesit, moszbatimin e urdhrave të Agjencisë së Inteligjencës Financiare ose mospërmbushjen e detyrimeve që cenojnë drejtpërdrejt funksionet e saj, Agjencia e Inteligjencës Financiare vendos masat administrative dhe gjokat sipas këtij ligji.

7. Në rastet kur Agjencia e Inteligjencës Financiare konstaton se një subjekt i detyruar ose një subjekt tjetër i licencuar, i autorizuar apo i regjistruar ka kryer shkelje të rënda ose të përsëritura të detyrimeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit ose financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, ose ka penguar ushtrimin e kompetencave të Agjencisë së Inteligjencës Financiare, kjo e fundit mund t'i kërkojë autoritetit mbikëqyrës ose licencues marrjen e masave përkatëse, përfshirë pezullimin, kufizimin ose revokimin e licencës, autorizimit ose regjistrimit, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin sektorial në fuqi.

8. Autoriteti mbikëqyrës ose licencues shqyrton kërkesën e Agjencisë së Inteligjencës Financiare dhe e njofton atë me shkrim për masat e marra ose arsyet e mosmarrjes së tyre brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.

9. Ushtrimi i kompetencave të Agjencisë së Inteligjencës Financiare sipas këtij neni nuk cenon kompetencat mbikëqyrëse të autoriteteve sektoriale të përcaktuara në këtë ligj.

10. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, miraton me vendim, procedurat për konstatimin dhe shqyrtimin e shkeljeve, si dhe për propozimin dhe vendosjen e masave administrative dhe të gjobave nga Agjencia e Inteligjencës Financiare.

Neni 32

Bashkëpunimi ndërmjet njësive të inteligjencës financiare

Agjencia e Inteligjencës Financiare bashkëpunon, në masën më të madhe të mundshme, me njësitë e inteligjencës financiare të shteteve anëtare dhe të vendeve të treta, pavarësisht nga forma e tyre e organizimit.

Neni 33

Kanale të sigurta komunikimi

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare përdor kanale të sigurta dhe të mbrojtura komunikimi për shkëmbimin e informacionit me njësitë homologe të inteligjencës financiare të shteteve anëtare dhe vendeve të treta. Këto kanale sigurojnë mbrojtjen e informacionit gjatë komunikimit dhe shkëmbimit të tij, si dhe mundësojnë mbajtjen e regjistrimeve të veprimeve të përpunimit të informacionit.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare ndërmerr të gjitha masat e nevojshme ligjore, organizative dhe teknike për t'u lidhur dhe për të përdorur sistemin FIU.net, që administrohet nga AMLA, në shkëmbimin e informacionit me njësitë homologe të inteligjencës financiare të shteteve anëtare, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të përdorë FIU.net për komunikimin me njësitë homologe të inteligjencës financiare të vendeve të treta, me autoritetet e tjera dhe me organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Evropian.

Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të përdorë FIU.net për shkëmbimin e informacionit me AMLA-n për qëllime të kryerjes së analizave të përbashkëta, në përputhje me nenin 35 të këtij ligji dhe në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare shkëmben informacion në përputhje me nenet 34 dhe 35 të këtij ligji duke përdorur FIU.net. Në rast të pamundësisë teknike për përdorimin e FIU.net, informacioni duhet të transmetohet me çdo mjet tjetër të përshtatshëm që garanton një nivel të lartë të sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

4. Agjencia e Inteligjencës Financiare shkëmben informacion me njësitë homologe të inteligjencës financiare të vendeve të treta që nuk janë të lidhura me FIU.net përmes kanaleve të sigurta dhe të mbrojtura të komunikimit.

5. Agjencia e Inteligjencës Financiare, në përmbushje të funksioneve të saj, bashkëpunon në masën më të madhe të mundshme me njësitë homologe të inteligjencës financiare për përdorimin e teknologjive më të fundit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Agjencia e Inteligjencës Financiare bashkëpunon në masën më të madhe të mundshme në zbatimin e zgjidhjeve të zhvilluara dhe të administruara nga AMLA, në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

6. Agjencia e Inteligjencës Financiare siguron përdorimin e funksionaliteteve teknike të FIU.net që mundësojnë krahasimin e automatizuar, mbi bazë përputhjeje ose mospërputhjeje, të të dhënave të vëna në dispozicion në FIU.net nga Agjencia e Inteligjencës

Financiare me të dhënat e vëna në dispozicion në atë sistem nga njësitë e tjera homologe të inteligjencës financiare dhe nga organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Evropian për aq sa një përputhje e tillë bie brenda mandateve përkatëse të atyre organeve, zyrave dhe agjencive të Bashkimit Evropian.

7. Agjencia e Inteligjencës Financiare merr masat e nevojshme për të garantuar sigurinë, konfidencialitetin dhe integritetin e informacionit të shkëmbyer përmes kanaleve të komunikimit. Kur ekzistojnë rreziqe që mund të cenojnë shkëmbimin e sigurt dhe të mbrojtur të informacionit, përfshirë rastet kur ka shqetësime lidhur me pavarësinë dhe autonominë e një njësie homologe të inteligjencës financiare, Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të kufizojë ose pezullojë shkëmbimin e informacionit.

Neni 34

Shkëmbimi i informacionit midis njësive të inteligjencës financiare

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare shkëmben, spontanisht ose me kërkesë, çdo informacion që mund të jetë i rëndësishëm për përpunimin ose analizimin e informacionit nga njësitë e inteligjencës financiare në lidhje me pastrimin e parave, veprave penale të lidhura me të ose financimin e terrorizmit, dhe për personin fizik ose juridik të përfshirë, pavarësisht nga lloji i veprës penale bazë që mund të përfshihet, edhe në rastet kur lloji i veprave penale bazë nuk identifikohet në kohën e shkëmbimit të informacionit.

Kërkesa për shkëmbim informacioni duhet të përmbajë faktet përkatëse, informacionin për rastin, arsyet e paraqitjes së kërkesës, lidhjen me shtetin e njësisë së inteligjencës financiare të cilës i drejtohet kërkesa, si dhe mënyrën se si do të përdoret informacioni i kërkuar.

Kur Agjencia e Inteligjencës Financiare merr një raportim të aktivitetit të dyshimtë, në përputhje me nenin 132, pika 1, germa “a” të këtij ligji, që lidhet me një shtet anëtar, ajo i përcjell pa vonesë, raportimin ose të gjithë informacionin përkatës të nxjerrë prej tij, njësisë homologe të inteligjencës financiare të shtetit anëtar.

2. Kur Agjencia e Inteligjencës Financiare i përgjigjet një kërkesë për informacion të paraqitur nga një njësi homologe e inteligjencës financiare, ajo përdor të gjithë gamën e kompetencave dhe mjeteve që ka në dispozicion dhe që do t'i përdorte zakonisht edhe në rastet e trajtimit të çështjeve në nivel kombëtar, për marrjen dhe analizimin e informacionit.

Kur Agjencia e Inteligjencës Financiare kërkon të marrë informacion shtesë nga një subjekt i detyruar që ka të vendosur veprimtarinë në një shtet anëtar, por që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë, kërkesa i drejtohet njësisë së inteligjencës financiare të shtetit anëtar në territorin e të cilit subjekti i detyruar ka të vendosur veprimtarinë. Kjo njësi duhet të marrë informacionin përkatës në përputhje me nenin 132, pikat 1 dhe 2 dhe ia përcjell pa vonesë Agjencisë së Inteligjencës Financiare informacionin e marrë.

3. Në rastet kur kërkohet dhënia e informacionit në përputhje me pikën 1 të këtij neni, Agjencia e Inteligjencës Financiare i përgjigjet kërkesës sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast, jo më vonë se 5 ditë pune nga marrja e kërkesës, nëse informacioni i kërkuar ndodhet në posedim të saj ose është i disponueshëm në një bazë të dhënash apo regjistër në të cilin Agjencia e Inteligjencës Financiare ka akses të drejtpërdrejtë.

Në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, ky afat mund të zgjatet deri në 10 ditë pune.

Kur Agjencia e Inteligjencës Financiare nuk është në gjendje të japë informacionin e

kërkuar, ajo njofton pa vonesë njësinë homologe të inteligjencës financiare që ka paraqitur kërkesën.

4. Në raste të jashtëzakonshme, të justifikuara dhe urgjente, dhe në përjashtim nga pika 3 e këtij neni, kur, sipas pikës 1 të këtij neni, Agjencisë së Inteligjencës Financiare i kërkohet të japë informacion që ndodhet në posedim të saj ose është i disponueshëm në një bazë të dhënash apo regjistër në të cilin ajo ka akses të drejtpërdrejtë, informacioni i kërkuar jepet jo më vonë se 1 ditë pune pas marrjes së kërkesës.

Kur Agjencia e Inteligjencës Financiare nuk është në gjendje t'i përgjigjet kërkesës brenda afatit prej 1 dite pune ose nuk ka akses të drejtpërdrejtë në informacionin e kërkuar, ajo njofton njësinë kërkuuese dhe jep arsyet përkatëse.

Kur dhënia e informacionit të kërkuar brenda afatit prej 1 dite pune do të përbënte një barrë jo proporcionale për Agjencinë e Inteligjencës Financiare, ajo mund të shtyjë dhënien e informacionit. Në këtë rast, Agjencia e Inteligjencës Financiare njofton menjëherë njësinë e inteligjencës financiare që ka paraqitur kërkesën dhe arsyeton shtyrjen e afatit.

Në këto raste, afati për dhënien e përgjigjes mund të zgjatet deri në maksimum 3 ditë pune.

5. Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të refuzojë shkëmbimin e informacionit vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, kur shkëmbimi do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të rendit juridik kombëtar.

Këto rrethana të jashtëzakonshme përcaktohen në mënyrë të tillë që të shmanget keqpërdorimi i tyre dhe kufizimi i pajustificuar i shkëmbimit të informacionit për qëllime analitike.

6. Afatet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni gjejnë zbatim vetëm për njësitë homologe të inteligjencës financiare të cilat janë pjesë e shteteve anëtare. Afatet për bashkëpunimin me njësitë e tjera homologe të inteligjencës financiare zbatohen sipas parimeve dhe procedurave të Grupit Egmont.

7. Ministri përgjegjës për financat, me propozimin e autoritetit përgjegjës, nxjerr me udhëzim standardet teknike zbatuese mbi formatin e shkëmbimit të informacionit me njësitë homologe të inteligjencës financiare të shteteve anëtare, bazuar në aktet e miratuara nga Komisioni Evropian në këtë fushë.

Neni 35

Analizat e përbashkëta

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare ka kompetencë të kryejë analiza të përbashkëta për transaksionet dhe aktivitetet e dyshimta.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare, për qëllimet e zbatimit të pikës 1 të këtij neni, me mbështetjen e AMLA-s dhe së bashku me njësitë e inteligjencës financiare të shteteve anëtare, ngre ekipe të përbashkëta analize për një qëllim të caktuar dhe për një periudhë të kufizuar kohore, e cila mund të zgjatet me pëlqimin e palëve, për të kryer analiza operative të transaksioneve ose aktiviteteve të dyshimta që përfshijnë një ose më shumë nga njësitë e inteligjencës financiare që kanë krijuar ekipin.

3. Ekipi i përbashkët i analizës mund të ngrihet kur:

a) analiza operative e një njësie të inteligjencës financiare mund të jetë komplekse dhe të kërkojnë shqyrtim të thelluar, veçanërisht kur çështjet kanë lidhje me shtete të tjera anëtare;

b) disa njësi të inteligjencës financiare po kryejnë analiza operative në të cilat rrethanat e rastit justifikojnë veprime të përbashkëta në shtetet anëtare të përfshira.

Kërkesa për ngritjen e një ekipi të përbashkët analize mund të paraqitet nga cilado prej njësive të inteligjencës financiare të përfshira ose nga AMLA, në përputhje me aktet rregullatore të Bashkimit Evropian.

4. Agjencia e Inteligjencës Financiare cakton një punonjës të saj për të marrë pjesë në ekipin e përbashkët të analizës, i cili të ketë kompetencat e plota në përputhje me këtë ligj dhe brenda kufijve të kompetencave të tij funksionale, të vërë në dispozicion informacionin që administrohet nga Agjencia e Inteligjencës Financiare për qëllimet e analizës së kryer nga ekipi i përbashkët i analizës.

5. Kur ekipi i përbashkët i analizës ka nevojë për mbështetje nga një njësi tjetër e inteligjencës financiare, e cila nuk është pjesë e ekipit, ajo mund t'i kërkojë asaj njësie që:

a) t'i bashkohet ekipit të përbashkët të analizës;

b) të vërë në dispozicion të ekipit të përbashkët të analizës informacion financiar, si dhe informacionin në kuadër të inteligjencës financiare.

6. Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe njësitë e inteligjencës financiare që marrin pjesë në analizat e përbashkëta mund të ftojnë palë të treta, duke përfshirë organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Evropian, për të marrë pjesë në analizat e përbashkëta, kur është e rëndësishme për qëllimet e analizave të përbashkëta dhe kur pjesëmarrja e tillë është në përputhje me kompetencat përkatëse ligjore të atyre palëve të treta.

Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe njësitë e inteligjencës financiare që marrin pjesë në analizën e përbashkët përcaktojnë kushtet që zbatohen për pjesëmarrjen e palëve të treta dhe vendosin masa që garantojnë konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit të shkëmbyer. Informacioni i shkëmbyer përdoret vetëm për qëllimet për të cilat është ngritur analiza e përbashkët.

Neni 36

Përdorimi i informacionit të shkëmbyer

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare përdor informacionin dhe dokumentet e marra në përputhje me nenet 32, 34 dhe 35 të këtij ligji për ushtrimin e funksioneve të saj, në përputhje me këtë ligj.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare, kur vepron në cilësinë e njësisë së inteligjencës financiare transmetuese, gjatë shkëmbimit të informacionit dhe dokumenteve në përputhje me nenet 32 dhe 34 të këtij ligji, mund të vendosë kufizime ose kushte për përdorimin e informacionit dhe dokumenteve të transmetuara në përputhje me këtë ligj.

Këto kufizime dhe kushte nuk zbatohen kur informacioni i transmetuar përbëhet nga një raportim i paraqitur nga një subjekt i detyruar në përputhje me nenin 132, pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, ose nga informacioni i nxjerrë prej këtij raportimi, që lidhet me një shtet anëtar, në të cilin subjekti i detyruar vepron nëpërmjet lirisë për të ofruar shërbime dhe kur raportimi ose informacioni nuk ka asnjë lidhje me Republikën e Shqipërisë, kur Agjencia e Inteligjencës Financiare vepron në cilësinë e njësisë së inteligjencës financiare transmetuese.

Njësia e inteligjencës financiare marrëse e informacionit duhet të përmbushë kufizimet dhe kushtet e vendosura për përdorimin e informacionit dhe dokumenteve të transmetuara.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare cakton të paktën një person kontakti ose pikë

kontakti përgjegjëse për marrjen e kërkesave për informacion nga njësitë homologe të inteligjencës financiare të shteteve anëtare apo të vendeve të treta.

Neni 37

Pëlqimi për shpërndarjen e mëtejshme të informacionit të shkëmbyer

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare siguron që informacioni i shkëmbyer në përputhje me nenet 32, 34 dhe 35 të këtij ligji të përdoret vetëm për qëllimin për të cilin është kërkuar ose dhënë. Çdo shpërndarje e mëtejshme e këtij informacioni nga Agjencia e Inteligjencës Financiare tek një autoritet, agjenci ose organ tjetër, si dhe çdo përdorim i këtij informacioni për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është dhënë fillimisht, i nënshtrohet pëlqimit paraprak të njësisë përkatëse të inteligjencës financiare që ka transmetuar informacionin.

Kërkesa për pëlqimin paraprak të parashikuar në paragrafin e mësipërm të kësaj pike, nuk zbatohet kur informacioni i dhënë nga njësia e inteligjencës financiare përbëhet nga një raport i aktivitetit të dyshimtë, i paraqitur nga një subjekt i detyruar në përputhje me nenin 132, pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, me kusht që ky raport ose informacion të lidhet me një shtet anëtar ku subjekti i detyruar vepron nëpërmjet lirisë për të ofruar shërbime dhe të mos ketë asnjë lidhje me Republikën e Shqipërisë, kur Agjencia e Inteligjencës Financiare vepron në cilësinë e njësisë së inteligjencës financiare transmetuese.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare jep pëlqimin paraprak për shpërndarjen e informacionit të kërkuar, pa vonesë dhe në masën më të madhe të mundshme, pavarësisht nga lloji i veprës penale dhe nga fakti nëse vepra penale është identifikuar ose jo.

Agjencia e Inteligjencës Financiare nuk duhet të refuzojë dhënien e pëlqimit për shpërndarjen e informacionit, përveç rasteve kur:

- a) kërkesa është jashtë fushës së zbatimit të dispozitave të këtij ligji; ose
- b) shpërndarja e informacionit mund të cenojë një hetim në proces; ose
- c) shpërndarja e informacionit nuk është në përputhje me parimet themelore të rendit juridik kombëtar.

3. Çdo refuzim për dhënien e pëlqimit arsyetohet në mënyrë të përshtatshme. Rastet në të cilat mund të refuzohet dhënia e pëlqimit përcaktohen në mënyrë të tillë që të shmanget keqpërdorimi dhe kufizimi i pajustificuar i shpërndarjes së informacionit pranë autoriteteve kompetente.

Neni 38

Efekti i dispozitave të së drejtës penale

Dallimet ndërmjet përkufizimeve të veprave penale bazë në legjislacionet kombëtare të shteteve anëtare apo të vendeve të treta nuk pengojnë Agjencinë e Inteligjencës Financiare t'i ofrojë ndihmë një njësie homologe të inteligjencës financiare dhe nuk kufizojnë shkëmbimin, shpërndarjen dhe përdorimin e informacionit në përputhje me nenet 34, 35, 36 dhe 37 të këtij ligji.

Neni 39

Konfidencialiteti i raportimit

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare siguron mekanizma për mbrojtjen e identitetit të subjekteve të detyruara dhe të punonjësve të tyre, apo të personave në pozicion të barasvlershëm, përfshirë agjentët dhe shpërndarësit, të cilët raportojnë dyshime në përputhje me nenin 132 të këtij ligji.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare nuk e bën të ditur burimin e raportimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, kur u përgjigjet kërkesave për informacion nga autoritetet kompetente në përputhje me nenin 24 të këtij ligji ose kur shpërndan rezultatet e analizave në përputhje me nenin 14, pika 6, të këtij ligji.

3. Pika 2 e këtij neni zbatohet pa cenuar dispozitat e legjislacionit procedural penal në fuqi.

KREU III MBIKËQYRJA

Seksioni 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 40 Autoritetet mbikëqyrëse dhe kompetencat e tyre

1. Subjektet e detyruara, që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas përcaktimeve të Pjesës II dhe Pjesës III të këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 45 të këtij ligji, i nënshtrohen mbikëqyrjes së përshtatshme dhe efektive nga autoritetet mbikëqyrëse, me qëllim parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

2. Autoritetet mbikëqyrëse, sipas këtij ligji, janë:

a) Banka e Shqipërisë për subjektet e detyruara që licencohen brenda fushës së saj të veprimtarisë;

b) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për subjektet e detyruara që licencohen brenda fushës së saj të veprimtarisë;

c) Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, për subjektet e detyruara që ushtrojnë veprimtari në fushën e lojërave të fatit;

d) Dhoma Kombëtare e Avokatisë, për avokatët;

e) Ministria e Drejtësisë, për noterët, ndërmjetësit e pasurive të paluajtshme dhe profesionistët e tjerë ligjorë të pavarur, kur përfshihen në transaksione sipas përcaktimeve në Pjesën II të këtij ligji;

f) Bordi i Mbikëqyrjes Publike, për audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar si dhe subjektet e detyruara që licencohen brenda fushës së saj të veprimtarisë;

g) Agjencia e Inteligjencës Financiare për subjektet e detyruara, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore për raportimin e transaksioneve ose aktiviteteve të dyshimta, raportimin e transaksioneve në para fizike, si dhe raportimin e transaksioneve sipas pragjeve të raportimit të përcaktuar në Pjesën II dhe Pjesën III të këtij ligji;

h) ministritë ose autoritetet e tjera kompetente, për subjektet e detyruara që licencohen

brenda fushës së tyre të veprimtarisë;

i) AMLA kur vepron në cilësinë e mbikëqyrësit, sipas përcaktimeve të lejuara në këtë ligj.

3. Këshilli i Ministrave miraton me vendim autoritetet mbikëqyrëse për mbikëqyrjen e secilit subjekt të detyruar në përputhje me këtë ligj.

Neni 41

Garancitë institucionale për ushtrimin e mbikëqyrjes

1. Autoritetet mbikëqyrëse ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, efektive dhe të vazhdueshme, me qëllim parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, në përputhje me detyrimet e parashikuara në këtë ligj dhe legjislacionin sektorial të fushës.

2. Autoriteteve mbikëqyrëse u sigurohen burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe teknike, në përputhje me nivelin e rrezikut, natyrën dhe numrin e subjekteve të detyruara që ato mbikëqyrin, si dhe për garantimin e ushtrimit efektiv të funksioneve të tyre sipas përcaktimeve në nenin 42 të këtij ligji.

3. Autoritetet mbikëqyrëse duhet:

a) të ngrenë dhe të forcojnë struktura të specializuara për ushtrimin e funksioneve të mbikëqyrjes;

b) të punësojnë dhe të trajnojnë punonjës të specializuar;

c) të përdorin sisteme dhe mjete teknike për kryerjen e analizave sektoriale dhe analizave të rrezikut, si dhe për kryerjen e inspektimeve dhe monitorimin e vazhdueshëm.

4. Punonjësit e autoriteteve mbikëqyrëse duhet:

a) të gëzojnë integritet të lartë, të kenë aftësi dhe kualifikime të përshtatshme profesionale dhe të kenë standarde të larta profesionale; dhe

b) t'i nënshtrohen rregullave të posaçme për ruajtjen e konfidencialitetit, ruajtjen e informacionit të klasifikuar, mbrojtjen e të dhënave personale dhe parandalimin e konfliktit të interesit.

5. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të autoriteteve mbikëqyrëse, kërkesat lidhur me burimet financiare, njerëzore dhe teknike, si dhe kriteret për kualifikimin dhe integritetin e punonjësve përcaktohen nga legjislacioni përkatës sektorial dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 42

Funksionet e autoriteteve mbikëqyrëse

1. Autoritetet mbikëqyrëse ushtrojnë këto funksione:

a) shpërndajnë informacionin dhe udhëzimet përkatëse për subjektet e detyruara, në përputhje me nenin 47 të këtij ligji;

b) përcaktojnë ato raste kur rreziqet specifike të identifikuara të një sektori janë të qarta dhe të njohura dhe, për rrjedhojë, nuk kërkohet kryerja e vlerësimeve individuale të dokumentuara të rrezikut nga subjektet e detyruara sipas nenit 92 të këtij ligji;

c) verifikojnë përshtatshmërinë dhe zbatimin e politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme të subjekteve të detyruara, në përputhje me Kreun II të Pjesës II të këtij ligji, si

dhe mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e burimeve njerëzore të vëna në dispozicion për përmbushjen e detyrimeve ligjore të Pjesës II të këtij ligji.

Autoritetet mbikëqyrëse për subjektet e investimeve kolektive përcaktojnë rastet kur raportimi i aktiviteteve të dyshimta mund t'u besohet ofruesve të shërbimeve, në përputhje me nenin 100, pika 7, të këtij ligji;

d) vlerësojnë dhe mbikëqyrin rregullisht rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit ose financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, si dhe rreziqet e moszbatimit ose shmangies së masave shtrënguese financiare, ndaj të cilave janë të ekspozuara subjektet e detyruara;

e) mbikëqyrin përputhshmërinë e subjekteve të detyruara me detyrimet që lidhen me masat shtrënguese financiare;

f) kryejnë verifikimet në distancë, inspektimet në vend dhe kontrole tematike, si dhe çdo verifikim, vlerësim dhe analizë tjetër të nevojshme, për të verifikuar që subjektet e detyruara përmbushin detyrimet e parashikuara në Pjesën II të këtij ligji, si dhe zbatojnë çdo masë administrative të vendosur në zbatim të nenit 67 të këtij ligji;

g) marrin masa të përshtatshme mbikëqyrëse për trajtimin e shkeljeve të detyrimeve të zbatueshme për subjektet e detyruara, të konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes, si dhe mbikëqyrin zbatimin e këtyre masave.

2. Autoritetet mbikëqyrëse kanë kompetencat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duke përfshirë kompetencën:

a) të kërkojnë nga subjektet e detyruara çdo informacion të nevojshëm për mbikëqyrjen dhe verifikimin e përputhshmërisë me detyrimet e parashikuara në Pjesën II dhe Pjesën III të ligjit, si dhe të kryejnë verifikime përkatëse, përfshirë pranë ofruesve të shërbimeve të cilëve subjektet e detyruara u kanë besuar, nëpërmjet kontraktimit, përmbushjen e një pjese të detyrimeve të tyre sipas këtij ligji;

b) të vendosin masa administrative të përshtatshme dhe proporcionale për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara, përfshirë gjobat, në përputhje me Seksionin 4 të këtij Kreu të Pjesës I të këtij ligji.

3. Autoritetet mbikëqyrëse financiare dhe autoritetet mbikëqyrëse përgjegjëse për ofruesit e shërbimeve të lojërave të fatit kanë, përveç kompetencave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, kompetencën për të kryer inspektime në ambientet e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit të detyruar, pa njoftim paraprak, kur kjo është e nevojshme për garantimin e zhvillimit të rregullt dhe efektiv të inspektimit, si dhe u sigurohen të gjitha mjetet e nevojshme për kryerjen e kësaj forme inspektimi.

Për qëllimet e paragrafit të parë të kësaj pike, autoritetet mbikëqyrëse kanë, të paktën, kompetencën:

a) të shqyrtojnë dokumentacionin, të dhënat ose regjistrat e subjekteve të detyruara dhe të marrin kopje ose ekstrakte të tyre;

b) të kenë akses në çdo program kompjuterik, bazë të dhënash, sistem të teknologjisë së informacionit ose mjet tjetër elektronik për regjistrimin e informacionit, që përdoret nga subjektet e detyruara;

c) të marrin informacion me shkrim ose verbalisht nga çdo person përgjegjës për politikën, procedurat dhe kontrollet e brendshme për parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, ose nga përfaqësuesit ose punonjësit e subjektit të detyruar, si dhe nga përfaqësuesit ose punonjësit e

ofruesve të shërbimeve, të cilëve subjekti i detyruar u ka besuar nëpërmjet kontraktimit, detyra në përputhje me nenin 100 të këtij ligji, si dhe të intervistojnë, me pëlqimin e tij, çdo person tjetër, për mbledhjen e informacionit që lidhet me objektin e inspektimit.

4. Mënyra e ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave mbikëqyrëse sipas këtij neni, përfshirë procedurat e inspektimit, verifikimit dhe marrjes së informacionit, rregullohen sipas këtij ligji, nga legjislacioni përkatës sektorial dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Neni 43

Delegimi i funksioneve mbikëqyrëse te organet vetërregulluese

1. Në rastin e subjekteve të detyruara të përcaktuara në nenin 86, pika 3, gjerat “a” dhe “b” të këtij ligji, ushtrimi i funksioneve mbikëqyrëse mund t’u delegohet organeve vetërregulluese, me kusht që këto organe:

a) të kenë kompetencat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse, sipas nenit 42 të këtij ligji; dhe

b) të disponojnë burime të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe teknike për ushtrimin e funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

2. Punonjësit e organeve vetërregulluese duhet të gëzojnë integritet të lartë profesional, të kenë kualifikime të përshtatshme dhe të ruajnë standarde të larta profesionale, si dhe t’u nënshtrohen rregullave për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të informacionit të klasifikuar, mbrojtjen e të dhënave personale dhe parandalimin e konfliktit të interesit.

3. Delegimi i funksioneve mbikëqyrëse te organet vetërregulluese, sipas këtij neni, rregullohet nga legjislacioni përkatës sektorial.

Neni 44

Mbikëqyrja e subjekteve që veprojnë në bazë të lirisë për të ofruar shërbime

1. Kur, për arsye të interesit më të lartë publik, legjislacioni shqiptar parashikon kërkesa të posaçme autorizimi për subjektet e detyruara që të ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, në bazë të lirisë për të ofruar shërbime, veprimtaritë e ushtruara nga subjektet e detyruara në bazë të këtyre autorizimeve i nënshtrohen mbikëqyrjes nga autoritetet mbikëqyrëse shqiptare, pavarësisht nëse këto aktivitete të autorizuar kryhen përmes një forme pranie të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo nëpërmjet mjeteve në distancë.

2. Autoritetet mbikëqyrëse shqiptare njoftojnë mbikëqyrësit e shtetit anëtar në të cilin ndodhet selia qendrore e subjektit të detyruar për ushtrimin e mbikëqyrjes sipas këtij neni.

3. Pikat 1 dhe 2 e këtij neni nuk zbatohen kur AMLA vepron si mbikëqyrës, në ushtrim të kompetencave të saj mbikëqyrëse sipas legjislacionit përcaktës të Bashkimit Evropian.

Neni 45

Mbikëqyrja e veprimtarive përmes të cilave ndërmjetës të caktuar operojnë në bazë të lirisë për të ofruar shërbime

1. Kur veprimtaritë e subjekteve të detyruara të përcaktuara në gjerat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike ushtrohen në territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të lirisë për të ofruar

shërbime, përmes agjentëve, shpërndarësve ose formave të tjera të pranisë, përfshirë rastet kur këto veprimtari ushtrohen në bazë të një autorizimi të dhënë sipas legjislacionit në fuqi që rregullon autorizimin dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit, këto veprimtari i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve mbikëqyrëse kompetente për:

- a) emetuesit e parasë elektronike, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) ofruesit e shërbimeve të pagesave, sipas legjislacionit në fuqi;
- c) ofruesit e shërbimeve të kripto-aseteve, sipas legjislacionit në fuqi.

Për qëllimet e kësaj pike, autoritetet mbikëqyrëse kompetente në territorin e të cilave kryhen këto veprimtari, ushtrojnë mbikëqyrje efektive dhe sigurojnë përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në Pjesën II dhe Pjesën III të këtij ligji.

2. Në përjashtim nga pika 1 e këtij neni, mbikëqyrja e agjentëve, shpërndarësve ose formave të tjera të pranisë të përmendura në atë pikë, kryhet nga autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar ku subjekti i detyruar ka selinë qendrore, kur:

a) nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në standardet teknike rregullatore të përcaktuara në nenin 49, pika 3, të këtij ligji; dhe

b) autoriteti mbikëqyrës, në territorin e të cilit ndodhen agjentët, shpërndarësit ose format e tjera të pranisë, njofton mbikëqyrësin e shtetit anëtar ku ndodhet selia qendrore e subjektit të detyruar se, duke marrë në konsideratë praninë e kufizuar të veprimtarisë së këtij subjekti në territorin e tij, mbikëqyrja e veprimtarive të përmendura në pikën 1 të këtij neni do të kryhet nga mbikëqyrësi i shtetit anëtar ku ndodhet selia qendrore e subjektit të detyruar.

3. Për qëllimet e këtij neni, mbikëqyrësi i shtetit anëtar ku ndodhet selia qendrore e subjektit të detyruar dhe autoriteti mbikëqyrës, kur subjekti i detyruar vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të lirisë për të ofruar shërbime nëpërmjet agjentëve ose shpërndarësve ose nëpërmjet formave të tjera të pranisë, shkëmbejnë ndërmjet tyre çdo informacion të nevojshëm për të vlerësuar nëse plotësohen kriteret e parashikuara në pikën 2, germa “a”, të këtij neni, duke përfshirë informacion për çdo ndryshim në rrethanat e subjektit të detyruar që mund të ndikojë në përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar ku ndodhet selia qendrore e subjektit të detyruar njofton subjektin e detyruar, brenda 2 javëve nga marrja e njoftimit sipas pikës 2, germa “b”, të këtij neni, se do të ushtrojë mbikëqyrjen e veprimtarive të agjentëve, shpërndarësve ose formave të tjera të pranisë, përmes të cilave subjekti i detyruar ushtron veprimtarinë në bazë të lirisë për të ofruar shërbime në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe do ta njoftojë atë për çdo ndryshim të mëvonshëm në lidhje me këtë mbikëqyrje.

5. Ky nen nuk zbatohet kur AMLA vepron si autoritet mbikëqyrës, në ushtrim të kompetencave të saj mbikëqyrëse sipas legjislacionit përkatës të Bashkimit Evropian.

Neni 46

Koordinimi i mbikëqyrjes në rast të shumë autoriteteve mbikëqyrëse

1. Kur mbikëqyrja e një kategorie të subjekteve të detyruara i është caktuar më shumë se një autoriteti mbikëqyrës, këto autoritete e ushtrojnë mbikëqyrjen në mënyrë të njëtrajtshme dhe efektive në të gjithë sektorin përkatës. Për këtë qëllim, caktohet një mbikëqyrës kryesor ose vendoset një mekanizëm koordinimi ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse.

2. Kur mbikëqyrja e subjekteve të detyruara, në tërësi, i është caktuar më shumë se një autoriteti mbikëqyrës, vendoset një mekanizëm koordinimi midis këtyre autoriteteve për të

siguruar që subjektet e detyruara mbikëqyrjen në mënyrë efektive sipas standardeve më të larta.

Ky mekanizëm koordinimi duhet të përfshijë të gjitha autoritetet mbikëqyrëse, përveç rasteve kur:

a) mbikëqyrja i është deleguar një organi vetërregullues, në këtë rast autoriteti publik i përcaktuar në nenin 60 të këtij ligji duhet të marrë pjesë në mekanizmin e koordinimit;

b) mbikëqyrja e një kategorie të subjekteve të detyruara i është caktuar më shumë se një autoriteti mbikëqyrës, në këtë rast, autoriteti mbikëqyrës kryesor merr pjesë në mekanizmin e koordinimit; në rast se autoriteti mbikëqyrës kryesor nuk është caktuar, autoritetet mbikëqyrëse caktojnë një përfaqësues ndërmjet tyre.

3. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të mekanizmit të koordinimit, përcaktimi i autoritetit mbikëqyrës kryesor, sipas rastit, si dhe mënyra e bashkërendimit të mbikëqyrjes sipas këtij neni përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 47

Informimi i subjekteve të detyruara

1. Autoritetet mbikëqyrëse vënë në dispozicion të subjekteve të detyruara, nën mbikëqyrjen e tyre, informacionin e duhur mbi pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

2. Informacioni i përmendur në pikën 1 të këtij neni përfshin, ndër të tjera:

a) vlerësimet e rrezikut të kryera në nivel të Bashkimit Evropian, ndërkombëtar ose rajonal, si dhe rekomandimet përkatëse të nxjerra në bazë të tyre, në masën që janë të zbatueshme për Republikën e Shqipërisë;

b) vlerësimet kombëtare ose sektoriale të rrezikut të hartuara në përputhje me nenin 10 të këtij ligji;

c) udhëzimet, rekomandimet dhe opinionet përkatëse të nxjerra nga AMLA, në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian;

d) informacion mbi vendet e treta të identifikuar në përputhje me Kreun III, Seksioni 2 të Pjesës II të këtij ligji;

e) çdo udhëzim, raport ose dokument orientues të hartuar nga autoritetet kompetente kombëtare, autoritetet mbikëqyrëse, Agjencia e Inteligjencës Financiare, autoritetet publike që mbikëqyrin organet vetërregulluese, institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit Evropian, AMLA-n, organizatat ndërkombëtare si dhe nga organet hartuese të standardeve lidhur me mënyrat e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë që mund të zbatohen në një sektor të caktuar, treguesit për identifikimin e transaksioneve ose aktiviteteve me rrezik, si dhe udhëzime mbi detyrimet e subjekteve të detyruara në lidhje me masat shtrënguese financiare.

3. Autoritetet mbikëqyrëse kryejnë veprimtari informuese dhe ndërgjegjësuere, sipas rastit, për të informuar subjektet e detyruara nën mbikëqyrjen e tyre mbi detyrimet e tyre në bazë të këtij ligji.

4. Autoritetet mbikëqyrëse sigurojnë që subjekteve të detyruara nën mbikëqyrjen e tyre t'u vihet pa vonesë në dispozicion informacioni për personat ose subjektet e shpalluara në lidhje me masat shtrënguese financiare në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi në këtë fushë.

Mbikëqyrja e bazuar në rrezik

1. Mbikëqyrësit ushtrojnë funksionet e tyre sipas mbikëqyrjes së bazuar në rrezik. Për këtë qëllim, duhet të sigurohet që mbikëqyrësit:

a) të kuptojnë qartë rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, të pranishme në Republikën e Shqipërisë;

b) të vlerësojnë të gjithë informacionin përkatës mbi rreziqet specifike kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me klientët, produktet dhe shërbimet e subjekteve të detyruara;

c) të bazojnë shpeshtësinë dhe intensitetin e mbikëqyrjes në vend, në distancë dhe tematike, në profilin e rrezikut të subjekteve të detyruara, si dhe në rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë në nivel kombëtar.

Për qëllimet e germës “c” të kësaj pike, mbikëqyrësit hartojnë programe vjetore mbikëqyrjeje, duke parashikuar kohën dhe burimet e nevojshme për të reaguar pa vonesë kur ka tregues objektivë dhe domethënës të shkeljes së detyrimeve të parashikuara në Pjesën II dhe Pjesën III të këtij ligji.

2. Mbikëqyrësit sigurojnë që, gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes, të marrin në konsideratë shkallën e lirisë së vlerësimit që u lejohet subjekteve të detyruara të zbatojnë qasjen e bazuar në rrezik dhe të shqyrtojnë në mënyrë të përshtatshme vlerësimet e rrezikut mbi të cilat mbështetet kjo liri vlerësimi nga subjektet e detyruara, si dhe përshtatshmërinë e politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme të tyre.

3. Mbikëqyrësit përgatisin një raport të detajuar vjetor për veprimtarinë e tyre mbikëqyrëse dhe publikojnë një përmbledhje të tij. Kjo përmbledhje nuk duhet të përmbajë informacion konfidencial dhe përfshin:

a) kategoritë e subjekteve të detyruara nën mbikëqyrje dhe numrin e subjekteve të detyruara në secilën kategori;

b) një përshkrim të kompetencave dhe detyrave që u janë besuar mbikëqyrësve, si dhe, kur është e nevojshme, të mekanizmave të përmendur në nenin 46 të këtij ligji në të cilët ato marrin pjesë dhe, për mbikëqyrësin kryesor, një përmbledhje të veprimtarive koordinuese të kryera;

c) një përmbledhje të veprimtarisë mbikëqyrëse të ushtruar gjatë periudhës raportuese.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, bazuar në aktet e miratuara nga Komisioni Evropian në këtë fushë, miraton me vendim, standardet teknike rregullatore që përcaktojnë standardet dhe metodologjinë për vlerësimin dhe klasifikimin e profilit të rrezikut të identifikuar dhe të profilit të rrezikut të mbetur të subjekteve të detyruara, si dhe për përcaktimin e shpeshtësisë së rishikimit të këtij profili rreziku. Shpeshtësia e rishikimit të profileve të rrezikut përcaktohet duke marrë në konsideratë, ndër të tjera, ndryshime të rëndësishme në strukturën, administrimin ose veprimtarinë e subjektit të detyruar, si dhe natyrën, përmasën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tij.

5. Ministri përgjegjës për financat, me propozim të autoritetit përgjegjës, miraton, brenda gjashtë muajve nga nxjerrja e udhëzimeve përkatëse nga AMLA, udhëzime për zbatim nga mbikëqyrësit mbi:

a) karakteristikat e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik;

b) masat që duhen marrë nga mbikëqyrësit për të siguruar mbikëqyrje të përshtatshme dhe efektive, duke përfshirë trajnimin e punonjësve të tyre;

c) hapat që duhen të ndërmarrin mbikëqyrësit gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së bazuar në rrezik.

Neni 49

Pika qendrore e kontaktit

1. Autoriteti mbikëqyrës, brenda fushës së kompetencave të tij dhe për qëllime të zbatimit të neneve 40 dhe 45, pika 1, të këtij ligji, mund t'u kërkojë emetuesve të parasë elektronike, ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe ofruesve të shërbimeve të krypto-aseteve, të cilët ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, të ndryshme nga një filial ose degë, ose kur operojnë përmes agjentëve, shpërndarësve ose formave të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, në bazë të lirisë për të ofruar shërbime, të caktojnë një pikë qendrore kontakti në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Pika qendrore e kontaktit siguron, në emër të subjektit të detyruar, përputhshmërinë me kërkesat e këtij ligji dhe lehtëson ushtrimin e mbikëqyrjes nga mbikëqyrësi kompetent, përfshirë edhe duke u ofruar mbikëqyrësve dokumente dhe informacione sipas kërkesës.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, bazuar në aktet e miratuara nga Komisioni Evropian në këtë fushë, miraton me vendim rregullat që përcaktojnë standardet teknike rregullatore dhe kriteret për përcaktimin e rrethanave në të cilat është i përshtatshëm caktimi i një pike qendrore kontakti, si dhe funksionet e pikës qendrore të kontaktit, sipas kërkesave të këtij neni.

Neni 50

Detyrimi për raportim nga mbikëqyrësit

1. Autoritetet mbikëqyrëse, kur, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, përfshirë inspektimet dhe verifikimet e kryera ndaj subjekteve të detyruara, ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër, zbulojnë apo marrin dijeni për fakte, rrethana, informacion ose të dhëna që mund të lidhen me pastrimin e parave, veprat penale të lidhura me të, financimin e terrorizmit ose financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, njoftojnë pa vonesë Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

2. Detyrimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet gjithashtu për mbikëqyrësit e tregjeve të kapitalit, tregut të këmbimit valutor dhe instrumenteve financiare të prejardhura.

3. Përmbushja e detyrimit për raportim tek Agjencia e Inteligjencës Financiare, sipas këtij neni, nuk zëvendëson dhe nuk cenon detyrimin e mbikëqyrësve për të njoftuar autoritetet kompetente të ndjekjes penale për veprimtari kriminale që konstatojnë ose për të cilat marrin dijeni gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, miraton me vendim rregulla të hollësishme për formën, mënyrën dhe procedurën e raportimit të të dhënave nga autoritetet mbikëqyrëse.

Neni 51

Dhënia e informacionit

Autoritetet mbikëqyrëse i japin Agjencisë së Inteligjencës Financiare, në mënyrë periodike dhe sipas kërkesës së saj, të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) listën e subjekteve të detyruara që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas formave të ushtrimit të veprimtarisë, dhe listën e formave të tjera të pranishme që janë nën mbikëqyrjen e autoriteteve mbikëqyrëse, në përputhje me nenin 45, pika 1, të këtij ligji, si dhe çdo ndryshim në këto lista;

b) çdo gjetje të rëndësishme që evidenton dobësi serioze në sistemet dhe procedurat e raportimit të subjekteve të detyruara;

c) rezultatet e vlerësimeve të rrezikut të kryera nga autoritetet mbikëqyrëse në përputhje me nenin 48 të këtij ligji, në formë të konsoliduar.

Neni 52

Parimet e përgjithshme të bashkëpunimit ndërmjet mbikëqyrësve

1. Mbikëqyrësit bashkëpunojnë ndërmjet tyre në masën më të madhe të mundshme, pavarësisht nga natyra ose statusi i tyre institucional.

2. Bashkëpunimi mund të përfshijë, brenda kufijve të kompetencave ligjore të mbikëqyrësit të cilit i drejtohet kërkesa:

a) kryerjen e kontrolleve, inspektimeve ose veprimeve të tjera mbikëqyrëse në emër të një mbikëqyrësi kërkues; dhe

b) përcjelljen e informacionit të siguruar nëpërmjet këtyre veprimeve; ose

c) mbështetjen dhe lehtësimin e kryerjes së kontrolleve, inspektimeve ose veprimeve të tjera mbikëqyrëse nga mbikëqyrësi kërkues.

Neni 53

Shkëmbimi i informacionit mbi veprimtaritë ndërkufitare

1. Mbikëqyrësit e shtetit anëtar të origjinës informojnë mbikëqyrësit e shtetit anëtar pritës sa më shpejt të jetë e mundur, dhe në çdo rast brenda 3 muajve nga marrja e njoftimit për ushtrimin e veprimtarive ndërkufitare nga subjekti i detyruar, mbi veprimtaritë që ky subjekt synon të ushtrojë në territorin e shtetit anëtar pritës, në përputhje me sa parashikohet në nenin 90, pika 1, të këtij ligji.

Çdo ndryshim i mëvonshëm i njoftuar nga subjekti i detyruar në përputhje me nenin 90, pika 2, të këtij ligji, lidhur me këto veprimtari, duhet t'i njoftohet mbikëqyrësit të shtetit anëtar pritës sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda 1 muaji nga marrja e njoftimit.

2. Mbikëqyrësit e shtetit anëtar të origjinës, ndajnë me mbikëqyrësit e shtetit anëtar pritës informacion mbi veprimtaritë që subjekti i detyruar kryen efektivisht në territorin e shtetit anëtar pritës, të marrë në kuadër të veprimtarisë së tyre mbikëqyrëse, përfshirë informacionin e dhënë nga subjektet e detyruara në përgjigje të pyetësorëve ose kërkesave mbikëqyrëse, si dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm që lidhet me veprimtaritë e kryera në shtetin anëtar pritës.

3. Informacioni i parashikuar në pikën 2 të këtij neni duhet të shkëmbehet të paktën një herë në vit. Kur ky informacion jepet në formë të përmbledhur, mbikëqyrësi i shtetit anëtar të origjinës i përgjigjet pa vonesë çdo kërkesë për informacion shtesë të paraqitur nga mbikëqyrësi i shtetit anëtar pritës.

4. Në përjashtim nga sa parashikohet në pikën 3 të këtij neni, mbikëqyrësi i shtetit anëtar të origjinës, duhet të informojë menjëherë mbikëqyrësin e shtetit anëtar pritës sapo të marrë njoftimin nga subjektet e detyruara, në përputhje me nenin 90, pika 1, të këtij ligji, se veprimtaritë në shtetin anëtar pritës kanë filluar.

5. Ky nen zbatohet në të njëjtën mënyrë kur autoritetet mbikëqyrëse ushtrojnë kompetencat e mbikëqyrësit të shtetit të origjinës ose të mbikëqyrësit të shtetit pritës, në kuadër të bashkëpunimit me shtete anëtare ose me vende të treta, në përputhje me përcaktimet e lejuara nga ky ligj.

Neni 54

Bashkëpunimi në kuadër të mbikëqyrjes në nivel grupi

1. Në rastin e institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare që janë pjesë e një grupi, për qëllime të zbatimit të neneve 40 dhe 42 të këtij ligji, mbikëqyrësit e shtetit anëtar të origjinës, bashkëpunojnë me mbikëqyrësit e shtetit anëtar pritës në masën më të gjerë të mundshme, pavarësisht nga natyra ose statusi i tyre institucional. Mbikëqyrësit financiarë bashkëpunojnë gjithashtu me AMLA, kur kjo e fundit vepron në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës.

2. Me përjashtim të rasteve kur AMLA vepron si autoritet mbikëqyrës, mbikëqyrësit e shtetit anëtar të origjinës mbikëqyrin zbatimin efektiv të politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme në të gjithë grupin, të përcaktuara në Kreun II, Seksionin 2 të Pjesës II të këtij ligji.

Mbikëqyrësi financiar i shtetit anëtar pritës mbikëqyr përputhshmërinë e institucioneve të vendosura në territorin e shtetit të tij me Pjesën II dhe Pjesën III të këtij ligji.

3. Për qëllimet e zbatimit të këtij neni, dhe në përjashtim të rasteve kur krijohen kolegje mbikëqyrëse PPP/FT në zbatim të nenit 57 të këtij ligji, mbikëqyrësit financiarë bashkëpunojnë dhe i japin njëri-tjetrit çdo informacion të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të tyre mbikëqyrëse, qoftë me kërkesë apo me nismën e tyre.

Në veçanti, mbikëqyrësit financiarë shkëmbejnë çdo informacion që mund të ndikojë ndjeshëm në vlerësimin e ekspozimit ndaj rrezikut të identifikuar ose rrezikut të mbetur të një institucioni krediti ose institucioni financiar duke përfshirë:

a) identifikimin e strukturës juridike, të drejtimit dhe organizative të grupit, duke përfshirë të gjitha filialet dhe degët e tij;

b) informacionin përkatës mbi pronarët përfitues dhe drejtuesit e lartë, përfshirë rezultatet e vlerësimeve të përshtatshmërisë dhe integritetit, të kryera sipas këtij ligji apo sipas legjislacionit sektorial në fuqi;

c) politikat, procedurat dhe kontrollet e vendosura në nivel grupi;

d) informacionin mbi masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit, përfshirë dosjet e klientëve dhe të dhënat dhe dokumentacionin mbi kryerjen e transaksioneve;

e) zhvillimet ose rrethanat negative që lidhen me shoqërinë mëmë, filialet ose degët, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme pjesë të tjera të grupit;

f) gjobat dhe masat administrative që mbikëqyrësit financiarë synojnë të vendosin në përputhje me dispozitat e Seksionit 4 të këtij Kreu të Pjesës I të ligjit.

4. Mbikëqyrësit financiarë janë të autorizuar që, brenda kufijve të kompetencave të tyre ligjore, të kryejnë verifikime ose kontrolle në emër të një autoriteti mbikëqyrës kërkues, si dhe

të ndajnë informacionin e përftuar nëpërmjet këtyre veprimeve, ose të lehtësojnë kryerjen e tyre nga autoriteti mbikëqyrës kërkuar.

5. Mbikëqyrësit financiarë mund t'i drejtohen AMLA-s për cilëndo nga situatat e mëposhtme:

a) kur një mbikëqyrës financiar nuk ka komunikuar informacionin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni;

b) kur një kërkesë për bashkëpunim është refuzuar ose nuk është trajtuar brenda një afati të arsyeshëm;

c) kur ekziston një mosmarrëveshje, e bazuar në arsye objektive, lidhur me shkeljet e identifikuar ose me gjobat që do të vendosen, apo masat administrative që do të zbatohen ndaj një subjekti ose grupi për të korrigjuar këto shkelje.

Në rastet e parashikuara në këtë pikë, AMLA mund të veprojë në përputhje me kompetencat e saj sipas legjislacionit përkatës të Bashkimit Evropian dhe përcaktimeve të dhëna në këtë ligj, dhe jep mendim mbi çështjen objekt referimi brenda 1 muaji nga marrja e kërkesës.

6. Dispozitat e këtij neni zbatohen për mbikëqyrjen edhe të:

a) grupeve të subjekteve të detyruara në sektorin jo financiar;

b) subjekteve të detyruara që veprojnë sipas lirisë për të ofruar shërbime, pa formë tjetër pranie ose vendosjeje në një shtet tjetër anëtar nga ai në të cilin janë themeluar, kur mbikëqyrja e veprimtarisë në atë shtet anëtar ushtrohet nga autoritetet mbikëqyrëse të atij shteti, në përputhje me nenin 45, pika 1, të këtij ligji.

7. Kur situatat e parashikuara në pikën 5 të këtij neni lindin në lidhje me autoritetet mbikëqyrëse të sektorit jo financiar, AMLA mund të veprojë në përputhje me kompetencat e saj sipas legjislacionit përkatës të Bashkimit Evropian dhe sipas përcaktimeve të dhëna në këtë ligj.

Në rastet kur subjektet e detyruara në sektorin jo financiar janë pjesë e strukturave që ndajnë pronësi të përbashkët, administrim të përbashkët ose kontroll të përbashkët të përputhshmërisë, duke përfshirë rrjete ose partneritete, mbikëqyrësit e sektorit jo financiar bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion ndërmjet tyre.

8. Për qëllimet e zbatimit të këtij neni, Këshilli i Ministrave, brenda gjashtë muajve nga data e nxjerrjes së akteve nga Komisioni Evropian, miraton me vendim standardet teknike rregullatore që detajojnë detyrat përkatëse të mbikëqyrësve të vendit të origjinës dhe atij pritës, si dhe modalitetet e bashkëpunimit midis tyre.

9. Ky nen zbatohet në të njëjtën mënyrë kur autoritetet mbikëqyrëse ushtrojnë kompetencat e mbikëqyrësit të shtetit të origjinës ose të mbikëqyrësit të shtetit pritës, në kuadër të bashkëpunimit me shtete anëtare ose me vende të treta, në përputhje me përcaktimet e lejuara nga ky ligj.

Neni 55

Bashkëpunimi mbikëqyrës në lidhje me subjektet e detyruara që kryejnë veprimtari ndërkufitare

1. Kur subjektet e detyruara që nuk janë pjesë e një grupi kryejnë veprimtari ndërkufitare, siç është parashikuar në nenin 64, pika 1 e këtij ligji, dhe mbikëqyrja ndahet midis mbikëqyrësve të shteteve anëtare të origjinës dhe atyre pritëse në përputhje me nenet 44 dhe

45 të këtij ligji, shtetet anëtare sigurojnë që këta mbikëqyrës të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në masën më të madhe të mundshme dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin në kryerjen e mbikëqyrjes në përputhje me këto nene.

2. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, dhe përveç rasteve kur kolegjet mbikëqyrëse PPP/FT ngrihen në përputhje me nenin 57 të këtij ligji, shtetet anëtare sigurojnë që mbikëqyrësit:

a) t'i vënë në dispozicion njëri-tjetrit çdo informacion që u nevojitet për ushtrimin e funksioneve të tyre mbikëqyrëse, qoftë me kërkesë ashtu edhe me iniciativën e tyre, duke përfshirë informacionin e parashikuar në nenin 54, pika 3, gërmat "a", "b" dhe "d" të këtij ligji, kur ky informacion është i nevojshëm për kryerjen e detyrave mbikëqyrëse;

b) informojnë njëri-tjetrin për çdo zhvillim ose rrethanë me ndikim negativ që lidhet me subjektin e detyruar ose me format e tij të pranisë dhe që mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në përmbushjen e kërkesave të zbatueshme nga ana e subjektit, si dhe gjobat dhe masat administrative që synojnë të vendosin, në përputhje me dispozitat e Seksionit 4 të këtij Kreu, të Pjesës I të ligjit;

c) janë të autorizuar që, brenda kufijve të kompetencave të tyre ligjore, të kryejnë verifikime ose kontrolle në emër të një autoriteti mbikëqyrës kërkuar, si dhe të ndajnë informacionin e përftuar nga këto veprime ose të lehtësojnë kryerjen e tyre nga autoriteti kërkuar.

Kjo pikë zbatohet gjithashtu për subjektet e detyruara që janë të themeluara në një shtet anëtar të vetëm dhe veprojnë në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime në një shtet tjetër anëtar pa formë tjetër pranie, kur mbikëqyrja e veprimtarisë në shtetin tjetër anëtar ushtrohet nga mbikëqyrësit e atij shteti anëtar, në përputhje me nenin 44 të këtij ligji.

3. Kur mbikëqyrja e subjektit të detyruar dhe çdo formë të pranisë të tij në shtete të tjera anëtare u besohet mbikëqyrësve të shtetit anëtar të origjinës në përputhje me nenin 45 të këtij ligji, shtetet anëtare sigurojnë që mbikëqyrësit e shtetit anëtar të origjinës të informojnë rregullisht mbikëqyrësit e shtetit anëtar pritës për masat në zbatim brenda subjektit të detyruar dhe përputhshmërinë e atij subjekti me kërkesat përkatëse, duke përfshirë ato në zbatim në shtetin anëtar pritës.

Kur konstatohen shkelje serioze, të përsëritura ose sistematike, mbikëqyrësit e shtetit anëtar të origjinës informojnë pa vonesë mbikëqyrësit e shtetit anëtar pritës për këto shkelje, si dhe për gjobat që synojnë të vendosin dhe masat administrative që synojnë të vendosin për korrigjimin e tyre.

Mbikëqyrësit e shtetit anëtar pritës i ofrojnë ndihmë mbikëqyrësve të shtetit anëtar të origjinës për të siguruar verifikimin e përputhshmërisë nga subjekti i detyruar me kërkesat ligjore. Në veçanti, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që mbikëqyrësit e shtetit anëtar pritës të informojnë mbikëqyrësit e shtetit anëtar të origjinës për çdo dyshim serioz që ata kanë në lidhje me përputhshmërinë e subjektit të detyruar me kërkesat përkatëse dhe të ndajnë çdo informacion që ata kanë në këtë drejtim me mbikëqyrësit e shtetit anëtar të origjinës.

Paragrafi i mësipërm zbatohet gjithashtu në rastin e subjekteve të detyruara që janë themeluar në një shtet anëtar të vetëm dhe veprojnë sipas lirisë për të ofruar shërbime në një shtet tjetër anëtar pa asnjë formë pranie, përveç rasteve kur mbikëqyrja e aktiviteteve në atë shtet tjetër anëtar kryhet nga mbikëqyrësit e atij shteti tjetër anëtar në përputhje me nenin 44 të këtij ligji.

4. Mbikëqyrësit kanë kompetencë t'i referojnë AMLA-s cilëndo nga situatat e

mëposhtme:

a) kur një mbikëqyrës nuk ka komunikuar informacionin e parashikuar në pikën 2, gjerat “a” dhe “b”, ose në pikën 3, paragrafi i parë dhe i dytë i këtij neni;

b) kur një kërkesë për bashkëpunim është refuzuar ose nuk është trajtuar brenda një afati të arsyeshëm;

c) kur ekziston një mosmarrëveshje, e bazuar në arsye objektive, lidhur me shkeljet e identifikuar ose me gjobat apo masat administrative që do të vendosen ndaj subjektit për korrigjimin e këtyre shkeljeve.

Në këto raste, AMLA vepron në përputhje me kompetencat e saj sipas legjislacionit përkatës të Bashkimit Evropian dhe përcaktimeve në këtë ligj dhe jep mendimin e saj mbi çështjen objekt referimi brenda 1 muaji nga marrja e kërkesës.

5. Ky nen zbatohet në të njëjtën mënyrë kur autoritetet mbikëqyrëse ushtrojnë kompetencat e mbikëqyrësit të shtetit të origjinës ose të mbikëqyrësit të shtetit pritës, në kuadër të bashkëpunimit me shtete anëtare ose me vende të treta, në përputhje me përcaktimet e lejuara nga ky ligj.

Neni 56

Shkëmbimi i informacionit për zbatimin e politikave në nivel grupi në vende të treta

Mbikëqyrësit, përfshirë AMLA, informojnë njëri-tjetrin për rastet kur legjislacioni i një vendi të tretë nuk lejon zbatimin e politikave, procedurave dhe kontrolleve të kërkuara sipas nenit 98 të këtij ligji.

Në këto raste, mbikëqyrësit mund të ndërmarrin veprime të koordinuara për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme.

Në vlerësimin e vendeve të treta që nuk lejojnë zbatimin e politikave, procedurave dhe kontrolleve të kërkuara sipas nenit 98 të këtij ligji, mbikëqyrësit duhet të marrin në konsideratë çdo kufizim ligjor që mund të pengojë zbatimin e duhur të këtyre politikave, procedurave dhe kontrolleve, duke përfshirë sekretin profesional, nivelin e pamjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave dhe kufizime të tjera që kufizojnë shkëmbimin e informacionit që mund të jetë i rëndësishëm për atë qëllim.

Seksioni 2

Bashkëpunimi në kuadër të kolegjeve mbikëqyrëse për PPP/FT dhe me autoritetet homologe të vendeve të treta

Neni 57

Kolegjet mbikëqyrëse për PPP/FT në sektorin financiar

1. Mbikëqyrësi financiar përgjegjës për shoqërinë mëmë të një grupi institucionesh krediti ose institucionesh financiare, ose të selisë qendrore të një institucioni krediti ose institucioni financiar, krijon kolegje të posaçme mbikëqyrëse për PPP/FT, në cilëndo nga situatat e mëposhtme:

a) kur një institucion krediti ose institucion financiar, duke përfshirë grupet e tyre, ka ngritur forma të veprimtarisë në të paktën dy shtete anëtare të ndryshme përveç shtetit anëtar ku ndodhet selia qendrore;

b) kur një institucion krediti ose institucion financiar i një vendi të tretë ka ngritur forma të veprimtarisë në të paktën tre shtete anëtare.

2. Anëtarë të përhershëm të kolegjit janë mbikëqyrësit financiar përgjegjës për shoqërinë mëmë ose për selinë qendrore, mbikëqyrësit financiarë përgjegjës për format e vendosjes së veprimtarisë në shtetet anëtare pritëse, si dhe mbikëqyrësit financiarë përgjegjës për format e tjera të pranishme në shtetet anëtare pritëse, në përputhje me nenin 45 të këtij ligji.

3. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen në rastet kur AMLA ushtron funksion mbikëqyrës.

4. Veprimtaritë e kolegjeve mbikëqyrëse për PPP/FT ushtrohen në mënyrë proporcionale me nivelin e rreziqeve të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë ndaj të cilave është i ekspozuar institucioni i kreditit, institucioni financiar ose grupi, si dhe me shkallën e veprimtarisë së tij ndërkufitare.

5. Për qëllimet e pikës 1 të këtij neni, mbikëqyrësit financiarë duhet të identifikojnë:

a) të gjitha institucionet e kreditit ose institucionet financiare të licencuara apo të autorizuar në territorin e tyre dhe që kanë forma të vendosjes të veprimtarisë në shtete të tjera anëtare ose në vende të treta;

b) të gjitha format e vendosjes të veprimtarisë të ngritura nga institucionet e kreditit ose institucionet financiare në shtete të tjera anëtare ose në vende të treta;

c) format e vendosjes të veprimtarisë në territorin e tyre nga institucionet e kreditit ose institucione financiare nga shtete të tjera anëtare ose nga vende të treta.

6. Në raste të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 45 të këtij ligji, kur institucionet e kreditit ose institucionet financiare kryejnë aktivitete në shtete të tjera anëtare sipas lirisë për të ofruar shërbime, mbikëqyrësi financiar i shtetit anëtar të origjinës mund të ftojë mbikëqyrësit financiar të atyre shteteve anëtare të marrin pjesë në kolegji si vëzhgues.

7. Kur një grup institucioneesh krediti ose institucioneesh financiare përfshin subjekte të detyruara në sektorin jo financiar, mbikëqyrësi financiar që krijon kolegjin duhet të ftojë mbikëqyrësit e këtyre subjekteve të detyruara të marrin pjesë në kolegji.

8. Kolegjet mbikëqyrëse për PPP/FT mund të ngrihen kur një institucion krediti ose institucion financiar i themeluar në Bashkimin Evropian ka vendosur forma veprimtarie në të paktën dy vende të treta.

Mbikëqyrësit financiarë mund të ftojnë autoritetet homologe të vendeve të treta për të ngritur një formë të tillë kolegji mbikëqyrës.

Mbikëqyrësit financiarë që marrin pjesë në kolegji duhet të lidhin një marrëveshje të shkruar, në të cilën përcaktohen kushtet dhe procedurat e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacionit.

9. Kolegjet mbikëqyrëse përdoren, ndër të tjera, për shkëmbimin e informacionit, dhënien e ndihmës juridike të ndërsjellët në kuadër të marrëdhënieve juridiksioneve ose koordinimin e mbikëqyrjes ndaj grupit ose institucionit, duke përfshirë, kur është e nevojshme, marrjen e masave të përshtatshme dhe proporcionale për adresimin e shkeljeve serioze të dispozitave të Pjesës II dhe Pjesës III të ligjit, që bëhen të ditura në nivel grupi ose të institucionit të kreditit ose institucionit financiar, ose në të gjitha format e vendosjes të veprimtarisë të ngritura nga grupi ose institucioni në juridiksionin e një mbikëqyrësi që merr pjesë në kolegji.

10. AMLA mund të marrë pjesë në takimet e kolegjeve mbikëqyrëse për PPP/FT dhe

lehtëson veprimtarinë e tyre, në përputhje me funksionin dhe kompetencat e saj. Në rast se AMLA vendos të marrë pjesë në takimet e një kolegji mbikëqyrës, ajo merr pjesë me status vëzhguesi.

11. Mbikëqyrësit financiarë mund të lejojnë autoritetet homologe të vendeve të treta të marrin pjesë si vëzhgues në kolegjet mbikëqyrëse për PPP/FT, në rastin e parashikuar në pikën 1, germa “b”, të këtij neni ose kur grupe të Bashkimit Evropian ose institucionet krediti dhe institucionet financiare operojnë përmes degëve ose shoqërive bija në ato vende të treta, me kusht që:

a) autoritetet homologe të vendeve të treta paraqesin një kërkesë për pjesëmarrje dhe anëtarët e kolegjit të mbikëqyrjes bien dakord për pjesëmarrjen e tyre, ose anëtarët e kolegjit bien dakord t’i ftojnë këto autoritete homologe të vendeve të treta;

b) të respektohen rregullat e mbrojtjes së të dhënave në lidhje me transferimin e tyre në përputhje me legjislacionin i cili garanton një nivel mbrojtjeje të barasvlershëm me standardet e Bashkimit Evropian në këtë fushë;

c) autoritetet homologe të vendeve të treta nënshkruajnë marrëveshjen me shkrim të parashikuar në pikën 8 të këtij neni dhe shkëmbejnë brenda kolegjit mbikëqyrës informacionin përkatës që disponojnë për qëllime të mbikëqyrjes së institucioneve të kreditit ose institucioneve financiare apo të grupit;

d) informacioni i shkëmbyer i nënshtrohet kërkesave për ruajtjen e sekretit profesional, të paktën të barasvlershme me ato të parashikuara në nenin 80, pika 1 e këtij ligji, dhe përdoret vetëm për qëllime të ushtrimit të detyrave mbikëqyrëse të mbikëqyrësve financiarë pjesëmarrës ose të autoriteteve homologe të vendeve të treta.

12. Mbikëqyrësit financiarë që ngrenë kolegje duhet të kryejnë një vlerësim nëse plotësohen kushtet e parashikuara të pikës 11 të këtij neni dhe ia paraqesin këtë vlerësim anëtarëve të përhershëm të kolegjit. Ky vlerësim duhet të kryhet përpara se autoriteti homolog i vendit të tretë të lejohet të marrë pjesë në kolegji dhe mund të përsëritet më pas sipas nevojës. Mbikëqyrësi financiar i shtetit anëtar të origjinës mund të kërkojë mbështetje nga AMLA për kryerjen e këtij vlerësimi.

13. Kur vlerësohet e nevojshme nga anëtarët e përhershëm të kolegjit të mbikëqyrjes, mund të ftohen vëzhgues shtesë, me kusht që të respektohen kërkesat për konfidencialitet. Vëzhguesit mund të përfshijnë mbikëqyrës të mbikëqyrjes së kujdesshme, përfshirë Bankën Qendrore Evropiane (ECB), kur vepron në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, si dhe autoritete mbikëqyrëse Evropiane dhe njësitë e inteligjencës financiare.

14. Kur anëtarët e një kolegji mbikëqyrjeje nuk bien dakord mbi masat që duhet të merren në lidhje me një subjekt të detyruar, ata mund t’ia referojnë çështjen te AMLA dhe të kërkojnë asistencën e saj në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fuqi në këtë fushë.

15. Këshilli i Ministrave, brenda gjashtë muajve nga data e nxjerrjes së akteve nga Komisioni Evropian, miraton me vendim standardet teknike rregullatore që përfshijnë:

a) kushtet e përgjithshme për funksionimin, mbi mbikëqyrjen e bazuar në rrezik të kolegeve mbikëqyrëse për PPP/FT në sektorin financiar, duke përfshirë kushtet e bashkëpunimit midis anëtarëve të përhershëm dhe me vëzhguesit, dhe funksionimin operativ të kolegeve të tilla;

b) modelin për marrëveshjen me shkrim që do të nënshkruhet nga mbikëqyrësit financiarë në përputhje me pikën 8 të këtij neni;

c) çdo masë shtesë që do të zbatohet nga kolegjet kur grupet përfshijnë subjekte të detyruara të sektorit jo financiar;

d) kushtet për pjesëmarrjen e mbikëqyrësve financiarë në vendet e treta.

16. Ky nen zbatohet në të njëjtën mënyrë kur autoritetet mbikëqyrëse ushtrojnë kompetencat e mbikëqyrësit të shtetit të origjinës ose të mbikëqyrësit të shtetit pritës, në kuadër të bashkëpunimit me shtete anëtare ose me vende të treta, në përputhje me përcaktimet e lejuara nga ky ligj.

Neni 58

Kolegjet mbikëqyrëse për PPP/ FT në sektorin jo financiar

1. Mbikëqyrësi jo financiarë përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërisë mëmë të një grupi subjektsh të detyruara në sektorin jo financiar, ose të selisë qendrore të një subjekti të detyruar në sektorin jo financiar, ka kompetencë të krijojë kolegje të posaçme mbikëqyrëse për PPP/FT në cilëndo nga situatat e mëposhtme:

a) kur një subjekt i detyruar në sektorin jo financiar, duke përfshirë grupet e tyre, ka ngritur forma të veprimtarisë në të paktën dy shtete anëtare të ndryshme përveç shtetit anëtar ku ndodhet selia qendrore;

b) kur një subjekt i një vendi të tretë, që i nënshtrohet detyrimeve ligjore për PPP/FT, që nuk është institucion krediti ose institucion financiar, ka ngritur forma të veprimtarisë në të paktën tre shtete anëtare.

Paragrafi i mësipërm zbatohet edhe për struktura që kanë pronësi të përbashkët, administrim të përbashkët ose kontroll të përbashkët të përputhshmërisë, duke përfshirë rrjete ose partneritete për të cilat zbatohen kërkesat në nivel grupi, në përputhje me sa parashikohet në nenin 98 të këtij ligji.

Anëtarë të përhershëm të kolegjit do të jenë mbikëqyrësit në sektorin jo financiar përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërisë mëmë ose të selisë qendrore, si dhe mbikëqyrësit jo financiar përgjegjës për mbikëqyrjen e formave të vendosjes të veprimtarisë në shtetet anëtare pritëse ose për mbikëqyrjen e atij subjekti të detyruar në shtete të tjera anëtare, në rastet e parashikuara në nenin 44, pika 1, të këtij ligji.

2. Kur mbikëqyrësi jo financiar përgjegjës, për mbikëqyrjen e shoqërisë mëmë të një grupi ose të selisë qendrore të një subjekti të detyruar, nuk krijon një kolegji mbikëqyrës, të paktën dy mbikëqyrës jo financiarë të përmendur në pikën 1, germa “b” të këtij neni, mund të paraqesin një mendim të arsyetuar se, duke marrë parasysh rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ndaj të cilave është i ekspozuar subjekti i detyruar ose grupi, si dhe shkallën e veprimtarisë së tij ndërkufitare, duhet të krijohet një kolegji. Ky mendim duhet të paraqitet nga të paktën dy mbikëqyrës jo financiar dhe i drejtohet:

a) mbikëqyrës jo financiar përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërisë mëmë të një grupi ose të selisë qendrore të një subjekti të detyruar;

b) AMLA;

c) të gjitha mbikëqyrësve të tjerë jo financiar.

Kur mbikëqyrësi jo financiar, i përmendur në germën “a” të kësaj pike, është një organ vetërregullues, mendimi i arsyetuar i paraqitet gjithashtu autoritetit publik përgjegjës për mbikëqyrjen e atij organi vetërregullues, në përputhje me nenin 60 të këtij ligji.

3. Kur, pas paraqitjes së një mendimi të arsyetuar në përputhje me pikën 2 të këtij neni,

mbikëqyrësi jo financiar përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërisë mëmë të një grupi ose të selisë qendrore të një subjekti të detyruar vijon të vlerësojë se nuk është e nevojshme ngritja e një kolegji mbikëqyrjeje, mbikëqyrësit e tjerë jo financiarë ngrenë kolegjin, me kusht që ai të përbëhet nga të paktën dy anëtarë. Në këto raste, këta mbikëqyrës jo financiarë vendosin ndërmjet tyre se cili do të jetë mbikëqyrësi përgjegjës për kolegjin. Mbikëqyrësi jo financiar përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërisë mëmë të grupit ose të selisë qendrore të subjektit të detyruar duhet të informohet për veprimtarinë e kolegjit dhe ka të drejtë t'i bashkohet kolegjit në çdo kohë.

4. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, mbikëqyrësit jo financiar duhet të identifikojnë:

a) të gjitha subjektet e detyruara në sektorin jo financiar që kanë selinë qendrore në territorin e tyre dhe që kanë forma të vendosjes së veprimtarisë në shtete të tjera anëtare ose në vende të treta;

b) të gjitha format e vendosjes të veprimtarisë të ngritura nga këto subjekte të detyruara në shtete të tjera anëtare ose në vende të treta;

c) format e vendosjes të veprimtarisë në territorin e tyre nga subjekte të detyruara në sektorin jo financiar me seli qendrore në shtete të tjera anëtare ose në vende të treta.

5. Kur subjektet e detyruara në sektorin jo financiar kryejnë veprimtari në shtete të tjera anëtare në kuadër të lirisë së ofrimit të shërbimeve, mbikëqyrësi jo financiarë i shtetit anëtar të origjinës mund të ftojë mbikëqyrësit jo financiar të atyre shteteve anëtare të marrin pjesë në kolegji si vëzhgues.

6. Kur një grup në sektorin jo financiar përfshin ndonjë institucion krediti ose institucion financiar, por prania e tyre në grup nuk përmbush pragun për krijimin e një kolegji sipas përcaktimeve në nenin 57 të këtij ligji, mbikëqyrësi që krijon kolegjin duhet të ftojë mbikëqyrësit financiarë të atyre institucioneve të kreditit ose institucioneve financiare të marrin pjesë në kolegji.

7. Kolegjet mbikëqyrëse PPP/FT mund të ngrihen kur një subjekt i detyruar në sektorin jo financiar, i themeluar në Bashkimin Evropian ka vendosur veprimtarinë në të paktën dy vende të treta. Mbikëqyrësit jo financiarë mund të ftojnë autoritetet homologe të atyre vendeve të treta për të krijuar një kolegji të tillë. Mbikëqyrësit jo financiar që marrin pjesë në kolegji duhet të lidhin një marrëveshje me shkrim, ku përcaktohen kushtet dhe procedurat e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacionit.

Kur kolegji ngrihet në lidhje me subjektet e detyruara të përmendura në nenin 86, pika 3, germa "a" dhe "b", ose grupet e tyre, marrëveshja me shkrim, e përmendur në këtë pikë, duhet të përfshijë gjithashtu procedura që sigurojnë se asnjë informacion i mbledhur në përputhje me nenin 103, pika 2, të këtij ligji, nuk shpërndahet, përveç rasteve kur zbatohet paragrafi i dytë i pikës 2 të nenit 103 të këtij ligji.

8. Kolegjet mbikëqyrëse përdoren, ndër të tjera, për shkëmbimin e informacionit, dhënien e ndihmës juridike të ndërsjellët në kuadër të marrëdhënieve juridiksioneve ose koordinimin e mbikëqyrjes ndaj grupit ose subjektit të detyruar, duke përfshirë, kur është e nevojshme, marrjen e masave të përshtatshme dhe proporcionale për adresimin e shkeljeve serioze të dispozitave të Pjesës II dhe Pjesës III të ligjit, që bëhen të ditura në nivel grupi ose të subjektit të detyruar, ose në të gjitha format e vendosjes të veprimtarisë të ngritura nga grupi ose subjekti i detyruar në juridiksionin e një mbikëqyrësi që merr pjesë në kolegji.

9. AMLA mund të marrë pjesë në takimet e kolegjeve mbikëqyrëse për PPP/FT dhe lehtëson veprimtarinë e tyre, në përputhje me funksionin dhe kompetencat e saj. Në rast se

AMLA vendos të marrë pjesë në takimet e një kolegji mbikëqyrës, ajo merr pjesë me status vëzhguesi.

10. Mbikëqyrësit jo financiarë mund të lejojnë autoritetet homologe të vendeve të treta të marrin pjesë si vëzhgues në kolegjet e mbikëqyrjes për PPP/FT, në rastin e parashikuar në pikën 1, germa “b” e këtij neni, ose kur subjekte të detyruara të Bashkimit Evropian në sektorin jo financiar ose grupet e tyre kryejnë veprimtari përmes degëve ose filialeve në ato vende të treta, me kusht që:

a) autoritetet homologe të vendeve të treta të paraqesin kërkesë për pjesëmarrje dhe anëtarët e kolegjit bien dakord për pjesëmarrjen e tyre, ose anëtarët e kolegjit të bien dakord për t’i ftuar këta homologë;

b) të respektohen rregullat e mbrojtjes së të dhënave në lidhje me transferimin e tyre në përputhje me legjislacionin i cili garanton një nivel mbrojtjeje të barasvlershëm me standardet e Bashkimit Evropian në këtë fushë;

c) autoritetet homologe të vendeve të treta nënshkruajnë marrëveshjen me shkrim, sipas përcaktimeve në pikën 7 të këtij neni, dhe shkëmbejnë brenda kolegjit informacionin përkatës që zotërojnë për qëllime të mbikëqyrjes së subjektit të detyruar ose të grupit.

d) informacioni i shkëmbyer i nënshtrohet kërkesave për ruajtjen e sekretit profesional, të paktën të barasvlershme me ato të parashikuara në nenin 80, pika 1, të këtij ligji, dhe përdoret vetëm për qëllime të kryerjes së detyrave mbikëqyrëse të mbikëqyrësve jo financiarë pjesëmarrës ose të autoriteteve homologe të vendeve të treta.

Mbikëqyrësit jo financiarë përgjegjës për mbikëqyrjen e shoqërisë mëmë të një grupi ose të selisë qendrore të një subjekti të detyruar ose, në rastet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, për kolegjin, kryejnë një vlerësim për të përcaktuar nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafin e parë të kësaj pike dhe ia paraqesin atë anëtarëve të përhershëm të kolegjit. Ky vlerësim do të kryhet përpara se autoriteti homolog i vendit të tretë të lejohet të bashkohet me kolegjin dhe mund të përsëritet sipas nevojës. Mbikëqyrësit jo financiarë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit mund të kërkojnë mbështetjen e AMLA për kryerjen e këtij vlerësimi.

11. Kur vlerësohet e nevojshme nga anëtarët e përhershëm të kolegjit, mund të ftohen vëzhgues shtesë, me kusht që të respektohen kërkesat për konfidencialitet. Vëzhguesit mund të përfshijnë edhe njësitë e inteligjencës financiare.

12. Kur anëtarët e një kolegji nuk bien dakord mbi masat që duhet të merren në lidhje me një subjekt të detyruar, ata mund t’ia referojnë çështjen AMLA dhe të kërkojnë ndihmën e saj në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fuqi. AMLA jep mendimin e saj mbi çështjen e mosmarrëveshjes brenda dy muajve.

13. Këshilli i Ministrave, brenda gjashtë muajve nga data e nxjerrjes së akteve nga Komisioni Evropian, miraton me vendim standardet teknike rregullatore që detajojnë:

a) kushtet e përgjithshme për funksionimin e kolegeve mbikëqyrëse të PPP/FT në sektorin jo financiar, duke përfshirë kushtet e bashkëpunimit midis anëtarëve të përhershëm dhe me vëzhguesit, dhe funksionimin operativ të këtyre kolegeve;

b) modelin për marrëveshjen me shkrim që duhet të nënshkruhet nga mbikëqyrësit jo financiarë në përputhje me pikën 7 të këtij neni;

c) kushtet për pjesëmarrjen e mbikëqyrësve jo financiarë në vendet e treta;

d) çdo masë shtesë që duhet të zbatohet nga kolegjet kur grupet përfshijnë institucione krediti ose institucione financiare.

14. Ky nen zbatohet në të njëjtën mënyrë kur autoritetet mbikëqyrëse ushtrojnë

kompetencat e mbikëqyrësit të shtetit të origjinës ose të mbikëqyrësit të shtetit pritës, në kuadër të bashkëpunimit me shtete anëtare ose me vende të treta, në përputhje me përcaktimet e lejuara nga ky ligj.

Neni 59

Bashkëpunimi me mbikëqyrësit e vendeve të treta

1. Mbikëqyrësit kanë kompetencë për të lidhur marrëveshje bashkëpunimi që parashikojnë bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni konfidencial me autoritetet homologe në vende të treta. Këto marrëveshje bashkëpunimi duhet të jenë në përputhje me rregullat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave dhe të lidhen mbi bazën e reciprocitetit dhe të garantojnë kërkesat për ruajtjen e sekretit profesional të paktën të barasvlershme me ato të parashikuara në nenin 80, pika 1, të këtij ligji. Informacioni konfidencial i shkëmbyer në përputhje me këto marrëveshje do të përdoret vetëm për qëllimin e kryerjes së detyrave mbikëqyrëse të këtyre autoriteteve.

Kur informacioni i shkëmbyer e ka origjinën nga një shtet tjetër anëtar, ai do të shpërndahet vetëm me pëlqimin e shprehur të mbikëqyrësit që e ka ndarë atë dhe, sipas rastit, vetëm për qëllimet për të cilat ai mbikëqyrës ka dhënë pëlqimin e tij.

2. Për qëllimet e pikës 1 të këtij neni, AMLA do të ofrojë ndihmën e nevojshme për të vlerësuar barasvlefshmërinë e kërkesave të sekretit profesional që zbatohen për autoritetin homolog të vendit të tretë.

3. Mbikëqyrësit njoftojnë AMLA për çdo marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruar në përputhje me këtë nen, brenda një muaji nga nënshkrimi i saj.

4. Këshilli i Ministrave, brenda gjashtë muajve nga data e nxjerrjes së akteve nga Komisioni Evropian, miraton me vendim standardet teknike zbatuese që detajojnë modelin që do të përdoret për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit të përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Seksioni 3

Dispozita të veçanta për organet vetërregulluese

Neni 60

Mbikëqyrja e organeve vetërregulluese

1. Në rastet kur organet vetërregulluese ushtrojnë funksione mbikëqyrëse ndaj subjekteve të detyruara të përcaktuara në nenin 86, pika 3, germa “a” dhe “b”, veprimtaria e tyre në ushtrimin e këtyre funksioneve i nënshtrohet mbikëqyrjes nga një autoritet publik kompetent, në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi.

2. Autoriteti publik që mbikëqyr organet vetërregulluese është përgjegjës për sigurimin e një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv mbikëqyrjeje ndaj subjekteve të detyruara të përcaktuara në nenin 86, pika 3, germa “a” dhe “b”, duke përfshirë:

a) verifikimin që çdo organ vetërregullues që kryen, ose synon të kryejë, funksionet e parashikuara në nenin 43 të këtij ligji, përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 3 të atij neni;

b) nxjerrjen e akteve nënligjore lidhur me ushtrimin e funksioneve të parashikuara në nenet 40 dhe 42 të këtij ligji;

c) sigurimin që organet vetërregulluese të kryejnë funksionet e tyre, në përputhje me Seksionin 1 të këtij Kreu, në mënyrë të përshtatshme dhe efektive;

d) shqyrtimin e përjashtimeve të dhëna nga organet vetërregulluese nga detyrimi për hartimin e një vlerësimi individual të dokumentuar të rrezikut, në përputhje me nenin 42, pika 1 e këtij ligji;

e) informimin e rregullt të organeve vetërregulluese për çdo aktivitet të planifikuar ose detyrë të kryer nga AMLA që lidhet me kryerjen e funksionit të tyre mbikëqyrës, duke përfshirë, në veçanti, planifikimin e vlerësimeve të ndërsjella ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fuqi.

3. Autoriteti publik që mbikëqyr organet vetërregulluese ka kompetenca të plota për të përmbushur përgjegjësitë e tij sipas pikës 2 të këtij neni. Së paku, autoriteti publik ka kompetencë të:

a) të kërkojë dhe të detyrojë dhënien e çdo informacioni që është i rëndësishëm për monitorimin e përputhshmërisë dhe për kryerjen e kontrolleve, me përjashtim të informacionit të mbledhur nga subjektet e detyruara të përcaktuara në nenin 86, pika 3, germa “a” dhe “b”, gjatë përcaktimit të pozitës juridike të klientit të tyre, sipas përcaktimeve të nenit 103, pika 2, të këtij ligji ose për kryerjen e detyrës për mbrojtjen ose përfaqësimin e klientit në, ose në lidhje me, procedura gjyqësore, duke përfshirë dhënien e këshillimit për fillimin ose shmangien e procedurave të tilla; pavarësisht nëse informacioni është mbledhur para, gjatë ose pas këtyre procedurave;

b) të nxjerrë udhëzime detyruese ndaj organit vetërregullues për të korrigjuar mos ushtrimin e funksioneve të parashikuara në nenin 42 të këtij ligji, ose për të përmbushur kërkesat e pikës 2 të atij neni, ose për të parandaluar çdo rast të tillë mos përmbushje.

Autoriteti publik kur nxjerr udhëzime për një organ vetërregullues, në përputhje me germën “b” të këtij neni, duhet të marrë në konsideratë çdo udhëzim përkatës të dhënë prej tij ose nga AMLA.

4. Autoriteti publik që mbikëqyr organet vetërregulluese i kryen funksionet e tij në mënyrë të pavarur, pa ndikim të papërshtatshëm dhe në kushte që garantojnë objektivitetin dhe paanshmërinë e vendimmarrjes së tij.

Punonjësit e autoritetit publik që mbikëqyr organet vetërregulluese u nënshtrohen kërkesave për ruajtjen e sekretit profesional të barasvlershme me ato të parashikuara në nenin 80 të këtij ligji. Këta punonjës duhet të ruajnë standarde të larta profesionale, duke përfshirë konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave, dhe të jenë me integritet të lartë.

Autoriteti publik që mbikëqyr organet vetërregulluese duhet të miratojë dhe të zbatojë procedura për parandalimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit.

5. Në rast të mosrespektimit nga organet vetërregulluese të kërkesave, udhëzimeve ose masave të marra nga autoriteti publik në përputhje me pikat 2 dhe 3 të këtij neni, legjislacioni sektorial përkatës duhet të parashikojë masa administrative ose gjoba efektive, proporcionale dhe parandaluese.

6. Autoriteti publik që mbikëqyr organet vetërregulluese informon pa vonesë autoritetet kompetente për hetimin dhe ndjekjen penale të veprimtarive kriminale, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Agjencisë së Inteligjencës Financiare, për çdo shkelje që përbën vepër penale dhe që konstatohet gjatë ushtrimit të detyrave të tij.

7. Autoriteti publik që mbikëqyr organet vetërregulluese publikon një raport vjetor që përmban informacion në lidhje me:

a) numrin dhe natyrën e shkeljeve të konstatuara nga çdo organ vetërregullues, si dhe gjobat e vendosura ose masat administrative të zbatuara ndaj subjekteve të detyruara;

b) numrin e raportimeve të transaksioneve të dyshimta, të raportuara tek autoriteti përgjegjës nga subjektet e detyruara që mbikëqyren nga çdo organ vetërregullues, pavarësisht nëse janë raportuar drejtpërdrejt në përputhje me nenin 132 pika 1, ose janë raportuar nga secili organ vetërregullues pranë autoritetit përgjegjës, në përputhje me nenin 133, pika 1, të këtij ligji;

c) numrin dhe përshkrimin e gjobave, të gjobave periodike dhe të masave administrative të vendosura sipas Seksionit 4 të këtij Kreu nga secili organ vetërregullues për të siguruar përputhshmërinë e subjekteve të detyruara me dispozitat e Pjesës II të këtij ligji dhe të parashikuara në nenin 65, pika 1 e këtij ligji;

d) numrin dhe përshkrimin e masave të marra nga autoriteti publik që mbikëqyr organet vetërregulluese në zbatim të këtij neni, si dhe numrin e udhëzimeve të lëshuara për organet vetërregulluese.

Raporti i parashikuar në këtë pikë duhet të publikohet në faqen zyrtare të internetit të autoritetit publik që mbikëqyr organet vetërregulluese.

Seksioni 4

Kundërvajtjet administrative

Neni 61

Dispozita të përgjithshme

1. Subjektet e detyruara mbajnë përgjegjësi për shkeljet e dispozitave të Pjesës II dhe të Pjesës III të këtij ligji.

2. Pa cenuar zbatimin e legjislacionit penal në fuqi, shkeljet e dispozitave të Pjesës II dhe Pjesës III të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe autoritetet mbikëqyrëse vendosin një ose disa gjoba apo masa administrative ndaj subjekteve të detyruara dhe sigurojnë ekzekutimin e tyre.

Gjobat dhe masat administrative të vendosura sipas këtij neni duhet të jenë efektive, proporcionale dhe të kenë efekt parandalues.

3. Në rast të shkeljeve të dispozitave të parashikuara në Pjesën II dhe në Pjesën III të këtij ligji, kur detyrimet zbatohen ndaj subjekteve të detyruara që kanë formën e personit juridik, gjobat dhe masat administrative mund të vendosen jo vetëm ndaj personit juridik, por edhe ndaj drejtuesve të lartë, si dhe ndaj personave të tjerë fizikë që sipas legjislacionit në fuqi mbajnë përgjegjësi për shkeljen.

4. Autoritetet mbikëqyrëse, kur konstatojnë shkelje që përbëjnë vepër penale sipas legjislacionit në fuqi, informojnë pa vonesë autoritetet kompetente për hetimin dhe ndjekjen penale.

5. Në përputhje me Pjesën I të këtij ligji dhe me legjislacionin sektorial në fuqi, vendosen gjobat dhe masat administrative sipas një ose më shumë prej mënyrave të mëposhtme:

a) drejtpërdrejt nga autoritetet mbikëqyrëse;

b) në bashkëpunim ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe autoriteteve të tjera;

c) nën përgjegjësinë e autoriteteve mbikëqyrëse, nëpërmjet delegimit të ushtrimit të

kompetencave tek autoritete të tjera;

d) me kërkesë të autoritetit mbikëqyrës drejtuar gjykatës kompetente për vendosjen e gjobës ose të masave administrative, kur kjo parashikohet nga legjislacioni përkatës në fuqi.

6. Autoritetet mbikëqyrëse, gjatë përcaktimit të llojit dhe nivelit të gjobave ose masave administrative, marrin në konsideratë të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë, kur është e aplikueshme:

- a) rëndësinë dhe kohëzgjatjen e shkeljes;
- b) numrin e rasteve të përsëritjes së shkeljes;
- c) shkallën e përgjegjësisë së personit fizik ose juridik përgjegjës për shkeljen;
- d) gjendjen financiare të personit fizik ose juridik përgjegjës për shkeljen, duke përfshirë qarkullimin total ose të ardhurat vjetore të tij;
- e) përfitimin e realizuar nga personi fizik ose juridik si rezultat i shkeljes, në masën që mund të përcaktohet;
- f) dëmet e shkaktuara palëve të treta nga shkelja, në masën që ato mund të përcaktohen;
- g) nivelin e bashkëpunimit të personit fizik ose juridik përgjegjës për shkeljen, me autoritetin kompetent;
- h) shkeljet e mëparshme të kryera nga personi fizik ose juridik përgjegjës për shkeljen.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, bazuar në aktet e miratuara nga Komisioni Evropian, miraton me vendim, standardet teknike rregullatore, që përcaktojnë:

- a) treguesit për klasifikimin e nivelit të rëndësisë së shkeljeve;
- b) kriteret që duhen marrë në konsideratë gjatë përcaktimit të nivelit të gjobave ose të zbatimit të masave administrative në përputhje me këtë Seksion;
- c) metodologjinë për vendosjen e gjobave periodike në përputhje me nenin 68 të këtij ligji, duke përfshirë shpeshtësinë e tyre.

8. Ministri përgjegjës për financat, me propozim të autoritetit përgjegjës, bazuar në udhëzimet e nxjerra nga AMLA në këtë fushë, nxjerr me udhëzim rregullat për përcaktimin e shumave bazë për vendosjen e gjobave, në raport me qarkullimin, të ndara sipas llojit të shkeljes dhe kategorisë së subjekteve të detyruara.

Neni 62

Përgjegjësia e personit juridik

1. Personi juridik mban përgjegjësi administrative për shkeljet e dispozitave të Pjesës II dhe Pjesës III të këtij ligji, kur këto shkelje kryhen në emër ose për përfitim të tij nga çdo person, i cili vepron individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik dhe ushtron funksione drejtuese në këtë person juridik, bazuar në një nga kriteret e mëposhtme:

- a) ka kompetencën për të përfaqësuar personin juridik;
- b) ka kompetencën për të marrë vendime në emër të personit juridik;
- c) ka kompetencën për të ushtruar kontroll brenda personit juridik.

2. Personi juridik mban përgjegjësi edhe kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga një person, sipas pikës 1 të këtij neni, ka sjellë kryerjen e shkeljeve të dispozitave të Pjesës II dhe Pjesës III të këtij ligji, nga një person nën autoritetin e tij në emër ose për përfitim të personit juridik.

3. Përgjegjësia administrative e personit juridik sipas këtij ligji nuk përjashton përgjegjësinë individuale të personave fizikë dhe ushtrohet pa cenuar zbatimin e legjislacionit penal në fuqi për përgjegjësinë e personave juridikë.

Neni 63

Koordinimi ndërinstitucional i mbikëqyrësve

1. Në ushtrimin e kompetencave për vendosjen e gjobave dhe masave administrative, mbikëqyrësit bashkëpunojnë ngushtë dhe kur është e nevojshme koordinojnë veprimet e tyre me autoritete të tjera kompetente, sipas rastit, në mënyrë që të sigurojnë që ato gjoba ose masa administrative të japin rezultatet e duhura dhe efektive.

2. Kur gjobat dhe masat administrative përfshijnë elemente ndërkufitare, mbikëqyrësit koordinojnë veprimet me autoritetet homologe, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

Neni 64

Masat mbikëqyrëse ndaj degëve të subjekteve të detyruara dhe ndaj disa veprimtarive të ushtruara në bazë të lirisë së ofrimit të shërbimeve

1. Në rastin e degëve ose formave të tjera të pranisë së subjekteve të detyruara, të cilat nuk kualifikohen si institucione krediti ose institucione financiare, si dhe të llojeve të caktuara të ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve të detyruara mbi të cilat autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar pritës ushtron mbikëqyrje në përputhje me nenin 45, pika 1, të këtij ligji, zbatohen pikat 2 deri në 5 të këtij neni.

2. Kur autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar pritës konstaton shkelje të detyrimeve ligjore nga një subjekt i detyruar që ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet një dege, forme tjetër të pranisë ose sipas një prej llojeve të ushtrimit të veprimtarisë të përmendura në pikën 1 të këtij neni, ai i kërkon subjektit të detyruar të marrë masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe informon autoritetin mbikëqyrës të shtetit anëtar të origjinës për shkeljet e konstatuara në lidhje me subjektin e detyruar, si dhe për kërkesën e drejtuar atij për përmbushjen e detyrimeve ligjore.

3. Nëse subjekti i detyruar nuk merr masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore, autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar pritës informon autoritetin mbikëqyrës të shtetit anëtar të origjinës për këtë fakt.

Autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës vepron pa vonesë dhe merr të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që subjekti i detyruar të korrigjojë shkeljet e konstatuara në degën ose formën tjetër të pranisë së tij, ose në kuadër të llojit përkatës të ushtrimit të veprimtarisë në shtetin anëtar pritës.

Autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës informon autoritetin mbikëqyrës të shtetit anëtar pritës për masat e ndërmarra në zbatim të kësaj pike.

4. Me përjashtim nga pika 3 e këtij neni, në rastet e shkeljeve serioze, të përsëritura ose sistematike nga subjektet e detyruara që ushtrojnë veprimtari nëpërmjet degëve, formave të tjera të pranisë ose sipas një prej llojeve të ushtrimit të veprimtarisë të përmendura në pikën 1 të këtij neni, të cilat kërkojnë masa korrigjuese të menjëhershme, autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar pritës mund, me nismën e vet, të marrë masa të përshtatshme dhe proporcionale për adresimin e këtyre shkeljeve.

Këto masa kanë karakter të përkohshëm dhe ndërpriten sapo shkeljet e konstatuara të jenë korrigjuar, përfshirë rastet kur korrigjimi realizohet me asistencën ose në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës të shtetit anëtar të origjinës të subjektit të detyruar.

Autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar pritës informon menjëherë autoritetin mbikëqyrës të shtetit anëtar të origjinës të subjektit të detyruar sapo identifikon shkelje serioze, të përsëritura ose sistematike, si dhe për çdo masë të marrë në përputhje me paragrafin e mësipërm, përveç rasteve kur masat ndërmerren në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës të shtetit të origjinës.

5. Në rast se autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës dhe autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar pritës nuk bien dakord mbi masat që duhet të merren ndaj një subjekti të detyruar, ata mund t'ia referojnë çështjen AMLA-s dhe të kërkojnë asistencën e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian. AMLA jep mendimin e saj për çështjen objekt mosmarrëveshjeje brenda 1 muaji.

6. Ky nen zbatohet në të njëjtën mënyrë kur autoritetet mbikëqyrëse ushtrojnë kompetencat e mbikëqyrësit të shtetit të origjinës ose të mbikëqyrësit të shtetit pritës, në kuadër të bashkëpunimit me shtete anëtare ose me vende të treta, në përputhje me përcaktimet e lejuara nga ky ligj.

Neni 65

Gjobat

1. Autoritetet mbikëqyrëse, sipas kompetencave të tyre të përcaktuara në nenin 40, pika 2, të këtij ligji, vendosin gjoba ndaj subjekteve të detyruara për shkelje të përcaktuara në dispozitat e Pjesës I të këtij ligji, si më poshtë:

a) për rastet kur nuk respektohen urdhrat, kërkesat ose afatet e njoftuara nga autoriteti përgjegjës në zbatim të neneve 18, 26 dhe 27 të këtij ligji, si dhe urdhrat ose kërkesat e autoriteteve mbikëqyrëse në zbatim të dispozitave të këtij ligji, personat përgjegjës dhe/ose subjektet e detyruara gjobiten nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 20 000 000 (njëzet milionë) lekë;

b) për rastet kur nuk janë zbatuar masat administrative të vendosura nga mbikëqyrësit në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, si dhe për shkelje që nuk kualifikohen si serioze, të përsëritura ose sistematike, subjektet gjobiten nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë;

c) për rastet kur subjektet e detyruara nuk regjistrohen në sistemin elektronik të raportimit të administruar nga autoriteti përgjegjës për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në këtë ligj, subjektet gjobiten nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Autoritetet mbikëqyrëse vendosin gjoba ndaj subjekteve të detyruara për shkelje të rënda, të përsëritura ose sistematike, të kryera me dashje ose nga pakujdesia, të detyrimeve të përcaktuara në dispozitat e Pjesës II të këtij ligji, si më poshtë:

a) për rastet kur nuk zbatohen detyrimet në lidhje me masat për politikën, procedurat dhe kontrollet e brendshme, të përcaktuara në Kreun II, nenet 91 deri në nenin 100 të këtij ligji, subjektet gjobiten nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë;

b) për rastet kur nuk zbatohen detyrimet në lidhje me masat për vigjilencën e duhur ndaj klientit, të përcaktuara në Kreun III, nenet 101 deri në nenin 131 të këtij ligji, subjektet gjobiten

nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

c) për rastet kur nuk zbatohen detyrimet në lidhje me detyrimin për raportim, të përcaktuara në Kreun IV, nenet 132 deri tek neni 137 i këtij ligji, subjektet gjobiten nga 300 000 (treqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

d) për rastet kur nuk zbatohen detyrimet në lidhje me zbatimin e masave për ruajtjen e të dhënave, të përcaktuara në nenin 140 të këtij ligji, subjektet gjobiten nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 8 000 000 (tetë milionë) lekë;

e) për rastet kur nuk zbatohen detyrimet në lidhje me detyrimin për raportim të përcaktuara në nenin 143, pika 4, e këtij ligji, subjektet gjobiten nga 300 000 (treqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

3. Autoritetet mbikëqyrëse vendosin gjopa ndaj subjekteve të detyruara për shkelje të rënda, të përsëritura ose sistematike, të kryera me dashje ose nga pakujdesia, të detyrimeve të përcaktuara në Pjesën III të këtij ligji, si më poshtë:

a) mospërmbushja nga një ofrues i shërbimit të pagesave për të shoqëruar transfertat e fondeve me informacionin e kërkuar mbi paguesin ose përfituesin e pagesës, në shkelje të neneve 151, 152 ose 153 të këtij ligji, ose nga një ofrues i shërbimit të krypto-aseteve për të shoqëruar transfertat e krypto-aseteve me informacionin e kërkuar mbi nismëtarin dhe përfituesin, në shkelje të nenit 161 ose nenit 162 të këtij ligji, subjektet gjobiten nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

b) mospërmbushja nga një ofrues i shërbimit të pagesave ose ofrues i shërbimit të krypto-aseteve për të ruajtur të dhënat, në shkelje të nenit 173 të këtij ligji, subjektet gjobiten nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

c) mospërmbushja nga një ofrues i shërbimit të pagesave për të zbatuar procedura efektive të bazuara në rrezik, në shkelje të nenit 155 ose nenit 159 të këtij ligji, ose nga një ofrues i shërbimit të krypto-aseteve për të zbatuar procedura efektive të bazuara në rrezik, në shkelje të nenit 164 të këtij ligji, subjektet gjobiten nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

d) mospërmbushja nga një ofrues ndërmjetës i shërbimit të pagesave për të zbatuar nenin 158 ose 159 ose nga një ofrues ndërmjetës i shërbimit të krypto-aseteve për të zbatuar nenet 166, 167 ose 168 të këtij ligji, subjektet gjobiten nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

e) mospërmbushja nga një ofrues i shërbimit të pagesave për të zbatuar nenin 156 ose nga një ofrues i shërbimit të krypto-aseteve për të zbatuar nenin 165 të këtij ligji, subjektet gjobiten nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë;

f) mospërmbushja nga një ofrues ndërmjetës i shërbimit të pagesave për të zbatuar nenin 160 ose nga një ofrues ndërmjetës i shërbimit të krypto-aseteve për të zbatuar nenin 169 të këtij ligji, subjektet gjobiten nga 200 000 (dyqind mijë) lekë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

4. Përveç sa parashikohet në pikat më sipër të këtij neni, kur subjekti është një person juridik dhe kundërvajtja administrative është kryer:

a) nga një punonjës jo në nivel të lartë dhe/ose administrimi, apo agjent, personi apo agjenti që ka kryer shkeljen gjobitet nga 20 000 (njëzet mijë) lekë deri në 300 000 (treqind mijë) lekë;

b) nga një administrator ose drejtues i subjektit, personi që ka kryer shkeljen gjobitet nga 40 000 (dyzet mijë) lekë deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë.

5. Për rastet e parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, autoritetet mbikëqyrëse mund të vendosin gjobë maksimale të paktën dyfishin e shumës së përfitimit të realizuar nga shkelja, kur ky përfitim mund të përcaktohet, ose jo më të vogël se 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, cilado prej tyre të jetë më e lartë.

6. Në përjashtim nga sa është parashikuar në pikën 5 të këtij neni, kur subjekti i detyruar është institucion krediti ose institucion financiar, mund të vendosen edhe gjobat e mëposhtme:

a) në rastin e një personi juridik, gjobë maksimale në një shumë jo më të vogël se 1 000 000 000 (një miliard) lekë, ose 10 % të qarkullimit total vjetor sipas pasqyrave financiare më të fundit të miratuara nga organi drejtues, cilado prej tyre të jetë më e lartë;

kur subjekti i detyruar është shoqëri mëmë ose filial i një shoqërie mëmë që është e detyruar të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe raportimin financiar, qarkullimi total vjetor përkatës është qarkullimi total vjetor ose lloji përkatës i të ardhurave në përputhje me regjimin kontabël të zbatueshëm bazuar në pasqyrat financiare më të fundit të konsoliduara të disponueshme, të miratuara nga organi drejtues i shoqërisë mëmë përfundimtare.

b) në rastin e një personi fizik, gjobë maksimale në një shumë jo më të vogël se 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë.

7. Autoritetet mbikëqyrëse mund të vendosin gjoba që tejkalojnë shumat e përmendura në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.

8. Në përcaktimin e masës së gjobës, autoriteti mbikëqyrës merr në konsideratë aftësinë paguese të subjektit të detyruar. Kur vendosja e gjobës mund të ndikojë në përputhshmërinë me rregullat e mbikëqyrjes së kujdesshme, autoriteti mbikëqyrës, përpara vendosjes së saj, konsultohet me autoritetet kompetente të fushës.

Neni 66

Masat për mosdhënien e aksesit ose pengimin e funksioneve të Agjencisë së Inteligjencës Financiare

1. Shkeljet e subjekteve të detyruara që lidhen me mosraportimin, mosdhënien e informacionit, mosrespektimin e afateve të përcaktuara nga Agjencia e Inteligjencës Financiare ose moszbatimin e urdhrave të saj trajtohen sipas neneve 65 dhe 67 të këtij ligji.

2. Kur një autoritet publik, person juridik publik ose privat, ose çdo subjekt tjetër që nuk është subjekt i detyruar, por administron informacion të nevojshëm për Agjencinë e Inteligjencës Financiare, refuzon ose pengon aksesin në këtë informacion, siguron akses të pjesshëm ose të vonuar, jep informacion të pasaktë ose të filtruar, nuk vë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar ose nuk respekton afatet e përcaktuara nga Agjencia, pa shkaqe të arsyeshme, ndaj tij vendoset gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

3. Kur refuzimi, vonesa, filtrimi, kufizimi ose mosdhënia e aksesit kryhen në mënyrë të qëllimshme, të përsëritur ose sistematike, ose cenojnë analizën financiare, bllokimin e fondeve, mosdhënien e pëlqimit për kryerjen e një transaksioni, shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit ose identifikimin e një rasti që i nënshtrohet detyrimit për raportim, ndaj subjektit shkelës vendoset gjobë nga 5 000 000 (pesë milionë) lekë deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë.

4. Përveç gjobës, Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të urdhërojë dhënien e

menjëhershme të aksesit, dokumentacionit ose informacionit, ruajtjen dhe mosndryshimin e të dhënave, të japë paralajmërim me shkrim, si dhe të njoftojë autoritetin mbikëqyrës, licencues ose disiplinor për marrjen e masave përkatëse, brenda kompetencave të tij.

5. Vendosja e masave administrative dhe gjobave sipas këtij neni nuk përjashton përgjegjësinë penale, civile ose disiplinore, kur shkelja përbën veprë penale ose sjell përgjegjësi tjetër sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 67

Masat administrative

1. Autoritetet mbikëqyrëse vendosin masa administrative ndaj një subjekti të detyruar kur konstatojnë:

a) shkelje të dispozitave të Pjesës II ose Pjesës III të këtij ligji, të shoqëruara me gjobë në rastin e shkeljeve të rënda, të përsëritura ose sistematike, ose si masa të pavarura;

b) mangësi në politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme të subjektit të detyruar, të cilat mund të çojnë në shkeljen e kërkesave të përmendura në germën “a” të kësaj pike, kur masat administrative mund të parandalojnë kryerjen e këtyre shkeljeve ose të zvogëlojnë rrezikun e tyre;

c) se politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme të subjektit të detyruar nuk janë në përputhje me rreziqet e pastrimit të parave dhe veprave penale të lidhura me të, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë ndaj të cilave subjekti është i ekspozuar.

2. Autoritetet mbikëqyrëse kanë, të paktën, këto kompetenca:

a) të japin rekomandime;

b) të japin paralajmërime;

c) të urdhërojnë subjektin e detyruar të përmbushë detyrimet e parashikuara në këtë ligj, përfshirë zbatimin e masave të veçanta korrigjuese;

d) të bëjnë një shpallje publike që identifikon personin fizik ose juridik përgjegjës dhe natyrën e shkeljes;

e) të urdhërojnë personin fizik ose juridik të ndërpresë sjelljen që përbën shkelje dhe të mos e përsërisë atë;

f) të kufizojnë ushtrimin e veprimtarisë, operacionet ose rrjetin e institucioneve që janë pjesë përbërëse e subjektit të detyruar, ose të kërkojnë heqjen dorë nga ushtrimi i veprimtarive të caktuara;

g) të kërkojnë, kur subjekti i detyruar ushtron veprimtarinë në bazë të një autorizimi ose licence, revokimin ose pezullimin e autorizimit ose licencës;

h) të kërkojnë ndryshime në strukturën e drejtimit të subjektit të detyruar.

3. Autoritetet mbikëqyrëse, nëpërmjet masave administrative të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, kanë kompetencë, në veçanti, të:

a) kërkojnë, pa vonesë të pajustificuar, vënien në dispozicion të çdo të dhëne apo informacioni të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre, në përputhje me këtë Kre të Pjesës I të ligjit, të kërkojnë dorëzimin e çdo dokumenti, ose të vendosin kërkesa shtesë ose më të shpeshta për raportim;

b) kërkojnë përforcimin e politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme;

c) kërkojnë nga subjekti i detyruar të zbatojë një politikë ose kërkesa të veçanta në

lidhje me kategori klientësh ose klientë individuale, transaksione, aktivitete ose kanale të ofrimit të shërbimeve që paraqesin rrezik të lartë;

d) kërkojnë zbatimin e masave për reduktimin e rreziqeve të identifikuar të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit ose financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë që lidhen me aktivitetet dhe produktet e subjektit të detyruar;

e) vendosin ndalim të përkohshëm ndaj çdo personi që ushtron funksione të drejtimit të lartë në një subjekt të detyruar, ose ndaj çdo personi tjetër fizik të konstatuar përgjegjës për shkeljen, për të ushtruar funksione drejtuese në subjekte të detyruara.

4. Masat administrative të parashikuara në pikën 2 të këtij neni duhet të shoqërohen, kur është e nevojshme, me afate të detyrueshme për zbatimin e tyre.

Subjektet e detyruara janë të detyruara t'i zbatojnë masat administrative brenda afateve të përcaktuara.

Autoritetet mbikëqyrëse ndjekin dhe vlerësojnë zbatimin nga subjekti i detyruar të masave administrative dhe veprimeve të kërkuara.

5. Autoritetet mbikëqyrëse mund të vendosin edhe lloje të tjera masash administrative, përveç atyre të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 68

Gjoba periodike

1. Kur subjekti i detyruar ose personi ndaj të cilit është vendosur masa administrative nuk përmbush, brenda afateve të përcaktuara, masat administrative të vendosura nga autoriteti mbikëqyrës në përputhje me nenin 67, pika 2, germet “c”, “e”, “f” dhe “h”, autoriteti mbikëqyrës ka kompetencën të vendosë gjoba periodike me qëllim detyrimin e subjektit të detyruar ose të personit përkatës për zbatimin e këtyre masave.

2. Gjobat periodike duhet të jenë efektive dhe proporcionale. Gjobat periodike zbatohen deri në momentin kur subjekti i detyruar ose personi përkatës përmbush masën administrative përkatëse.

3. Pavarësisht nga pika 2 e këtij neni, në rastin e personave juridikë, shuma e gjobës periodike nuk mund të kalojë 3 % të qarkullimit mesatar ditor të realizuar gjatë vitit financiar paraardhës.

Në rastin e personave fizikë, shuma e gjobës periodike nuk mund të kalojë 2 % të të ardhurave mesatare ditore të realizuara gjatë vitit kalendarik paraardhës.

4. Gjobat periodike vendosen për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj nga data e vendimit të autoritetit mbikëqyrës.

Nëse, me përfundimin e kësaj periudhe, subjekti i detyruar ose personi përkatës nuk ka përmbushur ende masën administrative, autoriteti mbikëqyrës ka kompetencën të vendosë gjoba periodike për një periudhë shtesë jo më të gjatë se 6 muaj.

5. Vendimi për vendosjen e gjobës periodike mund të merret nga data e vendosjes së masës administrative përkatëse. Gjoba periodike zbatohet nga data e marrjes së vendimit për vendosjen e saj.

Neni 69

Publikimi i gjobave, masave administrative dhe gjobave periodike

1. Mbikëqyrësit publikojnë në faqen e tyre zyrtare të internetit, në një format të aksesueshëm për publikun, vendimet për vendosjen e gjobave, vendimet për vendosjen e masave administrative të parashikuara në nenin 67, pika 2, germa “d” deri në “g”, në rastet e parashikuara në nenin 67, pika 1, germa “a”, si dhe vendimet për vendosjen e gjobave periodike sipas nenit 68 të këtij ligji.

2. Vendimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni publikohen nga mbikëqyrësi menjëherë pasi personat përgjegjës për shkeljen janë njoftuar në lidhje me to.

Përfshihet nga paragrafi i parë, kur publikimi ka të bëjë me masa administrative ndaj të cilave lejohet ankimi dhe që nuk synojnë korrigjimin e shkeljeve serioze, të përsëritura ose sistematike, publikimi mund të shtyhet deri në përfundimin e afatit për paraqitjen e ankimit.

Kur publikimi i referohet vendimeve ndaj të cilave është paraqitur ankim, mbikëqyrësi publikon menjëherë në faqen e tij zyrtare informacion mbi ankimin dhe çdo informacion të mëvonshëm lidhur me të, si dhe rezultatin përfundimtar të tij.

Gjithashtu pjesë e publikimit është edhe çdo vendim që shfuqizon një vendim të mëparshëm për vendosjen e gjobës administrative, aplikimin e masës administrative ose vendosjen e gjobës periodike.

3. Në publikimin e vendimeve përfshihet, të paktën:

- a) informacioni mbi llojin dhe natyrën e shkeljes;
- b) identiteti i personave përgjegjës;
- c) në rastin e gjobave dhe gjobave periodike, përfshihen shuma e tyre.

Mbikëqyrësit nuk janë të detyruar të zbatojnë paragrafin e parë të kësaj pike për vendimet që parashikojnë masa administrative me natyrë hetimore ose për vendimet e marra në përputhje me nenin 67, pika 2, germa “a” dhe “d”, të këtij ligji.

4. Kur publikimi i identitetit të personave përgjegjës ose i të dhënave personale të tyre vlerësohet nga mbikëqyrësi, pas një vlerësimi rast pas rasti, si jo proporcional, ose kur publikimi rrezikon stabilitetin e tregjeve financiare apo një hetim në vijim, autoriteti mbikëqyrës:

a) shtyn publikimin e vendimit deri në momentin kur pushojnë së ekzistuari arsyet që justifikojnë mospublikimin e tij;

b) publikon vendimin në mënyrë anonime, në përputhje me legjislacionin e fushës në fuqi, nëse një publikim i tillë siguron mbrojtjen efektive të të dhënave personale përkatëse; në këtë rast, publikimi i të dhënave përkatëse mund të shtyhet për një periudhë të arsyeshme, nëse parashikohet që brenda kësaj periudhe të pushojnë së ekzistuari arsyet që justifikojnë publikimin në mënyrë anonime;

c) nuk publikon vendimin, kur vlerësohet se masat e parashikuara në germa “a” dhe “b” nuk janë të mjaftueshme për të garantuar njërin nga kushtet e mëposhtme:

- i. që stabiliteti i tregjeve financiare të mos vihet në rrezik;
- ii. të garantohet proporcionaliteti i publikimit të vendimit në raport me gjobat ose masat administrative të vendosura për shkelje të vlerësuara si të natyrës së lehtë.

Vlerësimi i proporcionalitetit bëhet rast pas rasti dhe arsyetohet në vendimin përkatës.

5. Publikimet e bëra në përputhje me këtë nen qëndrojnë në faqen zyrtare të mbikëqyrësit për një periudhë prej 5 vitesh nga data e publikimit.

Të dhënat personale të përfshira në publikim ruhen në faqen zyrtare vetëm për aq kohë sa është e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe, në çdo rast, jo më shumë se 5 vjet.

Neni 70

Kompetencat e mbikëqyrësve për vendosjen dhe ekzekutimin e masave administrative dhe gjobave

1. Vendosja dhe zbatimi i masave administrative, si dhe vendosja dhe ekzekutimi i gjobave dhe gjobave periodike sipas këtij ligji, bëhet nga mbikëqyrësit, brenda fushës së kompetencës së tyre dhe në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin sektorial përkatës.
2. Mbikëqyrësit ushtrojnë këto kompetenca në përputhje me këtë ligj, legjislacionin sektorial përkatës dhe legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.
3. Vendimet e mbikëqyrësve për vendosjen e gjobave, masave administrative dhe gjobave periodike mund të ankimohen në gjykatën kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Procedurat e konstatimit, propozimit, shqyrtimit dhe vendosjes së masave administrative, gjobave dhe gjobave periodike nga mbikëqyrësit përcaktohen me akt nënligjor.
5. Procedurat e ankimit dhe ekzekutimit të gjobave të vendosura nga mbikëqyrësit kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 71

Parashkrimi i procedimit administrativ

1. E drejta e mbikëqyrësve për të konstatuar kundërvajtjet administrative dhe për të vendosur gjoba dhe masa administrative sipas këtij ligji parashkruhet me kalimin e 5 vjetëve nga data e kryerjes së kundërvajtjes administrative.
2. Afati i parashkrimit ndërpritet nga data e njoftimit të subjektit të detyruar me çdo akt formal të mbikëqyrësit që lidhet me konstatimin ose procedimin administrativ të kundërvajtjes.

Neni 72

Shkëmbimi i informacionit mbi gjobat dhe masat administrative

1. Mbikëqyrësit dhe, kur është e nevojshme, autoriteti publik që mbikëqyr organet vetërregulluese në ushtrimin e funksioneve të tyre mbikëqyrëse, njoftojnë AMLA për të gjitha masat administrative dhe gjobat e vendosura në përputhje me këtë Seksion, duke përfshirë çdo ankim të paraqitur lidhur me to dhe rezultatin përfundimtar të tyre.
2. Informacioni i parashikuar në pikën 1 të këtij neni do të shkëmbehet edhe me mbikëqyrës të tjerë, kur masa administrative ose gjoba e vendosur ka të bëjë me një subjekt që ushtron veprimtari në dy ose më shumë shtete anëtare.
3. AMLA mban në faqen e saj zyrtare të internetit lidhjet elektronike me publikimet e secilit mbikëqyrës, të bëra në përputhje me nenin 69 të këtij ligji, për gjobat e vendosura dhe masat administrative të zbatuara, si dhe pasqyron periudhën për të cilën secili shtet anëtar publikon gjobat dhe masat administrative.

Seksioni 5

Raportimi i shkeljeve

Mekanizmat për raportimin e shkeljeve dhe mbrojtja e personave raportues

1. Dispozitat e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve zbatohen për raportimin e shkeljeve të këtij ligji, të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, si dhe të çdo akti tjetër normativ që rregullon parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

2. Mbrojtja sipas ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve zbatohet ndaj:

a) personave që raportojnë shkelje sipas pikës 1 të këtij neni;

b) personave që janë objekt i raportimeve.

3. Për qëllime të këtij neni, “raportim i shkeljeve” nënkupton raportimin e çdo veprimi ose mosveprimi që përbën mospërmbyllje të detyrimeve të parashikuara në aktet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

4. Autoritetet mbikëqyrëse, sipas kompetencave të përcaktuara në këtë ligj, janë autoritetet kompetente për krijimin dhe administrimin e kanaleve të jashtme të raportimit të shkeljeve që lidhen me kërkesat e zbatueshme ndaj subjekteve të detyruara që ato mbikëqyrin. Autoritetet mbikëqyrëse kryejnë shqyrtimin dhe ndjekjen administrative të raportimeve të paraqitura, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e sinjalizuesve.

5. Autoritetet publike që mbikëqyrin organet vetërregulluese, sipas nenit 60 të këtij ligji, janë autoritetet kompetente për krijimin dhe administrimin e kanaleve të jashtme të raportimit dhe për ndjekjen e raportimeve të paraqitura nga organet vetërregulluese dhe personeli i tyre, për aq sa raportimet lidhen me kërkesat e zbatueshme ndaj organeve vetërregulluese në ushtrimin e funksioneve të tyre mbikëqyrëse në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Këto autoritete kryejnë shqyrtimin dhe ndjekjen administrative të raportimeve të paraqitura, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e sinjalizuesve.

6. Autoritetet e përcaktuara në pikat 4 dhe 5 të këtij neni miratojnë akte të brendshme për organizimin dhe funksionimin e kanaleve të raportimit, procedurat e pranimit, regjistrimit dhe shqyrtimit të raportimeve, si dhe për garantimin e konfidencialitetit, mbrojtjes së personave raportues dhe shmangies së konfliktit të interesit në trajtimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e sinjalizuesve.

7. Autoritetet mbikëqyrëse në sektorin jo financiar përgatisin dhe i përcjellin autoritetit përgjegjës dhe AMLA-s, mbi baza vjetore, informacion që përfshin:

a) numrin e raportimeve të marra, si dhe informacion mbi pjesën e raportimeve që janë ndjekur ose janë në proces ndjekjeje, përfshirë rastet e mbyllura, rastet e hapura dhe raportimet për të cilat është vendosur mosvijimi;

b) llojet e parregullsive apo shkeljeve të raportuara;

c) për raportimet që janë ndjekur, një përshkrim të veprimeve të ndërmarra nga autoriteti mbikëqyrës, si dhe, për raportimet që janë ende të hapura, veprimet që autoriteti mbikëqyrës synon të ndërmarrë;

d) për raportimet për të cilat është vendosur mosvijimi ose pushimi i shqyrtimit, arsyet përkatëse të këtij vendimi.

Raporti vjetor sipas kësaj pike nuk përmban të dhëna mbi identitetin, profesionin ose çdo informacion tjetër që mund të çojë në identifikimin e personave raportues.

KREU IV BASHKËPUNIMI

Seksioni 1

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërinstytucional në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Neni 74

Dispozita të përgjithshme

1. Institucionet përgjegjëse për hartimin e politikave, Agjencia e Inteligjencës Financiare, autoritetet mbikëqyrëse, përfshirë AMLA, dhe autoritetet e tjera kompetente, si dhe administrata tatimore, sigurojnë funksionimin efektiv të mekanizmave të krijuar për bashkëpunimin dhe bashkërendimin në nivel kombëtar, sipas përcaktimeve në nenin 9 të këtij ligji, për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, si dhe për parandalimin e moszbatimit dhe shmangies së masave shtrënguese financiare, duke përfshirë edhe përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

2. Autoritetet kompetente që kanë akses ose disponojnë informacion mbi pronësinë përfituese, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për regjistrin e pronarëve përfitues, vënë në dispozicion këtë informacion autoriteteve homologe kompetente të shteteve anëtare ose vendeve të treta, në kohën e duhur dhe pa pagesë.

3. Autoritetet kompetente nuk duhet të ndalojnë ose të vendosin kushte të paarsyeshme ose tepër kufizuese për shkëmbimin e informacionit ose dhënien e ndihmës midis autoriteteve kompetente dhe homologëve të tyre për qëllimet e zbatimit të këtij ligji. Autoritetet kompetente nuk duhet të refuzojnë një kërkesë për ndihmë me arsyetimin se:

- a) kërkesa konsiderohet se përfshin edhe çështje tatimore;
- b) legjislacioni kombëtar kërkon ruajtjen e sekretit ose konfidencialitetit nga subjektet raportuese, përveç rasteve kur informacioni i kërkuar mbrohet nga sekreti profesional, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 133, pika 2, të këtij ligji;
- c) është në zhvillim një verifikim, hetim, procedim ose analizë nga autoriteti përgjegjës, përveç rasteve kur dhënia e ndihmës do të pengonte drejtpërdrejt këtë verifikim, hetim, procedim ose analizë;
- d) natyra ose statusi i autoritetit kompetent homolog kërkuar është i ndryshëm nga natyra ose statusi i autoritetit kompetent të cilit i kërkohet ndihma.

Neni 75

Komunikimi i listës së autoriteteve kompetente

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare, për qëllime të lehtësimit dhe promovimit të bashkëpunimit efektiv dhe shkëmbimit të informacionit, i komunikon Komisionit Evropian dhe AMLA-s:

- a) listën e mbikëqyrësve përgjegjës për mbikëqyrjen e përputhshmërisë së subjekteve

të detyruara me Pjesën II të këtij ligji, si dhe, kur është e nevojshme, emrin e autoritetit publik që mbikëqyr organet vetërregulluese në kryerjen e funksioneve të tyre mbikëqyrëse në përputhje me këtë ligj, së bashku me të dhënat përkatëse të kontaktit;

b) të dhënat e kontaktit të Agjencisë së Inteligjencës Financiare, në cilësinë e saj si njësi e inteligjencës financiare;

c) listën e autoriteteve të tjera kompetente kombëtare.

2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, të dhënat e kontaktit përfshijnë:

a) një pikë kontakti ose, në mungesë të saj, emrin dhe funksionin e personit të kontaktit;

b) adresën elektronike (email) dhe numrin e telefonit të pikës së kontaktit ose, në mungesë të saj, adresën elektronike profesionale (email) dhe numrin e telefonit të personit të kontaktit.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare siguron që informacioni i komunikuar sipas pikës 1 të këtij neni të përditësohet pa vonesë, sapo të ndodh një ndryshim në të dhënat përkatëse.

4. Autoritetet kompetente të përfshira në listën e komunikimit sipas këtij neni, brenda fushës së kompetencave të tyre, shërbejnë si pikë kontakti për autoritetet homologe të shteteve anëtare.

5. Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe autoritetet mbikëqyrëse, brenda kompetencave të tyre, shërbejnë si pikë kontakti për AMLA-n.

Neni 76

Bashkëpunimi me AMLA

Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe autoritetet mbikëqyrëse bashkëpunojnë me AMLA-n dhe i vënë në dispozicion çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të saj, në përputhje me përcaktimet e lejuara nga ky ligj.

Seksioni 2

Bashkëpunimi me autoritete të tjera dhe shkëmbimi i informacionit konfidencial

Neni 77

Bashkëpunimi në lidhje me institucionet e kreditit ose institucionet financiare

1. Mbikëqyrësit financiarë, Agjencia e Inteligjencës Financiare, autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit ose institucioneve financiare sipas legjislacionit sektorial në fuqi dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare bashkëpunojnë ngushtë ndërmjet tyre, brenda kompetencave të tyre dhe i vënë në dispozicion njëri-tjetrit informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre përkatëse.

2. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk duhet të cenojë asnjë procedurë verifikimi apo shqyrtimi paraprak, analizë të njërive të inteligjencës financiare, hetim apo procedim penal, në përputhje me legjislacionin penal ose administrativ në fuqi të shtetit ku ndodhet mbikëqyrësi financiar ose autoriteti i ngarkuar me kompetenca për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit ose institucioneve financiare, si dhe nuk duhet të ndikojë në detyrimin për ruajtjen e sekretit profesional, siç parashikohet në nenin 80, pika 1 e këtij ligji.

3. Në rastet kur mbikëqyrësi financiar identifikon mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm për PPP/FT dhe zbatimin e kërkesave të Pjesës II të këtij ligji nga një institucion krediti, të cilat rrisin ndjeshëm rrezikun ndaj të cilit institucioni është ose mund të jetë i ekspozuar, mbikëqyrësi financiar njofton menjëherë Autoritetin Bankar Evropian (EBA) dhe autoritetin kompetent për mbikëqyrjen e institucionit të kreditit sipas Direktivës 2013/36/BE, përfshirë Bankën Qendrore Evropiane (ECB) që vepron në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 1024/2013.

Në rastet e një rreziku të mundshëm në rritje, mbikëqyrësit financiarë duhet të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion me autoritetet kompetente që mbikëqyrin institucionin në përputhje me Direktivën 2013/36/BE dhe të hartojnë një vlerësim të përbashkët që duhet t'i njoftohet EBA-s nga mbikëqyrësi që ka bërë njoftimin fillestar. AMLA duhet të mbahet e informuar për çdo njoftim të tillë.

4. Në rastet kur mbikëqyrësi financiar konstaton se një institucion krediti ka refuzuar të krijojë ose ka vendosur të ndërpresë një marrëdhënie biznesi, por dokumentimi i masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit, në përputhje me nenin 103, pika 3, të këtij ligji, nuk e justifikon këtë refuzim ose ndërprerje, ai duhet të njoftojë autoritetin kompetent mbikëqyrës për të siguruar përputhshmërinë e atij institucioni krediti me Direktivën 2014/92/BE ose Direktivën 2015/2366/BE.

5. Mbikëqyrësit financiarë duhet të bashkëpunojnë me autoritetet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, siç përcaktohet në nenin 2(1), pika (18), të Direktivës 2014/59/BE ose me autoritetet e caktuara, siç përcaktohet në nenin 2(1), pika (18), të Direktivës 2014/49/BE.

Mbikëqyrësit financiarë duhet të informojnë autoritetet e përmendura në këtë pikë kur, gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre mbikëqyrëse, ata identifikojnë, për çështje që lidhen me PPP/FT, një nga situatat e mëposhtme:

a) një probabilitet të shtuar që depozitat të bëhen të padisponueshme;

b) ekziston një rrezik që një institucion krediti ose institucion financiar të konsiderohet se është ose mund të jetë në kushtet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme sipas nenit 32(4) të Direktivës 2014/59/BE.

Me kërkesë të autoriteteve të përmendura në paragrafin e mësipërm, kur ekziston një probabilitet i shtuar që depozitat të bëhen të padisponueshme ose rreziku që një institucion krediti ose institucion financiar të konsiderohet se plotëson kushtet për ndërhyrje të jashtëzakonshme sipas nenit 32(4) të Direktivës 2014/59/BE, mbikëqyrësit financiarë duhet t'i informojnë këto autoritete për çdo transaksion, llogari ose marrëdhënie biznesi të administruar nga ai institucion krediti ose institucioni financiar që është bllokuar apo nuk është dhënë pëlqimi për kryerjen e transaksioneve nga njësia e inteligjencës financiare në përputhje me nenin 26 të këtij ligji.

6. Mbikëqyrësit financiarë duhet të raportojnë çdo vit te AMLA mbi bashkëpunimin e tyre me autoritetet e tjera në përputhje me këtë nen, duke përfshirë rolin e Agjencisë së Inteligjencës Financiare në këtë bashkëpunim.

7. Ministri përgjegjës për financat, me propozimin e autoritetit përgjegjës, nxjerr me udhëzim, brenda gjashtë muajve nga data e nxjerrjes së akteve nga AMLA, udhëzime mbi bashkëpunimin midis mbikëqyrësve financiarë dhe autoriteteve të përmendura në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij neni, duke përfshirë nivelin e përfshirjes së autoritetit përgjegjës në këtë bashkëpunim.

Neni 78

Bashkëpunimi në lidhje me audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit

1. Autoritetet mbikëqyrëse për audituesit ligjorë, Agjencia e Inteligjencës Financiare, autoriteti publik kompetent për mbikëqyrjen e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit dhe autoritetet homologe të shteteve anëtare, bashkëpunojnë ngushtë ndërmjet tyre, brenda fushës së kompetencave përkatëse dhe shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për ushtrimin e detyrave të tyre përkatëse.

2. Informacioni konfidencial i shkëmbyer në përputhje me këtë nen përdoret nga autoritetet e përmendura në pikën 1 vetëm për ushtrimin e funksioneve të tyre sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi, ligjeve sektoriale që rregullojnë fushën e mbikëqyrjes së auditimit ligjor, si dhe në kuadër të procedurave administrative ose gjyqësore që lidhen posaçërisht me ushtrimin e këtyre funksioneve.

3. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve të përmendura në pikën 1 të këtij neni mund të kufizohet ose të ndalohet në rastet kur një bashkëpunim i tillë do të cenonte një procedurë verifikimi ose shqyrtimi paraprak, analizat e kryera nga Agjencia e Inteligjencës Financiare, procedimet hetimore ose penale, apo procedimet administrative, në përputhje me legjislacionin penal apo administrativ në fuqi.

Neni 79

Bashkëpunimi me autoritetet përgjegjëse për zbatimin e masave shtrënguese financiare

1. Autoritetet mbikëqyrëse, Agjencia e Inteligjencës Financiare, autoritetet përgjegjëse për zbatimin e masave shtrënguese financiare sipas legjislacionit në fuqi dhe autoritetet homologe përkatëse të shteteve anëtare bashkëpunojnë ngushtë ndërmjet tyre, brenda kompetencave përkatëse dhe shkëmbejnë me njëri-tjetrin informacionin që është i rëndësishëm për ushtrimin e detyrave të tyre përkatëse.

2. Informacioni konfidencial i shkëmbyer në përputhje me këtë nen përdoret nga autoritetet e përmendura në pikën 1 vetëm për ushtrimin e funksioneve të tyre sipas këtij ligji, ligjeve sektoriale, si dhe në kuadër të procedimeve administrative ose gjyqësore që lidhen posaçërisht me ushtrimin e këtyre funksioneve.

3. Bashkëpunimi, përfshirë shkëmbimin e informacionit, ndërmjet autoriteteve të përmendura në pikën 1 të këtij neni mund të kufizohet ose të ndalohet kur një bashkëpunim i tillë do të cenonte një procedurë verifikimi ose shqyrtimi paraprak, një hetim në proces, ose procedime penale ose administrative, në përputhje me legjislacionin penal ose administrativ në fuqi.

Neni 80

Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional

1. Të gjithë personat që punojnë ose që kanë punuar për autoritetet mbikëqyrëse dhe autoritetin publik që mbikëqyrin organet vetrregulluese të përcaktuara në nenin 60 të këtij ligji, autoritetet kompetente të përmendura në këtë ligj, si dhe audituesit apo ekspertët që veprojnë në emër të këtyre autoriteteve, janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional.

Pa cenuar rastet që lidhen me hetimin apo ndjekjen penale sipas legjislacionit në fuqi,

si dhe informacionin e dhënë Agjencisë së Inteligjencës Financiare sipas neneve 19, 20, 21, 22, 50 dhe 51 të këtij ligji, informacioni konfidencial i marrë nga personat e përmendur në pikën 1 të këtij neni, gjatë ushtrimit të detyrave sipas këtij ligji, mund të bëhet i ditur vetëm në formë të përmbledhur apo të grupuar, në mënyrë të tillë që subjektet e detyruara individuale të mos mund të identifikohen.

Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional vazhdon edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës ose të angazhimit me autoritetin përkatës.

2. Pika 1 e këtij neni nuk pengon shkëmbimin e informacionit ndërmjet:

a) autoriteteve mbikëqyrëse brenda vendit, autoriteteve homologe të shteteve anëtare, përfshirë AMLA, kur vepron në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës, si dhe autoriteteve publike të përmendura në nenin 60 të këtij ligji;

b) autoriteteve mbikëqyrëse, autoriteteve publike të përmendura në nenin 60 të këtij ligji dhe Agjencisë së Inteligjencës Financiare;

c) autoriteteve mbikëqyrëse, autoriteteve publike të përmendura në nenin 60 të këtij ligji dhe autoriteteve kompetente të përcaktuara në nenin 85, pika 1, germa “c” dhe “d”, ose autoriteteve homologe që ushtrojnë funksione të njëjta sipas legjislacionit të zbatueshëm;

d) autoriteteve të mbikëqyrjes financiare dhe autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian që rregullojnë mbikëqyrjen e institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare, përfshirë Bankën Qendrore Evropiane kur vepron në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian, si brenda Republikës së Shqipërisë ashtu edhe me autoritete homologe të shteteve anëtare.

Për qëllimet e germës “d”, shkëmbimi i informacionit i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Çdo autoritet ose organ vetërregullues që merr informacion konfidencial në përputhje me pikën 2 të këtij neni e përdor këtë informacion vetëm:

a) për ushtrimin e detyrave të tij sipas këtij ligji, ose akteve të tjera të Bashkimit Evropian në fushën e PPP/FT, të rregullimit dhe mbikëqyrjes së kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare, përfshirë vendosjen e gjobave apo masave administrative;

b) në kuadër të një ankimi të bërë kundër një vendimi të autoritetit ose organit vetërregullues, duke përfshirë procedurat gjyqësore;

c) në kuadër të procedurave gjyqësore të filluara në përputhje me dispozita të veçanta të parashikuara në këtë ligj, në aktet e Bashkimit Evropian në fushën PPP/FT ose në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes së kujdesshme të institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare.

4. Shkelja e detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional përbën shkelje disiplinore dhe, sipas rastit, administrative ose penale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Rregullat e detajuara për klasifikimin, ruajtjen, përpunimin dhe shkëmbimin e informacionit konfidencial, si dhe masat teknike dhe organizative për garantimin e sekretit profesional, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 81

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe autoriteteve të tjera

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 133, pika 2, të këtij ligji, autoritetet

kompetente autorizohen të shkëmbejnë informacion ndërmjet:

a) autoriteteve mbikëqyrëse dhe autoriteteve publike që mbikëqyrin organet vetërregulluese, sipas Kreut III, Pjesa I të këtij ligji, si brenda vendit ashtu edhe me autoritetet homologe të shteteve anëtare;

b) autoriteteve mbikëqyrëse dhe autoriteteve që, sipas ligjit, janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregjeve financiare, në ushtrimin e funksioneve të tyre përkatëse mbikëqyrëse;

c) autoriteteve mbikëqyrëse përgjegjëse për audituesit ligjorë dhe, sipas rastit, autoriteteve publike që mbikëqyrin organet vetërregulluese sipas Kreut III, Pjesa I të këtij ligji, si dhe autoriteteve publike kompetente për mbikëqyrjen e audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në përputhje me aktet që rregullojnë auditimin ligjor, përfshirë autoritete homologe të shteteve anëtare.

Detyrimet për ruajtjen e sekretit profesional të parashikuara në nenin 80, pikat 1 dhe 3, nuk pengojnë shkëmbimin e informacionit të parashikuar në këtë pikë.

Informacioni konfidencial i shkëmbyer sipas kësaj pike përdoret vetëm për ushtrimin e detyrave të autoriteteve përkatëse dhe në kuadër të procedimeve administrative ose gjyqësore që lidhen posaçërisht me ushtrimin e këtyre funksioneve. Informacioni i marrë i nënshtrohet, në çdo rast, detyrimeve për ruajtjen e sekretit profesional të barasvlershëm me ato të parashikuara në nenin 80, pika 1, të këtij ligji.

2. Autoritetet mbikëqyrëse mund të autorizojnë zbulimin e informacionit të caktuar tek autoritetet e tjera kombëtare që, sipas ligjit, janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregjeve financiare ose që kanë kompetenca të posaçme në fushën e parandalimit ose hetimit të pastrimit të parave dhe të veprave penale që lidhen me të apo financimit të terrorizmit. Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional, i parashikuar në nenin 80, pikat 1 dhe 3, nuk përbën pengesë për dhënien e këtij informacioni.

Megjithatë, informacioni konfidencial i shkëmbyer sipas këtij neni përdoret vetëm për përmbushjen e detyrave ligjore të autoriteteve përkatëse. Personat që kanë akses në këtë informacion i nënshtrohen detyrimeve për ruajtjen e sekretit profesional të paktën ekuivalente me ato të parashikuara në nenin 80, pika 1, të këtij ligji.

3. Autoritetet mbikëqyrëse mund të lejojnë dhënien e informacionit të caktuar që lidhet me mbikëqyrjen e subjekteve të detyruara për përputhshmërinë me Pjesën e II të ligjit, komisioneve parlamentare hetimore, Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe organeve të tjera që, sipas ligjit, kanë kompetenca hetimore në Republikën e Shqipërisë, me kusht që të plotësohen kriteret e përcaktuara në vijim:

a) organet përkatëse të kenë një mandat të qartë dhe të përcaktuar në ligj për të hetuar ose për të ushtruar kontroll mbi veprimtarinë e autoriteteve mbikëqyrëse ose të autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit në fushën e kësaj mbikëqyrjeje;

b) informacioni të jetë rreptësisht i domosdoshëm për përmbushjen e mandatit të përmendur në germën “a” të kësaj pike;

c) personat që kanë akses në këtë informacion t’i nënshtrohen detyrimeve për ruajtjen e sekretit profesional sipas legjislacionit kombëtar, të paktën në të njëjtin nivel me ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni;

d) kur informacioni është marrë nga një autoritet homolog i një shteti anëtar, ky informacion nuk mund të bëhet i ditur pa pëlqimin e shprehur të mbikëqyrësit që e ka dhënë dhe vetëm për qëllimin për të cilin është dhënë ky pëlqim.

4. Autoritetet mbikëqyrëse mund të lejojnë gjithashtu dhënien e informacionit sipas

këtij neni komiteteve të përkohshme hetimore të ngritura nga Parlamenti Evropian, në përputhje me nenin 226 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe nenin 2 të Vendimit 95/167/EC, Euratom, ECSC të Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit Evropian, në masën dhe për sa këto akte të Bashkimit Evropian janë të zbatueshme për Republikën e Shqipërisë sipas marrëveshjeve ndërkombëtare në fuqi ose me aderimin e saj në Bashkimin Evropian, kur një dhënie e tillë është e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së këtyre komiteteve.

5. Shkëmbimi i informacionit sipas këtij neni kryhet në masën e nevojshme dhe proporcionale me qëllimin për të cilin kërkohet.

Neni 82

Forma dhe mënyra e bashkëpunimit ndërinstitucional

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, brenda gjashtë muajve nga data e miratimit të akteve të AMLA-s, miraton me vendim, rregullat për:

a) mënyrën dhe format e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente të përcaktuara në Seksionin 1 të këtij Kreu, si dhe bashkëpunimit të tyre me autoritetet e përmendura në Seksionin 2 të këtij Kreu dhe me subjektet përgjegjëse për regjistrat qendrorë, me qëllim parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

b) procedurat që zbatohen nga autoritetet kompetente që ushtrojnë mbikëqyrje ose kontroll mbi subjektet e detyruara sipas legjislacionit sektorial, për marrjen në konsideratë të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre sipas këtij ligji.

KREU V

MBROJTJA E TË DHËNAVE

Neni 83

Përpunimi i disa kategorive të të dhënave personale

1. Autoritetet kompetente, në masën që është e nevojshme për zbatimin e këtij ligji, mund të përpunojnë kategori të veçanta të të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë të dhëna që zbulojnë origjinën racore ose etnike, bindjet politike, fetare ose filozofike, anëtarësimin në organizata sindikale, si dhe të dhëna gjenetike, biometrike, të dhëna për shëndetin ose për jetën seksuale apo orientimin seksual të një personi, si dhe të dhëna personale që lidhen me dënime penale dhe vepra penale, duke garantuar masa mbrojtëse të përshtatshme për të drejtat dhe liritë e subjektit të të dhënave, krahas masave mbrojtëse të mëposhtme:

a) përpunimi i këtyre të dhënave kryhet vetëm rast pas rasti dhe vetëm nga personeli i autoritetit kompetent që është caktuar dhe autorizuar në mënyrë të posaçme për kryerjen e këtyre detyrave;

b) personeli i autoriteteve kompetente respekton standarde të larta profesionale në drejtim të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave, gëzon integritet të lartë dhe zotëron aftësitë e nevojshme profesionale, përfshirë aftësinë për trajtimin etik dhe të sigurt të grupeve të mëdha të të dhënave;

c) autoritetet kompetente vendosin masa teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e të dhënave në përputhje me standarde të larta teknologjike;

d) çdo akses, përpunim, ndryshim ose komunikim i këtyre të dhënave regjistrohet dhe është i gjurmueshëm;

e) të dhënat ruhen vetëm për atë kohë sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimit për të cilin janë përpunuar dhe fshihen ose anonimizohen pas përfundimit të këtij qëllimi, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Autoritetet kompetente nëpërmjet akteve nënligjore sigurojnë mekanizma të brendshëm kontrolli dhe mbikëqyrjeje për përpunimin e këtyre të dhënave, përfshirë auditime periodike.

3. Përpunimi i të dhënave që lidhen me dënimet penale dhe veprat penale kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

PJESA II

MASAT PËR ZBATIM NGA SUBJEKTET E DETYRUARA PËR PARANDALIMIN E PËRDORIMIT TË SISTEMIT FINANCIAR PËR QËLLIME TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Seksioni 1

Objekti dhe përkufizime

Neni 84

Objekti

Pjesa II e këtij ligji përcakton rregullat për:

a) masat që duhet të zbatojnë subjektet e detyruara për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;

b) masa për të kufizuar përdorimin e instrumenteve financiare që mundësojnë anonimitetin e përdoruesit.

Neni 85

Përkufizime

Për qëllime të zbatimit të Pjesës II të këtij ligji, zbatohen përkufizimet e përcaktuara në Pjesën I, Pjesën III dhe Pjesën IV të këtij ligji, si dhe përkufizimet e mëposhtme:

1. “autoritet kompetent” nënkupton:

a) Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF);

b) një autoritet mbikëqyrës;

c) një autoritet publik që ka funksionin e hetimit ose ndjekjes penale të pastrimit të parave dhe veprave penale që lidhen me të, ose të financimit të terrorizmit, ose të financimit

të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, ose që ka funksionin e gjurmimit, ngrirjes, bllokimit, sekuestrimit apo konfiskimit të pasurive kriminale;

d) një autoritet publik me përgjegjësi të caktuara në luftën kundër pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit;

2. “mbikëqyrës” nënkupton çdo autoritet ose organ të ngarkuar me përgjegjësi për të siguruar përputhshmërinë e subjekteve të detyruara me kërkesat e Pjesës II të këtij ligji, përfshirë AMLA-n, kur ushtron kompetencat e parashikuara nga aktet e Bashkimit Evropian;

3. “autoritet mbikëqyrës” nënkupton një mbikëqyrës që është autoritet publik ose autoritet publik që kontrollon organet vetërregulluese në ushtrimin e funksioneve të tyre mbikëqyrëse sipas Kreut III të Pjesës I të këtij ligji, ose AMLA kur vepron në cilësinë e mbikëqyrësit në përputhje me aktet e Bashkimit Evropian;

4. “organ vetërregullues” nënkupton organin që përfaqëson anëtarët e një profesioni dhe që ka një rol në rregullimin e tyre, në kryerjen e funksioneve të caktuara mbikëqyrëse ose monitoruese dhe në sigurimin e zbatimit të rregullave që lidhen me to;

5. “adresë e vetë-hostuar” ka të njëjtin kuptim si përkufizimi i dhënë në nenin 150, pika 20 të këtij ligji;

6. “kripto-aset” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në nenin 150, pika 10, të këtij ligji;

7. “shërbim i lidhur me kripto-asetet” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin për tregjet e kripto-aseteve. Në kuptim të këtij ligji ky përkufizim nuk përfshin ofrimin e shërbimit të këshillimit në lidhje me kripto-asetet;

8. “ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve” ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin për tregjet e kripto-aseteve kur kryhen një ose më shumë shërbime kripto-asetesh të përcaktuara në atë ligj;

9. “llogari kripto-asetesh” ka të njëjtin kuptim si përkufizimi i dhënë në nenin 150, pika 19 të këtij ligji;

10. “kripto-asete me anonimitet të shtuar” nënkupton kripto-asete që kanë veçori të integruara për të mundësuar anonimitetin e informacionit të transfertës së kripto-aseteve, qoftë në mënyrë sistematike apo sipas zgjedhjes së përdoruesit;

11. “IBAN virtual” nënkupton një identifikues që bën të mundur që pagesat të ridrejtohen te një llogari pagese e identifikuar nga një IBAN i ndryshëm nga ai identifikues;

12. “identifikues i personit juridik” nënkupton një kod reference unik alfanumerik, i bazuar në standardin ISO 17442, që i caktohet një personi juridik në shtetet e Bashkimit Evropian (*Legal Entity Identifier/LEI*);

13. “numri i identifikimit tatimor” nënkupton numrin sipas certifikatës së regjistrimit të personit të tatueshëm, të lëshuar sipas legjislacionit në fuqi, ku pasqyrohet numri i NUIS/NIPT;

14. “llogari transitore” është llogaria korrespondente që përdoret në mënyrë të drejtpërdrejtë nga palët e treta për të kryer transaksione biznesi në emër të tyre;

15. “agjent futbollit” nënkupton personin fizik ose juridik i cili, përkundrajt pagesës, ofron shërbime ndërmjetësimi dhe përfaqëson lojtarët e futbollit ose klubet profesionale të futbollit në negociata me qëllim lidhjen e një kontrate për një lojtar futbollit, ose përfaqëson në negociata klubet profesionale të futbollit me qëllim lidhjen e një marrëveshjeje për transferimin e një lojtari futbollit;

16. “klub profesional i futbollit” nënkupton çdo person juridik që zotëron ose

administrojnë një klub futbolli, i cili është pajisur me licencë dhe merr pjesë në ligat kombëtare të futbollit në vend dhe lojtarët dhe personeli i të cilit janë të angazhuar në bazë kontrate dhe paguhen kundrejt shërbimeve të tyre;

17. “burimi i pasurisë” është tërësia e fondeve dhe pasurive që posedon klienti;

18. “drejtues të lartë” nënkupton anëtarët e organit drejtues, në funksionin e tij drejtues, si dhe nëpunësit dhe punonjësit me njohuri të mjaftueshme mbi ekspozimin e subjektit të detyruar ndaj rrezikut të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë dhe me përvojë të mjaftueshme për të marrë vendime që ndikojnë në ekspozimin e tij ndaj rrezikut;

19. “grup” nënkupton një grup shoqërisht tregtare, i përbërë nga shoqëria mëmë, shoqëritë bija të kontrolluara prej saj, si dhe të gjitha subjektet mbi të cilat shoqëria mëmë apo shoqëria e kontrolluar prej saj ushtron ndikim influencues apo ku zotëron pjesëmarrje si dhe krijon detyrim për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;

20. “fonde” ose “pasuri” nënkupton çdo lloj pasurie, qoftë materiale ose jo materiale, e luajtshme ose e paluajtshme, e prekshme ose e paprekshme, si dhe dokumente ligjore ose instrumente ligjore, në çfarëdo forme, përfshirë ato elektronike ose digjitale, që vërtetojnë titullin e pronësisë ose interes në këto pasuri, sipas përcaktimeve në legjislacionin penal në fuqi;

21. “fonde ose pasuri të tjera” nënkupton çdo pasuri, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, pasuri financiare, burimet ekonomike, duke përfshirë naftën dhe burimet e tjera natyrore, pronë të çdo lloji, të prekshme ose e paprekshme, të luajtshme ose të paluajtshme, sido që të jetë fituar, dhe dokumente ose instrumente ligjore të çdo forme, duke përfshirë ato elektronike ose digjitale, që vërtetojnë titullin e pronësisë ose interesin në fonde të tilla ose pasuri të tjera, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, kredi bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, titujt, letrat me vlerë, obligacionet, dëftesat ose letrat e kreditit, dhe çdo interes, dividend ose të ardhura të tjera mbi ose vlerë që rrjedh nga ose gjenerohet nga fonde të tilla ose pasuri të tjera, dhe çdo pasuri tjetër që potencialisht mund të përdoret për të marrë fonde, mallra ose shërbime;

22. “institucion krediti” ka kuptimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për bankat dhe për qëllime të këtij ligji nënkupton gjithashtu:

a) çdo person juridik, veprimtaria e të cilit konsiston në pranimin e depozitave ose fonde të tjera të ripagueshme nga publiku dhe në dhënien e kredive për llogari të vet;

b) një degë të institucionit të kreditit, kur ajo ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nëse zyra qendrore e institucionit të kreditit ndodhet në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose në një vend të tretë. Në kuptimin e kësaj pike, “degë” nënkupton një vend të ushtrimit të veprimtarisë, i cili përbën një pjesë juridikisht të varur të institucionit të kreditit dhe ushtron drejtpërdrejt të gjitha ose një pjesë të veprimtarive për të cilat institucioni është autorizuar.

23. “institucion financiar” nënkupton çdo person juridik, i ndryshëm nga institucioni i kreditit, që ushtron një ose më shumë veprimtari financiare në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi dhe që i nënshtrohet licencimit, rregullimit ose mbikëqyrjes nga autoritetet kompetente.

Në kuptim të këtij ligji, si institucione financiare konsiderohen, ndër të tjera:

a) institucioni financiar jo bankë, institucion pagese, përfshirë zyrat e këmbimit valutor,

institucionet e parasë elektronike, shoqëritë e kredidhënies dhe subjektet e tjera që ofrojnë shërbime financiare, sipas legjislacionit sektorial në fuqi; si dhe shoqëritë kontrolluese financiare, shoqëritë kontrolluese financiare të përziera dhe shoqëritë kontrolluese me veprimtari financiare të përziera;

b) shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit për sa kohë që ushtrojnë veprimtari të sigurimit të jetës ose veprimtarisë së sigurimit të lidhura me investimet, si dhe shoqëritë kontrolluese të tyre sipas legjislacionit sektorial në fuqi;

c) ndërmjetësit e sigurimit, kur ushtrojnë veprimtari në fushën e sigurimit të jetës ose produkteve të sigurimit të lidhura me investime, përveç rasteve kur veprojnë pa mbajtur ose administruar fonde të klientëve dhe nën përgjegjësinë e plotë të një shoqërie sigurimi;

d) firmat e investimit, fondet e investimit kolektiv, shoqëritë administruese të fondeve të investimit dhe administratorët e fondeve alternative të investimit;

e) depozitarët qendrorë të titujve dhe subjektet e tjera që kryejnë funksione të regjistrimit, shlyerjes ose ruajtjes së instrumenteve financiare;

f) kreditorët dhe ndërmjetësit e kredisë, për sa kohë që marrin, mbajnë ose transferojnë fonde në lidhje me marrëveshje kredie, sipas legjislacionit sektorial në fuqi;

g) ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve, përfshirë këmbimin, ruajtjen, administrimin ose ndërmjetësimin e tyre, sipas legjislacionit sektorial në fuqi;

h) çdo degë në territorin e Republikës së Shqipërisë e një institucioni financiar të huaj, pavarësisht vendndodhjes së zyrës qendrore, për sa kohë që ushtron veprimtari në përputhje me legjislacionin shqiptar.

24. “informacion bazë” nënkupton:

a) në lidhje me një person juridik:

i. forma ligjore dhe emri i personit juridik;

ii. akti i themelimit dhe statuti, nëse janë hartuar si dokumente të veçanta;

iii. adresa e selisë së regjistruar ose zyrtare dhe, nëse është e ndryshme, vendi kryesor i ushtrimit të veprimtarisë dhe vendi i krijimit;

iv. lista e përfaqësuesve ligjorë;

v. sipas rastit, lista e aksionarëve, pronarëve përfitues ose anëtarëve, duke përfshirë informacionin mbi numrin e aksioneve të zotëruara nga secili aksionar dhe kategoritë e këtyre aksioneve, si dhe natyrën e të drejtave përkatëse të votës;

vi. kur disponohen, numri i regjistrimit, identifikuesi i personit juridik evropian, numri i identifikimit tatimor dhe identifikuesi i personit juridik;

vii. në rastin e fondacioneve, pasuritë e zotëruara nga fondacioni për të ndjekur qëllimet e tij;

b) në lidhje me një organizim ligjor:

i. emri ose identifikuesi unik i organizimit ligjor;

ii. akti i themelimit të trustit ose një akt i barasvlershëm;

iii. qëllimet e organizimit ligjor, nëse ka ndonjë të tillë;

iv. pasuritë e zotëruara nga organizimi ligjor ose të administruara nëpërmjet tij;

v. vendi i banimit të kujdestarëve të trustit të posaçëm ose personave që mbajnë pozicione të barasvlershme në organizimin ligjor të ngjashëm dhe, nëse është i ndryshëm, vendi nga ku administrohet trusti i posaçëm ose organizimi ligjor i ngjashëm;

25. “institucion guaskë” nënkupton:

a) për institucionet e kreditit dhe institucionet financiare të ndryshme nga ofruesit e

shërbimeve të krypto-aseteve: një institucion krediti ose një institucion financiar, ose një institucion që kryen aktivitete të barasvlershme me ato që kryhen nga institucionet e kreditit dhe institucionet financiare, të krijuara në një juridiksion në të cilin nuk ka prani fizike, që nënkupton ekzistencën e funksioneve drejtuese dhe administruese të mirëfillta, dhe që nuk është pjesë e një grupi të rregulluar financiar;

b) për ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve: një subjekt, emri i të cilit figuron në regjistrin e krijuar nga ligji për tregjet e krypto-aseteve ose një subjekt i një vendi të tretë që ofron shërbime të krypto-aseteve pa qenë i licencuar ose i regjistruar, dhe pa qenë subjekt i mbikëqyrjes në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në atë vend;

26. “klient” është personi i cili është përdorues i shërbimeve të ofruara nga subjektet e detyruara të përcaktuara në nenin 86 të këtij ligji;

27. “kujdestar” është personi, i cili është ligjërisht i autorizuar të kontrollojë dhe të administrojë fonde apo pasuri të një organizimi ligjor për llogari të një pale të tretë;

28. “marrëdhënie biznesi” nënkupton një marrëdhënie biznesi, profesionale ose ekonomike e lidhur me veprimtaritë profesionale të një subjekti të detyruar, e cila krijohet midis një subjekti të detyruar dhe një klienti, përfshirë rastet kur nuk ekziston një kontratë e shkruar, dhe e cila, në momentin e krijimit të saj, pritet të ketë ose, më pas, fiton karakter të përsëritur ose të vazhdueshëm;

29. “marrëdhënie korrespondente” nënkupton:

a) ofrimin e shërbimeve bankare nga një institucion krediti si korrespondent të një institucion tjetër krediti si pritës, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve të llogarisë rrjedhëse apo të llogarive të tjera të detyrimit dhe të shërbimeve të ndërlidhura, si administrimi i parave, transfertat ndërkombëtare të fondeve, sipas përkufizimit në legjislacionin në fuqi, klerimi/shlyerja e çeqeve, llogari përmes të cilave klientët mund të kryejnë drejtpërdrejt pagesa dhe shërbimet e këmbimit valutor;

b) marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare duke përfshirë rastet kur shërbime të ngjashme ofrohen nga një institucion korrespondent të një institucion pritës, dhe duke përfshirë marrëdhëniet e krijuara për transaksionet e titujve ose transfertat e fondeve sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi, transaksionet me krypto-asetet ose transfertat e krypto-aseteve;

30. “masa shtrënguese financiare” nënkupton masa shtrënguese financiare të BE, masa shtrënguese financiare të OKB dhe masa shtrënguese financiare të OKB në lidhje me financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë;

31. “masat shtrënguese financiare të BE” nënkupton bllokimin e pasurisë, si dhe ndalimin e vënies në dispozicion, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të fondeve ose pasurive të tjera në përfitim të personave dhe subjekteve të shpallura nga aktet e Bashkimit Evropian, të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi për masat shtrënguese ndërkombëtare.

32. “masat shtrënguese financiare të OKB” nënkupton ngrirjen, bllokimin e pasurive, si dhe ndalimin e vënies në dispozicion, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të fondeve ose pasurive të tjera në përfitim të personave dhe subjekteve të shpallura në përputhje me:

a) Rezolutën 1267 (1999) të Këshillit të Sigurimit të OKB dhe rezolutat pasardhëse të saj;

b) Rezolutën 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të OKB, duke përfshirë vendimin për

zbatimin e masave përkatëse ndaj personit ose subjektit dhe komunikimin publik të këtij vendimi;

c) masat shtrënguese financiare të OKB në lidhje me financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

Këto masa kanë të njëjtin kuptim dhe janë të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit;

33. “masat shtrënguese financiare të OKB në lidhje me financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë” nënkupton ngrirjen, bllokimin e pasurive, si dhe ndalimet e vënies në dispozicion të fondeve ose pasurive të tjera, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në përfitim të personave dhe subjekteve të shpallur ose të listuar në përputhje me:

a) Rezolutën 1718 (2006) të Këshillit të Sigurimit të OKB dhe rezolutat pasardhëse të saj;

b) Rezolutën 2231 (2015) të Këshillit të Sigurimit të OKB dhe rezolutat pasardhëse të saj;

c) çdo rezolutë tjetër të Këshillit të Sigurimit të OKB që imponon ngrirjen e pasurive dhe ndalimin e vënies në dispozicion të fondeve ose pasurive të tjera në lidhje me financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

Këto masa kanë të njëjtin kuptim dhe janë të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin në fuqi për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

34. “mallra me vlerë të lartë” janë mallrat e renditura në Aneksin IV të Pjesës II të këtij ligji;

35. “metale dhe gurë të çmuar” janë metalet dhe gurët e renditura në Aneksin V të Pjesës II të këtij ligji;

36. “të mira kulturore” janë pasuritë që kanë vlerë artistike, historike, arkeologjike, etnografike ose kulturore sipas përcaktimeve në legjislacionin për trashëgiminë kulturore;

37. “mjete monetare” ka të njëjtin kuptim si përkufizimi i përcaktuar në nenin 185, pika 1, të këtij ligji;

38. "organ drejtues" nënkupton organin ose organet e subjektit të detyruar që emërohen në përputhje me përcaktimet e legjislacionit sektorial në fuqi, që kanë kompetenca për të përcaktuar strategjinë, objektivat dhe drejtimin e përgjithshëm të subjektit të detyruar, si dhe që mbikëqyrin dhe monitorojnë vendimmarrjen drejtuese, dhe përfshijnë personat që drejtojnë në mënyrë efektive veprimtarinë e subjektit të detyruar; kur nuk ekziston një organ i tillë, personi që drejton në mënyrë efektive veprimtarinë e subjektit të detyruar do të konsiderohet si organ drejtues;

39. "organ drejtues në funksionin e tij drejtues" nënkupton organin drejtues përgjegjës për funksionimin dhe administrimin e përditshëm të subjektit të detyruar;

40. "organ drejtues në funksionin e tij mbikëqyrës" nënkupton organin drejtues që vepron në rolin e tij mbikëqyrës dhe të monitorimit të vendimmarrjes drejtuese;

41. “ofrues i shërbimeve të financimit kolektiv” nënkupton çdo person juridik që në kuadër të veprimtarisë së tij profesionale, operon një platformë digjitale ose mekanizëm tjetër organizativ për të lehtësuar mbledhjen e fondeve nga një numër i papërcaktuar investitorësh ose kontribuesish për financimin e projekteve, veprimtarive ekonomike ose subjekteve, nëpërmjet huadhënies, investimit ose formave të tjera të financimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit sektorial të fushës;

42. “ndërmjetës i financimit kolektiv” nënkupton një sipërmarrje tjetër përveç një ofruesi të shërbimit të financimit kolektiv, veprimtaria e të cilit konsiston në ndërlidhjen ose lehtësimin e ndërlidhjes, përmes një sistemi informacioni të bazuar në internet të hapur për publikun ose për një numër të kufizuar financuesish, të:

a) titullarëve të projekteve, të cilët janë persona fizikë ose juridikë që kërkojnë financim për projekte, të përbëra nga një ose një grup operacionesh të paracaktuara që synojnë një objektiv të caktuar, duke përfshirë mbledhjen e fondeve për një kauzë ose ngjarje të caktuar, pavarësisht nëse këto projekte i propozohen publikut ose një numri të kufizuar financuesish; dhe

b) financuesve, të cilët janë çdo person fizik ose juridik që kontribuon në financimin e projekteve, nëpërmjet kredive, me ose pa interes, ose donacioneve, duke përfshirë rastet kur donacionet e tilla i japin të drejtë donatorit për një përfitim jo material;

43. “pastrim i produkteve të veprës penale” ka të njëjtin kuptim si në dispozitat e Kodit Penal;

44. “financim i terrorizmit” ka të njëjtin kuptim si në dispozitat e Kodit Penal;

45. “veprimtari kriminale” është çdo veprimtari që përbën vepër penale sipas legjislacionit penal në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Për qëllime të këtij ligji, në kuptimin e veprimtarisë kriminale përfshihen gjithashtu, pa u kufizuar në to:

a) veprat penale që, sipas legjislacionit penal në fuqi, lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale, financimin e terrorizmit, krimin e organizuar, korrupsionin, mashtrimin, përvetësimin ose çdo formë tjetër përfitimi të paligjshëm nga veprimtaria kriminale;

b) veprat penale që cenojnë interesat financiare të shtetit, përfshirë mashtrimin, korrupsionin aktiv dhe pasiv, si dhe përvetësimin ose shpërdorimin e fondeve publike, sipas legjislacionit penal dhe financiar në fuqi;

46. “person”, në kuptim të këtij ligji, nënkupton individin, personin fizik, personin fizik tregtar apo personin juridik;

47. “procedura njihe klientin tënd” nënkupton një sërë rregullash, të përdorura nga subjektet e detyruara, që kanë të bëjnë me politikat e pranimi të identifikimit të klientit dhe administrimit të rrezikut të tyre;

48. “pronar përfitues” ka të njëjtin kuptim si në legjislacionin në fuqi për regjistrin e pronarëve përfitues;

49. “person i ekspozuar politikisht” është një person fizik që është ose ka qenë i ngarkuar me funksione të rëndësishme publike, duke përfshirë:

a) në Republikën e Shqipërisë:

i. kreu i shtetit, kreu i qeverisë, ministrat dhe zëvendësministrat;

ii. anëtarët e parlamentit;

iii. anëtarët e organeve drejtuese të partive politike që mbajnë vende në organet ekzekutive ose legjislative kombëtare, ose në organet ekzekutive ose legjislative rajonale apo vendore që përfaqësojnë zona zgjedhore me të paktën 50 000 banorë;

iv. anëtarët e gjykatave të larta, të gjykatave kushtetuese ose të organeve të tjera gjyqësore të nivelit të lartë, vendimet e të cilave nuk mund të ankimohen më tej, përveçse në rrethana të jashtëzakonshme;

v. anëtarët e gjykatave të audituesve ose të bordit të bankës qendrore;

vi. ambasadorët, të ngarkuarit me punë dhe oficerët e rangut të lartë në forcat e

armatosura;

vii. anëtarët e organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të ndërmarrjeve të kontrolluara në bazë të ndonjë prej marrëdhënieve të renditura në ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare ose kur këto ndërmarrje kualifikohen si ndërmarrje të mesme ose të mëdha ose grupe të mesme ose të mëdha, sipas përkufizimit në këtë ligj, nga autoritetet rajonale ose vendore;

viii. krerët e autoriteteve vendore ose rajonale, përfshirë kryetarët e bashkive dhe drejtuesit e strukturave të qarqeve, të cilët ushtrojnë funksione publike të rëndësishme, me të paktën 50 000 banorë;

ix. individët, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarin e pasurive të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, pavarësisht nëse kanë detyrimin për deklarin sipas legjislacionit në fuqi për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë.

b) në një organizatë ndërkombëtare:

i. zyrtarët e rangut më të lartë, zëvendësit e tyre dhe anëtarët e bordit ose funksionet e barasvlershme në një organizatë ndërkombëtare;

ii. përfaqësuesit në Republikën e Shqipërisë;

c) në nivel Bashkimi Evropian: funksionet në nivelin e institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian që janë të barasvlershme me ato të renditura në germën “a”, nënpikat “i”, “ii”, “iv”, “v” dhe “vi” të kësaj pike;

d) në një vend të tretë: funksionet e barasvlershme me ato të parashikuara në germën “a” të kësaj pike, përveç nënpikës “ix”;

50. Funksionet publike të përmendura në pikën 49 të këtij neni nuk përfshijnë funksionet e nëpunësve të nivelit të mesëm ose të ulët.

Kur kjo justifikohet nga organizimi administrativ dhe nga rreziku i pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit, mund të përcaktohen me ligj pragje më të ulëta për përcaktimin e funksioneve publike të spikatura si më poshtë:

a) anëtarët e organeve drejtuese të partive politike të përfaqësuara në nivel rajonal ose vendor, siç përmenden në pikën 49, germa “a”, nënpika “iii” e këtij neni;

b) krerët e autoriteteve rajonale dhe vendore, siç përmenden në pikën 49, germa “a”, nënpika “viii” e këtij neni;

c) në lidhje me pikën 49, germa “a”, nënpika “vii” të këtij neni, kur kjo justifikohet nga struktura administrative dhe nga niveli i rrezikut, me ligj mund të përcaktohen pragje më të ulëta për identifikimin e sipërmarrjeve të kontrolluara nga autoritetet rajonale ose vendore, krahasuar me pragjet e përgjithshme të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare;

d) kur kjo justifikohet nga strukturat e tyre sociale dhe kulturore dhe nga niveli i rrezikut, autoritetet kompetente mund të përcaktojnë një fushë më të gjerë zbatimi për përcaktimin e vëllezërve e motrave si anëtarë të familjes së personave të ekspozuar politikisht, sikurse përmendet në pikën 51, germa “d” të këtij neni.

51. “anëtar i familjes” është:

a) bashkëshorti ose bashkëshortja, bashkëjetuesi ose bashkëjetuesja, ose një person në një partneritet të regjistruar ose bashkim civil apo në një marrëdhënie të ngjashme;

b) fëmija dhe bashkëshorti ose bashkëshortja, bashkëjetuesja ose bashkëjetuesi e i/e fëmijës, ose një person në një partneritet të regjistruar ose bashkim civil ose në një marrëdhënie të ngjashme me fëmijën;

c) prindi;

d) për funksionet e përmendura në pikën 49, germa "a", nënpika "i" dhe funksionet e barasvlershme në nivel të Bashkimit Evropian ose në një vend të tretë, vëllai ose motra;

52. "person i njohur si bashkëpunëtor i ngushtë" është:

a) një person fizik i cili dihet se ka një pronësi të përbashkët përfituese mbi persona juridikë ose organizime ligjore, ose çdo marrëdhënie tjetër të ngushtë biznesi, me një person të ekspozuar politikisht;

b) një person fizik i cili ka pronësi të vetme përfituese të një personi juridik ose organizimi ligjor që dihet se është krijuar për përfitimin de facto të një personi të ekspozuar politikisht;

53. "para fizike" ka të njëjtin kuptim si përkufizimi i dhënë në nenin 185, pika 2 e këtij ligji;

54. "para elektronike" nënkupton vlerën monetare të ruajtur në formë elektronike ose magnetike, e përfaqësuar nga një kërkesë ndaj emetuesit, e cila emetohet kundrejt marrjes së fondeve me qëllim kryerjen e transaksioneve të pagesave dhe që pranohet nga persona fizikë ose juridikë të ndryshëm nga emetuesi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për shërbimin e pagesave.

Në kuptim të këtij ligji, nuk përfshihet vlera monetare e ruajtur në instrumente që përdoren vetëm për qëllime të kufizuara, përfshirë instrumentet që mundësojnë blerjen e mallrave ose shërbimeve vetëm në ambientet e emetuesit ose brenda një rrjeti të kufizuar shërbimesh, si dhe instrumentet që përdoren vetëm për një gamë të kufizuar mallrash ose shërbimesh;

55. "partneritet për shkëmbimin e informacionit" nënkupton mekanizmin që mundëson ndarjen dhe përpunimin e informacionit ndërmjet subjekteve të detyruara dhe, sipas rastit, autoriteteve kompetente të përcaktuara në pikën 1 germat "a", "b", "c" të këtij neni, për qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe të veprave penale që lidhen me të dhe financimit të terrorizmit, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkufitar, dhe pavarësisht nga forma e këtij partneriteti;

56. "shërbim i transfertës së parasë ose vlerës" nënkupton kryerjen e biznesit për të pranuar para fizike ose mjete apo instrumente të tjera të tregut të parasë dhe/ose të pagesave (çeqe, dëftesa, certifikata të depozitave, kartat e debitit ose të kreditit, kartat elektronike të pagesave etj.), titujt, si dhe çdo dokument tjetër që vërteton ekzistencën e një detyrimi monetar ose një vlere tjetër të depozituar dhe për t'i paguar përfituesit një shumë korresponduese në para fizike, ose në një formë tjetër, me anë të komunikimit, mesazhit, transferimit ose përmes sistemit të kleringut apo të shlyerjes, të cilit i përket shërbimi i transfertës së parasë ose vlerës.

57. "shoqëri mëmë" nënkupton:

a) për grupet me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë ose në një shtet tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, një subjekt i detyruar që konsiderohet shoqëri mëmë sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe auditimin ligjor, i cili nuk është vetë filial i një shoqërie tjetër, me kusht që të paktën një nga filialet e tij të jetë subjekt i detyruar sipas këtij ligji;

b) për grupet me seli qendrore jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur të paktën dy nga filialet e tyre janë subjekte të detyruara të vendosura në territorin e Republikës së

Shqipërisë, një shoqëri e këtij grupi e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë që:

- i. është subjekt i detyruar sipas këtij ligji;
- ii. është shoqëri që nuk është filial i një shoqërie tjetër që është subjekt i detyruar dhe që është e vendosur në territorin e Bashkimit Evropian;
- iii. ka rol dhe peshë të mjaftueshme brenda grupit, si dhe njohuri të mjaftueshme mbi veprimtarinë e grupit që i nënshtrohet kërkesave të këtij ligji; dhe
- iv. i është caktuar përgjegjësia për zbatimin e kërkesave në nivel grupi, në përputhje me dispozitat e këtij ligji që rregullojnë kërkesat e zbatueshme në nivel grupi.

58. “shoqëri kontrolluese me veprimtari të përzier financiare” nënkupton një shoqëri, e ndryshme nga një shoqëri kontrolluese financiare ose një shoqëri kontrolluese financiare e përzier, e cila nuk është filial i një shoqërie tjetër dhe filialet e së cilës përfshijnë të paktën një institucion krediti ose një institucion financiar;

59. “shoqëritë kontrolluese me veprimtari të përzier jo financiare” nënkupton një shoqëri, përveç një shoqërie kontrolluese financiare ose një shoqërie kontrolluese financiare të përzier, e cila nuk është degë e një shoqërie tjetër, degët e së cilës përfshijnë të paktën një subjekt të detyruar të përmendur në nenin 86, pika 3 të këtij ligji;

60. “shërbim i lojërave të fatit” nënkupton shërbimin që përfshin vendosjen e basteve me një shumë me vlerë monetare në lojëra fati, duke përfshirë ato që përmbajnë elemente aftësie, siç janë lotaritë, lojërat e kazinosë, lojërat e pokerit dhe transaksionet e basteve që ofrohen në një vendndodhje fizike, ose me çdo mjet në distancë, me anë të mjeteve elektronike ose të çdo teknologjie tjetër që lehtëson komunikimin, dhe me kërkesë individuale të marrësit të shërbimit;

61. “transaksion” nënkupton një shkëmbim dhe/ose ndërveprim, që përfshin dy ose më shumë palë, apo një veprim i kërkuar nga klienti për llogari të tij pa përfshirjen e palëve të tjera.

62. “transaksione të lidhura me njëri-tjetrin” nënkupton dy ose më shumë transaksione me origjinë, destinacion dhe qëllim të njëjtë ose të ngjashëm, ose me karakteristika të tjera përkatëse, të kryera gjatë një periudhe të caktuar kohore;

63. “transaksion rastësor” nënkupton çdo transaksion ose ofrim të shërbimeve të lidhura me një transaksion, që kryhet nga një subjekt i detyruar jashtë kuadrit të një marrëdhënieje biznesi, pavarësisht nëse kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione që duket se janë të lidhura ndërmjet tyre.

64. “trust i posaçëm” nënkupton një trust të krijuar qëllimisht nga themeluesi, midis të gjallëve apo për shkak të vdekjes, zakonisht në formën e një dokumenti me shkrim, për t'i vendosur aktivet nën kontrollin e një kujdestari në përfitim të një përfituesi ose për një qëllim të caktuar;

65. “përfitues të një kompetence diskrecionale” nënkupton personat fizikë ose juridikë, ose një kategori të personave fizikë ose juridikë, mes të cilëve kujdestarët mund të zgjedhin përfituesit në një trust diskrecional;

66. “përfitues në mungesë të ushtrimit të diskrecionit” janë personat fizikë ose juridikë ose një kategori e personave fizikë ose juridikë, që janë përfitues të një trusti diskrecional në rast se kujdestarët nuk arrijnë të ushtrojnë diskrecionin e tyre;

67. “organizim ligjor” nënkupton një trust të posaçëm ose një organizim që ka një strukturë ose funksion të ngjashëm me atë të një trusti të posaçëm, duke përfshirë “fiducie” dhe disa forma të “Treuhand” dhe “fideicomiso”;

68. “ofrues shërbimesh për trustet ose për shoqëritë tregtare” nënkupton çdo person

fizik ose juridik që, nëpërmjet veprimtarisë së tij, u ofron palëve të treta një nga shërbimet e mëposhtme:

- a) formimin e shoqërive tregtare ose të personave të tjerë juridikë;
- b) vepron si, ose kujdeset që një person tjetër të veprojë si, drejtor, administrator ose sekretar i një shoqërie tregtare apo personi juridik, si partner i një partneriteti apo në një pozicion të ngjashëm në lidhje me persona të tjerë juridikë;
- c) ofrimin e një zyre të regjistruar, adrese të ushtrimit të veprimtarisë, adrese korrespondence ose adrese administrative, si dhe shërbime të tjera të lidhura për një shoqëri, një partneritet ose çdo person tjetër juridik apo organizim ligjor;
- d) vepron si, ose cakton që një person tjetër të veprojë si, kujdestar i një trusti të posaçëm, ose kryen një funksion të barasvlershëm për një organizim ligjor të ngjashëm;
- e) vepron si, ose cakton që një person tjetër të veprojë si, aksionar përfaqësues për një person tjetër;

69. “vendosje e veprimtarisë” nënkupton ushtrimin faktik të një veprimtarie ekonomike nga një subjekt i detyruar i parashikuar në nenin 86 të këtij ligji, në territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, në një shtet të ndryshëm nga ai në të cilin ndodhet selia e tij qendrore, për një periudhë të pacaktuar kohore dhe përmes një pranije të qëndrueshme organizative, që përfshin:

- a) një degë ose filial;
- b) në rastin e institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare, çdo formë pranije që, sipas legjislacionit rregullator përkatës të mbikëqyrjes së kujdesshme, kualifikohet si vendosje e veprimtarisë.

70. “vend i tretë” nënkupton çdo juridiksion, shtet i pavarur ose territor autonom që nuk është pjesë e Bashkimit Evropian dhe që ka legjislacionin ose regjimin e vet të zbatimit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Seksioni 2

Fusha e zbatimit

Neni 86

Subjektet e detyruara

Subjektet e mëposhtme konsiderohen si subjekte të detyruara për qëllimet e këtij ligji:

- 1. institucionet e kreditit;
- 2. institucionet financiare;
- 3. personat fizikë ose juridikë të mëposhtëm që veprojnë në ushtrim të veprimtarive të tyre profesionale:

- a) audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar dhe këshilltarët tatimorë, si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik, duke përfshirë profesionet e lira, të tillë si avokatët, që marrin përsipër të ofrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të personave të tjerë me të cilët ata janë të lidhur, ndihmë materiale, mbështetje ose këshillim në lidhje me çështjet tatimore si aktivitet kryesor biznesi apo veprimtari profesionale;

- b) noterët, avokatët dhe profesionistët e tjerë të lirë, kur ata marrin pjesë, qoftë duke vepruar në emër dhe për llogari të klientit të tyre në çdo transaksion financiar ose të pasurive të paluajtshme, ose duke ndihmuar në planifikimin ose kryerjen e transaksioneve për klientin e tyre në lidhje me një nga rastet e mëposhtme:

- i. blerjen dhe/ose shitjen e pasurive të paluajtshme ose të personave juridikë;
- ii. administrimin e parave, letrave me vlerë ose pasurive të tjera të klientit, duke përfshirë krypto-asetet;
- iii. hapjen ose administrimin e llogarive bankare, të kursimit, të letrave me vlerë ose të krypto-aseteve;
- iv. organizimin e masave të nevojshme për krijimin, funksionimin ose administrimin e shoqërive tregtare;
- v. krijimin, ngritjen, funksionimin ose administrimin e trusteve, organizimeve ligjore, shoqërive tregtare, fondacioneve, ose strukturave të ngjashme;
- c) ofruesit e shërbimeve për trustet ose shoqëritë tregtare;
- d) agjentët e pasurive të paluajtshme dhe profesionistët e tjerë të pasurive të paluajtshme kur ata veprojnë si ndërmjetës në transaksionet e pasurive të paluajtshme, përfshirë edhe në lidhje me dhënien me qira të pasurive të paluajtshme për transaksionet për të cilat qiraja mujore arrin në vlerën e barabartë apo më të madhe se 1 000 000 (një milion) lek ose kundërvleftën e saj në monedhat e tjera të huaja, pavarësisht nga mënyra e pagesës;
- e) personat që kryejnë tregtim të metaleve dhe gurëve të çmuar si veprimtari të rregullt ose kryesore profesionale;
- f) personat që kryejnë tregtim të mallrave me vlerë të lartë, si veprimtari të rregullt ose kryesore profesionale;
- g) ofruesit e shërbimeve të lojërave të fatit;
- h) ofruesit e shërbimeve të financimit kolektiv dhe ndërmjetësit e financimit kolektiv;
- i) personat që tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetës në tregtimin e të mirave kulturore, duke përfshirë rastet kur kryhet nga galeri arti ose shtëpi ankandi, kur vlera e transaksionit ose e transaksioneve të lidhura arrin në vlerën e barabartë apo më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvleftën e saj në monedhat e tjera të huaja;
- j) personat që ruajnë, tregtojnë ose veprojnë si ndërmjetës në tregtimin e të mirave kulturore dhe mallrave me vlerë të lartë, kur kjo kryhet brenda zonave të lira dhe magazinave doganore, kur vlera e transaksionit ose e transaksioneve të lidhura arrin në vlerën e barabartë apo më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvleftën e saj në monedhat e tjera të huaja;
- k) ndërmjetësit për kreditë hipotekore dhe konsumatore, të ndryshme nga institucionet e kreditit dhe institucionet financiare, me përjashtim të ndërmjetësve të kreditit që kryejnë veprimtari nën përgjegjësinë e një ose disa kreditorëve ose ndërmjetësve të kreditit;
- l) operatorët e migracionit përmes investimit të autorizuar për të përfaqësuar ose për të ofruar shërbime ndërmjetësimi për shtetasit huaj që kërkojnë të fitojnë të drejta qëndrimi në Republikën e Shqipërisë në këmbim të çdo lloj forme investimi, duke përfshirë transferimin e kapitalit, blerjen ose marrjen me qira të pronës, investimet në obligacione qeveritare, investimet në persona juridikë, dhurimin ose financimin e një veprimtarie me interes publik dhe kontributet në buxhetin e shtetit;
- m) shoqëritë kontrolluese me veprimtari të përzier jo financiare;
- n) agjentët e futbollit;
- o) klubet profesionale të futbollit në lidhje me transaksionet e mëposhtme:
 - i. transaksionet me një investitor;
 - ii. transaksionet me një sponsor;
 - iii. transaksionet me agjentët e futbollit ose ndërmjetës të tjerë;

iv. transaksionet me qëllim transferimin e një lojtari futbollit.

Neni 87

Përfshirjet për ofrues të caktuar të shërbimeve të lojërave të fatit

1. Me ligj mund të përfshihen, plotësisht ose pjesërisht, ofruesit e shërbimeve të lojërave të fatit nga kërkesat e përcaktuara në Pjesën II të këtij ligji mbi bazën e rrezikut të ulët të vërtetuar që paraqet natyra dhe, sipas rastit, shkalla e funksionimit të këtyre shërbimeve.

Përfshirjet e përmendura në paragrafin e mësipërm nuk zbatohen për:

a) kazinotë;

b) ofruesit e shërbimeve të lojërave të fatit, veprimtaria kryesore e të cilëve është ofrimi i shërbimeve të lojërave të fatit në internet ose shërbimeve të basteve sportive, përveç:

i. shërbimeve të lojërave të fatit në internet të operuara nga shteti, qoftë përmes një autoriteti publik ose një sipërmarrje ose organi të kontrolluar nga shteti;

ii. shërbimeve të lojërave të fatit në internet, organizimi, funksionimi dhe administrimi i të cilave rregullohet nga shteti.

2. Për qëllimet e pikës 1 të këtij neni, Agjencia e Inteligjencës Financiare në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës kompetent, kryejnë vlerësimin e rrezikut të shërbimeve të lojërave të fatit duke vlerësuar:

a) rreziqet, kërcënimet dhe dobësitë që paraqesin shërbimet e lojërave të fatit për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, si dhe faktorët për zbutjen e këtyre rreziqeve;

b) rreziqet që lidhen me madhësinë e transaksioneve dhe mënyrat e përdorura të pagesës;

c) zonën gjeografike në të cilën administrohen shërbimet e lojërave të fatit, duke përfshirë dimensionin e tyre ndërkufitar dhe aksesueshmërinë nga shtetet anëtare ose vendet e treta.

Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, autoritetet e përmendura në pikën 2 të këtij neni duhet të marrin në konsideratë gjetjet e vlerësimit kombëtar të rrezikut.

3. Autoriteti mbikëqyrës kompetent merr masa të bazuara në vlerësimin e rrezikut ose masa të tjera të përshtatshme, me qëllim për të siguruar që përfshirjet e parashikuara në këtë nen të mos keqpërdoren.

Neni 88

Përfshirjet për klube të caktuara profesionale futbollit

1. Me ligj mund të përfshihen, plotësisht ose pjesërisht, klubet profesionale të futbollit që marrin pjesë në kategorinë më të lartë të ligës kombëtare të futbollit dhe që kanë një xhiro vjetore totale më të ulët se 500 000 000 (pesëqind milion) lekë ose kundërvleftën e saj në monedhat e tjera të huaja, për secilin nga 2 vitet e mëparshme kalendarike, nga kërkesat e përcaktuara në Pjesën II të ligjit, mbi bazën e rrezikut të ulët të vërtetuar që paraqet natyra dhe shkalla e veprimtarisë së këtyre klubeve profesionale të futbollit.

Me ligj mund të përfshihen, plotësisht ose pjesërisht, klubet profesionale të futbollit që marrin pjesë në një kategori më të ulët se kategoria më e lartë e ligës kombëtare të futbollit nga kërkesat e përcaktuara në Pjesën II të ligjit mbi bazën e rrezikut të ulët të vërtetuar që

paraqet natyra dhe shkalla e veprimtarisë së këtyre klubeve profesionale të futbollit.

2. Për qëllimet e pikës 1 të këtij neni, Agjencia e Inteligjencës Financiare në bashkëpunim me autoritetin mbikëqyrës kompetent kryejnë vlerësimin e rrezikut të klubeve profesionale të futbollit duke vlerësuar:

a) rreziqet, kërcënimet dhe dobësitë që paraqesin klubet profesionale të futbollit për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, si dhe faktorët për zbutjen e këtyre rreziqeve;

b) rreziqet që lidhen me madhësinë dhe dimensionin ndërkufitar të transaksioneve.

Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, autoritetet e përmendura në pikën 2 të këtij neni duhet të marrin në konsideratë gjetjet e vlerësimit kombëtar të rrezikut.

3. Autoriteti mbikëqyrës kompetent merr masa të bazuara në vlerësimin e rrezikut ose masa të tjera të përshtatshme, me qëllim për të siguruar që përjashtimet e parashikuara në këtë nen të mos keqpërdoren.

Neni 89

Përjashtimet për veprimtari të caktuara financiare

1. Me përjashtim të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e transfertave të parave sipas legjislacionit sektorial në fuqi, mund të përjashtohen me ligj nga kërkesat e Pjesës II të këtij ligji personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë një ose më shumë veprimtari financiare në mënyrë rastësore ose shumë të kufizuar, kur konstatohet se ekziston rrezik i ulët i pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë dhe të provohet se plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) veprimtaria financiare të jetë e kufizuar në terma absolutë;

b) veprimtaria financiare të jetë e kufizuar në nivel transaksioni;

c) veprimtaria financiare të mos jetë veprimtaria kryesore e këtyre subjekteve;

d) veprimtaria financiare të jetë ndihmëse dhe e lidhur drejtpërdrejt me veprimtarinë kryesore të këtyre subjekteve;

e) veprimtaria kryesore e këtyre subjekteve të mos jetë një veprimtari e përmendur në nenin 86, pika 3, germa "a" deri në "d" ose "g";

f) veprimtaria financiare t'u ofrohet vetëm klientëve të veprimtarisë kryesore të këtyre subjekteve dhe jo publikut të gjerë.

2. Për qëllimet e pikës 1, germa "a" e këtij neni, duhet që xhiroja totale e veprimtarisë financiare të mos tejkalojë një prag mjaftueshëm të ulët. Ky prag duhet të përcaktohet me ligj në nivel kombëtar, në varësi të llojit të veprimtarisë financiare.

3. Për qëllimet e pikës 1, germa "b" e këtij neni, zbatohet një prag maksimal për klient dhe për transaksion të vetëm, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një veprim të vetëm ose nëpërmjet transaksioneve të lidhura.

Ky prag maksimal përcaktohet, në nivel kombëtar, me ligj, në varësi të llojit të veprimtarisë financiare dhe duhet të jetë mjaftueshëm i ulët në mënyrë që të garantohet se llojet e transaksioneve në fjalë të mos përbëjnë një metodë praktike dhe efikase për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, në vlerën e barabartë apo më të madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvleftën e saj në monedhat e tjera të huaja, pavarësisht nga mënyra e pagesës.

4. Për qëllimet e pikës 1, germa "c" e këtij neni, duhet që xhiroja totale e veprimtarisë

financiare të mos tejkalojë 5% të xhiros totale të personit fizik ose juridik.

5. Gjatë vlerësimit të rrezikut të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit për qëllimet e këtij neni, Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe autoriteti mbikëqyrës kompetent i kushtojnë vëmendje të veçantë veprimtarive financiare që, për shkak të natyrës së tyre, paraqesin rrezik më të lartë për t'u përdorur ose keqpërdorur për pastrim parash, financim të terrorizmit apo financim të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

6. Autoriteti mbikëqyrës kompetent merr masa të bazuara në vlerësimin e rrezikut ose masa të tjera të përshtatshme, me qëllim për të siguruar që përjashtimet e parashikuara në këtë nen të mos keqpërdoren.

Neni 90

Njoftimi i veprimtarive ndërkufitare dhe zbatimi i ligjit në nivel kombëtar

1. Subjektet e detyruara që synojnë të ushtrojnë, për herë të parë, veprimtari në territorin e një shteti anëtar duhet të njoftojnë mbikëqyrësin e shtetit anëtar të origjinës, për veprimtaritë që synojnë të kryejnë në atë shtet anëtar. Njoftimi duhet të dërgohet sapo subjekti i detyruar fillon procedurat për ushtrimin e kësaj veprimtarie ndërkufitare dhe, në rastin e vendosjes së veprimtarisë, jo më pak se 3 muaj përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë. Subjektet e detyruara duhet të njoftojnë menjëherë mbikëqyrësin e shtetit anëtar të origjinës, pas fillimit të ushtrimit të këtyre veprimtarive në shtetin tjetër anëtar.

Paragrafi i mësipërm i kësaj pike, nuk zbatohet për subjektet e detyruara që i nënshtrohen procedurave të veçanta të njoftimit për ushtrimin e lirisë së vendosjes ose të lirisë për të ofruar shërbime, sipas përcaktimeve në këtë ligj, ose për rastet kur subjekti i detyruar i nënshtrohet kërkesave të veçanta për autorizim për të ushtruar veprimtari në territorin e atij shteti tjetër anëtar.

2. Subjekti i detyruar njofton mbikëqyrësin e shtetit anëtar të origjinës për çdo ndryshim të planifikuar në informacionin e njoftuar sipas pikës 1 të këtij neni, të paktën 1 muaj përpara kryerjes së ndryshimit.

3. Në rastet kur në këtë Pjesë II të ligjit lejohet të miratohen rregulla shtesë për subjektet e detyruara, këto të fundit janë të detyruara të zbatojnë rregullat e shtetit në të cilin janë të themeluara.

4. Në rastet kur subjektet e detyruara ushtrojnë veprimtari nëpërmjet vendosjes në më shumë se një shtet anëtar, ato sigurojnë që secila vendosje të zbatojë rregullat e shtetit anëtar në të cilin është vendosur.

5. Në rastet kur subjektet e detyruara, të përcaktuara në nenin 45, pika 1 të këtij ligji, ushtrojnë veprimtari në një shtet tjetër anëtar, përveç atij në të cilin janë të themeluara, nëpërmjet agjentëve, shpërndarësve ose formave të tjera të pranishme në vendosur në ato shtete, në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime, ato zbatojnë rregullat e shtetit anëtar në të cilin ofrojnë shërbimet përkatëse në lidhje me këto veprimtari, përveç rasteve kur zbatohet neni 45, pika 2; në këtë rast, ato zbatojnë rregullat e shtetit anëtar në të cilin ndodhet selia e tyre qendrore.

6. Në rastet kur subjektet e detyruara duhet të caktojnë një pikë qendrore kontakti në përputhje me nenin 49 të këtij ligji, ato duhet të sigurojnë që pika qendrore e kontaktit të sigurojë përputhshmërinë me legjislacionin e zbatueshëm në emër të subjektit të detyruar.

7. Ky nen zbatohet në të njëjtën mënyrë kur autoritetet mbikëqyrëse ushtrojnë kompetencat e mbikëqyrësit të shtetit të origjinës ose të mbikëqyrësit të shtetit pritës, në kuadër

të bashkëpunimit me shtete anëtare ose me vende të treta, në përputhje me përcaktimet e lejuara nga ky ligj.

KREU II

POLITIKAT, PROCEDURAT DHE KONTROLLET E BRENDSHME TË SUBJEKTEVE TË DETYRUARA

Seksioni 1

Politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme, vlerësimi i rrezikut dhe burimet njerëzore

Neni 91

Fusha e zbatimit të politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme

1. Subjektet e detyruara duhet të miratojnë politika, procedura dhe kontrolle të brendshme për të siguruar përputhshmërinë me Pjesën II dhe Pjesën III të këtij ligj, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre, si dhe me çdo akt administrativ të nxjerrë nga mbikëqyrësit dhe, në veçanti:

a) të zbusin dhe të administrojnë në mënyrë efektive rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, të identifikuar në nivel kombëtar, të Bashkimit Evropian dhe të subjektit të detyruar;

b) përveç zbatimit të detyrimit për masat shtrënguese financiare, të marrin masa për zbutjen dhe menaxhimin efektiv të rreziqeve që rrjedhin nga moszbatimi apo shmangia e tyre.

Politikat, procedurat dhe kontrollet e përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të jenë proporcionale me natyrën e veprimtarisë së subjektit të detyruar, duke përfshirë rreziqet dhe kompleksitetin e saj, si dhe me madhësinë e subjektit të detyruar dhe duhet të mbulojnë të gjitha veprimtaritë e subjektit të detyruar që përfshihen në fushën e zbatimit të Pjesës II të këtij ligji.

2. Politikat, procedurat dhe kontrollet e përmendura në pikën 1 të këtij neni përfshijnë:

a) politikat dhe procedurat e brendshme, duke përfshirë në veçanti:

i. kryerjen dhe përditësimin e vlerësimit të rrezikut në nivel subjekti;

ii. kuadrin e administrimit të rrezikut të subjektit të detyruar;

iii. vigjilencën e duhur ndaj klientit për zbatimin e Kreut III të Pjesës II të këtij ligji, duke përfshirë procedurat për përcaktimin nëse klienti, pronari përfitues ose personi në emër të të cilit ose për përfitimin e të cilit kryhet një transaksion ose veprimtari është person i ekspozuar politikisht, anëtar i familjes së tij ose person i njohur si bashkëpunëtor i ngushtë i tij;

iv. raportimin e transaksioneve të dyshimta;

v. kontraktimin e jashtëm dhe mbështetjen të subjekte të tjera të detyruara për kryerjen e vigjilencës së duhur ndaj klientit;

vi. ruajtjen e të dhënave dhe politikat lidhur me përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me nenet 139 dhe 140 të Pjesës II të këtij ligji;

vii. mbikëqyrjen dhe administrimin e përputhshmërisë me këto politika dhe procedura të brendshme në përputhje me pikën 2, germa “b”, të këtij neni, identifikimin dhe administrimin e mangësive dhe zbatimin e masave korrigjuese;

viii. verifikimin, në përpjesëtim me rreziqet që lidhen me detyrat dhe funksionet që do të kryhen, gjatë rekrutimit dhe ngarkimit të punonjësve në detyra dhe funksione të caktuara, si dhe gjatë emërimit të agjentëve dhe shpërndarësve për të përcaktuar se këta persona kanë reputacion të mirë;

ix. komunikimin e brendshëm të politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme të subjektit të detyruar, përfshirë edhe ndaj agjentëve, shpërndarësve dhe ofruesve të shërbimeve të përfshirë në zbatimin e politikave të tij për parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë;

x. organizimin periodik të programeve të kualifikimit, si dhe miratimin dhe zbatimin e një politike për trajnimin e punonjësve dhe, sipas rastit, të agjentëve dhe shpërndarësve, lidhur me masat e vendosura në subjektin e detyruar për përmbushjen e kërkesave të Pjesës II dhe Pjesës III të këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tyre dhe çdo akti administrativ të nxjerrë nga autoritetet mbikëqyrëse;

b) kontrollet e brendshme dhe funksionin e auditimit të pavarur për verifikimin e politikave dhe procedurave të brendshme të përmendura në pikën 2, germa “a”, të këtij neni dhe të kontrolleve të vendosura në subjektin e detyruar. Në mungesë të funksionit të auditimit të pavarur, subjektet e detyruara mund t’ia besojnë këtë verifikim një eksperti të jashtëm.

3. Politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dokumentohen me shkrim.

Politikat e brendshme miratohen nga organi drejtues në funksionin e tij drejtues.

Procedurat dhe kontrollet e brendshme miratohen të paktën në nivelin e drejtuesit të përputhshmërisë.

4. Subjektet e detyruara sigurojnë përditësimin e vazhdueshëm të politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme, si dhe përmirësimin e tyre në rast se identifikohen mangësi.

5. Ministri përgjegjës për financat, me propozimin e autoritetit përgjegjës, nxjerr udhëzime mbi elementet që subjektet e detyruara duhet të marrin në konsideratë, në varësi të natyrës së veprimtarisë së tyre, përfshirë rreziqet dhe kompleksitetin, si dhe madhësinë e tyre, kur përcaktojnë shtrirjen e politikave, procedurave dhe kontrolleve të tyre të brendshme, në veçanti lidhur me personelin e caktuar për funksionet e përputhshmërisë.

Këto udhëzime identifikojnë gjithashtu situatat në të cilat, për shkak të natyrës dhe madhësisë së subjektit të detyruar:

i) kontrollet e brendshme duhet të organizohen në nivelin e funksionit të veprimtarisë së subjektit të detyruar, funksionit të përputhshmërisë dhe funksionit të auditimit;

ii) funksioni i auditimit të pavarur mund të kryhet nga një ekspert i jashtëm.

Neni 92

Vlerësimi i rrezikut në nivel subjekti

1. Subjektet e detyruara marrin masat e duhura, në përpjesëtim me natyrën e veprimtarisë së tyre, duke përfshirë rreziqet dhe kompleksitetin, si dhe madhësinë e tyre, për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë ndaj të cilave janë të ekspozuara, si dhe rreziqet e moszbatimit dhe shmangies së masave shtrënguese financiare, duke marrë parasysh të paktën sa vijon:

a) variablat e rrezikut të përcaktuara në Aneksin I dhe faktorët e rrezikut të përcaktuar në Aneksin II dhe Aneksin III, të Pjesës II të këtij ligji;

b) rezultatet e vlerësimeve kombëtare të rrezikut, si dhe të çdo vlerësimi përkatës sektorial të rrezikut të kryer në nivel kombëtar;

c) rezultatet e vlerësimit të rrezikut në nivel Bashkimi Evropian;

d) informacionin përkatës të publikuar nga organizmat ndërkombëtarë përcaktues të standardeve në fushën e parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë ose në nivel të Bashkimit Evropian, publikimet përkatëse të Komisionit Evropian apo të AMLA;

e) informacionin mbi rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë të hartuar nga autoritetet kompetente;

f) informacion mbi bazën e klientëve.

Subjektet e detyruara para nxjerrjes së produkteve të reja, shërbimeve ose praktikave të reja të ushtrimit të veprimtarisë, duke përfshirë përdorimin e kanaleve të reja të shpërndarjes dhe teknologjive të reja ose në zhvillim në lidhje me produktet dhe shërbimet e reja ose ekzistuese, ose para fillimit të ofrimit të një shërbimi ose produkti ekzistues për një segment të ri klientësh ose në një zonë të re gjeografike, identifikojnë dhe vlerësojnë, në veçanti, rreziqet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë dhe marrin masat e duhura për administrimin dhe zbutjen e këtyre rreziqeve.

2. Vlerësimi i rrezikut në nivel subjekti, i hartuar nga subjekti i detyruar sipas pikës 1 të këtij neni, dokumentohet, përditësohet dhe rishikohet rregullisht, duke përfshirë edhe rastet e ngjarjeve të brendshme ose të jashtme që ndikojnë ndjeshëm në rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë që lidhen me veprimtaritë, produktet, transaksionet, kanalet e shpërndarjes, klientët ose zonat gjeografike në të cilat ushtron veprimtarinë subjekti.

Vlerësimi i rrezikut në nivel subjekti vihet në dispozicion të autoriteteve mbikëqyrëse me kërkesën e tyre.

Vlerësimi i rrezikut në nivel subjekti hartohet nga përgjegjësi i përputhshmërisë dhe miratohet nga organi drejtues në funksionin e tij drejtues, si dhe i komunikohet organit drejtues në funksionin e tij mbikëqyrës, kur një organ i tillë ekziston.

3. Me përjashtim të institucioneve të kreditit, institucioneve financiare, ofruesve të shërbimeve të financimit kolektiv dhe ndërmjetësve të financimit kolektiv, mbikëqyrësit mund të vendosin që vlerësimet individuale të dokumentuara të rrezikut në nivel subjekti të mos kërkojnë, kur rreziqet specifike të identifikuar që lidhen me sektorin janë të qarta dhe të kuptueshme.

4. Ministri përgjegjës për financat, me propozimin e autoritetit përgjegjës, nxjerr udhëzime mbi kërkesat minimale për përmbajtjen e vlerësimit të rrezikut në nivel subjekti të hartuar nga subjektet e detyruara, sipas pikës 1 të këtij neni, si dhe mbi burimet shitesë të informacionit që duhet të merren në konsideratë gjatë kryerjes së këtij vlerësimi.

Neni 93

Funksionet e përputhshmërisë

1. Subjektet e detyruara caktojnë një drejtues përputhshmërie, që është një anëtar i

organit drejtues në funksionin e tij drejtues, i cili ka përgjegjësinë për të siguruar përputhshmërinë me Pjesën II dhe Pjesën III të këtij ligji, me aktet nënligjore në zbatim, si dhe me çdo akt administrativ të nxjerrë nga çdo autoritet mbikëqyrës.

Drejtuesi i përputhshmërisë siguron që politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme të subjektit të detyruar të jenë në përputhje me ekspozimin e tij ndaj rrezikut dhe që ato të zbatohen në mënyrë efektive. Drejtuesi i përputhshmërisë siguron gjithashtu që të caktohen burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale për këtë qëllim.

Drejtuesi i përputhshmërisë është përgjegjës për marrjen e informacionit për çdo mangësi të rëndësishme ose materiale të konstatuar në politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme.

Kur organi drejtues në funksionin e tij drejtues është një organ kolegjal që mban përgjegjësi kolektive për vendimmarrjen e tij, drejtuesi i përputhshmërisë është përgjegjës për ta ndihmuar dhe këshilluar atë, si dhe për përgatitjen e vendimeve të parashikuara në këtë nen.

2. Subjektet e detyruara caktojnë një përgjegjës përputhshmërie, të emëruar nga organi drejtues në funksionin e tij drejtues, i cili mban një pozicion mjaftueshëm të lartë në strukturën organizative të subjektit për ushtrimin efektiv të funksioneve të tij.

Përgjegjësi i përputhshmërisë është përgjegjës për zbatimin e politikave, procedurave dhe kontrolleve në veprimtarinë e përditshme të subjektit të detyruar në kuadër të kërkesave për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, përfshirë zbatimin e masave shtrënguese financiare, si dhe shërben si pikë kontakti për autoritetet kompetente.

Përgjegjësi i përputhshmërisë është gjithashtu përgjegjës për raportimin e transaksioneve të dyshimta pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare, në përputhje me nenin 132, pika 1 të këtij ligji.

Në rastet kur subjektet e detyruara i nënshtrohen kontrolleve të verifikimit të integritetit dhe përshtatshmërisë për drejtuesit e tyre të lartë apo mbi pronarët përfitues në bazë të nenit 8 të këtij ligji, edhe përgjegjësi i përputhshmërisë i nënshtrohet verifikimit për përmbushjen e këtyre kërkesave.

Subjekti i detyruar, që është pjesë e një grupi, mund të caktojë si përgjegjës të përputhshmërisë një person që ushtron këtë funksion në një subjekt tjetër në të njëjtin grup, kur kjo justifikohet nga madhësia e subjektit dhe niveli i ulët i rrezikut që paraqesin veprimtaritë e tij.

Përgjegjësi i përputhshmërisë mund të largohet nga funksioni vetëm pas njoftimit paraprak të organit drejtues në funksionin e tij drejtues. Subjekti i detyruar njofton mbikëqyrësin për largimin e përgjegjësit të përputhshmërisë, duke specifikuar nëse vendimi lidhet me kryerjen e detyrave të tij sipas këtij ligji.

Përgjegjësi i përputhshmërisë mund, me nismën e tij ose me kërkesë, t'i paraqesë mbikëqyrësit informacion në lidhje me largimin e tij nga detyra. Mbikëqyrësi mund ta përdorë këtë informacion për ushtrimin e kompetencave të tij mbikëqyrëse në përmbushje të neneve 40 dhe 42 të këtij ligji.

3. Subjektet e detyruara duhet të sigurojnë burime të përshtatshme për funksionet e përputhshmërisë, përfshirë burimet njerëzore dhe burimet teknologjike, në përpjesëtim me madhësinë, natyrën dhe rreziqet e subjektit të detyruar, për ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre, si dhe duhet të sigurojnë që personave përgjegjës për këto funksione u jepen kompetencat për të propozuar të gjitha masat e nevojshme për të siguruar efektivitetin e politikave,

procedurave dhe kontrolleve të brendshme të subjektit të detyruar.

4. Subjektet e detyruara duhet të marrin masa për të siguruar që përgjegjësi i përputhshmërisë të jetë i mbrojtur nga hakmarrja, diskriminimi dhe çdo trajtim tjetër i padrejtë dhe që vendimet e përgjegjësit të përputhshmërisë të mos cenohen ose të mos ndikohen padrejtësisht nga interesat e veprimtarisë, përfshirë ato tregtare të subjektit të detyruar.

5. Subjektet e detyruara duhet të sigurojnë që përgjegjësi i përputhshmërisë dhe personi përgjegjës për funksionin e auditimit, të përcaktuar në nenin 91, pika 2, germa “b”, të këtij ligji, të mund të raportojnë drejtpërdrejt te organi drejtues në ushtrimin e funksionit të tij drejtues dhe, në mënyrë të pavarur, te organi drejtues në ushtrimin e funksionit të tij mbikëqyrës, kur ky i fundit ekziston, si dhe të parashtrojnë çështje dhe të paralajmërojnë organin drejtues për zhvillime të caktuara lidhur me rrezikun që ndikojnë ose mund të ndikojnë te subjekti i detyruar.

Subjektet e detyruara duhet të sigurojnë që personat që marrin pjesë drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë në zbatimin e Pjesës II dhe Pjesës III të këtij ligji, si dhe të çdo akti administrativ të nxjerrë nga autoritetet mbikëqyrëse, të kenë akses në të gjithë informacionin dhe të gjitha të dhënat e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre.

6. Drejtuesi i përputhshmërisë raporton rregullisht tek organi drejtues lidhur me zbatimin e politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme të subjektit të detyruar. Në veçanti, drejtuesi i përputhshmërisë i paraqet organit drejtues një herë në vit, ose, sipas rastit, edhe më shpesh, një raport mbi zbatimin e politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme të subjektit të detyruar, të hartuar nga përgjegjësi i përputhshmërisë, dhe duhet ta mbajë të informuar organin drejtues mbi rezultatin e çdo rishikimi. Drejtuesi i përputhshmërisë duhet të ndër marrë veprimet e nevojshme për të korrigjuar në kohën e duhur çdo mangësi të identifikuar.

7. Funksionet e drejtuesit të përputhshmërisë dhe të përgjegjësit të përputhshmërisë mund të kryhen nga i njëjti person, kur natyra e veprimtarisë së subjektit të detyruar, duke përfshirë rreziqet dhe kompleksitetin e saj, si dhe madhësia e tij, e justifikojnë këtë. Këto funksione mund të bashkohen edhe me funksione të tjera.

Kur subjekti i detyruar është një person fizik ose një person juridik, veprimtaria e të cilit ushtrohet nga një person fizik i vetëm, ky person është përgjegjës për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në këtë nen.

Neni 94

Njohja me kërkesat ligjore

1. Subjektet e detyruara duhet të marrin masa për të siguruar që punonjësit e tyre ose personat në pozicione të ngjashme, funksioni i të cilëve e kërkon, përfshirë agjentët dhe shpërndarësit, të jenë të njohur me kërkesat që burojnë nga Pjesa II dhe Pjesa III të këtij ligji, nga aktet nënligjore dhe aktet administrative të nxjerra nga mbikëqyrësit, si dhe me vlerësimin e rrezikut në nivel subjekti, politikat e brendshme, procedurat dhe kontrollet e miratuara nga subjekti i detyruar, përfshirë edhe në lidhje me përpunimin e të dhënave personale për qëllime të zbatimit të Pjesës II të këtij ligji.

2. Subjektet e detyruara duhet të sigurojnë që masat e përmendura në pikën 1 të këtij neni të përfshijnë pjesëmarrjen e punonjësve ose personave në pozicione të ngjashme, duke përfshirë agjentët dhe shpërndarësit, në programe të veçanta, të vazhdueshme trajnimi për t'i

ndihmuar ata të njohin apo të identifikojnë veprimet që mund të lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë dhe për t'i udhëzuar ata se si të veprojnë në raste të tilla.

Programet duhet të jenë të përshtatshme për funksionet ose aktivitetet e tyre dhe për rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë ndaj të cilave është i ekspozuar subjekti i detyruar, dhe këto programe duhet të dokumentohen rregullisht.

Neni 95

Integriteti i punonjësve

1. Punonjësit ose personat në pozicione të ngjashme, duke përfshirë agjentët dhe shpërndarësit, që marrin pjesë drejtpërdrejt në përputhshmërinë e subjektit të detyruar me kërkesat ligjore të Pjesës II dhe Pjesës III të këtij ligji, të çdo akti nënligjor dhe të çdo akti administrativ të nxjerrë nga mbikëqyrësit, duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi në përputhje me rreziqet që lidhen me detyrat e kryera, përmbajtja e të cilit miratohet nga përgjegjësi i përputhshmërisë, për:

a) aftësitë, njohuritë dhe ekspertizën individuale për të kryer funksionet e tyre në mënyrë efektive;

b) reputacionin e mirë, ndershmërinë dhe integritetin.

2. Vlerësimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni duhet të kryhet para se punonjësi ose personi në një pozicion të ngjashëm të ushtrojë funksionin, duke përfshirë agjentët dhe shpërndarësit, dhe duhet të përsëritet rregullisht. Intensiteti i vlerësimeve të mëvonshme duhet të përcaktohet në bazë të detyrave që i janë ngarkuar personit dhe rreziqeve që lidhen me funksionin që ai kryen.

3. Punonjësit ose personat në pozicione të ngjashme, duke përfshirë agjentët dhe shpërndarësit, të cilëve u ngarkohen detyra që kanë të bëjnë me përputhshmërinë e subjektit të detyruar me Pjesën II dhe Pjesën III të këtij ligji, me çdo akt nënligjor dhe me çdo akt administrativ të nxjerrë nga mbikëqyrësit, duhet të informojnë përgjegjësin e përputhshmërisë lidhur me çdo marrëdhënie të ngushtë private ose profesionale të krijuar me klientët e subjektit të detyruar ose me klientët e mundshëm dhe nuk mund të lejohen të kryejnë detyra që kanë të bëjnë me përputhshmërinë e subjektit të detyruar në lidhje me këta klientë.

4. Subjektet e detyruara duhet të miratojnë procedura për parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve të interesit që mund të ndikojnë në kryerjen e detyrave që lidhen me përputhshmërinë e subjektit të detyruar me Pjesën II dhe Pjesën III të këtij ligji, të çdo akti nënligjor dhe çdo akti administrativ të nxjerrë nga mbikëqyrësit.

5. Ky nen nuk zbatohet kur subjekti i detyruar është një person fizik ose një person juridik, veprimtaria e të cilit ushtrohet vetëm nga një person fizik.

Neni 96

Raportimi i shkeljeve dhe mbrojtja e personave raportues

1. Subjektet e detyruara sigurojnë që raportimi i shkeljeve të detyrimeve që rrjedhin nga Pjesa II dhe Pjesa III të këtij ligji, nga aktet nënligjore dhe aktet administrative të nxjerra nga mbikëqyrësit, si dhe mbrojtja e personave që raportojnë këto shkelje, të realizohen në

përputhje me legjislacionin në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

2. Subjektet e detyruara krijojnë dhe zbatojnë kanale të brendshme për raportimin e shkeljeve të detyrimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

3. Pika 2 e këtij neni nuk zbatohet kur subjekti i detyruar është një person fizik ose një person juridik veprimtaritë e të cilit kryhen nga një person fizik i vetëm.

Neni 97

Situata e punonjësve të veçantë

Kur një person fizik që bën pjesë në një nga kategoritë e përcaktuara në nenin 86, pika 3 e këtij ligji, ushtron veprimtari profesionale në cilësinë e punonjësit të një personi juridik, detyrimet dhe kërkesat e parashikuara, në këtë Pjesë II të këtij ligji, zbatohen ndaj personit juridik dhe jo ndaj personit fizik.

Seksioni 2

Dispozitat që zbatohen për grupet

Neni 98

Kërkesat në shkallë grupi

1. Shoqëria mëmë garanton që kërkesat për procedurat e brendshme, vlerësimin e rrezikut dhe organizimin e strukturës administrative të punonjësve, të parashikuara nga Seksioni 1 i këtij Kreu, të zbatohen në të gjitha degët dhe filialet e grupit në shtetet anëtare dhe, për grupet, selia qendrore e të cilave ndodhet në Bashkimin Evropian apo në vendet e treta.

Për këtë qëllim, shoqëria mëmë duhet të kryejë një vlerësim të rrezikut në nivel grupi, duke marrë parasysh vlerësimet e rrezikut në nivel subjekti të kryera nga të gjitha degët dhe filialet e grupit, dhe harton dhe zbaton politika, procedura dhe kontrolle të unifikuara në nivel grupi, duke përfshirë ato për mbrojtjen e të dhënave personale dhe shkëmbimin e informacionit brenda grupit për qëllime të PPP/FT, si dhe për të siguruar që punonjësit brenda grupit të jenë në dijeni të kërkesave që rrjedhin nga Pjesa II e këtij ligji.

Subjektet e detyruara pjesë e grupit zbatojnë këto politika, procedura dhe kontrolle në nivel grupi, duke marrë në konsideratë veçoritë e tyre specifike dhe rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuara.

Politikat, procedurat dhe kontrollet në nivel grupi, si dhe vlerësimet e rrezikut në nivel grupi, të përmendura në këtë pikë, përfshijnë të gjitha elementet e përcaktuara përkatësisht në nenet 91 dhe 92 të këtij ligji.

Për qëllimet e zbatimit të kësaj pike, kur një grup ka një njësi të vendosur në më shumë se një shtet anëtar dhe, për grupet selia qendrore e të cilave ndodhet në Bashkimin Evropian apo në vende të treta, shoqëria mëmë duhet të marrë në konsideratë informacionin e publikuar nga autoritetet e të gjitha shteteve anëtare ose vendeve të treta ku ndodhen njësitë e grupit.

2. Funksionet e përputhshmërisë përcaktohen në nivelin e grupit. Këto funksione përfshijnë një drejtues të përputhshmërisë në nivelin e grupit dhe, kur kjo justifikohet nga veprimtaritë e kryera në nivel grupi, një përgjegjës për përputhshmërinë. Vendimi për shtrirjen e funksioneve të përputhshmërisë dokumentohet.

Drejtuesi i përputhshmërisë i raporton rregullisht organit drejtues në funksionin e tij drejtues të shoqërisë mëmë mbi zbatimin e politikave, procedurave dhe kontrolleve në nivel grupi.

Drejtuesi i përputhshmërisë paraqet të paktën një herë në vit një raport mbi zbatimin e politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme të subjektit të detyruar dhe ndërmerr masat e nevojshme për të korrigjuar, në kohën e duhur, çdo mangësi të identifikuar.

Kur organi drejtues në funksionin e tij drejtues është një organ me përgjegjësi kolektive për vendimmarrjen e tij, drejtuesi i përputhshmërisë e ndihmon dhe e këshillon atë, si dhe përgatit vendimet e nevojshme për zbatimin e këtij neni.

3. Politikat, procedurat dhe kontrollet që lidhen me shkëmbimin e informacionit, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, kërkojnë që subjektet e detyruara brenda grupit të shkëmbejnë informacione kur ky shkëmbim është i nevojshëm për qëllime të zbatimit të masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit dhe të administrimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Shkëmbimi i informacionit brenda grupit përfshin, në veçanti, identitetin dhe karakteristikat e klientit, pronarët e tij përfitues ose personin në emër të të cilit vepron klienti, natyrën dhe qëllimin e marrëdhënies së biznesit dhe të transaksioneve rastësore, si dhe dyshimet, të shoqëruara me analizat përkatëse, se fondet përbëjnë produkte të veprave penale ose lidhen me financimin e terrorizmit, të raportuara pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare në përputhje me nenin 132 të këtij ligji, përveç rasteve kur udhëzohet ndryshe nga kjo agjenci.

Politikat, procedurat dhe kontrollet në shkallë grupi nuk pengojnë subjektet brenda grupit që nuk janë subjekte të detyruara t'u japin informacion subjekteve të detyruara brenda të njëjtit grup, kur ky shkëmbim është i nevojshëm për këto subjekte të detyruara për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në Pjesën II të këtij ligji.

Shoqëritë mëmë miratojnë politika, procedura dhe kontrolle në nivel grupi për të siguruar që informacioni i shkëmbyer në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni t'i nënshtrohet garancive të mjaftueshme në lidhje me konfidencialitetin, mbrojtjen e të dhënave dhe përdorimin e informacionit, përfshirë masat për të parandaluar zbulimin e tij.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, miraton me vendim, standardet teknike rregullatore që përcaktojnë kërkesat minimale për politikat, procedurat dhe kontrollet në nivel grupi, duke përfshirë standardet minimale për shkëmbimin e informacionit brenda grupit, kriteret për identifikimin e shoqërisë mëmë në rastet e përcaktuara nga neni 85, pika 57, germa "b", si dhe kushtet në të cilat dispozitat e këtij neni zbatohen për subjektet që janë pjesë e strukturave që ndajnë pronësi, administrim ose kontroll të përputhshmërisë, duke përfshirë rrjetet ose partneritetet, si dhe kriteret për identifikimin e shoqërisë mëmë në ato raste.

Neni 99

Degët dhe filialet në vende të treta

1. Kur degët ose filialet e subjekteve të detyruara ndodhen në vende të treta, në të cilat kërkesat minimale për PPP/FT janë më pak kërkuese se ato të përcaktuara në Pjesën II të këtij ligji, shoqëria mëmë siguron që këto degë ose filiale të përmbushin kërkesat e parashikuara në Pjesën II të këtij ligji, duke përfshirë kërkesat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave, ose kërkesa të barasvlershme me to.

2. Kur legjislacioni i një vendi të tretë nuk lejon përmbushjen e kërkesave të Pjesës II të këtij ligji, shoqëria mëmë merr masa shtesë për të siguruar që degët dhe filialet në atë vend të tretë të trajtojnë në mënyrë efektive rrezikun e PPP/FT dhe informon mbikëqyrësit për këto masa shtesë.

Kur mbikëqyrësit vlerësojnë se masat shtesë nuk janë të mjaftueshme, ata ndërmarrin masa të tjera mbikëqyrëse, duke përfshirë kërkesën që grupi të mos hyjë në asnjë marrëdhënie biznesi, të përfundojë ato ekzistuese, të mos kryejë transaksione apo të mbyllë veprimtaritë e tij në vendin e tretë.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, miraton me vendim, standardet teknike rregullatore që specifikojnë llojin e masave shtesë të përmendura në pikën 2 të këtij neni, duke përfshirë veprimet minimale që duhet të ndërmerren nga subjektet e detyruara kur ligji i një vendi të tretë nuk lejon zbatimin e masave të kërkuara sipas nenit 98 të këtij ligji dhe veprimet shtesë mbikëqyrëse të kërkuara në raste të tilla.

Seksioni 3 Kontraktimi

Neni 100 Kontraktimi i detyrimeve

1. Subjektet e detyruara mund t'u kontraktojnë ofruesve të shërbimeve kryerjen e detyrimeve që rrjedhin nga Pjesa II e këtij ligji. Subjekti i detyruar njofton mbikëqyrësin për kontraktimin e detyrimeve përpara se ofruesi i shërbimit të fillojë kryerjen e detyrës së kontraktuar.

2. Gjatë kryerjes së detyrimeve të kontraktuara sipas këtij neni, ofruesit e shërbimeve konsiderohen pjesë funksionale e subjektit të detyruar, përfshirë edhe rastet kur atyre u kërkohet të konsultojnë regjistrat qendrorë sipas përcaktimeve në ligjin për regjistrin e pronarëve përfitues me qëllim kryerjen e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit në emër dhe për llogari të subjektit të detyruar.

Subjekti i detyruar mbetet plotësisht përgjegjës për çdo veprim ose mosveprim që lidhet me detyrimet e kontraktuara dhe që kryhen nga ofruesit e shërbimeve.

Për çdo detyrim të kontraktuar, subjekti i detyruar duhet të jetë në gjendje t'i provojë mbikëqyrësit se e kupton arsyetimin për veprimtaritë e kryera nga ofruesi i shërbimit dhe mënyrën e ndjekur në zbatimin e tyre, si dhe faktin se këto veprimtari zbusin rreziqet specifike ndaj të cilave subjekti i detyruar është i ekspozuar.

3. Detyrimet e kontraktuara sipas pikës 1 të këtij neni nuk duhet të kryhen në mënyrë të tillë që të dëmtojnë në mënyrë thelbësore cilësinë e politikave dhe procedurave të subjektit të detyruar për përmbushjen e kërkesave të Pjesës II dhe Pjesës III të këtij ligji, si dhe të masave të kontrollit të vendosura për testimin e këtyre politikave dhe procedurave.

Në asnjë rast nuk mund të kontraktohen detyrimet e mëposhtme:

a) propozimi dhe miratimi i vlerësimit të rrezikut në nivel subjekti në përputhje me nenin 92 të këtij ligji;

b) miratimi i politikave, procedurave dhe kontrolleve të brendshme të subjektit të detyruar në përputhje me nenin 91 të këtij ligji;

c) vendimmarrja mbi përcaktimin e profilit të rrezikut që i atribuohet klientit;

d) vendimmarrja për vendosjen e një marrëdhënie biznesi ose kryerjen e një transaksioni rastësor me një klient;

e) raportimi pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare i transaksioneve ose aktiviteteve të dyshimta sipas nenit 132 të këtij ligji ose i raportimeve në përputhje me nenet 137 dhe 143 të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur këto veprimtari i delegohen një subjekti tjetër të detyruar që bën pjesë në të njëjtin grup dhe është i vendosur në të njëjtin shtet anëtar;

f) miratimi i kriterëve për zbulimin e transaksioneve dhe aktiviteteve të dyshimta ose të pazakonta.

4. Subjekti i detyruar, përpara se të kontraktojë detyrimet në përputhje me pikën 1 të këtij neni, duhet të sigurohet që ofruesi i shërbimit ka kualifikimet e nevojshme dhe të mjaftueshme për kryerjen e detyrimeve të kontraktuara.

Kur një subjekt i detyruar kontraktin një detyrim në përputhje me pikën 1 të këtij neni, ai siguron që ofruesi i shërbimit, si dhe çdo ofrues i mëtejshëm i shërbimit të kontraktuar prej tij, zbatojnë politikat dhe procedurat e miratuara nga subjekti i detyruar.

Kushtet për kryerjen e këtyre detyrave përcaktohen në një marrëveshje me shkrim ndërmjet subjektit të detyruar dhe ofruesit të shërbimit. Subjekti i detyruar kryen kontrolle periodike për të verifikuar zbatimin efektiv të këtyre politikave dhe procedurave nga ofruesi i shërbimit. Shpeshësia e këtyre kontrolleve përcaktohet në bazë të natyrës kritike të detyrimeve të kontraktuara.

5. Subjektet e detyruara sigurojnë që kontraktimi i detyrimeve të mos kryhet në mënyrë të tillë që të cenohet në mënyrë thelbësore aftësinë e autoriteteve mbikëqyrëse për të monitoruar dhe gjurmuar përputhshmërinë e subjektit të detyruar me kërkesat e Pjesës II dhe Pjesës III të ligjit.

6. Në përjashtim nga përcaktimet e pikës 1 të këtij neni, subjektet e detyruara nuk mund të kontraktin detyrimet e përcaktuara në Pjesën II të këtij ligji tek ofrues të shërbimeve që banojnë ose janë vendosur në vende të treta të identifikuar, sipas Seksionit 2 të Kreut III të Pjesës II të këtij ligji, përveç rasteve kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) subjekti i detyruar ia kontraktin detyrimet vetëm ofruesve të shërbimeve që bëjnë pjesë në të njëjtin grup;

b) grupi zbaton politika dhe procedura për PPP/FT, masa të vigjilencës së duhur ndaj klientit dhe rregulla për ruajtjen e të dhënave, të cilat janë plotësisht në përputhje me Pjesën II të këtij ligji ose me kërkesa të barasvlershme në vendet e treta;

c) zbatimi efektiv i kërkesave të përmendura në germën "b" të kësaj pike mbikëqyret në nivel grupi nga autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës në përputhje me Kreun III të Pjesës I të këtij ligji.

7. Në përjashtim nga pika 3 e këtij neni, kur një sipërmarrje e investimit kolektiv nuk ka personalitet juridik ose ka vetëm një bord drejtues dhe i ka deleguar një subjekti tjetër përpunimin e kërkesave për regjistrimin dhe mbledhjen e fondeve nga investitorët, sipas legjislacionit në fuqi, kjo sipërmarrje mund t'i delegojë njërit prej ofruesve të saj të shërbimeve kryerjen e detyrimeve të përmendura në pikën 3, germat "c", "d" dhe "e" të këtij neni.

Kontraktimi i detyrimeve të përmendura në këtë pikë mund të kryhet vetëm pasi sipërmarrja e investimit kolektiv të ketë njoftuar qëllimin e saj për të kontraktuar kryerjen e këtyre detyrimeve tek mbikëqyrësi, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, dhe mbikëqyrësi të ketë miratuar këtë kontraktim, duke marrë në konsideratë:

a) burimet, përvojën dhe njohuritë e ofruesit të shërbimeve në lidhje me parandalimin

e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë;

b) njohuritë e ofruesit të shërbimit për llojin e veprimtarive ose transaksioneve të kryera nga sipërmarrja e investimit kolektiv.

8. Ministri përgjegjës për financat, me propozimin e autoritetit përgjegjës, bazuar në aktet e nxjerra nga AMLA, nxjerr udhëzime për subjektet e detyruara lidhur me:

a) krijimin e marrëdhënieve të kontraktimit të detyrimeve, përfshirë çdo marrëdhënie të mëvonshme kontraktimi të detyrimeve, në përputhje me këtë nen, administrimin e tyre dhe procedurat për monitorimin e zbatimit të funksioneve nga ofruesi i shërbimit, veçanërisht për funksionet që konsiderohen kritike;

b) rolet dhe përgjegjësitë e subjektit të detyruar dhe të ofruesit të shërbimit në kuadër të një marrëveshjeje të kontraktimit të detyrimeve;

c) mënyrën e mbikëqyrjes ndaj kontraktimit të detyrimeve, si dhe pritshmëritë mbikëqyrëse në lidhje me kontraktimin e funksioneve kritike.

KREU III

VIGJILENCA E DUHUR NDAJ KLIENTIT

Seksioni 1

Dispozita të përgjithshme

Neni 101

Zbatimi i masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit

1. Subjektet e detyruara duhet të zbatojnë masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit në cilëndo nga rastet e mëposhtme:

a) kur vendosin një marrëdhënie biznesi;

b) kur kryejnë një transaksion rastësor me vlerë të paktën 1 000 000 (një milion) lek ose kundërvlerën në monedha të huaja, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura, ose me një vlerë më të ulët të përcaktuar në përputhje me standardet teknike rregullatore të miratuara sipas pikës 9 të këtij neni;

c) kur marrin pjesë në krijimin e një personi juridik, krijimin e një organizimi ligjor ose, për subjektet e detyruara të përcaktuara në nenin 86, pika 3, gerat "a", "b" ose "c", në transferimin e pronësisë së një personi juridik, pavarësisht nga vlera e transaksionit;

d) në të gjitha rastet, kur ekziston dyshim për pastrim parash ose financim të terrorizmit, pavarësisht nga çdo përjashtim, shmangie ose prag i përcaktuar;

e) kur ka dyshime mbi vërtetësinë ose përshtatshmërinë e të dhënave të identifikimit të klientit të marra më parë;

f) kur ka dyshime nëse personi me të cilin ndërveprojnë është klienti ose personi i autorizuar për të vepruar në emër të klientit.

2. Përveç rasteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, institucionet e kreditit dhe institucionet financiare, me përjashtim të ofruesve të shërbimeve të krypto-aseteve, duhet të zbatojnë masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit kur fillojnë ose kryejnë një transaksion rastësor që përbën një transfertë fondesh, sipas përcaktimeve në nenin 150, pika 7 të këtij ligji,

me vlerë të paktën 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose nëpërmjet disa transaksioneve të lidhura.

3. Në përjashtim të përcaktimit në pikën 1, germa “b” të këtij neni, ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet:

a) të zbatojnë masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit kur kryejnë një transaksion rastësor me vlerë të paktën 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose nëpërmjet transaksioneve të lidhura;

b) të zbatojnë të paktën masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit të përmendur në nenin 102 pika 1 germa “a”, kur kryejnë një transaksion rastësor me vlerë nën 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një veprim të vetëm ose nëpërmjet transaksioneve të lidhura.

4. Në përjashtim të përcaktimeve në pikën 1, germa “b” e këtij neni, subjektet e detyruara duhet të zbatojnë të paktën masat e vigjilencës së duhur të përmendur në nenin 102, pika 1, germa “a”, kur kryejnë një transaksion rastësor në para fizike me vlerë të paktën 300 000 (treqind mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose nëpërmjet transaksioneve të lidhura.

Kjo pikë nuk zbatohet në rastet kur legjislacioni në fuqi, bazuar në nenin 143, pika 2, parashikon kufizime për pagesat në para fizike në vlera të barabarta ose më të ulëta se 300 000 (treqind mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 143, pika 3, germa “b”.

5. Në përjashtim të përcaktimeve në pikën 1 të këtij neni, subjektet që ofrojnë shërbime të lojërave të fatit zbatojnë masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit gjatë marrjes së fitimeve, vënies së një kuote basti ose gjatë të dyja veprimeve, kur kryejnë transaksione me vlerë të paktën 200 000 (dyqind mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, pavarësisht nëse transaksioni kryhet në një transaksion të vetëm ose nëpërmjet transaksioneve të lidhura.

6. Subjektet e detyruara, në funksion të zbatimit të këtij Kreu të Pjesës II të ligjit, do të konsiderojnë si klientë të tyre personat e mëposhtëm:

a) në rastin e subjekteve të detyruara siç përmenden në nenin 86, pikat 3, gerrat “e”, “f” dhe “i”, si dhe personave që tregtojnë mallra me vlerë të lartë siç përcaktohet në nenin 86, pika 3 “j” të këtij ligji, përveç klientit të drejtpërdrejtë, edhe furnizuesin e mallrave;

b) në rastin e noterëve, avokatëve dhe profesionistëve të tjerë të pavarur ligjorë që ndërmjetësojnë një transaksion dhe kur ata janë i vetmi noter, avokat ose profesionist i pavarur ligjor që ndërmjetëson atë transaksion, të dyja palët e transaksionit;

c) në rastin e agjentëve të pasurive të paluajtshme, të dyja palët e transaksionit;

d) në lidhje me shërbimet e inicimit të pagesave të kryera nga ofruesit e këtyre shërbimeve, tregtari;

e) në lidhje me ofruesit e shërbimeve të financimit kolektiv dhe ndërmjetësuesit e financimit kolektiv, personin fizik ose juridik që kërkon financim dhe personin fizik ose juridik që siguron financim nëpërmjet platformës së financimit kolektiv.

7. Mbikëqyrësit mund t’i përjashtojnë subjektet e detyruara, drejtpërdrejt ose në bashkëpunim me autoritete të tjera në atë shtet anëtar, nga zbatimi, plotësisht ose pjesërisht, i masave të vigjilencës të duhur ndaj klientit të përcaktuara në nenin 102, pika 1, gerrat “a”, “b” dhe “c”, në lidhje me paranë elektronike, bazuar në rrezikun e ulët të provuar që paraqet

natyra e produktit, kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme për zbutjen e rrezikut:

a) instrumenti i pagesës nuk mund të rimbushet dhe vlera e ruajtur në mënyrë elektronike nuk tejkalon 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja;

b) instrumenti i pagesës përdoret ekskluzivisht për blerjen e mallrave ose shërbimeve të ofruara nga emetuesi ose brenda një rrjeti ofruesish shërbimesh;

c) instrumenti i pagesës nuk është i lidhur me një llogari pagese dhe nuk lejon shkëmbimin e vlerës së ruajtur në para fizike ose me krypto-asete;

d) emetuesi kryen monitorim të mjaftueshëm të transaksioneve ose marrëdhënies së biznesit për të mundësuar zbulimin e transaksioneve të pazakonta ose të dyshimta.

8. Ofruesit e shërbimeve të lojërave të fatit mund ta përmbushin detyrimin për zbatimin e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit, sipas përcaktimeve në nenin 102, pika 1, germa “a”, duke identifikuar klientin dhe duke verifikuar identitetin e tij në momentin e hyrjes në kazino ose në ambiente të tjera fizike të lojërave të fatit, me kusht që të kenë sisteme që mundësojnë lidhjen e transaksioneve me klientë të caktuar.

9. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës të financave, bazuar në aktet e nxjerra nga Komisioni Evropian, miraton me vendim, standardet teknike rregullatore të cilat duhet të përcaktojnë:

a) subjektet e detyruara, sektorët ose transaksionet që lidhen me rrezik më të lartë të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe për të cilat zbatohet një vlerë më e ulët se vlera e përcaktuar në pikën 1, germa “b” e këtij neni;

b) vlerat përkatëse të transaksioneve rastësore;

c) kriteret që duhet të merren në konsideratë për identifikimin e transaksioneve rastësore dhe marrëdhënieve të biznesit;

d) kriteret për identifikimin e transaksioneve të lidhura.

Standardet teknike rregullatore duhet të marrin parasysh nivelet e rreziqeve të modeleve të biznesit të llojeve të ndryshme të subjekteve të detyruara dhe vlerësimin e rrezikut në nivel kombëtar të hartuar sipas nenit 10 të ligjit.

Neni 102

Masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit

1. Në zbatim të masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit, subjektet e detyruara duhet të zbatojnë të gjitha masat e mëposhtme:

a) identifikimin e klientit dhe verifikimin e identitetit të tij;

b) identifikimin e pronarëve përfutues dhe marrjen e masave të përshtatshme për verifikimin e identitetit të tyre, në mënyrë që subjekti i detyruar të bindet për identitetin e pronarit përfutues dhe të kuptojë strukturën e pronësisë dhe të kontrollit të klientit;

c) vlerësimin dhe, sipas rastit, marrjen e informacionit dhe kuptimin e qëllimit dhe natyrës së synuar të marrëdhënies së biznesit ose të transaksioneve rastësore;

d) verifikimin nëse klienti ose pronarët përfutues i nënshtrohen masave shtrënguese financiare, dhe, në rastin e një klienti ose pale në një organizim ligjor që është person juridik, nëse persona fizikë ose juridikë, të cilët janë subjekt i masave shtrënguese financiare, kontrollojnë personin juridik ose zotërojnë më shumë se 50 % të të drejtave të pronësisë së këtij personi juridik ose një interes kontrollues në të, qoftë individualisht ose së bashku;

e) vlerësimin dhe, sipas rastit, marrjen e informacionit mbi natyrën e veprimtarisë së klientit, duke përfshirë, në rastin e personave juridik, nëse ata ushtrojnë veprimtari të caktuara, ose mbi profesionin apo punësimin e tyre;

f) kryerjen e monitorimit të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit, duke përfshirë shqyrtimin e transaksioneve të kryera gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies së biznesit, për të siguruar që transaksionet e kryera janë në përputhje me njohuritë e subjektit të detyruar për klientin, veprimtarinë dhe profilin e rrezikut të tij, duke përfshirë, kur është e nevojshme, burimin e fondeve;

ë) përcaktimin nëse klienti, pronari përfitues i klientit dhe, sipas rastit, personi në emër ose në përfitim të të cilit kryhet një transaksion ose veprimtari, është person i ekspozuar politikisht, anëtar i familjes ose person i njohur si bashkëpunëtor i afërt;

g) kur një transaksion ose veprimtari po kryhet në emër të ose për përfitimin e personave fizikë të ndryshëm nga klienti, identifikimin dhe verifikimin e identitetit të këtyre personave fizikë;

gj) verifikimin nëse çdo person që pretendon të veprojë në emër të klientit është i autorizuar për ta bërë këtë, si dhe identifikimin dhe verifikimin e identitetit të tij.

2. Subjektet e detyruara përcaktojnë shtrirjen e masave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, bazuar në një analizë individuale të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke marrë në konsideratë karakteristikat specifike të klientit dhe të marrëdhënies së biznesit ose transaksionit rastësor, si dhe vlerësimin e rrezikut në nivel të veprimtarisë së subjektit të detyruar, të kryer në përputhje me nenin 92 të këtij ligji, variablat e rrezikut për pastrimin e parave dhe financimit të terrorizmit të përcaktuara në Aneksin I, si dhe faktorët e rrezikut të përcaktuar në Aneksin II dhe Aneksin III të Pjesës II të këtij ligji.

Kur subjektet e detyruara identifikojnë një rrezik të shtuar për pastrim parash ose financim të terrorizmit, ato zbatojnë masa të vigjilencës së zgjeruar sipas Seksionit 4 të këtij Kreu.

Kur identifikohen situata me rrezik më të ulët, subjektet e detyruara mund të zbatojnë masa të vigjilencës së thjeshtuar në përputhje me Seksionin 3 të këtij Kreu.

3. Subjektet e detyruara duhet në çdo kohë të jenë në gjendje t'u demonstrojnë mbikëqyrësve se masat e marra janë të përshtatshme në raport me rreziqet e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë që janë identifikuar.

4. Ministri përgjegjës për financat, me propozimin e autoritetit përgjegjës, nxjerr udhëzime mbi variablat dhe faktorët e rrezikut që duhet të merren në konsideratë nga subjektet e detyruara gjatë vendosjes së marrëdhënieve të biznesit ose kryerjes së transaksioneve rastësore.

Neni 103

Pamundësia për të përmbushur kërkesat për zbatimin e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit

1. Kur subjekti i detyruar nuk është në gjendje të përmbushë kërkesat për zbatimin e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit të përcaktuara në nenin 102, pika 1, subjekti nuk e kryhen transaksionin ose nuk vendos marrëdhënien e biznesit, si dhe ndërpret marrëdhënien ekzistuese të biznesit dhe vlerëson mundësinë e raportimit të aktivitetit të dyshimtë në

Agjencinë e Inteligjencës Financiare në lidhje me klientin, në përputhje me nenin 132 të këtij ligji.

Ndërprerja e marrëdhënies së biznesit, në përputhje me paragrafin e mësipërm, nuk pengon marrjen nga subjekti i detyruar të fondeve, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin e pagesave.

Kur një subjekt i detyruar ka detyrimin të ruajë pasuritë e klientit të tij, ndërprerja e marrëdhënies së biznesit nuk konsiderohet se kërkon tjetërsimin e pasurive të klientit.

Në rastin e kontratave të sigurimit të jetës, subjektet e detyruara, kur është e nevojshme si masë alternative ndaj ndërprerjes së marrëdhënies së biznesit, nuk kryejnë veprime për klientin, përfshirë pagesat ndaj përfituesve, deri në përmbushjen e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit të përcaktuara në nenin 102, pika 1 të këtij ligji.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për noterët, avokatët, profesionistët e tjerë të pavarur ligjorë, audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar dhe këshilltarët tatimorë, në masën që këta subjekte përcaktojnë situatën juridike të klientit të tyre, ose kryejnë detyrën e mbrojtjes ose përfaqësimit të klientit në procedurat gjyqësore, ose në lidhje me to, përfshirë dhënien e këshillave për fillimin ose shmangien e procedurave të tilla.

Paragrafi i mësipërm i kësaj pike nuk zbatohet kur subjektet e detyruara të përmendura në të:

a) marrin pjesë në pastrimin e parave, veprave penale që lidhen me të ose financimin e terrorizmit;

b) japin këshillim ligjor për qëllimet e pastrimit të parave, veprave penale që lidhen me të ose financimin e terrorizmit; ose

c) kanë dijeni se klienti kërkon këshillim ligjor për qëllime të pastrimit të parave, veprave penale që lidhen me të ose financimit të terrorizmit.

Dijenja ose qëllimi mund të nxirren nga rrethana objektive faktike.

3. Subjektet e detyruara duhet të mbajnë evidenca për masat e marra për përmbushjen e kërkesave për zbatimin e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit, duke përfshirë evidencat për vendimet e marra, dokumentet mbështetëse përkatëse dhe arsyetimet. Dokumentet, të dhënat ose informacioni i mbajtur nga subjekti i detyruar përditësohen sa herë që masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit rishikohet në përputhje me nenin 108 të këtij ligji.

Detyrimi për të mbajtur evidencat, sipas parashikimeve të kësaj pike, zbatohet gjithashtu në rastet kur subjektet e detyruara refuzojnë vendosjen e një marrëdhënie biznesi, ndërpresin një marrëdhënie biznesi ose zbatojnë masa alternative në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

4. Banka e Shqipërisë, bazuar në aktet e nxjerra nga AMLA dhe Autoriteti Evropian Bankar (EBA) nxjerr udhëzime mbi masat që mund të merren nga institucionet e kreditit dhe institucionet financiare për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat PPP/FT, duke përfshirë ato që lidhen me marrëdhëniet e biznesit më të prekura nga procesi i reduktimit të rrezikut (*derisking*).

Neni 104

Identifikimi dhe verifikimi i identitetit të klientëve dhe pronarëve përfitues

1. Me përjashtim të rasteve me rrezik më të ulët, ndaj të cilave zbatohen masat sipas Seksionit 3 të këtij Kreu, dhe pavarësisht nga zbatimi i masave shitesë në rastet e rrezikut më të

lartë sipas Seksionit 4 të këtij Kreu, subjektet e detyruara duhet të marrin, të paktën, informacionin e mëposhtëm për identifikimin e klientit, të çdo personi që pretendon të veprojë në emër të klientit dhe të personave fizikë në emër ose për përfitimin e të cilëve kryhet një transaksion ose veprimtari:

a) për personin fizik:

i. të gjithë emrat dhe mbiemrat;

ii. vendin dhe datën e plotë të lindjes;

iii. shtetësinë ose shtetësitë, ose mungesën e shtetësisë, si dhe, sipas rastit, statusin e refugjatit ose të përfituesit të mbrojtjes plotësuese, si dhe numrin kombëtar të identifikimit, kur është i disponueshëm;

iv. vendbanimin e zakonshëm ose, nëse nuk ka një adresë të përhershme banimi me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, adresën postare në të cilën personi fizik mund të kontaktohet dhe, kur është i disponueshëm, numrin e identifikimit tatimor;

b) për personin juridik:

i. formën juridike dhe emërtimin e personit juridik;

ii. adresën e selisë së regjistruar ose zyrtare dhe, nëse është e ndryshme prej saj, vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë, si dhe shtetin ku është krijuar;

iii. emrat e përfaqësuesve ligjorë të personit juridik, si dhe, kur janë të disponueshëm, numrin e regjistrimit, numrin e identifikimit tatimor dhe identifikuesin e personit juridik;

iv. emrat e personave që zotërojnë pjesë të kapitalit ose mbajnë pozicionin e drejtuesit në cilësinë e personit të emëruar, duke përfshirë përcaktimin e cilësisë së tyre si aksionarë ose drejtorë të emëruar;

c) për kujdestarin e një trusti të posaçëm ose personin që mban një pozicion të barasvlershëm në një organizim ligjor të ngjashëm:

i. informacion bazë mbi organizimin ligjor; megjithatë, në lidhje me pasuritë e mbajtura në kuadër të organizimit ligjor ose të administruara përmes tij, identifikohen vetëm pasuritë që do të administrohen në kuadër të marrëdhënies së biznesit ose të transaksionit rastësor;

ii. adresa e vendbanimit të kujdestarëve ose personave që mbajnë një pozicion të barasvlershëm në një organizim ligjor të ngjashëm dhe, nëse është i ndryshëm, adresa e vendit nga ku trusti i posaçëm ose organizimi ligjor i ngjashëm administrohet, aktin që përcakton dhe rregullon funksionimin e organizimit ligjor përfshirë kompetencat që rregullojnë dhe detyrojnë organizimin ligjor, si dhe, kur janë të disponueshme, numrin e identifikimit tatimor dhe identifikuesin e personit juridik;

d) për format e tjera ligjore që kanë zotësi juridike sipas legjislacionit në fuqi:

i. emërtimin, adresën e selisë së regjistruar ose adresën e barasvlershme;

ii. emrat e personave të autorizuar për të përfaqësuar, si dhe, sipas rastit, formën juridike, numrin e identifikimit tatimor, numrin e regjistrimit, identifikuesin e personit juridik dhe aktet e themelimit ose dokumente të barasvlershme me to.

2. Për qëllime të identifikimit të pronarit përfitues të një personi juridik ose të një organizimi ligjor, subjektet e detyruara mbledhin informacionin e përcaktuar në ligjin për regjistrin e pronarëve përfitues.

Kur, pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e mundshme të identifikimit, nuk identifikohen persona fizikë si pronarë përfitues ose kur ka dyshime se personat e identifikuar janë pronarë përfitues, subjektet e detyruara dokumentojnë faktin se nuk është identifikuar asnjë pronar përfitues dhe identifikojnë të gjithë personat fizikë që mbajnë pozicionet e drejtuesve të lartë

administrues të personit juridik, si dhe verifikojnë identitetin e tyre.

Kur kryerja e verifikimit të identitetit të përmendur në paragrafin e dytë të kësaj pike mund t'i bëjë të ditur klientit se subjekti i detyruar ka dyshime lidhur me pronësinë përfituese të personit juridik, subjekti i detyruar nuk kryen verifikimin e identitetit të drejtuesve të lartë administrues dhe, në vend të kësaj, dokumenton masat e marra për përcaktimin e identitetit të pronarëve përfitues dhe të drejtuesve të lartë administrues.

Subjektet e detyruara duhet të mbajnë evidenca për masat e marra, si dhe për vështirësitë e hasura gjatë procesit të identifikimit, të cilat kanë çuar në nevojën e identifikimit të një drejtuesi të lartë administrues.

3. Institucionet e kreditit dhe institucionet financiare marrin informacion për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të personave fizikë ose juridikë që përdorin çdo IBAN virtual të lëshuar prej tyre, si dhe të llogarisë përkatëse bankare ose të pagesave të lidhura me të.

Institucioni i kreditit ose institucioni financiar që administron llogarinë bankare ose të pagesave, në të cilën ridrejtohen pagesat nga një IBAN virtual i lëshuar nga një institucion tjetër krediti ose financiar, siguron që të mund të marrë nga institucioni që ka lëshuar IBAN-in virtual informacionin për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të personit fizik që përdor atë IBAN virtual, pa vonesë dhe, në çdo rast, brenda 5 ditëve pune nga kërkesa për këtë informacion.

4. Në rastin e përfituesve të trusteve ose të personave juridikë apo organizimeve ligjore të ngjashme, të cilët përcaktohen në bazë të karakteristikave të veçanta ose një kategorie të caktuar, subjekti i detyruar merr informacion të mjaftueshëm për përfituesin, në mënyrë që të jetë në gjendje të përcaktojë identitetin e tij në momentin e kryerjes së pagesës ose në momentin e ushtrimit nga përfituesi të të drejtave të tij të fituara.

5. Në rastin e trusteve diskrecionale, subjekti i detyruar merr informacion të mjaftueshëm lidhur me personat që janë objekt i një kompetence diskrecionale dhe përfituesit në mungesë të ushtrimit të diskrecionit, në mënyrë që të jetë në gjendje të përcaktojë identitetin e përfituesit në momentin kur kujdestarët ushtrojnë kompetencën e tyre diskrecionale ose në momentin kur përfituesit bëhen përfitues për shkak të mos ushtrimit të kompetencës diskrecionale nga kujdestarët.

6. Subjektet e detyruara marrin informacionin, dokumentet dhe të dhënat e nevojshme për verifikimin e identitetit të klientit dhe të çdo personi që pretendon se vepron në emër të tij, përmes një prej mjeteve të mëposhtme:

a) paraqitjes së dokumentit të identifikimit, pasaportës ose dokumentit të barasvlershëm me të dhe, sipas rastit, marrjes së informacionit nga burime të besueshme dhe të pavarura, qoftë të aksesueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të dhëna të siguruar nga klienti;

b) përdorimit të mjeteve të identifikimit elektronik dhe të shërbimeve të besuara për skemat e identifikimit elektronik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore, në lidhje me nivelet e sigurisë “thelbësor” ose “i lartë”, si dhe shërbimeve të tjera të përcaktuara në Pjesën II të këtij ligji;

7. Subjektet e detyruara verifikojnë identitetin e pronarit përfitues dhe, sipas rastit, të personave në emër ose për përfitimin e të cilëve kryhet një transaksion ose veprimtari, nëpërmjet njërës prej mënyrave të mëposhtme:

a) në përputhje me pikën 6 të këtij neni;

b) marrjen e masave të përshtatshme për të siguruar informacionin, dokumentet dhe të

dhënat e nevojshme nga klienti ose nga burime të tjera të besueshme, duke përfshirë regjistrat publikë, përveç regjistrave qendrorë.

Subjektet e detyruara përcaktojnë shtrirjen e informacionit që do të konsultohet, duke marrë parasysh rreziqet që paraqiten nga transaksioni rastësor ose marrëdhënia e biznesit dhe nga pronari përfitues, përfshirë rreziqet që lidhen me strukturën e pronësisë.

Përveç mjeteve të verifikimit të përcaktuara në këtë pikë, subjektet e detyruara verifikojnë informacionin mbi pronarët përfitues përmes konsultimit të regjistrat elektronik të pronarëve përfitues dhe regjistrave të tjerë qendrorë.

Neni 105

Koha e kryerjes së verifikimit të identitetit të klientit dhe pronarit përfitues

1. Verifikimi i identitetit të klientit, pronarit përfitues dhe çdo personi të përcaktuar në nenin 102, pika 1, gjerat “g” dhe “gj”, kryhet përpara vendosjes së një marrëdhënieje biznesi ose kryerjes së një transaksioni rastësor. Ky detyrim nuk zbatohet për rastet me rrezik më të ulët sipas përcaktimeve të Seksionit 3 të këtij Kreu, me kusht që niveli i ulët i rrezikut të justifikojë shtyrjen e këtij verifikimi.

Për agjentët e pasurive të paluajtshme, verifikimi i përmendur në paragrafin e mësipërm të kësaj pike kryhet pas pranimit të një oferte nga shitësi ose qiradhënësi dhe, në çdo rast, përpara transferimit të fondeve ose pasurisë.

2. Në përjashtim nga pika 1 e këtij neni, verifikimi i identitetit të klientit dhe pronarit përfitues mund të kryhet gjatë vendosjes së marrëdhënieje të biznesit, kur kjo është e nevojshme për të mos ndërprerë zhvillimin normal të veprimtarisë dhe kur ekziston rrezik i ulët i pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

Në këto raste, procedurat përkatëse duhet të përfundojnë sa më shpejt të jetë e mundur pas kontaktit fillestar me klientin.

3. Në përjashtim nga pika 1 e këtij neni, një institucion krediti ose institucion financiar mund të hapë një llogari, përfshirë edhe llogaritë që lejojnë kryerjen e transaksioneve në tituj të transferueshëm, sipas kërkesës së klientit, me kusht që të jenë vendosur masa mbrojtëse të përshtatshme që sigurojnë se klienti ose personi që vepron në emër të tij nuk kryen transaksione deri në përmbushjen e plotë të masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit të përcaktuar në nenin 102, pika 1, gjerat “a” dhe “b”, të këtij ligji.

4. Subjektet e detyruara, gjatë vendosjes së një marrëdhënieje të re biznesi me një person juridik ose me kujdestarin e një trusti të posaçëm, ose personin që mban një pozicion të barasvlerëshëm në një organizim ligjor të ngjashëm, të identifikuar sipas ligjit për regjistrin e pronarëve përfitues dhe që ka detyrimin për regjistrimin e informacionit sipas atij ligji, duhet të mbledhin dokumentacion të vlefshëm që provon regjistrimin ose një ekstrakt të regjistrat, të lëshuar së fundmi, që konfirmon vlefshmërinë e regjistrimit.

Neni 106

Raportimi i mospërputhjeve në regjistrin e pronarëve përfitues

1. Subjektet e detyruara raportojnë në regjistrin e pronarëve përfitues çdo mospërputhje që konstatojnë ndërmjet informacionit mbi pronarët përfitues të disponueshëm në regjistër dhe informacionit që ato kanë mbledhur gjatë zbatimit të masave të vigjilencës së duhur ndaj

klientit, në përputhje me nenin 102, pika 1, germa “b” dhe nenin 104, pika 7 të këtij ligji.

Mospërputhjet e përmendura në paragrafin e mësipërm raportohen pa vonesë dhe, në çdo rast, brenda 14 ditëve kalendarike pas konstatimit të tyre. Kur raportojnë këto mospërputhje, subjektet e detyruara bashkëlidhin informacionin e siguruar prej tyre që tregon mospërputhjen, si dhe identifikojnë personat që ato konsiderojnë të jenë pronarët përfitues dhe, sipas rastit, aksionarët e emëruar dhe drejtorët apo administratorët e emëruar, së bashku me arsyetimin përkatës.

2. Në përjashtim nga pika 1 e këtij neni, subjektet e detyruara mund të mos i raportojnë mospërputhjet në regjistrin e pronarëve përfitues dhe, në vend të kësaj, mund t’i kërkojnë informacion shtesë klientit, kur mospërputhjet e konstatuara:

a) lidhen vetëm me gabime shtypi, mënyra të ndryshme *transliterimi* ose pasaktësi të vogla që nuk ndikojnë në identifikimin e pronarëve përfitues ose pozicionit të tyre; ose

b) rezultojnë nga të dhëna të papërditësuara, por pronarët përfitues njihen nga subjekti i detyruar nëpërmjet një burimi tjetër të besueshëm dhe nuk ekzistojnë arsye për të dyshuar se synohet fshehja e informacionit.

Kur një subjekt i detyruar arrin në përfundimin se informacioni mbi pronësinë përfituese në regjistrin është i pasaktë, ai i kërkon klientit të paraqesë pa vonesë informacionin e saktë në regjistrin e pronarëve përfitues, dhe në çdo rast, brenda 14 ditëve kalendarike, sipas legjislacionit në fuqi.

Kjo pikë nuk zbatohet për rastet me rrezik më të lartë, ndaj të cilave zbatohen masat sipas Seksionit 4 të këtij Kreu.

3. Kur klienti nuk ka paraqitur informacionin e saktë brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, subjekti i detyruar raporton mospërputhjen në regjistrin e pronarëve përfitues në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

4. Ky nen nuk zbatohet për noterët, avokatët, profesionistët e tjerë ligjorë të pavarur, audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar dhe konsulentët tatimorë, në lidhje me informacionin që ata marrin nga klienti ose sigurojnë për klientin, gjatë përcaktimit të pozitës juridike të atij klienti ose gjatë ushtrimit të detyrës së tyre për mbrojtjen ose përfaqësimin e atij klienti në, ose lidhur me, procedurat gjyqësore, duke përfshirë dhënien e këshillave për fillimin ose shmangien e këtyre proceseve, pavarësisht nëse ky informacion merret ose sigurohet para, gjatë ose pas këtyre procedurave.

5. Kërkesat e këtij neni, zbatohen në çdo rast, kur subjektet e detyruara të përmendura në pikën 4 të këtij neni, japin këshillim ligjor në cilëndo prej situatave të parashikuara nga neni 103, pika 2, gerrat “a”, “b” dhe “c”.

6. Raportimi i mospërputhjeve në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas këtij neni, nuk zëvendëson detyrimin për raportimin e aktivitetit të dyshimtë pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare.

Neni 107

Identifikimi i qëllimit dhe natyrës së marrëdhënies së biznesit ose të transaksionit rastësor

1. Përpara vendosjes së një marrëdhënie biznesi ose kryerjes së një transaksioni rastësor, subjekti i detyruar duhet të sigurohet se kupton qëllimin dhe natyrën e synuar të tyre. Për këtë qëllim, subjekti i detyruar merr, kur është e nevojshme, informacion mbi:

a) qëllimin dhe arsyetimin ekonomik të transaksionit rastësor ose të marrëdhënies së biznesit;

b) shumën e parashikuar të veprimeve që pritet të kryhen ose që janë planifikuar;

c) burimin e fondeve;

d) destinacionin e fondeve;

e) veprimtarinë ekonomike ose profesionin e klientit.

2. Për qëllimet e pikës 1, germa "a", të këtij neni, subjektet e detyruara të përcaktuara në nenin 137, marrin informacion për të përcaktuar nëse përdorimi i mallrave me vlerë të lartë, të përmendura në atë nen është për qëllime tregtare apo jo tregtare.

Neni 108

Monitorimi i vazhdueshëm i marrëdhënies së biznesit dhe monitorimi i transaksioneve të kryera nga klientët

1. Subjektet e detyruara kryejnë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit, duke përfshirë transaksionet e kryera nga klienti gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies së biznesit, për të siguruar që këto transaksione janë në përputhje me njohuritë që subjekti i detyruar ka për klientin, veprimtarinë ekonomike të klientit dhe profilin e rrezikut të tij, si dhe, kur është e nevojshme, me informacionin në lidhje me origjinën dhe destinacionin e fondeve, si dhe për të identifikuar ato transaksione që duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi më të thelluar në përputhje me nenin 132, pika 4 të këtij ligji.

Kur marrëdhëniet e biznesit përfshijnë më shumë se një produkt ose shërbim, subjektet e detyruara sigurojnë që masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit të zbatohen për të gjitha këto produkte dhe shërbime.

Kur subjektet e detyruara që i përkasin një grupi kanë marrëdhënie biznesi me klientë të cilët janë gjithashtu klientë të subjekteve të tjera brenda atij grupi, qofshin këto subjekte të detyruara apo subjekte që nuk u nënshtrohen kërkesave në lidhje me PPP/FT, ato marrin në konsideratë informacionin që lidhet me këto marrëdhënie të tjera biznesi për qëllimet e monitorimit të marrëdhënies së biznesit me klientët e tyre.

2. Në kuadër të monitorimit të vazhdueshëm të përmendur në pikën 1 të këtij neni, subjektet e detyruara duhet të sigurojnë që dokumentet, të dhënat ose informacioni përkatës i klientit të mbahen të përditësuar.

Periodha midis përditësimeve të informacionit të klientit sipas paragrafit të mësipërm të kësaj pike, përcaktohet në bazë të rrezikut që paraqet marrëdhënia e biznesit dhe në çdo rast nuk mund të tejkalojë:

a) për klientët me rrezik më të lartë, ndaj të cilëve zbatohen masat sipas Seksionit 4 të këtij Kreu, 1 vit;

b) për të gjithë klientët e tjerë, 5 vite.

3. Përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, subjektet e detyruara duhet të rishikojnë dhe, kur është e nevojshme, përditësojnë informacionin për klientin, në rastet kur:

a) ndodh një ndryshim në rrethanat përkatëse të klientit;

b) subjekti i detyruar ka një detyrim ligjor, gjatë vitit kalendarik përkatës, për të kontaktuar klientin me qëllim rishikimin e informacionit përkatës mbi pronarët përfitues ose për të përmbushur detyrimet ligjore në kuadër të shkëmbimit të informacionit me autoritetet

tatimore;

c) subjekti i detyruar merr dijeni për një fakt apo rrethanë të rëndësishme që lidhet me klientin.

4. Përveç monitorimit të vazhdueshëm të përmendur në pikën 1 të këtij neni, subjektet e detyruara verifikojnë rregullisht nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin 102, pika 1, germa “d”. Shpeshtësia e këtij verifikimi është në përpjesëtim me ekspozimin e subjektit të detyruar dhe të marrëdhënies së biznesit ndaj rrezikut të moszbatimit dhe shmangies së masave shtrënguese financiare.

Për institucionet e kreditit dhe institucionet financiare, verifikimi i përmendur në paragrafin e mësipërm të kësaj pike, kryhet gjithashtu në rast të çdo shpallje të re në lidhje me masat shtrënguese financiare.

Kërkesat e kësaj pike nuk zëvendësojnë detyrimin për zbatimin e masave shtrënguese financiare ose kërkesave më rigorozë të parashikuara në legjislacionin në fuqi për verifikimin e klientëve kundrejt listave të masave shtrënguese financiare.

5. Ministri i Financave, me propozimin e autoritetit përgjegjës, nxjerr udhëzime për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit dhe për monitorimin e transaksioneve të kryera në kuadër të saj.

Neni 109

Masat e përkohshme për klientët që i nënshtrohen masave shtrënguese financiare të Kombeve të Bashkuara (OKB)

1. Në lidhje me klientët të cilët i nënshtrohen masave shtrënguese financiare të OKB ose që kontrollohen nga persona fizikë ose juridikë, subjekte apo entitete, që u nënshtrohen masave shtrënguese financiare të OKB, ose në të cilat personat fizikë ose juridikë, subjektet apo entitete të tilla që i nënshtrohen masave shtrënguese financiare të OKB zotërojnë, individualisht ose së bashku, më shumë se 50% të të drejtave të pronësisë ose kanë interes apo pjesëmarrje kontrolluese, subjektet e detyruara duhet të mbajnë evidenca lidhur me:

a) fondet ose pasuritë e tjera që administrojnë për klientin në momentin kur publikohen masat shtrënguese financiare të OKB;

b) transaksionet që tentojnë të kryhen nga klienti;

c) transaksionet e kryera për klientin.

2. Subjektet e detyruara duhet ta zbatojnë këtë nen nga momenti i publikimit të masave shtrënguese financiare të OKB deri në momentin e fillimit të zbatimit të masave shtrënguese financiare përkatëse në Republikën e Shqipërisë.

Neni 110

Standardet teknike rregullatore për kryerjen e vigjilencës së duhur ndaj klientit

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat, miraton me vendim, standardet teknike rregullatore që përcaktojnë:

a) kërkesat që zbatohen për subjektet e detyruara në përputhje me nenin 102 dhe informacionin që duhet të mblidhet për qëllime të kryerjes së vigjilencës së thjeshtuar, vigjilencës së duhur dhe vigjilencës së zgjeruar, në përputhje me nenet 104, 107, 114, pika 1 dhe 115, pika 4 të këtij ligji, duke përfshirë kërkesat minimale në situata me rrezik të ulët;

b) llojin e masave të vigjilencës së thjeshtuar që subjektet e detyruara mund të zbatojnë në situata me rrezik të ulët në përputhje me nenin 114, pika 1 të këtij ligji, duke përfshirë masat e zbatueshme për kategori të caktuara të subjekteve të detyruara dhe për produkte ose shërbime të caktuara, duke marrë parasysh rezultatet e vlerësimit kombëtar të rrezikut sipas nenit 10 të këtij ligji;

c) faktorët e rrezikut të lidhur me karakteristikat e instrumenteve të parasë elektronike që duhet të merren në konsideratë nga mbikëqyrësit gjatë përcaktimit të masës së përjashtimit sipas nenit 101, pika 7 të këtij ligji;

d) burimet e besueshme dhe të pavarura të informacionit që mund të përdoren për verifikimin e të dhënave të identifikimit të personave fizikë ose juridikë për qëllimet e nenit 104, pikat 6 dhe 7 të këtij ligji;

e) listën e elementeve që duhet të përmbajnë mjetet e identifikimit elektronik dhe shërbimet e besuara të përmendura në nenin 104, pika 6, germa “b”, në mënyrë që të përmbushen kërkesat e nenit 102, pika 1, gjerat “a” dhe “b”, në rastin e zbatimit të vigjilencës së duhur, të thjeshtuar dhe të zgjeruar.

2. Kërkesat dhe masat e përmendura në pikën 1, gjerat “a” dhe “b” të këtij neni, bazohen në kriteret e mëposhtme:

- a) rrezikun e identifikuar që lidhet me shërbimin e ofruar;
- b) rreziqet e lidhura me kategoritë e klientëve;
- c) natyrën, vlerën dhe shpeshtësinë e transaksionit;
- d) kanalet e përdorura për kryerjen e marrëdhënies së biznesit ose të transaksionit rastësor.

3. Këto standarde teknike rregullatore rishikohen rregullisht dhe, kur është e nevojshme, përditësimi i këtyre standardeve bëhet, ndër të tjera, për të marrë parasysh inovacionin dhe zhvillimet teknologjike.

Seksioni 2

Politikat ndaj vendeve të treta dhe kërcënimet për PPP/FT me origjinë nga jashtë vendit

Neni 111

Identifikimi i vendeve të treta me mangësi strategjike në sistemet e tyre kombëtare për PPP/FT

1. Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, miraton me vendim, listën e vendeve të treta me mangësi strategjike në sistemin e tyre kombëtar për PPP/FT, të cilat janë ato të identifikuara dhe të shpallura nga aktet e Bashkimit Evropian si “vende të treta me rrezik të lartë”.

2. Subjektet e detyruara, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, duhet të zbatojnë masat e vigjilencës së zgjeruar të përcaktuara në nenin 115, pika 4 të këtij ligji në lidhje me marrëdhëniet e biznesit ose transaksionet rastësore që përfshijnë persona fizikë ose juridikë nga ai vend i tretë.

3. Subjektet e detyruara zbatojnë kundërmasa specifike, të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni, që zbusin rreziqet specifike që rrjedhin nga secili vend i tretë me rrezik të lartë.

4. Në rastet kur autoritetet kompetente identifikojnë se një vend i tretë, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, paraqet një rrezik specifik të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit ose financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë, i cili nuk adresohet në mënyrë të mjaftueshme nga masat e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, autoritetet kompetente mund t'u kërkojnë subjekteve të detyruara të zbatojnë masa shtesë për zbutjen e rreziqeve specifike që burojnë nga ai vend i tretë. Rreziku i identifikuar dhe kundërmasat përkatëse duhet të dokumentohen dhe t'i komunikohen Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave, brenda 5 ditëve nga zbatimi i masave.

5. Pas marrjes së njoftimit, në përputhje me pikën 4 të këtij neni, Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave vlerëson informacionin e marrë me qëllim përcaktimin nëse rreziqet specifike të vendit të tretë ndikojnë në integritetin e tregut të brendshëm të vendit si dhe rishikon nëse kundërmasat specifike të identikuara marrin parasysh ndryshimet në kuadrin ligjor PPP/FT të vendit të tretë, janë proporcionale dhe të përshtatshme me rreziqet. Komiteti i Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave në përfundim të vlerësimit vendos, kur është e përshtatshme, shtimin e kundërmasave të nevojshme ose refuzimin e tyre.

Neni 112

Identifikimi i vendeve të treta me dobësi në përputhshmëri në sistemet e tyre kombëtare për PPP/FT

1. Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, miraton me vendim, listën e vendeve të treta me dobësi në përputhshmëri në sistemet e tyre kombëtare për PPP/FT, të cilat janë ato të identikuara dhe të shpallura nga aktet e Bashkimit Evropian.

2. Subjektet e detyruara, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, duhet të zbatojnë masat e vigjilencës së zgjeruar të përcaktuara në nenin 115, pika 4 të këtij ligji në lidhje me zbutjen e rreziqeve që lidhen me marrëdhëniet e biznesit ose transaksionet rastësore që përfshijnë persona fizikë ose juridikë nga ai vend i tretë.

Neni 113

Identifikimi i vendeve të treta që paraqesin një kërcënim specifik dhe serioz për sistemin financiar të Bashkimit Evropian

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, miraton me vendim, listën e vendeve të treta të identikuara nga aktet e Bashkimit Evropian, në rastet e jashtëzakonshme kur vlerësohet e domosdoshme zbutja e një kërcënimi specifik dhe serioz për sistemin financiar të Bashkimit Evropian dhe funksionimin e duhur të tregut të brendshëm, i cili buron nga ato vende të treta dhe nuk mund të adresohet në përputhje me nenin 111 dhe 112 të këtij ligji.

2. Subjektet e detyruara, në zbatim të pikës 1 të këtij neni, duhet të zbatojnë masat e vigjilencës së zgjeruar të përcaktuara në nenin 115, pika 4, për të zbutur rreziqet në lidhje me marrëdhëniet e biznesit ose transaksionet rastësore që përfshijnë persona fizikë ose juridikë nga ai vend i tretë.

3. Subjektet e detyruara zbatojnë kundërmasa specifike, të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni, të cilat synojnë zbutjen e rreziqeve specifike që rrjedhin nga secili vend i tretë me rrezik të lartë.

4. Ministri i Financave, me propozimin e autoritetit përgjegjës, mbi bazën e akteve të nxjerra nga AMLA, nxjerr udhëzime që përcaktojnë rreziqet, trendet dhe metodat e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që përfshijnë zonat gjeografike jashtë territorit të Bashkimit Evropian ndaj të cilave janë të ekspozuara subjektet e detyruara.

5. Udhëzimet e nxjerra sipas pikës 4 të këtij neni do të rishikohen të paktën çdo 2 vjet, në përputhje edhe me aktet që do të nxirren nga AMLA.

Seksioni 3

Masat e vigjilencës së thjeshtuar ndaj klientit

Neni 114

Masat e vigjilencës së thjeshtuar

1. Subjektet e detyruara, duke marrë parasysh faktorët e rrezikut të përcaktuar në Aneksin II dhe Aneksin III të Pjesës II të këtij ligji, kur marrëdhënia e biznesit ose transaksioni paraqet një nivel të ulët rreziku, mund të zbatojnë masat e mëposhtme të vigjilencës së thjeshtuar ndaj klientit në lidhje me:

a) verifikimin e identitetit të klientit dhe pronarit përfitues pas krijimit të marrëdhënies së biznesit, me kusht që niveli specifik i ulët i rrezikut të identifikuar të justifikojë këtë shtyrje, por në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga krijimi i marrëdhënies së biznesit;

b) reduktimin e shpeshtësisë së përditësimit të të dhënave të identifikimit të klientit;

c) reduktimin e sasisë së informacionit të mbledhur për identifikimin e qëllimit dhe natyrës së synuar të marrëdhënies së biznesit ose transaksionit rastësor, ose përcaktimin e tij në bazë të llojit të transaksioneve ose marrëdhënies së biznesit të krijuar;

d) reduktimin e shpeshtësisë ose shkallës së kontrollit të transaksioneve të kryera nga klienti;

e) zbatimin e çdo mase tjetër të vigjilencës së thjeshtuar, të përcaktuar në aktet nënligjore të nxjerra në përputhje me nenin 110 të këtij ligji.

Masat e përmendura në paragrafin e mësipërm, të kësaj pike, duhet të jenë në përputhje me natyrën dhe madhësinë e veprimtarisë dhe me elementet specifike të rrezikut më të ulët të identifikuar. Në çdo rast, subjektet e detyruara duhet të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit, për të mundësuar zbulimin e transaksioneve të pazakonta ose të dyshimta.

2. Subjektet e detyruara duhet të sigurojnë që procedurat e brendshme të përcaktuara sipas nenit 91 të këtij ligji, të përmbajnë masat specifike të verifikimit të thjeshtuar që do të zbatohen për llojet e ndryshme të klientëve që paraqesin rrezik më të ulët.

Subjektet e detyruara dokumentojnë vendimet për marrjen në konsideratë të faktorëve shtesë që lidhen me rrezikun më të ulët.

3. Për qëllime të zbatimit të masave të vigjilencës së thjeshtuar të përmendura në pikën 1, germa "a" e këtij neni, subjektet e detyruara miratojnë procedura për menaxhimin e rrezikut lidhur me kushtet në të cilat mund të ofrojnë shërbime ose të kryejnë transaksione për një klient

përpara përfundimit të verifikimit, duke përfshirë kufizimin e shumës, numrit ose llojeve të transaksioneve që mund të kryhen, ose monitorimin e transaksioneve për të garantuar që ato janë në përputhje me normat e pritshme për marrëdhënien përkatëse të biznesit.

4. Subjektet e detyruara verifikojnë në mënyrë periodike që vazhdojnë të ekzistojnë kushtet për zbatimin e masave të vigjilencës së thjeshtuar.

Shpeshësia e këtyre verifikimeve përcaktohet në përpjesëtim me natyrën dhe madhësinë e veprimtarisë, si dhe me rreziqet që paraqet marrëdhënia specifike.

5. Subjektet e detyruara nuk duhet të zbatojnë masat e vigjilencës së thjeshtuar në cilëndo nga situatat e mëposhtme:

a) subjektet e detyruara kanë dyshime në lidhje me vërtetësinë e informacionit të dhënë nga klienti ose pronari përfitues gjatë fazës së identifikimit, ose konstatojnë mospërputhje në lidhje me atë informacion;

b) faktorët që tregojnë një rrezik më të ulët nuk janë më të pranishëm;

c) monitorimi i transaksioneve të klientit dhe informacioni i mbledhur në kuadër të marrëdhënies së biznesit përjashtojnë një skenar me rrezik më të ulët;

d) ekziston dyshimi për pastrim parash ose financim të terrorizmit;

e) ekziston dyshimi se klienti ose personi që vepron në emër të klientit po përpiket të anashkalojë ose t'i shmanget masave shtrënguese financiare.

Seksioni 4

Masat e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit

Neni 115

Fusha e zbatimit të masave të vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit

1. Subjektet e detyruara, në rastet e përcaktuara në nenet 111, 112, 113 dhe 117 deri në 127, si dhe në raste të tjera me rrezik të lartë të identifikuar nga subjektet e detyruara në përputhje me nenin 102, pika 2, paragrafi i dytë, zbatojnë masa të vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit për të menaxhuar dhe zbutur në mënyrë të përshtatshme këto rrezeqe.

2. Subjektet e detyruara shqyrtojnë origjinën dhe destinacionin e fondeve të përfshira, si dhe qëllimin e të gjitha transaksioneve që plotësojnë të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) transaksioni ka natyrë komplekse;

b) transaksioni është në mënyrë të pazakontë me vlerë të lartë;

c) transaksioni kryhet në një formë të pazakontë;

d) transaksioni nuk ka një qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor.

3. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara nga Seksioni 2 i këtij Kreu, gjatë vlerësimit të rrezeqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të paraqitura nga një marrëdhënie biznesi ose një transaksion rastësor, subjektet e detyruara marrin në konsideratë të paktën faktorët e rrezikut potencial më të lartë të përcaktuar në Aneksin III të Pjesës II të këtij ligji dhe udhëzimet e miratuara në përputhje me nenin 113, pikat 4 dhe 5 të këtij ligji, si dhe çdo tregues tjetër të rrezikut më të lartë, përfshirë njoftimet e nxjerra nga Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe gjetjet e vlerësimit të rrezikut në nivel të veprimtarisë së subjektit të detyruar, sipas nenit 92 të këtij ligji.

4. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në Seksionin 2 të këtij Kreu, në rastet me rrezik më të lartë të përmendura në pikën 1 të këtij neni, subjektet e detyruara zbatojnë masa të

vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit, në përpjesëtim me rreziqet më të larta të identifikuara, të cilat mund të përfshijnë masat e mëposhtme:

- a) marrjen e informacionit shtesë për klientin dhe pronarët përfitues;
- b) marrjen e informacionit shtesë mbi natyrën e synuar të marrëdhënies të biznesit;
- c) marrjen e informacionit shtesë mbi burimin e fondeve dhe burimin e pasurisë së klientit dhe të pronarëve përfitues;
- d) marrjen e informacionit mbi arsyet e transaksioneve të synuara ose të kryera dhe përputhshmërinë e tyre me marrëdhënien e biznesit;
- e) marrjen e miratimit të drejtuesve të lartë lidhur me krijimin ose vazhdimësinë e marrëdhënies të biznesit;
- f) kryerjen e monitorimit të thelluar të marrëdhënies të biznesit duke rritur numrin dhe shpeshtësinë e kontrolleve të kryera dhe duke përzgjedhur modelet e transaksioneve që kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm;
- g) kërkesën që pagesa e parë të kryhet nëpërmjet një llogarie në emër të klientit pranë një institucioni krediti që i nënshtrohet standardeve të vigjilencës së duhur ndaj klientit jo me pak rigorozë se ato të përcaktuara në Pjesën II të këtij ligji.

5. Kur një marrëdhënie biznesi e identifikuar me rrezik të lartë përfshin administrimin e pasurive apo aktiveve me vlerë të paktën 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë ose kundërvlerën në një monedhë tjetër të huaj, nëpërmjet shërbimeve të personalizuar për një klient që zotëron pasuri apo aktive totale me vlerë të paktën 5 000 000 000 (pesë miliardë) lekë ose kundërvlerën në një monedhë tjetër të huaj, qofshin këto pasuri apo aktive financiare, të investueshme ose të paluajtshme, ose kombinim i tyre, duke përjashtuar banesën private të klientit, institucionet e kreditit, institucionet financiare dhe ofruesit e shërbimeve për trustet ose shoqëritë tregtare zbatojnë masat e mëposhtme të vigjilencës së zgjeruar, përveç çdo mase tjetër të zbatuar sipas pikës 4 të këtij neni:

- a) masa specifike, përfshirë procedurat për zbutjen e rreziqeve që lidhen me shërbimet dhe produktet e personalizuar të ofruara për atë klient;
- b) marrjen e informacionit shtesë mbi burimin e fondeve të klientit;
- c) miratimin dhe zbatimin e masave për parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve të interesit midis klientit dhe drejtuesve të lartë, ose punonjësve të subjektit të detyruar që kryejnë detyra në lidhje me përputhshmërinë e subjektit të detyruar për këtë klient.

6. Ministri përgjegjës për financat, me propozim të autoritetit përgjegjës, nxjerr udhëzime mbi masat që duhet të ndërmerren nga institucionet e kreditit, institucionet financiare dhe ofruesit e shërbimeve për trustet ose shoqëritë tregtare, për të përcaktuar nëse një klient zotëron pasuri apo aktive totale me vlerë të paktën 5 000 000 000 (pesë miliardë) lekë ose kundërvlerën në një monedhë tjetër të huaj, në formën e pasurive financiare, të investueshme ose të paluajtshme, dhe mënyrën e përcaktimit të kësaj vlere.

7. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në Seksionin 2 të këtij Kreu, kur nëpërmjet vlerësimit kombëtar të rrezikut të hartuar në bazë të nenit 10 të këtij ligji, përfshirë vlerësimet sektoriale të rrezikut, identifikohen raste me rrezik më të lartë të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, mbikëqyrësit mund t'u kërkojnë subjekteve të detyruara zbatimin e masave të vigjilencës së zgjeruar dhe, sipas rastit, të përcaktojnë masat konkrete që duhet të zbatohen.

Mbikëqyrësit njoftojnë brenda 1 muaji nga miratimi i tyre i vendimeve, sipas kësaj pike, Komitetin e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave duke shoqëruar njoftimin me

një arsyetim të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që mbështesin këtë vendim.

8. Masat e vigjilencës së zgjeruar nuk zbatohen automatikisht ndaj degëve ose filialeve të subjekteve të detyruara të vendosura në Bashkimin Evropian, të cilat ndodhen në vendet e treta sipas përcaktimeve në nenet 111, 112 dhe 113 të këtij ligji, kur këto degë ose filiale zbatojnë plotësisht politikat, procedurat dhe kontrollet në nivel grupi në përputhje me nenin 99 të këtij ligji.

Neni 116

Masat kundërvepruese për zbutjen e kërcënimeve nga jashtë për PPP/FT

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, për qëllimet e zbatimit të neneve 111 dhe 113 të këtij ligji, miraton me vendim, zbatimin ndërmjet masave kundërvepruese të mëposhtme:

a) masa kundërvepruese që subjektet e detyruara duhet t'i zbatojnë ndaj personave fizikë dhe personave juridikë që kanë lidhje me vende të treta me rrezik të lartë dhe, sipas rastit, me vende të tjera që paraqesin kërcënim për sistemin financiar të Republikës së Shqipërisë, të cilat përfshijnë:

- i. zbatimin e elementeve shtesë të masave të vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit;
- ii. vendosjen e mekanizmave shtesë të raportimit ose raportimin sistematik të transaksioneve financiare;
- iii. kufizimin e marrëdhënieve të biznesit ose të transaksioneve me persona fizikë ose persona juridikë nga këto vende të treta;

b) masa kundërvepruese që subjektet e detyruara duhet t'i zbatojnë ndaj vendeve të treta me rrezik të lartë dhe, sipas rastit, ndaj vendeve të tjera që paraqesin kërcënim për sistemin financiar të Republikës së Shqipërisë, të cilat përfshijnë:

i. refuzimin e krijimit të filialeve, degëve ose zyrave të përfaqësimit të subjekteve të detyruara nga vendi përkatës, ose marrjen në konsideratë të faktit që subjekti përkatës i detyruar është nga një vend i tretë që nuk ka regjime të përshtatshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

ii. ndalimin e subjekteve të detyruara për të krijuar degë ose zyra përfaqësimi në vendin e tretë përkatës, ose marrjen në konsideratë të faktit që dega ose zyra e përfaqësimit përkatëse do të ndodhej në një vend të tretë që nuk ka regjime të përshtatshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

iii. kërkimin e një kontrolli mbikëqyrës të shtuar ose të kërkesave të shtuara për auditim të jashtëm për degët dhe filialet e subjekteve të detyruara që ndodhen në vendin e tretë përkatës;

iv. kërkimin e kërkesave të shtuara për auditim të jashtëm për grupet financiare lidhur me çdo degë dhe filial të tyre që ndodhet në vendin e tretë përkatës;

v. kërkimin që institucionet e kreditit dhe institucionet financiare të rishikojnë dhe ndryshojnë ose, kur është e nevojshme, të ndërpresin marrëdhëniet korrespondente me institucionet përkatëse të vendit të tretë në fjalë.

Neni 117

Masat specifike të vigjilencës së zgjeruar për marrëdhëniet korrespondente ndërkufitare

1. Në rastet e marrëdhënieve korrespondente ndërkufitare, përfshirë marrëdhëniet e krijuara për transaksione me tituj ose transfertat fondesh, që përfshijnë ekzekutimin e pagesave me një institucion korrespondent të një vendi të tretë, përveç masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit të përcaktuar në nenin 102 të këtij ligji, institucionet e kreditit dhe institucionet financiare, gjatë krijimit të një marrëdhënie biznesi, duhet të:

a) mbledhin informacion të mjaftueshëm për institucionin korrespondent për të kuptuar plotësisht natyrën e veprimtarisë së institucionit përkatës dhe për të përcaktuar, nëpërmjet informacionit të disponueshëm publikisht, reputacionin e institucionit dhe cilësinë e mbikëqyrjes së tij;

b) vlerësojnë kontrollet e institucionit korrespondent për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

c) marrin miratimin e drejtuesve të lartë para krijimit të marrëdhënieve të reja korrespondence;

d) dokumentojnë përgjegjësitë përkatëse të secilit institucion;

e) në lidhje me llogaritë e aksesueshme drejtpërdrejt nga klientët (*payable-through accounts*), të sigurohen që institucioni korrespondent ka verifikuar identitetin e klientëve që kanë akses të drejtpërdrejtë në llogaritë e institucionit korrespondent dhe ka kryer ndaj tyre masat e vigjilencës së duhur, si dhe që është në gjendje t'i sigurojë institucionit kërkues korrespondent të dhënat përkatëse të vigjilencës të duhur ndaj klientit, me kërkesë të këtij të fundit.

2. Në rastet kur institucionet e kreditit dhe institucionet financiare vendosin të ndërpresin marrëdhëniet korrespondente ndërkufitare për arsye që lidhen me politikat e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ato dokumentojnë vendimin e tyre.

Neni 118

Masat specifike të vigjilencës së zgjeruar për marrëdhëniet korrespondente ndërkufitare të ofruesve të shërbimeve të krypto-aseteve

1. Me përjashtim nga sa është parashikuar në nenin 117 të këtij ligji, në lidhje me marrëdhëniet korrespondente ndërkufitare që përfshijnë ofrues të shërbimeve për krypto-asetet me një subjekt korrespondent që nuk është i themeluar territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që ofron shërbime të ngjashme, përfshirë transfertat e krypto-aseteve, ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve, përveç masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit, të përcaktuara në nenin 102 të këtij ligji, gjatë krijimit të një marrëdhënie biznesi, duhet të:

a) përcaktojnë nëse subjekti korrespondent është i licencuar ose i regjistruar;

b) mbledhin informacion të mjaftueshëm për subjektin korrespondent për të kuptuar plotësisht natyrën e veprimtarisë së tij dhe për të përcaktuar, nëpërmjet informacionit të disponueshëm publikisht, reputacionin e subjektit dhe cilësinë e mbikëqyrjes së tij;

c) vlerësojnë kontrollet e subjektit korrespondent për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

d) marrin miratimin e drejtuesve të lartë para krijimit të marrëdhënies së re korrespondente;

e) dokumentojnë përgjegjësitë përkatëse të secilës palë në marrëdhënien

korrespondente;

f) në lidhje me llogaritë e krypto-aseteve të aksesueshme drejtpërdrejt nga klientët (*payable-through crypto-asset accounts*), të sigurohen që subjekti korrespondent ka verifikuar identitetin e klientëve që kanë akses të drejtpërdrejtë në llogaritë e subjektit korrespondent dhe ka kryer ndaj tyre masat e vazhdueshme të vigjilencës së duhur, si dhe që është në gjendje t'i sigurojë subjektit korrespondent të dhënat përkatëse të vigjilencës së duhur ndaj klientit, me kërkesë të këtij të fundit.

Kur ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve vendosin të ndërpresin marrëdhëniet korrespondente për arsye që lidhen me politikat e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ata dokumentojnë vendimin e tyre.

Ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve përditësojnë rregullisht informacionin e vigjilencës së duhur ndaj klientit për marrëdhënien korrespondente ose sa herë që shfaqen rreziqe të reja në lidhje me subjektin korrespondent.

2. Ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve marrin në konsideratë informacionin e mbledhur në përputhje me pikën 1 të këtij neni, me qëllim përcaktimin në bazë të mbikëqyrjes të bazuar në rrezik, të masave të përshtatshme që duhet të merren për të zbutur rreziqet që lidhen me subjektin korrespondent.

3. Autoriteti mbikëqyrës kompetent nxjerr udhëzime për të specifikuar kriteret dhe elementet që ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të marrin në konsideratë gjatë kryerjes së vlerësimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni dhe masat për zbutjen e rrezikut të përmendura në pikën 2 të këtij neni, duke përfshirë masat minimale që duhet të ndërmerren nga ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve kur konstatohet se subjekti korrespondent nuk është i regjistruar ose i licencuar.

Neni 119

Masat specifike për institucionet përgjegjëse të vendeve të treta

1. Institucionet e kreditit dhe institucionet financiare zbatojnë masat e parashikuara në pikën 6 të këtij neni në lidhje me institucionet përgjegjëse të vendeve të treta me të cilat kanë një marrëdhënie korrespondente në përputhje me nenet 117 ose 118 të këtij ligji, për të cilat autoriteti mbikëqyrës kompetent ka nxjerrë rekomandim në përputhje me pikën 2 të këtij neni.

2. Autoriteti mbikëqyrës kompetent, përfshirë AMLA kur ushtron funksionet e saj mbikëqyrëse, nxjerr një rekomandim drejtuar institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare kur ekzistojnë të dhëna se institucionet përgjegjëse të vendeve të treta ndodhen në një nga situatat e mëposhtme:

a) janë në shkelje të rëndë, të përsëritur ose sistematike të kërkesave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

b) kanë mangësi në politikat, procedurat dhe kontrollet e tyre të brendshme, të cilat ka të ngjarë të çojnë në shkelje të rënda, të përsëritura ose sistematike të kërkesave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

c) kanë vendosur politika, procedura dhe kontrole të brendshme që nuk janë në përputhje me rreziqet e pastrimit të parave, veprave penale që lidhen me to dhe financimit të terrorizmit, ndaj të cilave është ekspozuar institucioni përgjegjës i vendit të tretë.

3. Rekomandimi i përmendur në pikën 2 të këtij neni nxirret kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) bazuar në informacionin e disponueshëm në kuadër të veprimtarive të saj mbikëqyrëse, autoriteti mbikëqyrës financiar, përfshirë AMLA kur ushtron veprimtaritë e saj mbikëqyrëse, vlerëson se një institucion përgjegjës i një vendi të tretë ndodhet në një nga situatat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni dhe mund të ndikojë në ekspozimin ndaj rrezikut të marrëdhënies korresponente;

b) pas vlerësimit të informacionit të disponueshëm nga autoriteti mbikëqyrës financiar i përmendur në germën "a" të kësaj pike, ekziston një dakordësi ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse financiare dhe autoriteteve mbikëqyrëse të shteteve anëtare se institucioni përgjegjës i vendit të tretë ndodhet në një nga situatat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni dhe mund të ndikojë në ekspozimin ndaj rrezikut të marrëdhënies korresponente.

4. Përpara nxjerrjes së rekomandimit të përmendur në pikën 2 të këtij neni, AMLA konsultohet me autoritetin mbikëqyrës të vendit të tretë përgjegjës për institucionin përgjegjës dhe i kërkon këtij autoriteti të paraqesë qëndrimin e vet dhe qëndrimin e institucionit përgjegjës lidhur me përshtatshmërinë e politikave, procedurave dhe kontrolleve për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe të masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit të vendosura nga institucioni përgjegjës për të zbutur rreziqet e pastrimit të parave, veprave penale që lidhen me to dhe financimit të terrorizmit, si dhe masat korrigjuese që duhet të zbatohen.

Nëse nuk merret përgjigje brenda 2 muajve ose nëse përgjigja e dhënë nuk tregon se institucioni përgjegjës i vendit të tretë mund të zbatojë politika, procedura dhe kontrolle të duhura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe të aplikojë masa të përshtatshme të vigjilencës së duhur ndaj klientit për të zbutur rreziqet ndaj të cilave është ekspozuar dhe që mund të ndikojnë në marrëdhënien korresponente, AMLA vijon me nxjerrjen e rekomandimit.

5. Autoritetet mbikëqyrëse apo AMLA tërheqin rekomandimin e përmendur në pikën 2 të këtij neni, sapo vlerëson se institucioni përgjegjës i vendit të tretë për të cilin është nxjerrë ky rekomandim nuk plotëson më kushtet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

6. Në lidhje me institucionet përgjegjëse të vendeve të treta të përmendura në pikën 1 të këtij neni, institucionet e kreditit dhe institucionet financiare:

a) nuk hyjnë në marrëdhënie të reja biznesi me institucionin përgjegjës të vendit të tretë, përveç rasteve kur, bazuar në informacionin e mbledhur sipas nenit 117 ose 118, arrijnë në përfundimin se masat zbutëse të zbatuara ndaj marrëdhënies së biznesit me institucionin përgjegjës të vendit të tretë dhe masat e vendosura nga vetë institucioni përgjegjës i vendit të tretë mund të zbusin në mënyrë të përshtatshme rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që lidhen me këtë marrëdhënie biznesi;

b) për marrëdhëniet ekzistuese të biznesit me institucionin përgjegjës të vendit të tretë:

i. rishikojnë dhe përditësojnë informacionin mbi institucionin përgjegjës në përputhje me nenet 117 ose 118;

ii. ndërpresin marrëdhënien e biznesit, përveç rasteve kur, bazuar në informacionin e mbledhur sipas nënpikës "i" të kësaj pike, arrijnë në përfundimin se masat zbutëse të zbatuara ndaj marrëdhënies së biznesit me institucionin përgjegjës të vendit të tretë dhe masat e vendosura nga institucioni përgjegjës i vendit të tretë mund të zbusin në mënyrë të përshtatshme rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që lidhen me këtë marrëdhënie biznesi;

c) informojnë institucionin përgjegjës për përfundimet që kanë arritur lidhur me rreziqet

që paraqet marrëdhënia korrespondente, pas rekomandimit të autoritetit mbikëqyrës kompetent apo AMLA-s, si dhe për masat e marra në përputhje me shkronjat "a" ose "b" të kësaj pike.

Kur AMLA apo autoritetet mbikëqyrëse kompetente ka tërhequr një rekomandim sipas pikës 5 të këtij neni, institucionet e kreditit dhe institucionet financiare rishikojnë vlerësimin e tyre nëse institucionet përgjegjëse të vendeve të treta plotësojnë ndonjë nga kushtet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

7. Institucionet e kreditit dhe institucionet financiare dokumentojnë çdo vendim të marrë në përputhje me këtë nen.

Neni 120

Ndalimi i marrëdhënieve korrespondente me institucionet guaskë

1. Institucionet e kreditit dhe institucionet financiare nuk hyjnë ose nuk vazhdojnë një marrëdhënie korrespondente me një institucion guaskë. Institucionet e kreditit dhe institucionet financiare marrin masat e duhura për të siguruar që të mos krijojnë ose vijnë marrëdhënie korrespondente me një institucion krediti ose institucion financiar për të cilin dihet se lejon përdorimin e llogarive të tij nga një institucion guaskë.

2. Përveç kërkesës së përcaktuar në pikën 1, ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve sigurojnë që llogaritë e tyre të mos përdoren nga institucione guaskë për ofrimin e shërbimeve të krypto-aseteve. Për këtë qëllim, ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve vendosin politika, procedura dhe kontrole të brendshme për të zbuluar çdo përpjekje për përdorimin e llogarive të tyre për ofrimin e shërbimeve të parregulluara të krypto-aseteve.

Neni 121

Masat për zbutjen e rreziqeve në lidhje me transaksionet me një adresë të vetë-hostuar

1. Ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve identifikojnë dhe vlerësojnë rrezikun e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që lidhet me transfertat e krypto-aseteve drejtuar një adrese të vetë-hostuar ose me origjinë nga një adresë e tillë. Për këtë qëllim, ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve miratojnë politika, procedura dhe kontrole të brendshme.

Ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve zbatojnë masa zbutëse në përpjesëtim me rreziqet e identifikuar. Këto masa zbutëse përfshijnë një ose disa nga masat e mëposhtme:

a) marrjen e masave të bazuara në rrezik për të identifikuar dhe verifikuar identitetin e nismëtarit ose përfituesit të një transferte të kryer nga ose drejt një adrese të vetë-hostuar, ose pronarit përfitues të nismëtarit ose përfituesit, përfshirë edhe nëpërmjet mbështetjes të palët të treta;

b) kërkimin e informacionit shtesë mbi origjinën dhe destinacionin e krypto-aseteve;

c) kryerjen e monitorimit të zgjeruar dhe të vazhdueshëm të transaksioneve me një adresë të vetë-hostuar;

d) çdo masë tjetër për zbutjen dhe menaxhimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe rrezikut të moszbatimit dhe shmangies së masave shtrënguese financiare.

2. Autoriteti mbikëqyrës kompetent, nxjerr udhëzime për të specifikuar masat zbutëse të përmendura në pikën 1 të këtij neni, duke përfshirë:

a) kriteret dhe mjetet për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të nismëtarit ose

përfituesit të një transferte të kryer nga ose drejt një adresë e vetë-hostuar, përfshirë nëpërmjet mbështetjes të palë të treta, duke marrë parasysh zhvillimet më të fundit teknologjike;

b) kriteret dhe mënyrat për verifikimin nëse adresa e vetë-hostuar është ose jo në pronësi ose nën kontrollin e një klienti.

Neni 122

Dispozita të posaçme lidhur me aplikantët e skemave të qëndrimit në këmbim të investimeve

Përveç masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit të parashikuara në nenin 102 të këtij ligji, në lidhje me klientët që janë shtetas të vendeve të treta dhe që janë në proces aplikimi për të drejtën për leje qëndrimi në këmbim të çdo forme investimi, përfshirë transfertat, blerjen ose dhënien me qira të pasurive të paluajtshme, investimin në obligacione shtetërore, investimin në persona juridikë tregtar, dhurimin ose financimin e një veprimtarie në interes publik, si dhe kontributet në buxhetin e shtetit, subjektet e detyruara zbatojnë, të paktën, masat e vigjilencës së zgjeruar të përcaktuara në nenin 115, pika 4, germat “a”, “c”, “e” dhe “f”, të këtij ligji.

Neni 123

Dispozita të posaçme për personat e ekspozuar politikisht

1. Përveç masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit të përcaktuara në nenin 102 të këtij ligji, subjektet e detyruara zbatojnë masat e mëposhtme në lidhje me transaksionet rastësore ose marrëdhëniet e biznesit me personat e ekspozuar politikisht:

a) marrin miratimin e drejtuesve të lartë për kryerjen e transaksioneve rastësore ose për krijimin apo vazhdimin e marrëdhënieve të biznesit me persona të ekspozuar politikisht;

b) marrin masat e nevojshme për të përcaktuar burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve të përfshira në marrëdhëniet e biznesit ose transaksionet rastësore me persona të ekspozuar politikisht;

c) kryejnë monitorim të zgjeruar dhe të vazhdueshëm të këtyre marrëdhënieve të biznesit.

2. Ministri përgjegjës për financat, me propozim të autoritetit përgjegjës, nxjerr udhëzime në lidhje me çështjet e mëposhtme:

a) kriteret për identifikimin e personave të njohur si bashkëpunëtorë të ngushtë;

b) nivelin e rrezikut të lidhur me një kategori të caktuar të personave të ekspozuar politikisht, anëtarëve të familjes ose personave të njohur si bashkëpunëtorë të ngushtë, duke përfshirë udhëzimet për mënyrën e vlerësimit të këtyre rreziqeve kur personi nuk është më i ngarkuar me një funksion të rëndësishëm publik, për qëllimet e zbatimit të nenit 126 të këtij ligji.

Neni 124

Lista e funksioneve të larta publike

1. Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nxjerr dhe mban të përditësuar një listë me funksionet e sakta të cilat, sipas ligjeve, rregulloreve dhe akteve administrative të brendshme, kualifikohen si funksione të larta publike për qëllimet e

zbatimit të nenit 85, pika 49 e këtij ligji.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare i kërkon organizatave ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë që të hartojnë dhe të mbajnë të përditësuar listën e funksioneve të larta publike që lidhen me atë organizatë, për qëllimet e zbatimit të nenit 85, pika 49 e këtij ligji.

Këto lista përfshijnë gjithashtu çdo funksion që mund t'u besohet përfaqësuesve të vendeve të treta dhe të organizmave ndërkombëtare të akredituara në nivel Bashkimi Evropian.

Këto lista, si dhe çdo ndryshim i bërë në to, u vihet në dispozicion subjekteve të detyruara për marrjen e masave të parashikuara në këtë ligj.

Neni 125

Personat e ekspozuar politikisht që janë përfitues të policave të sigurimit

Subjektet e detyruara marrin masa të arsyeshme për të përcaktuar nëse përfituesit e një police sigurimi të jetës ose të një police tjetër të lidhur me investime, ose, kur është e zbatueshme, pronari përfitues i përfituesit, janë persona të ekspozuar politikisht.

Këto masa merren jo më vonë se në momentin e pagesës së përfitimit ose në momentin e kalimit, tërësisht ose pjesërisht, të të drejtave që rrjedhin nga polica.

Kur identifikohen rreziqe më të larta, përveç zbatimit të masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit sipas nenit 102 të këtij ligji, subjektet e detyruara:

- a) informojnë drejtuesit e lartë përpara pagesës së përfitimeve që rrjedhin nga polica;
- b) kryejnë një shqyrtim të zgjeruar të të gjithë marrëdhënies së biznesit me mbajtësin e policës.

Neni 126

Masat për personat që kanë pushuar së qeni persona të ekspozuar politikisht

1. Kur një person i ekspozuar politikisht nuk është më i ngarkuar me një funksion të lartë publik, nga Republika e Shqipërisë, nga Bashkimi Evropian, nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian, nga një vend i tretë ose një organizatë ndërkombëtare, subjektet e detyruara marrin në konsideratë rrezikun e vazhdueshëm që paraqet ky person, si rezultat i funksionit të mëparshëm, gjatë vlerësimit të rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me nenin 102 të këtij ligji.

2. Subjektet e detyruara zbatojnë një ose disa nga masat e përcaktuara në nenin 115, pika 4 e këtij ligji, për zbutjen e rreziqeve që paraqet personi i ekspozuar politikisht, deri në momentin kur rreziqet e përmendura në pikën 1 të këtij neni nuk ekzistojnë më, por në çdo rast jo më pak se 12 muaj pas datës kur personi ka pushuar së ushtruar funksionin e lartë publik.

3. Detyrimi i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni zbatohet në mënyrë të përshtatshme edhe kur një subjekt i detyruar kryen një transaksion rastësor ose krijon një marrëdhënie biznesi me një person i cili në të kaluarën ka qenë i ngarkuar me një funksion të lartë publik nga Republika e Shqipërisë, nga Bashkimi Evropian, nga një shtet anëtar i Bashkimit Evropian, nga një vend i tretë ose një organizatë ndërkombëtare.

Neni 127

Anëtarët e familjes dhe personat që njihen si bashkëpunëtorë të ngushtë të personave të

ekspozuar politikisht

Masat e përmendura në nenet 123, 125 dhe 126 të këtij ligji zbatohen gjithashtu ndaj anëtarëve të familjes dhe personave të njohur si bashkëpunëtorë të ngushtë të personave të ekspozuar politikisht.

Seksioni 5

Dispozitat të posaçme të vigjilencës së duhur ndaj klientit

Neni 128

Kërkesa të veçanta për sektorin e sigurimit të jetës dhe sigurimeve të tjera të lidhura me investimet

1. Për veprimtaritë e sigurimit të jetës ose sigurimeve të tjera të lidhura me investimet, krahas masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit që kërkohen për klientin dhe pronarin përfitues, subjektet e detyruara zbatojnë masat e mëposhtme të vigjilencës së duhur ndaj klientit për përfituesit e policave të sigurimit të jetës dhe të sigurimeve të tjera të lidhura me investimet, menjëherë sapo përfituesit të identifikohen ose të përcaktohen:

a) në rastin e përfituesve të identifikuar si persona të emërtuar në mënyrë specifike ose si organizime ligjore, regjistrojnë emrin e personit ose organizimit ligjor;

b) në rastin e përfituesve të përcaktuar në bazë të karakteristikave, kategorisë ose mënyrave të tjera, marrin informacion të mjaftueshëm për këta përfitues, në mënyrë që të jenë në gjendje të përcaktojnë identitetin e përfituesit në momentin e pagesës së përfitimit.

2. Për qëllimet e pikës 1 të këtij neni, verifikimi i identitetit të përfituesve dhe, kur është e zbatueshme, i pronarëve të tyre përfitues, kryhet në momentin e pagesës së përfitimit.

Në rast të kalimit, tërësisht ose pjesërisht, të një police sigurimi jete ose sigurimi tjetër të lidhur me investimet të një palë e tretë, subjektet e detyruara që kanë dijeni për këtë kalim identifikojnë pronarin përfitues në momentin e kalimit, të personi fizik, personi juridik ose organizimi ligjor që merr për përfitimin e vet vlerën e policës së transferuar.

Seksioni 6

Mbështetja në subjekte të tjera të detyruara për zbatimin e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit

Neni 129

Dispozita të përgjithshme në lidhje me mbështetjen të subjektet e tjera të detyruara

1. Subjektet e detyruara mund të mbështeten të subjekte të tjera të detyruara, pavarësisht nëse ndodhen në një shtet anëtar ose në një vend të tretë, për përmbushjen e kërkesave të vigjilencës së duhur ndaj klientit të përcaktuara në nenin 102, pika 1, germa "a", "b" dhe "c", me kusht që:

a) subjektet e tjera të detyruara të zbatojnë kërkesat për vigjilencën e duhur ndaj klientit dhe kërkesat për ruajtjen e të dhënave të përcaktuara në Pjesën II të ligjit, ose kërkesa të barasvlershme me to, kur subjektet e tjera të detyruara janë të vendosura në një vend të tretë;

b) përputhshmëria e subjekteve të tjera të detyruara me kërkesat për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të mbikëqyret në përputhje me Kreun III të Pjesës I të këtij ligji.

Përgjegjësia përfundimtare për përmbushjen e kërkesave për vigjilencën e duhur ndaj klientit mbetet te subjekti i detyruar që mbështetet te një subjekt tjetër i detyruar.

2. Kur vendosin të mbështeten te subjekte të tjera të detyruara që ndodhen në vende të treta, subjektet e detyruara marrin në konsideratë faktorët e rrezikut gjeografik të renditur në Aneksin II dhe Aneksin III të Pjesës II të këtij ligji dhe çdo informacion ose udhëzim përkatës të nxjerrë Komisioni Evropian, AMLA dhe autoritetet kompetente.

3. Në rastin e subjekteve të detyruara që janë pjesë e një grupi, përputhshmëria me kërkesat e këtij neni dhe të nenit 130 mund të sigurohet nëpërmjet politikave, procedurave dhe kontrolleve në nivel grupi, me kusht që të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) subjekti i detyruar mbështetet vetëm në informacionin e dhënë nga një subjekt i detyruar që është pjesë e të njëjtit grup;

b) grupi zbaton politika dhe procedura për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, masa të vigjilencës së duhur ndaj klientit dhe rregulla për ruajtjen e të dhënave, të cilat janë plotësisht në përputhje me Pjesën II të këtij ligji ose me rregulla të barazvlefshme në vendet e treta;

c) zbatimi efektiv i kërkesave të përcaktuara në germen "b" të kësaj pike mbikëqyret në nivel grupi nga autoriteti mbikëqyrës i shtetit anëtar të origjinës në përputhje me Kreun III të Pjesës I të këtij ligji ose nga autoriteti përkatës i vendit të tretë në përputhje me rregullat e atij vendi të tretë.

4. Subjektet e detyruara nuk mund të mbështeten te subjektet e detyruara të themeluara në vendet e treta të identifikuar në përputhje me Seksionin 2 të këtij Kreu. Subjektet e detyruara të themeluara në Bashkimin Evropian, degët dhe filialet e të cilave janë të themeluara në këto vende të treta, mund të mbështeten te këto degë dhe filiale, kur plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

Neni 130

Procesi i mbështetjes në një subjekt tjetër të detyruar

1. Subjektet e detyruara marrin nga subjekti i detyruar tek i cili mbështeten të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit të përcaktuara në nenin 102, pika 1, gerrat "a", "b" dhe "c", ose lidhur me marrëdhënien e biznesit që prezantohet.

2. Subjektet e detyruara që mbështeten te subjekte të tjera të detyruara marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që subjekti i detyruar tek i cili mbështeten t'u sigurojë, me kërkesë:

a) kopje të informacionit të mbledhur për të identifikuar klientin;

b) të gjitha dokumentet mbështetëse ose burimet e besueshme të informacionit që janë përdorur për të verifikuar identitetin e klientit dhe, kur është e zbatueshme, të pronarëve të tij përfutues ose të personave në emër të të cilëve vepron klienti, duke përfshirë të dhënat e marra përmes mjeteve elektronike të identifikimit dhe shërbimeve të besuara sipas legjislacionit në fuqi; dhe

c) çdo informacion të mbledhur lidhur me qëllimin dhe natyrën e synuar të

marrëdhënies së biznesit.

3. Informacioni i përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni i sigurohet subjektit të detyruar nga subjekti tek i cili mbështetet, pa vonesë dhe, në çdo rast, brenda 5 ditëve pune.

4. Kushtet për transmetimin e informacionit dhe dokumenteve të përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni përcaktohen në një marrëveshje me shkrim ndërmjet subjekteve të detyruara.

5. Kur subjekti i detyruar mbështetet te një subjekt tjetër i detyruar që është pjesë e të njëjtit grup, marrëveshja me shkrim mund të zëvendësohet me një procedurë të brendshme të vendosur në nivel grupi, me kusht që të plotësohen kërkesat e përcaktuara në nenin 129, pika 3 e këtij ligji.

Neni 131

Udhëzime për mbështetjen në subjekte të tjera të detyruara

Ministri përgjegjës për financat, me propozim të autoritetit përgjegjës, nxjerr udhëzime për subjektet e detyruara lidhur me:

a) kushtet që konsiderohen të pranueshme për subjektet e detyruara për t'u mbështetur në informacionin e mbledhur nga një subjekt tjetër i detyruar, duke përfshirë rastet e kryerjes së masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit të ushtruar në distancë;

b) rolet dhe përgjegjësitë e subjekteve të detyruara të përfshira në një situatë kur mbështeten te një subjekt tjetër i detyruar;

c) mbikëqyrja e bazuar në rrezik lidhur me mbështetjen në subjekte të tjera të detyruara.

KREU IV

DETYRIMET E RAPORTIMIT

Neni 132

Raportimi i aktivitetit të dyshimtë

1. Subjektet e detyruara dhe, sipas rastit, drejtorët dhe punonjësit e tyre, bashkëpunojnë plotësisht me autoritetin përgjegjës, duke siguruar në mënyrë të menjëhershme:

a) raportimin pranë autoritetit përgjegjës, me iniciativën e tyre, kur subjekti i detyruar ka dijeni, dyshon ose ka baza të arsyeshme për të dyshuar se fondet ose aktivitetet, pavarësisht nga shuma e përfshirë, janë të ardhura nga veprimtari kriminale ose lidhen me pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit, si dhe përgjigjen ndaj kërkesave të autoritetit përgjegjës për informacion shtesë në raste të tilla;

b) vënien në dispozicion autoritetit përgjegjës, me kërkesë të tij, të të gjithë informacionit të nevojshëm, duke përfshirë informacionin mbi regjistrat e transaksioneve, brenda afateve të përcaktuara.

2. Të gjitha transaksionet e dyshimta, duke përfshirë transaksionet që tentohen të kryhen dhe dyshimet që rrjedhin nga pamundësia për të ushtruar vigjilencën e duhur ndaj klientit, duhet të raportohen në përputhje me parashikimet e pikës 1 të këtij neni.

3. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, subjektet e detyruara duhet t'i përgjigjen kërkesave për informacion të autoritetit përgjegjës brenda 5 ditëve pune. Në raste të justifikuara dhe

urgjente, autoriteti përgjegjës mund ta shkurtojë këtë afat, duke përfshirë edhe në më pak se 24 orë.

Në përjashtim nga sa parashikohet në këtë pikë, autoriteti përgjegjës mund ta zgjasë afatin e përgjigjes përtej 5 ditëve pune kur e konsideron të justifikuar këtë gjë dhe me kusht që zgjatja të mos dëmtojë analizat që kryhen prej tij.

4. Për qëllimet e pikës 1, subjektet e detyruara vlerësojnë transaksionet ose veprimtaritë e kryera nga klientët e tyre mbi bazën e të gjitha fakteve dhe informacionit përkatës për të cilin kanë dijeni apo që disponojnë, në lidhje me këto transaksione ose veprimtari. Kur është e nevojshme, subjektet i japin përparësi këtij vlerësimi duke marrë në konsideratë urgjencën e transaksionit ose veprimtarisë, si dhe rreziqet që ndikojnë në shtetin në të cilin ato janë themeluar.

Dyshimi, sipas pikës 1, germa “a” të këtij neni, bazohet, ndër të tjera, në karakteristikat e klientit dhe të personave të lidhur me të, në përmasat dhe natyrën e transaksionit ose veprimtarisë, në mënyrat dhe modelet e kryerjes së tyre, në lidhjen ndërmjet disa transaksioneve ose veprimtarive, në origjinën, destinacionin ose përdorimin e fondeve, si dhe në çdo rrethanë tjetër të njohur nga subjekti, përfshirë përputhjen e transaksionit ose veprimtarisë me informacionin e mbledhur në përputhje me Kreun III të Pjesës II të këtij ligji, përfshirë profilin e rrezikut të klientit.

5. Ministri përgjegjës për financat, me propozim të autoritetit përgjegjës, nxjerr udhëzime për identifikimin e treguesve të veprimtarive ose sjelljeve të dyshimta, të cilat përditësohen periodikisht.

6. Personi përgjegjës për përputhshmërinë, i emëruar në përputhje me nenin 93, pika 2, raporton informacionin e përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni pranë autoritetit përgjegjës.

7. Subjektet e detyruara duhet të sigurojnë që personi përgjegjës për përputhshmërinë, i emëruar në përputhje me nenin 93, pika 2, si dhe çdo punonjës ose person tjetër që ushtron funksione të ngjashme, përfshirë agjentët dhe shpërndarësit, të cilët janë të përfshirë në kryerjen e detyrave të parashikuara nga ky nen, të mbrohen nga çdo formë hakmarrjeje, diskriminimi ose trajtimi tjetër i padrejtë për shkak të ushtrimit të këtyre detyrave.

Zbatimi i kësaj pike nuk cenon mbrojtjen shtesë që personat, e përmendur në paragrafin e parë të kësaj pike, mund të gëzojnë sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e sinjalizuesve.

8. Kur subjektet e detyruara bashkëpunojnë në kuadër të një partneriteti për shkëmbim informacioni dhe ky bashkëpunim rezulton në dijeni, dyshim ose ka baza të arsyeshme për të dyshuar se fondet, pavarësisht nga shuma e përfshirë, janë të ardhura nga veprimtari kriminale ose lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, subjektet e detyruara që kanë identifikuar dyshime në lidhje me veprimtaritë e klientëve të tyre mund të caktojnë midis tyre subjektin që do të ngarkohet me paraqitjen e raportit të aktivitetit të dyshimtë pranë njësisë së inteligjencës financiare sipas pikës 1, germa “a” e këtij neni. Raporti i paraqitur përfshin të paktën emrin dhe të dhënat e kontaktit të të gjitha subjekteve të detyruara që kanë marrë pjesë në aktivitetet e dërgimit të raportit të aktivitetit të dyshimtë.

Kur subjektet e detyruara, të përmendura në këtë pikë, kanë të vendosur veprimtarinë në disa shtete, informacioni duhet t'i raportohet secilës njësi të inteligjencës financiare përkatëse. Për këtë qëllim, subjektet e detyruara duhet të sigurohen që raporti të dorëzohet nga një subjekt i detyruar brenda territorit të shtetit ku ndodhet njësisia e inteligjencës financiare.

Kur subjektet e detyruara vendosin të mos përdorin mundësinë për të paraqitur një raport të vetëm, në përputhje me nën paragrafin e parë të kësaj pike, ato përfshijnë në raportet

e tyre një referencë se dyshimi është rezultat i një partneriteti bashkëpunimi për shkëmbim informacioni.

9. Subjektet e detyruara të përmendura në pikën 8 të këtij neni duhet të ruajnë një kopje të çdo raportimi të paraqitur sipas këtij neni dhe në përputhje me sa parashikohet në nenin 140 të këtij ligji.

Neni 133

Raportimi i aktivitetit të dyshimtë nga kategori të caktuara të subjekteve të detyruara

1. Në përjashtim nga sa përcaktohet në nenin 132, pikat 1 dhe 2, subjektet e detyruara të parashikuara në nenin 86, pika 3, germet “a” dhe “b”, mund ta raportojnë informacionin e parashikuar në nenin 132, pikat 1 dhe 2, nëpërmjet organit të tyre vetërregullues të caktuar me ligj.

Organi vetërregullues duhet ta përcjellë informacionin, sipas përcaktimeve të kësaj pike, menjëherë dhe të pandryshuar pranë autoritetit përgjegjës.

2. Noterët, avokatët, profesionistët e tjerë ligjorë të pavarur, audituesit ligjorë, kontabilistët e miratuar dhe konsulentët tatimorë përjashtohen nga kërkesat e përcaktuara në nenin 132, pikat 1 dhe 2, për aq sa ky përjashtim lidhet me informacionin që ata marrin nga, ose në lidhje me një klient, gjatë vlerësimit të pozitës juridike të klientit, ose gjatë kryerjes së detyrës së tyre për mbrojtjen ose përfaqësimin e atij klienti në procedurat gjyqësore, duke përfshirë këshillimin lidhur me nisjen ose shmangien e këtyre procedurave, pavarësisht nëse ky informacion është marrë para, gjatë ose pas këtyre procedurave.

3. Përjashtimi i përmendur në pikën 2 të këtij neni nuk zbatohet në rastet kur subjektet e detyruara të përmendura në të:

a) përfshihen në pastrimin e parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, financimin e terrorizmit ose financimin e përhapjes së armëve të dëmtimit në masë;

b) ofrojnë këshilla ligjore për qëllime të pastrimit të parave, veprave penale bazë të lidhura me të, financimit të terrorizmit ose financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë; ose

c) kanë dijeni se klienti po kërkon këshilla ligjore për qëllime të pastrimit të parave, veprave penale të lidhura me të, financimit të terrorizmit ose financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

Dijenja ose qëllimi mund të nxirren nga rrethana fakti objektive.

4. Përveç rasteve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, kur justifikohet mbi bazën e rrezikut më të lartë të pastrimit të parave, veprave penale të lidhura me to, financimit të terrorizmit ose financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë të lidhura me lloje të caktuara transaksionesh, me vendim të Këshillit të Ministrave mund të vendoset që përjashtimi i parashikuar sipas pikës 2 të këtij neni, të mos zbatohet për ato lloje transaksionesh dhe, sipas rastit, të vendosë detyrime shtesë raportimi për subjektet e detyruara të përmendura në atë pikë.

Neni 134

Moskryerja e transaksioneve

1. Subjektet e detyruara nuk kryejnë transaksionet për të cilat kanë dijeni ose dyshojnë se lidhen me të ardhura nga veprimtari kriminale ose me financimin e terrorizmit, derisa të

kenë dërguar një raport të aktivitetit të dyshimtë në përputhje me nenin 132, pika 1, germa “a”, të këtij ligji, dhe të kenë përmbushur çdo udhëzim të mëtijshëm specifik të dhënë nga autoriteti përgjegjës ose autoritete të tjera kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Subjektet e detyruara mund ta kryejnë transaksionin në fjalë, pasi të kenë vlerësuar rreziqet që lidhen me vazhdimin e kryerjes së tij, nëse nuk janë udhëzuar ndryshe nga autoriteti përgjegjës brenda 3 ditëve pune nga paraqitja e raportit.

Pavarësisht nga parashikimi i paragrafit të mësipërm, kur Agjencia e Inteligjencës Financiare ka vendosur bllokimin ose mosdhënien e pëlqimit për kryerjen e transaksionit, sipas nenit 26 të këtij ligji, subjekti i detyruar nuk e kryen transaksionin për aq kohë sa masa është në fuqi dhe vepron në përputhje me urdhrin e Agjencisë dhe afatet e parashikuara në nenin 26 të këtij ligji.

2. Në rastet kur nuk është e mundur të shmanget kryerja e transaksionit, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, ose kur moskryerja e transaksionit ka të ngjarë të pengojë përpjekjet për të gjurmuar përfituesit e një transaksioni të dyshimtë, subjekti njofton menjëherë autoritetin përgjegjës pas kryerjes të transaksionit.

Neni 135

Përgjashtimi nga përgjegjësia ligjore për raportim pranë autoritetit përgjegjës

Raportimi i informacionit të autoritetit përgjegjës, i kryer në mirëbesim nga një subjekt i detyruar ose nga një punonjës apo drejtues i këtij subjekti, në përputhje me nenet 132 dhe 133 të këtij ligji, nuk përbën shkelje të asnjë kufizimi për zbulimin e informacionit të parashikuar me kontratë apo në dispozita ligjore, nënligjore ose administrative, dhe nuk ngarkon subjektin e detyruar, drejtuesit apo punonjësit e tij me asnjë lloj përgjegjësie penale, administrative apo civile edhe në rrethana kur ata nuk kanë qenë saktësisht në dijeni të veprimtarisë kriminale që qëndron në themel të rastit dhe pavarësisht nëse veprimtaria e paligjshme ka ndodhur realisht.

Neni 136

Ndalimi i informimit

1. Subjektet e detyruara dhe drejtuesit e tyre, punonjësit ose personat në pozicione të ngjashme, duke përfshirë agjentët dhe shpërndarësit, nuk duhet të informojnë klientin përkatës ose persona të tjerë të tretë mbi faktin se transaksionet ose aktivitetet janë duke u vlerësuar, janë vlerësuar ose do të vlerësohen në përputhje me nenin 132, se informacioni është duke u dërguar, do të dërgohet ose është dërguar në përputhje me nenin 132 apo 133, apo se po kryhet ose mund të kryhet një analizë e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

2. Ndalimi i parashikuar në pikën 1 nuk zbatohet për dërgimin e informacionit tek autoritetet kompetente dhe tek organet vetërregulluese, kur këto ushtrojnë funksione mbikëqyrëse, si dhe për dërgimin e informacionit me qëllim hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit ose veprimtarive të tjera kriminale.

3. Me përjashtim nga pika 1 e këtij neni, shkëmbimi i informacionit mund të kryhet ndërmjet subjekteve të detyruara që i përkasin të njëjtit grup, ose ndërmjet këtyre subjekteve dhe degëve dhe filialeve të tyre të vendosura në vende të treta, me kusht që ato degë dhe filiale të respektojnë plotësisht politikat dhe procedurat në nivel grupi, duke përfshirë procedurat për shkëmbimin e informacionit brenda grupit, në përputhje me nenin 98 të këtij ligji, dhe që

politikat dhe procedurat në nivel grupi të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

4. Me përjashtim nga pika 1 e këtij neni, shkëmbimi i informacionit mund të kryhet ndërmjet subjekteve të detyruara të përmendura në nenin 86, pika 3, gerat "a" dhe "b", ose ndërmjet subjekteve nga vende të treta që u nënshtrohen kërkesave të barasvlershme me ato të përcaktuara në këtë ligj, të cilat ushtrojnë veprimtaritë e tyre profesionale, qoftë si punëmarrës apo jo, brenda të njëjtit person juridik ose brenda një strukture më të gjerë të cilës personi i përket dhe që ndan një pronësi, administrim ose kontroll të përbashkët të përputhshmërisë, duke përfshirë rrjetet ose partneritetet për shkëmbim informacioni.

5. Për subjektet e detyruara të parashikuara në nenin 86, pika 1, 2, 3, gerat "a" dhe "b", në rastet që lidhen me të njëjtin transaksion ku përfshihen dy ose më shumë subjekte të detyruara, dhe në përjashtim nga pika 1 e këtij neni, shkëmbimi i informacionit mund të kryhet ndërmjet subjekteve përkatëse, me kusht që ato të jenë të vendosura në një shtet anëtar, ose në një vend të tretë që zbaton kërkesa të barasvlershme me ato të parashikuara në Pjesën II të këtij ligji, dhe që ato t'i nënshtrohen detyrimeve për ruajtjen e sekretit profesional dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

6. Kur subjektet e detyruara të parashikuara në nenin 86, pika 3, gerat "a" dhe "b", përpiqen të ndalojnë ose të pengojnë një klient nga kryerja e një veprimtarie të paligjshme, kjo nuk konsiderohet informim në kuptim të pikës 1 të këtij neni.

Neni 137

Raportime në bazë të pragut për mallra të caktuara me vlerë të lartë

1. Personat që tregtojnë mallra me vlerë të lartë i raportojnë autoritetit përgjegjës të gjitha transaksionet që përfshijnë shitjen e mallrave të mëposhtme me vlerë të lartë, kur këto mallra blihen për qëllime jo tregtare:

a) mjete motorike me një çmim prej të paktën 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lek ose kundërvleftën e saj në monedhat e tjera të huaja;

b) mjete lundruese me një çmim prej të paktën 750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lek ose kundërvleftën e saj në monedhat e tjera të huaja;

c) mjete fluturuese me një çmim prej të paktën 750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lek ose kundërvleftën e saj në monedhat e tjera të huaja.

2. Institucionet e kreditit dhe institucionet financiare, si dhe subjekte të tjera të detyruara të parashikuara në nenin 86, pika 3 e ligjit, që ofrojnë shërbime në lidhje me blerjen ose transferimin e së drejtës së pronësisë mbi mallrat e përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të raportojnë pranë autoritetit përgjegjës të gjitha transaksionet që kryejnë për klientët e tyre në lidhje me këto mallra.

3. Raportimi i transaksioneve sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni kryhet brenda afateve dhe sipas procedurave të përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji.

KREU V

SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 138

Partneritetet për shkëmbimin e informacionit

1. Anëtarët e partneriteteve për shkëmbimin e informacionit mund të shkëmbejnë informacion ndërmjet tyre vetëm në masën e nevojshme dhe të domosdoshme për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në Kreun III të Pjesës II dhe në nenin 132 të këtij ligji, në përputhje me të drejtat themelore dhe garancitë procedurale gjyqësore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Subjektet e detyruara që synojnë të marrin pjesë në një partneritet për shkëmbim informacioni njoftojnë autoritetet mbikëqyrëse përkatëse, të cilat, sipas rastit, në konsultim me njëra-tjetrën dhe me autoritetet përgjegjëse për verifikimin e përputhshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, verifikojnë që partneriteti për shkëmbim informacioni ka mekanizma për të siguruar përputhshmërinë me këtë nen dhe që është kryer vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave siç përmendet në pikën 4, germa "h" të këtij neni.

Verifikimi kryhet përpara fillimit të veprimtarive të partneritetit për shkëmbim informacioni. Sipas rastit, autoritetet mbikëqyrëse konsultohen edhe me autoritetin përgjegjës.

Përgjegjësia për përputhshmërinë me kërkesat ligjore i takon pjesëmarrësve në partneritetin për shkëmbim informacioni.

3. Informacioni i shkëmbyer në kuadër të një partneriteti për shkëmbim informacioni kufizohet në:

a) informacionin mbi klientin, duke përfshirë çdo informacion të marrë gjatë identifikimit dhe verifikimit të identitetit të klientit dhe, sipas rastit, pronarit përfitues të klientit;

b) informacionin mbi qëllimin dhe natyrën e synuar të marrëdhënies së biznesit ose transaksionit rastësor ndërmjet klientit dhe subjektit të detyruar, si dhe, sipas rastit, burimin e pasurisë dhe burimin e fondeve të klientit;

c) informacionin mbi transaksionet e klientëve;

d) informacionin mbi faktorët e rrezikut më të lartë dhe më të ulët që lidhen me klientin;

e) analizën e rreziqeve që lidhen me klientin, të kryer nga subjekti i detyruar në përputhje me nenin 102, pika 2 e këtij ligji;

f) informacionin e mbajtur nga subjekti i detyruar në përputhje me nenin 140, pika 1 e këtij ligji;

g) informacion mbi dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit, në përputhje me nenin 132 të këtij ligji.

Informacioni i përmendur në këtë pikë shkëmbehet vetëm në shkallën e nevojshme për kryerjen e veprimtarive të partneritetit për shkëmbim informacioni.

4. Kushtet e mëposhtme zbatohen për shkëmbimin e informacionit në kontekstin e një partneriteti për shkëmbim informacioni:

a) subjektet e detyruara regjistrojnë të gjitha rastet e shkëmbimit të informacionit brenda partneritetit;

b) subjektet e detyruara nuk duhet të mbështeten vetëm në informacionin e marrë në kuadër të partneritetit për shkëmbimin e informacionit për përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas këtij ligji;

c) subjektet e detyruara nuk nxjerrin konkluzione ose nuk marrin vendime që ndikojnë në marrëdhënien e biznesit me klientin ose në kryerjen e transaksioneve rastësore për klientin mbi bazën e informacionit të marrë nga pjesëmarrësit e tjerë në partneritetin për shkëmbim

informacioni pa e vlerësuar atë informacion; çdo informacion i marrë në kontekstin e partneritetit që përdoret në një vlerësim që rezulton në një vendim për refuzim ose ndërprerje të marrëdhënies së biznesit ose për kryerjen e një transaksioni rastësor përfshihet në evidencat e mbajtura në përputhje me nenin 103, pika 3 të këtij ligji dhe në këto evidenca cilësohet fakti se informacioni buron nga një partneritet për shkëmbim informacioni;

d) subjektet e detyruara kryejnë vlerësimin e tyre të transaksioneve që përfshijnë klientët, me qëllim përcaktimin e atyre transaksioneve që mund të lidhen me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit ose që mund të përfshijnë produkte që burojnë nga veprimtaritë kriminale;

e) subjektet e detyruara marrin masa të përshtatshme teknike dhe organizative, duke përfshirë masa që mundësojnë pseudonimizimin, për të garantuar një nivel sigurie dhe konfidencialiteti në përpjesëtim me natyrën dhe shtrirjen e informacionit të shkëmbyer;

f) shkëmbimi i informacionit bëhet vetëm në lidhje me klientët, kur:

i. sjellja ose veprimtaritë e transaksioneve të të cilëve lidhen me një nivel më të lartë rreziku për pastrim parash dhe veprave penale që lidhen me të ose financim të terrorizmit, sipas vlerësimit kombëtar të rrezikut në përputhje me nenin 10 të këtij ligji dhe, sipas rastit, vlerësimeve të tjera të rrezikut të kryera në kuadër të mekanizmave të bashkëpunimit ndërkombëtar;

ii. përfshihen në ndonjë nga situatat e parashikuara në nenet 111, 112, 113 dhe 117 deri në 127 të këtij ligji;

iii. për të cilët subjektet e detyruara kanë nevojë të mbledhin informacion shtesë për të përcaktuar nëse lidhen me një nivel më të lartë rreziku për pastrim parash dhe veprave penale që lidhen me të ose financim të terrorizmit.

g) informacioni i gjeneruar përmes përdorimit të inteligjencës artificiale, teknologjive të mësimit automatik ose algoritmeve mund të shkëmbehet vetëm kur këto procese i janë nënshtruar mbikëqyrjes së përshtatshme nga njeriu;

h) përpara përpunimit të çdo të dhëne personale në kuadër të partneriteteve për shkëmbim informacioni, kryhet një vlerësim i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

i) autoritetet kompetente që marrin pjesë në partneritete për shkëmbim informacioni sigurojnë, vënë në dispozicion dhe shkëmbejnë informacion vetëm në masën që kjo është e domosdoshme për përmbushjen e detyrave dhe kompetencave të tyre ligjore, sipas legjislacionit në fuqi;

j) kur autoritetet kompetente të përmendura në nenin 85, pika 1, germa "c" marrin pjesë në një partneritet për shkëmbim informacioni, ato marrin, japin ose shkëmbejnë të dhëna personale dhe informacione operacionale vetëm në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me dispozitat në fuqi të legjislacionit procedural penal kombëtar, duke përfshirë autorizimin gjyqësor paraprak ose çdo masë mbrojtëse tjetër procedurale kombëtare sipas nevojës;

k) shkëmbimi i informacionit për transaksionet e dyshimta sipas pikës 3, germa "g", të këtij neni, kryhet vetëm kur njësia e inteligjencës financiare, së cilës i është dorëzuar raporti i transaksionit të dyshimtë sipas neneve 132 ose 133 të këtij ligji, ka dhënë pëlqimin për shpërndarjen e tij.

5. Informacioni i marrë në kuadër të një partneriteti për shkëmbim informacioni nuk transmetohet më tej, me përjashtim të rasteve kur:

a) informacioni i jepet një subjekti tjetër të detyruar në përputhje me nenin 130, pika 1, e këtij ligji;

b) informacioni duhet të përfshihet në një raport që i dorëzohet njësisë të inteligjencës financiare ose të jepet në përgjigje të një kërkesë të njësisë të inteligjencës financiare sipas nenit 132, pika 1 dhe 2 e këtij ligji;

c) kur informacioni i vihet në dispozicion AMLAs në përputhje me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian;

d) informacioni i marrë në kuadër të partneriteteve për shkëmbim informacioni mund t'u vihet në dispozicion organeve ligjzbatuese ose autoriteteve gjyqësore vetëm me kërkesë të tyre dhe në përputhje me legjislacionin procedural penal në fuqi, duke iu nënshtruar, kur kërkohet, autorizimeve paraprake ose garancive të tjera procedurale të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

6. Subjektet e detyruara që marrin pjesë në partneritete për shkëmbim informacioni përcaktojnë politika dhe procedura për shkëmbimin e informacionit, në kuadër të politikave dhe procedurave të tyre të brendshme të miratuara në përputhje me nenin 91 të këtij ligji. Këto politika dhe procedura duhet të:

a) specifikojnë vlerësimin që kryhet për të përcaktuar llojin, shtrirjen dhe nivelin e informacionit që mund të shkëmbehet në kuadër të partneritetit, si dhe parashikojnë, kur është e nevojshme në funksion të natyrës së informacionit ose të masave mbrojtëse procedurale të zbatueshme, akses të diferencuar ose të kufizuar në informacion për anëtarët e partneritetit;

b) përcaktojnë qartë rolet, përgjegjësitë dhe detyrimet e pjesëmarrësve në partneritetin për shkëmbim informacioni, përfshirë përgjegjësinë për përpunimin, përdorimin, ruajtjen dhe transmetimin e informacionit;

c) identifikojnë vlerësimet e rrezikut, përfshirë vlerësimin kombëtar të rrezikut dhe vlerësimet e brendshme të rrezikut të subjektit të detyruar, që merren në konsideratë për të përcaktuar situatat me rrezik më të lartë në të cilat lejohet shkëmbimi i informacionit.

Politikat dhe procedurat e brendshme për shkëmbimin e informacionit hartohen dhe miratohen përpara se subjekti i detyruar të marrë pjesë në një partneritet për shkëmbim informacioni.

7. Kur autoritetet mbikëqyrëse vlerësojnë të nevojshme, subjektet e detyruara që marrin pjesë në një partneritet për shkëmbim informacioni sigurojnë kryerjen e një auditimi të pavarur mbi funksionimin e këtij partneriteti dhe i shkëmbejnë rezultatet me autoritetet mbikëqyrëse.

KREU VI

MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE MBAJTJA E TË DHËNAVE

Neni 139

Përpunimi i të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale në zbatim të këtij ligji bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Për sa kohë që është rreptësisht e nevojshme për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, subjektet e detyruara mund të përpunojnë edhe kategori të veçanta të të dhënave personale, si dhe të dhëna personale që lidhen me dënimet penale dhe

veprat penale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe duke iu nënshtruar kushteve dhe masave mbrojtëse të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Në rastet kur, në zbatim të këtij ligji, subjektet e detyruara përpunojnë kategori të veçanta të të dhënave personale, ato janë të detyruara që:

a) të informojnë klientët e tyre ose klientët e ardhshëm se këto kategori të dhënash mund të përpunohen për qëllime të përmbushjes së kërkesave të këtij ligji;

b) të dhënat të burojnë nga burime të besueshme dhe të jenë të sakta dhe të përditësuara;

c) të mos marrin vendime që mund të çojnë në rezultate të njëanshme dhe diskriminuese mbi bazën e këtyre të dhënave;

d) të zbatojnë masa të një niveli të lartë sigurie për mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht për garantimin e konfidencialitetit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Në rastet kur, në zbatim të këtij ligji, subjektet përpunojnë të dhëna personale që lidhen me dënimet penale ose veprat penale, ky përpunim lejohet vetëm në rastet kur:

a) këto të dhëna personale të kenë lidhje me pastrimin e parave dhe veprave penale që lidhen me të ose financimin e terrorizmit;

b) subjektet e detyruara janë të detyruara të miratojnë procedura të posaçme që garantojnë, gjatë përpunimit të këtyre të dhënave, dallimin e qartë ndërmjet pretendimeve, hetimeve, procedimeve dhe dënimeve, duke respektuar të drejtën për një gjykim të drejtë, të drejtën e mbrojtjes dhe prezumimin e pafajësisë.

4. Të dhënat personale të përpunuara nga subjektet e detyruara në zbatim të këtij ligji përpunohen vetëm për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë dhe nuk përpunohen më tej në një mënyrë që bie ndesh me këto qëllime.

Ndalohet përpunimi ose përdorimi i të dhënave personale të mbledhura në zbatim të këtij ligji për qëllime tregtare ose për çdo qëllim tjetër të papajtueshëm me qëllimet e parandalimit të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit apo financimit të përhapjes së armëve të dëmtimit në masë.

5. Subjektet e detyruara mund të marrin vendime mbi bazën e procese të automatizuara, përfshirë profilizimin, ose procese që përfshijnë sisteme të inteligjencës artificiale, me kusht që:

a) të dhënat e përpunuara nga sisteme të tilla të jenë të kufizuara në të dhënat e marra në përputhje me Kreun III të Pjesës II të këtij ligji;

b) çdo vendim për të hyrë ose refuzuar të hyjë ose të mbajë një marrëdhënie biznesi me një klient ose për të kryer ose refuzuar të kryejë një transaksion rastësor për një klient, ose për të rritur ose ulur shkallën e masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit, i nënshtrohet ndërhyrjes njerëzore për të siguruar saktësinë dhe përshtatshmërinë e një vendimi të tillë; dhe

c) klienti ka të drejtë të marrë një shpjegim për vendimin e marrë dhe ta kundërshtojë atë vendim, me përjashtim të rasteve që lidhen me raportimin e transaksioneve të dyshimta sipas nenit 132 të këtij ligji.

Neni 140

Ruajtja e të dhënave

1. Subjektet e detyruara ruajnë dokumentet dhe informacionin e mëposhtëm:

a) një kopje të dokumenteve dhe të informacionit të marrë gjatë realizimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit në përputhje me Kreun III të Pjesës II të këtij ligji, duke përfshirë informacionin e marrë me anë të mjeteve elektronike të identifikimit;

b) të dhënat e vlerësimit të kryer sipas nenit 132, pika 4, duke përfshirë informacionin dhe rrethanat e shqyrtuara dhe rezultatet e këtij vlerësimi, pavarësisht nëse ky vlerësim rezulton apo jo në një raportim transaksioni të dyshimtë pranë autoritetit përgjegjës, si dhe një kopje të raportit të transaksionit të dyshimtë, nëse ka një të tillë;

c) provat mbështetëse dhe të dhënat e transaksioneve, që përbëhen nga dokumentet origjinale ose kopjet e pranueshme në procedurat gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi, të cilat janë të nevojshme për të identifikuar transaksionet;

d) kur marrin pjesë në partneritete për shkëmbim informacioni sipas Kreut V, të Pjesës II të këtij ligji, kopje të dokumenteve dhe informacionit të marrë në kuadër të këtyre partneriteteve dhe të dhëna për të gjitha rastet e shkëmbimit të informacionit.

Subjektet e detyruara duhet të sigurojnë që dokumentet, informacioni dhe të dhënat e mbajtura në përputhje me këtë nen të mos redaktohen.

2. Me përjashtim nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, subjektet e detyruara mund të vendosin të zëvendësojnë ruajtjen e kopjeve të informacionit me ruajtjen e referencave ndaj këtij informacioni, me kusht që natyra dhe mënyra e ruajtjes së këtij informacioni të sigurojë që subjektet e detyruara të mund t'ia japin informacionin menjëherë autoriteteve kompetente dhe që informacioni të mos mund të modifikohet ose ndryshohet.

Subjektet e detyruara që përdorin përjashtimin e përmendur në këtë pikë duhet të përcaktojnë në procedurat e tyre të brendshme të hartuara sipas nenit 91 të këtij ligji, kategoritë e informacionit për të cilat ata do të ruajnë një referencë në vend të një kopjeje ose dokumenti origjinali, si dhe procedurat për marrjen e informacionit në mënyrë që ai të mund t'u jepet autoriteteve kompetente në bazë të kërkesës.

3. Informacioni i përmendur në pikat 1 dhe 2 ruhet për një periudhë prej 5 vitesh duke filluar nga data e përfundimit të marrëdhënies së biznesit ose nga data e kryerjes së transaksionit rastësor, apo nga data e refuzimit për të hyrë në një marrëdhënie biznesi ose për të kryer një transaksion rastësor. Pa cenuar afatet e ruajtjes së të dhënave të përcaktuara nga legjislacioni tjetër në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, subjektet e detyruara duhet të fshijnë të dhënat personale pas kalimit të periudhës 5-vjeçare.

Autoritetet kompetente mund të kërkojnë ruajtjen e mëtejshme të informacionit të përmendur në këtë pikë rast pas rasti, me kusht që kjo ruajtje të jetë e nevojshme për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Kjo periudhë e mëtejshme e ruajtjes nuk tejkalon 5 vite.

4. Në rastet kur, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në Republikën e Shqipërisë janë duke u zhvilluar procedime hetimore ose gjyqësore që lidhen me parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit dhe një subjekt i detyruar disponon apo mban informacion ose dokumente që lidhen me këto procedime, në vijim, subjekti i detyruar mund t'i ruajë këto informacione ose dokumente për një periudhë prej 5 vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Me vendim të autoriteteve kompetente, pa cenuar parashikimet e legjislacionit penal në fuqi, ruajtja e informacionit ose dokumenteve të përmendura në paragrafin e mësipërm të kësaj pike, mund të lejohet ose kërkohet për një periudhë shtesë deri në 5 vjet, kur nevoja dhe proporcionaliteti i kësaj ruajtjeje janë vlerësuar si të domosdoshme për parandalimin, zbulimin,

hetimin ose ndjekjen penale të dyshimeve për pastrim të parave ose financimit të terrorizmit.

Neni 141

Sigurimi i të dhënave për autoritetet kompetente

Subjektet e detyruara duhet të kenë sisteme dhe mekanizma të përshtatshëm që u mundësojnë t'u përgjigjen në mënyrë të plotë dhe të shpejtë kërkesave për informacion nga autoriteti përgjegjës ose nga autoritetet e tjera kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi, nëse mbajnë ose kanë mbajtur, gjatë një periudhe 5 vjeçare para kërkesës, një marrëdhënie biznesi me persona të caktuar, si dhe për natyrën e kësaj marrëdhënieje.

Këto përgjigje jepen nëpërmjet kanaleve të sigurta dhe në një mënyrë që garanton konfidencialitetin e plotë të kërkesave dhe të informacionit të shkëmbyer.

KREU VII

MASAT PËR ZBUTJEN E RREZIQEVE QË RRJEDHIN NGA INSTRUMENTET ANONIME

Neni 142

Llogaritë anonime, aksionet e mbajtësit dhe titujt e aksioneve të mbajtësit

1. Institucionet e kreditit, institucionet financiare dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve ndalohen të mbajnë llogari bankare dhe llogari pagese anonime, librezë kursimi anonime, kaseta depozitash të sigurta anonime ose llogari anonime të krypto-aseteve, si dhe çdo llogari që në ndonjë mënyrë tjetër lejon anonimizimin e mbajtësit të llogarisë së klientit ose anonimizimin apo rritjen e vështirësisë në identifikimin, gjurmimin e transaksioneve apo fshehjes së tyre, përfshirë nëpërmjet krypto-aseteve me veçori që rrisin anonimitetin.

Pronarët dhe përfituesit e llogarive ekzistuese bankare ose të pagesave anonime, librezave anonime, kasetave anonime të depozitave të sigurisë të mbajtura nga institucionet e kreditit ose institucionet financiare, ose llogarive të krypto-aseteve, duhet t'i nënshtrohen masave të vigjilencës së duhur ndaj klientit përpara se këto llogari, librezë kursimi ose kaseta depozite të përdoren në çfarëdo mënyre.

2. Institucionet e kreditit dhe institucionet financiare që veprojnë si pranues pagesash sipas legjislacionit në fuqi, nuk pranojnë pagesa të kryera me karta të parapaguara anonime të lëshuara në vende të treta, përveç nëse parashikohet ndryshe në standardet teknike rregullatore të miratuara në përputhje me nenin 110 të këtij ligji, kur është provuar një nivel i ulët rreziku.

3. Shoqëritë tregtare ndalohen të emetojnë aksione të mbajtësit dhe janë të detyruara të konvertojnë të gjitha aksionet ekzistuese të mbajtësit në aksione të regjistruara, t'i ruajnë ato në depozitarin qendror të titujve në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit ose t'i depozitojnë pranë një institucioni financiar brenda datës 10 korrik 2029.

Shoqëritë me letra me vlerë të listuara në një treg të rregulluar, ose aksionet e të cilave emetohen si tituj në formë të ndërmjetësuar, si nëpërmjet ruajtjes së tyre në depozitarin qendror të titujve ose nëpërmjet emetimit të drejtëpërdrejt në formë të dematerializuar sipas legjislacionit në fuqi, do të lejohen të emetojnë aksione të reja dhe të mbajnë aksionet ekzistuese të mbajtësit.

Për aksionet ekzistuese të mbajtesit që nuk janë konvertuar, ruajtur në depozitarin qendror të titujve ose depozituar pranë një institucioni krediti apo financiar deri më 10 korrik 2029, të gjitha të drejtat e votës dhe të drejtat për përfitim nga shpërndarja e dividendëve pezullohen automatikisht deri në përmbushjen e këtyre kërkesave. Të gjitha aksionet e tilla që nuk janë konvertuar, ruajtur në depozitarin qendror të titujve ose depozituar pranë një institucioni krediti apo financiar deri më 10 korrik 2030 do të anulohen, duke sjellë uljen përkatëse të kapitalit themeltar.

Shoqërive u ndalohet të emetojnë tituj të aksioneve të mbajtesit që nuk janë në formë të ndërmjetësuar.

Neni 143

Kufijtë e pagesave të mëdha në para fizike për mallra ose shërbime

1. Personat që tregtojnë mallra ose ofrojnë shërbime nuk mund të pranojnë ose të kryejnë një pagesë në para fizike kur vlera e transaksionit tejkalon kufirin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore ose kundërvlerën e tij në monedha të huaja, pavarësisht nëse pagesa kryhet në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione që rezultojnë të jenë të lidhura me njëri-tjetrin.

2. Me ligj mund të përcaktohen pragje më të ulëta se ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Kur ekzistojnë tashmë kufizime në nivel kombëtar që janë nën kufirin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ato vazhdojnë të zbatohen.

3. Kufiri i përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohet për:

a) pagesat ndërmjet personave fizikë, të cilët nuk veprojnë në kuadër të një veprimtarie profesionale;

b) pagesat ose depozitat në para fizike të kryera pranë institucioneve të kreditit, emetuesve të parasë elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të pagesave.

4. Pagesat ose depozitat në para fizike, të përcaktuara në pikën 3, germa “b”, të këtij neni, me vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, pavarësisht nëse pagesat ose depozitat kryhen në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione që janë të lidhura me njëri-tjetrin, duhet të raportohen pranë autoritetit përgjegjës në përputhje me nenin 22 të këtij ligji.

Mosraportimi i pagesave ose depozitave në para fizike nga subjektet e detyruara, sipas përcaktimeve të kësaj pike, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas nenit 65 të këtij ligji.

5. Pranimi ose kryerja e pagesave, në kundërshtim me kufirin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, nga personat fizikë ose juridikë që veprojnë në kuadër të një veprimtarie profesionale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.

6. Kur, për shkak të forcës madhore, mjetet e pagesës që përdorin fonde, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin e pagesave, të ndryshme nga kartëmonedhat dhe monedhat, bëhen të padisponueshme në nivel kombëtar, me ligj mund të pezullohet përkohësisht zbatimi i kufizimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Pezullimi zbatohet vetëm për aq kohë sa vazhdojnë rrethanat e forcës madhore dhe përfundon menjëherë sapo këto rrethana pushojnë së ekzistuari.

KREU VIII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE MBI BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR

Seksioni 1

Bashkëpunimi ndërmjet njësisë së inteligjencës financiare dhe EPPO

Neni 144

Bashkëpunimi ndërmjet autoritetit përgjegjës dhe EPPO

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare i raporton, pa vonesë, Zyrës së Prokurorisë Publike Evropiane (EPPO) rezultatet e analizave të saj dhe çdo informacion shtesë përkatës kur ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se është kryer ose po kryhet pastrim parash ose veprimtari të tjera kriminale, për të cilat EPPO mund të ushtrojë kompetencat e saj, në përputhje me aktet përkatëse të Bashkimit Evropian.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare i përgjigjet në kohën e duhur kërkesave për informacion të EPPO në lidhje me pastrimin e parave dhe veprimtaritë e tjera kriminale, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe EPPO mund të shkëmbejnë rezultatet e analizave strategjike, duke përfshirë tipologjitë dhe treguesit e rrezikut, kur këto analiza lidhen me pastrimin e parave dhe veprimtaritë e tjera kriminale, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.

Neni 145

Kërkesat për informacion drejtuar EPPO

1. EPPO i përgjigjet pa vonesë kërkesave të arsyetuara për informacion të Agjencisë së Inteligjencës Financiare, kur ky informacion është i nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të saj sipas Kreut II të Pjesës I të këtij ligji.

2. EPPO mund ta shtyjë ose ta refuzojë dhënien e informacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, kur dhënia e tij mund të cenojë mbarëvajtjen dhe konfidencialitetin e një hetimi në zhvillim e sipër.

3. EPPO i komunikon në kohën e duhur Agjencisë së Inteligjencës Financiare shtyrjen ose refuzimin e dhënies së informacionit të kërkuar, duke përfshirë arsyet përkatëse.

Seksioni 2

Bashkëpunimi ndërmjet autoritetit përgjegjës dhe OLAF

Neni 146

Bashkëpunimi ndërmjet autoritetit përgjegjës dhe OLAF

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare i transmeton, pa vonesë, rezultatet e analizave të saj dhe çdo informacion shtesë përkatës OLAF, kur ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se janë kryer ose po kryhen mashtrime, korrupsion ose veprimtari të tjera të paligjshme që cenojnë interesat financiare të Bashkimit Evropian, për të cilat OLAF mund të ushtrojë kompetencat e

tij, në përputhje me aktet përkatëse të Bashkimit Evropian.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare i përgjigjet në kohë kërkesave për informacion nga OLAF në lidhje me mashtrimin, korrupsionin ose çdo veprimtari tjetër të paligjshme, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni.

3. Agjencia e Inteligjencës Financiare dhe OLAF mund të shkëmbejnë rezultatet e analizave strategjike, duke përfshirë tipologjitë dhe treguesit e rrezikut, kur këto analiza lidhen me mashtrimin, korrupsionin ose veprimtaritë e tjera të paligjshme, sipas përcaktimeve në pikën 1 të këtij neni.

Neni 147

Kërkesat për informacion drejtuar OLAF

1. OLAF u përgjigjet pa vonesë kërkesave të arsyetuara për informacion nga Agjencia e Inteligjencës Financiare, kur ky informacion është i nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të saj sipas Kreut II të Pjesës I të këtij ligji.

2. OLAF mund të shtyjë ose refuzojë dhënien e informacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, kur dhënia e tij mund të ndikojë negativisht në mbarëvajtjen e një hetimi në zhvillim e sipër.

3. OLAF i komunikon Agjencisë së Inteligjencës Financiare këtë shtyrje ose refuzim në kohën e duhur, duke përfshirë arsyet përkatëse.

PJESA III

MASAT PËR INFORMACIONIN QË SHOQËRON TRANSFERTAT E FONDEVE DHE KRIPTO-ASETEVE TË CAKTUARA

KREU I

OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIMET

Neni 148

Objekti

Pjesa III e këtij ligji përcakton rregullat për:

a) informacionin për pagesin dhe përfituesin e pagesës që shoqëron transfertat e fondeve, në çdo monedhë, si dhe informacionin për nismëtarin dhe përfituesin që shoqëron transfertat e krypto-aseteve, me qëllim parandalimin, zbulimin dhe hetimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kur të paktën një nga ofruesit e shërbimeve të pagesave ose ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve të përfshirë në transfertën e fondeve apo transfertën e krypto-aseteve është themeluar ose ka selinë e regjistruar, sipas rastit, në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) politikat e brendshme, procedurat dhe kontrollet për të siguruar zbatimin e masave shtrënguese, kur të paktën një nga ofruesit e shërbimeve të pagesave apo ofruesit e shërbimeve

të krypto-aseteve të përfshirë në transfertën e fondeve apo transfertën e krypto-aseteve është themeluar ose ka selinë e regjistruar, sipas rastit, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 149

Fusha e zbatimit

1. Pjesa III e këtij ligji zbatohet për:

a) transfertat e fondeve, në çdo monedhë, të cilat dërgohen ose merren nga një ofrues i shërbimeve të pagesave ose nga një ofrues ndërmjetës i shërbimeve të pagesave, i themeluar në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) transfertat e krypto-aseteve, përfshirë transfertat e kryera nëpërmjet bankomatëve të krypto-aseteve (*kripto-ATM*), kur ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve ose ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të krypto-aseteve i nismëtarit ose i përfituesit ka selinë e regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Pjesa III e këtij ligji nuk zbatohet për shërbimet që sipas legjislacionit në fuqi për shërbimet e pagesave nuk konsiderohen shërbime pagese dhe përjashtohen nga fusha e zbatimit të atij legjislacioni.

3. Pjesa III e këtij ligji nuk zbatohet për transfertat e fondeve ose për transfertat e tokenëve të parasë elektronike, siç përcaktohen në ligjin për tregjet e krypto-aseteve, të kryera duke përdorur kartë pagesash, instrumente të parasë elektronike, telefon celular, ose çdo pajisje tjetër digjitale apo e teknologjisë së informacionit me parapagesë ose paspagesë me karakteristika të ngjashme, me kusht që të përmbushen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) karta, instrumenti ose pajisja përdoret ekskluzivisht për pagesën e mallrave ose shërbimeve; dhe

b) numri i kartës, instrumentit ose pajisjes shoqëron të gjitha transfertat që rrjedhin nga transaksioni.

Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit të parë dhe të germave “a” dhe “b” të kësaj pike, ky ligj zbatohet kur një kartë pagesash, një instrument i parasë elektronike, një telefon celular ose çdo pajisje tjetër digjitale apo e teknologjisë së informacionit, me parapagesë ose paspagesë, me karakteristika të ngjashme, përdoret për të kryer një transfertë fondesh apo të token të parasë elektronike ndërmjet personave fizikë që veprojnë si konsumatorë, për qëllime që nuk lidhen me veprimtarinë tregtare, ekonomike ose profesionale.

4. Pjesa III e këtij ligji nuk zbatohet për personat që nuk kanë veprimtari tjetër përveç konvertimit të dokumenteve në format letër në të dhëna elektronike dhe që e kryejnë këtë veprimtari në bazë të një kontrate me një ofrues të shërbimeve të pagesave, ose për personat që nuk kanë veprimtari tjetër përveç ofrimit për ofruesit e shërbimeve të pagesave të sistemeve të transmetimit të mesazheve ose sistemeve të tjera mbështetëse për transmetimin e fondeve, ose të sistemeve të kleringut dhe shlyerjes.

5. Pjesa III e këtij ligji nuk zbatohet për një transfertë fondesh kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) përfshin tërheqjen e parave fizike nga paguesi nga llogaria e tij e pagesës;

b) përbën transfertë fondesh drejt një autoriteti publik si pagesë për taksa, gjoba ose detyrime të tjera brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

c) si paguesi ashtu edhe përfituesi i pagesës janë ofrues të shërbimeve të pagesave që veprojnë në emër dhe për llogari të tyre;

d) kryhet nëpërmjet shkëmbimit të imazheve të çeqeve, përfshirë çeqet e përpunuara në mënyrë elektronike (*truncated cheques*).

6. Pjesa III e këtij ligji nuk zbatohet për një transfertë të krypto-aseteve kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) si nismëtari ashtu edhe përfituesi janë ofrues të shërbimeve të krypto-aseteve që veprojnë në emër dhe për llogari të tyre;

b) transfertat e krypto-aseteve kryhet ndërmjet personave, pa përfshirjen e një ofruesi të shërbimeve të krypto-aseteve.

Tokenët e parasë elektronike, sipas përkufizimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi për tregjet e krypto-aseteve, trajtohen si krypto-asete për qëllimet e zbatimit të Pjesës III të këtij ligji.

7. Këshilli i Ministrave mund të vendosë që Pjesa III e këtij ligji të mos zbatohet për transfertat e fondeve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë drejt një llogarie pagese të përfituesit të pagesës, duke lejuar pagesën ekskluzivisht për ofrimin e mallrave ose shërbimeve kur plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit është subjekt i detyrimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

b) ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit është në gjendje të gjurmojë, nëpërmjet përfituesit të pagesës, me anë të identifikuesit unik të transaksionit, transfertat e fondeve nga personi që ka një marrëveshje me përfituesin e pagesës për ofrimin e mallrave ose shërbimeve;

c) shuma e transfertës së fondeve nuk tejkalon shumën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë.

Neni 150

Përkufizime

Për qëllime të zbatimit të Pjesës III të këtij ligji, zbatohen përkufizimet e përcaktuara në Pjesën I, Pjesën II dhe Pjesën IV të këtij ligji dhe përkufizimet e mëposhtme:

1. “pagues” nënkupton personin që mban një llogari pagese, nga e cila autorizohet transfertat e fondeve, ose, në mungesë të një llogarie pagese, personin që jep urdhrin për transfertën e fondeve;

2. “përfitues i pagesës” nënkupton personin që është marrësi i synuar i transfertës së fondeve;

3. “ofrues i shërbimeve të pagesave” ka të njëjtin kuptim si përkufizimi i dhënë në ligjin për shërbimet e pagesave;

4. “ofrues ndërmjetës i shërbimeve të pagesave” nënkupton ofruesin e shërbimeve të pagesave, i cili nuk është ofruesi i shërbimeve të pagesave i paguesit apo i përfituesit dhe që, në emër të ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit, apo të përfituesit ose të një ofruesi tjetër ndërmjetës të shërbimeve të pagesave, merr dhe transmeton një transfertë fondesh;

5. “llogari pagese” ka të njëjtin kuptim si përkufizimi i dhënë në ligjin për shërbimet e pagesave;

6. “fonde” ka të njëjtin kuptim si përkufizimi i dhënë në ligjin për shërbimet e pagesave;

7. “transferta e fondeve” është çdo transaksion që kryhet, të paktën pjesërisht, me mjete elektronike, për llogari të një paguesi nëpërmjet një ofruesi të shërbimeve të pagesave, me

qëllim vënien e fondeve në dispozicion të një përfituesi të pagesës nëpërmjet një ofruesi të shërbimeve të pagesave, pavarësisht nëse paguesi dhe përfituesi i pagesës janë i njëjti person dhe pavarësisht nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave i paguesit dhe ai i përfituesit të pagesës janë i njëjti subjekt, duke përfshirë:

- a) transfertën e kreditit, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin për shërbimet e pagesave;
- b) debitimin direkt, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin për shërbimet e pagesave;
- c) dërgimin e parave, vendas apo ndërkufitar, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin për shërbimet e pagesave;

d) transfertën e kryer nëpërmjet një karte pagese, një instrumenti të parasë elektronike, një telefoni celular ose çdo pajisjeje tjetër digjitale apo të teknologjisë së informacionit me parapagesë ose paspagesë, me karakteristika të ngjashme;

8. “nismëtari” është një person që mban një llogari kripto-asetesh pranë një ofruesi të shërbimeve të kripto-aseteve, një adresë në regjistrin e shpërndarë, ose një pajisje që lejon ruajtjen e kripto-aseteve, dhe që autorizon një transfertë të kripto-aseteve nga ajo llogari, adresë në regjistrin e shpërndarë apo pajisje, ose, në mungesë të elementeve të mësipërme, një person që urdhëron ose inicion një transfertë të kripto-aseteve;

9. “përfitues” është një person i përcaktuar si marrësi i synuar i transfertës së kripto-aseteve;

10. “kripto-aset” ka të njëjtin kuptim si përkufizimi i dhënë në legjislacionin për tregjet e kripto-aseteve. Ky përkufizim nuk përfshin kategoritë e kripto-aseteve të cilat përjashtohen nga fusha e zbatimit të atij ligji ose që, në raste të tjera, kualifikohen si fonde;

11. “ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve” ka të njëjtin kuptim si përkufizimi i dhënë në legjislacionin për tregjet e kripto-aseteve kur kryhen një ose më shumë shërbime kripto-asetesh të përcaktuara sipas atij ligji;

12. “ofrues ndërmjetës i shërbimeve të kripto-aseteve” nënkupton një ofrues të shërbimeve të kripto-aseteve, i cili nuk është ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve i nismëtarit apo i përfituesit dhe i cili merr dhe transmeton një transfertë të kripto-aseteve në emër të ofruesit të shërbimeve të kripto-aseteve të nismëtarit ose të përfituesit, apo të një ofruesi tjetër ndërmjetës të shërbimeve të kripto-aseteve;

13. “transfertë e kripto-aseteve” nënkupton çdo transaksion me qëllim lëvizjen e kripto-aseteve nga një adresë në regjistrin e shpërndarë, llogari kripto-asetesh apo çdo pajisje tjetër që mundëson ruajtjen e kripto-aseteve, në një adresë, llogari ose pajisje tjetër të tillë, i cili kryhet nga të paktën një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve që vepron në emër të një nismëtari ose përfituesi, pavarësisht nëse nismëtari dhe përfituesi janë i njëjti person dhe pavarësisht nëse ofruesi i shërbimeve të kripto-aseteve i nismëtarit dhe ai i përfituesit janë i njëjti subjekt;

14. “transfertë në grup” nënkupton një grupim të përbërë nga disa transfertat individuale fondesh ose transfertat individuale të kripto-aseteve, të bashkuara për transmetim të përbashkët;

15. “identifikues unik i transaksionit” nënkupton një kombinim germash, numrash ose simbolesh i përcaktuar nga ofruesi i shërbimeve të pagesave, në përputhje me protokollet e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes, ose të sistemeve të mesazheve të përdorura për transfertat e fondeve, ose të përcaktuara nga një ofrues i shërbimeve të kripto-aseteve, i cili lejon gjurmueshmërinë e transaksionit deri te paguesi dhe përfituesi, ose gjurmueshmërinë e transfertës së kripto-aseteve deri te nismëtari dhe përfituesi;

16. “transfertë e kripto-aseteve ndërmjet personave” nënkupton transfertën e kripto-aseteve që kryhet pa përfshirjen e një ofruesi të shërbimeve të kripto-aseteve;

17. “bankomatet e krypto-aseteve” ose “ATM-të e krypto-aseteve” nënkuptojnë terminale elektronike fizike ose online, të cilat i mundësojnë një ofruesi të shërbimeve të krypto-aseteve të kryejë, në veçanti, veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve të transfertave të krypto-aseteve sipas përcaktimit të dhënë në ligjin për tregjet e krypto-aseteve;

18. “adresë në regjistrin e shpërndarë” nënkupton një kod alfanumerik që identifikon një adresë në një rrjet që përdor teknologjinë e regjistrit të shpërndarë (DLT), ose një teknologji të ngjashme ku mund të dërgohen ose merren krypto-asete;

19. “llogari krypto-asetesh” nënkupton një llogari që mbahet nga një ofrues i shërbimeve të krypto-aseteve, në emër dhe për llogari të një ose disa personave fizikë ose personave juridikë dhe që mund të përdoret për kryerjen e transfertave të krypto-aseteve;

20. “adresë e vetë-hostuar” nënkupton një adresë në regjistrin e shpërndarë që nuk lidhet me asnjërin nga sa vijon:

a) me një ofrues të shërbimeve të krypto-aseteve;

b) me një subjekt që nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë dhe që ofron shërbime të njëjta ose të ngjashme me ato të një ofruesi të shërbimeve të krypto-aseteve;

21. “teknologji e regjistrit të shpërndarë” ose “DLT” është teknologjia e regjistrave të shpërndarë sipas përkufizimit të dhënë në ligjin për tregjet e krypto-aseteve.

KREU II

DETYRIMET E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE

Seksioni 1

Detyrimet e ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit

Neni 151

Informacioni që shoqëron transfertat e fondeve

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit duhet të sigurojë që transfertat e fondeve të shoqërohet me informacionin e mëposhtëm për paguesin:

a) emrin dhe mbiemrin ose emërtimin e paguesit;

b) numrin e llogarisë së pagesës së paguesit;

c) adresën e paguesit, përfshirë emrin e shtetit, numrin e dokumentit zyrtar të identifikimit dhe numrin e identifikimit të klientit, ose, në mënyrë alternative, datën dhe vendin e lindjes së paguesit;

d) kur ekziston fusha përkatëse në formatin e mesazhit të pagesës dhe kur ky informacion është vënë në dispozicion nga paguesi, identifikuesin e personit juridik (LEI) të paguesit ose, në mungesë të tij, çdo identifikues tjetër zyrtar të barasvlershëm.

2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit duhet të sigurojë që transfertat e fondeve të shoqërohet me informacionin e mëposhtëm për përfituesin e pagesës:

a) emrin dhe mbiemrin ose emërtimin e përfituesit të pagesës;

b) numrin e llogarisë së pagesës së përfituesit të pagesës;

c) kur ekziston fusha përkatëse në formatin e mesazhit të pagesës dhe kur ky informacion është vënë në dispozicion nga paguesi, identifikuesin e personit juridik (LEI) të përfituesit ose, në mungesë të tij, çdo identifikues tjetër zyrtar të barasvlershëm.

3. Në përjashtim nga pika 1, germa “b”, dhe pika 2, germa “b” të këtij neni, në rastin e një transferte që nuk kryhet nga ose drejt një llogarie pagese, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit duhet të sigurojë që transfertat e fondeve të shoqërohet me një identifikues unik të transaksionit, në vend të numrit të llogarisë së pagesës.

4. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, përpara transfertës së fondeve, duhet të verifikojë saktësinë e informacionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dhe, kur është e zbatueshme, në pikën 3 të këtij neni, në bazë të dokumenteve, të dhënave ose informacionit të marrë nga burime të besueshme dhe të pavarura.

5. Verifikimi i parashikuar në pikën 4 të këtij neni konsiderohet i kryer kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) identiteti i paguesit është verifikuar në përputhje me dispozitat e Pjesës II të këtij ligji mbi identifikimin dhe verifikimin e klientit, dhe informacioni i marrë në kuadër të këtij verifikimi ruhet në përputhje me dispozitat e këtij ligji për ruajtjen e dokumentacionit;

b) zbatohen dispozitat e Pjesës II të këtij ligji që lejojnë verifikimin e identitetit pas vendosjes së marrëdhënies së biznesit.

6. Pa cenuar përjashtimet e parashikuara në nenet 152 dhe 153 të këtij ligji, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk ekzekuton asnjë transfertë fondesh përpara se të sigurojë përputhjen e plotë me këtë nen.

Neni 152

Transfertat e fondeve në nivel vendi

1. Me përjashtim të kërkesave të parashikuara në nenin 151, pikat 1 dhe 2, kur të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të përfshirë në zinxhirin e pagesës janë të regjistruar, licencuar ose kanë selinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, transfertat e fondeve shoqërohen të paktën me:

a) numrin e llogarisë së pagesës së paguesit dhe të përfituesit të pagesës; ose

b) identifikuesin unik të transaksionit, në rastet kur zbatohet neni 151, pika 3, pa cenuar kërkesat e tjera për informacion të parashikuara në ligjin për shërbimet e pagesave, kur është e aplikueshme.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit duhet që brenda 3 ditëve pune nga marrja e kërkesës për informacion nga ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit ose nga një ofrues i shërbimeve të pagesave ndërmjetës, të vërë në dispozicion si më poshtë:

a) për transfertat e fondeve mbi 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, pavarësisht nëse këto transfertat kryhen në një transaksion të vetëm apo në disa transaksione që duket se janë të lidhura me njëri-tjetrin, informacionin rreth paguesit ose përfituesit të pagesës në përputhje me nenin 151 të këtij ligji;

b) për transfertat e fondeve që nuk tejkalojnë 100 000 (njëqind mijë) lekë, ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, dhe që nuk duket se janë të lidhura me transfertat të tjera fondesh, të cilat, së bashku me transfertën në fjalë, tejkalojnë 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, të paktën:

i. emrat e paguesit dhe të përfituesit të pagesës; dhe

ii. numrat e llogarive të pagesës të paguesit dhe të përfituesit të pagesës ose, në rastet kur zbatohet neni 151, pika 3, identifikuesin unik të transaksionit.

3. Në përjashtim nga neni 151, pika 4, në rastin e transfertave të fondeve të përcaktuara në pikën 2, germa “b”, të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave i paguesit nuk është i detyruar të verifikojë informacionin për paguesin, përveç rasteve kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit:

a) ka marrë fondet që do të transferohen në para fizike ose në para elektronike anonime, ose

b) ka dyshime të arsyeshme për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Neni 153

Transfertat ndërkufitare të fondeve

1. Në rastin e një transferte në grup nga një pagues i vetëm, kur ofruesit e shërbimeve të pagesave të përfituesve të pagesës janë të regjistruar, licencuar ose kanë selinë e tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, neni 151, pika 1, i këtij ligji, nuk zbatohet për transfertat individuale të përfshira së bashku në të, me kusht që:

a) transferata në grup të përmbajë informacionin e përcaktuar në nenin 151, pikat 1, 2 dhe 3;

b) ky informacion të jetë verifikuar në përputhje me nenin 151, pikat 4 dhe 5; dhe

c) transfertat individuale të mbajnë numrin e llogarisë së pagesës së paguesit ose, kur zbatohet neni 151, pika 3, identifikuesin unik të transaksionit.

2. Në përjashtim të nenit 151, pika 1, dhe, kur është e aplikueshme, pa cenuar informacionin e kërkuar nga ligji për shërbimet e pagesave, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës është i regjistruar, licencuar ose ka selinë e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, transfertat e fondeve që nuk tejkalojnë 100 000 (njëqind mijë) lekë, ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, dhe që nuk duket se janë të lidhura me transfertat të tjera fondesh të cilat, së bashku me transfertën në fjalë, tejkalojnë 100 000 (njëqind mijë) lekë, ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, duhet të shoqërohen të paktën nga:

a) emrat e paguesit dhe të përfituesit të pagesës; dhe

b) numrat e llogarisë së pagesës së paguesit dhe përfituesit të pagesës ose, kur zbatohet neni 151, pika 3, identifikuesin unik të transaksionit.

3. Në përjashtim të nenit 151, pika 4 të këtij ligji, ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit nuk është i detyruar të verifikojë informacionin mbi paguesin sipas kësaj pike, përveç nëse ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit:

a) ka marrë fonde që do të transmetohen në para fizike ose në para elektronike anonime; ose

b) ka dyshime të arsyeshme për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

Seksioni 2

Detyrimet e ofruesit të shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës

Neni 154

Identifikimi i rasteve të mungesës së informacionit rreth paguesit ose përfituesit të pagesës

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës duhet të zbatojë procedura efektive për të identifikuar nëse fushat që lidhen me informacionin mbi pagesin dhe përfituesin e pagesës në sistemin e mesazheve ose sistemin e pagesave dhe të shlyerjes, të përdorur për të kryer transfertën e fondeve janë plotësuar duke përdorur karaktere ose të dhëna të pranuar në përputhje me rregullat dhe procedurat nga ai sistem.

2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës duhet të zbatojë procedura efektive, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, monitorimin gjatë ose pas transfertave, për të identifikuar nëse mungon informacioni i mëposhtëm mbi pagesin ose përfituesin e pagesës:

a) për transfertat e fondeve kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është i licencuar, i regjistruar ose ushtron veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, informacionin e parashikuar në nenin 152 të këtij ligji;

b) për transfertat e fondeve në rastet kur ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit është i licencuar, i regjistruar ose ushtron veprimtari jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, informacionin e parashikuar në nenin 151, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c” dhe në nenin 151, pika 2, gjerat “a” dhe “b”;

c) për transfertat në grup, në rastet kur ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit është i licencuar, i regjistruar ose ushtron veprimtari jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, informacionin e parashikuar në nenin 151, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c” dhe në nenin 151, pika 2, gjerat “a” dhe “b”, në lidhje me transfertën përkatëse të përfshirë në grup.

3. Në rastin e transfertave të fondeve që tejkalojnë 100 000 (njëqind mijë) lekë, ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, pavarësisht nëse këto transfertat kryhen në një transaksion të vetëm apo në disa transaksione që duket se janë të lidhura me njëri-tjetrin, përpara kreditimit të llogarisë së pagesës së përfituesit të pagesës ose përpara vënies së fondeve në dispozicion të tij, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës duhet të verifikojë saktësinë e informacionit mbi përfituesin e pagesës, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, në bazë të dokumenteve, të dhënave ose informacionit të marrë nga burime të besueshme dhe të pavarura, pa cenuar kërkesat e parashikuara në ligjin për shërbimet e pagesave.

4. Në rastin e transfertave të fondeve që nuk tejkalojnë 100 000 (njëqind mijë) lek, ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, të cilat nuk duket se janë të lidhura me transfertat të tjera fondesh të cilat, së bashku me transfertën në fjalë, tejkalojnë 100 000 (njëqind mijë) lekë, ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës nuk ka nevojë të verifikojë saktësinë e informacionit mbi përfituesin e pagesës, përveç rasteve kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës:

a) kryen pagesën e fondeve në para fizike apo në para elektronike anonime; ose

b) ka dyshime të arsyeshme për pastrim parash ose financim të terrorizmit.

5. Procesi i verifikimit i parashikuar në pikat 3 dhe 4 të këtij neni konsiderohet i kryer kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme:

a) identiteti i përfituesit të pagesës është verifikuar dhe të dhënat përkatëse janë ruajtur në përputhje me kërkesat e Pjesës II të këtij ligji;

b) për përfituesin e pagesës zbatohen dispozitat e Pjesës II të këtij ligji që lejojnë kryerjen e verifikimit në një moment të mëvonshëm ose në kuadër të një marrëdhënieje biznesi ekzistuese, në përputhje me qasjen e bazuar në rrezik.

Transfertat e fondeve për të cilat mungojnë informacione apo ka informacione të paplota rreth paguesit ose përfituesit të pagesës

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës duhet të zbatojë procedura efektive të bazuara në rrezik, duke përfshirë procedurat e përcaktuara në Pjesën II të këtij ligji, për të përcaktuar nëse duhet kryer, refuzuar ose pezulluar një transfertë fondesh që nuk përmban informacionin e plotë të kërkuar për paguesin dhe përfituesin e pagesës dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura pasuese.

Kur ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit të pagesës konstaton, në momentin e marrjes së një transferte fondesh, se informacioni i parashikuar në nenin 151, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”, nenin 151, pika 2, germat “a” dhe “b”, nenin 152, pika 1, ose nenin 153 të këtij ligji, mungon ose është i paplotë ose ky informacion nuk është plotësuar duke përdorur karaktere ose të dhëna të pranueshme sipas rregullave të sistemit të mesazheve apo të sistemit të pagesave dhe shlyerjes, sipas përcaktimeve në nenin 154, pika 1, ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit të pagesës, në përputhje me qasjen e bazuar në rrezik, duhet:

a) të refuzojë transfertën; ose

b) të kërkojë informacionin e kërkuar për paguesin dhe përfituesin e pagesës, përpara ose pas kreditimit të llogarisë së pagesës së përfituesit të pagesës ose vënies së fondeve në dispozicion të përfituesit të pagesës.

2. Kur një ofrues i shërbimeve të pagesave nuk arrin në mënyrë të përsëritur të japë informacionin e kërkuar mbi paguesin ose përfituesin e pagesës ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit të pagesës, duhet:

a) të marrë masa, të cilat fillimisht mund të përfshijnë dhënien e paralajmërimeve dhe caktimin e afateve për përmbushjen e detyrimit, përpara se të vazhdojë me refuzimin, kufizimin apo ndërprerjen në përputhje me germën “b” të kësaj pike në rast se informacioni i kërkuar ende nuk është dhënë; ose

b) të refuzojë drejtpërdrejt çdo transfertë të ardhshme të fondeve nga ai ofrues i shërbimeve të pagesave, ose të kufizojë ose të ndërpresë marrëdhënien e tij të veprimtarisë me atë ofrues të shërbimit të pagesave.

Ofruesi i shërbimit të pagesave i përfituesit të pagesës duhet të raportojë mospërmbushjen e detyrimit për informacion sipas kësaj pike dhe masat e marra, pranë autoritetit mbikëqyrës kompetent.

Neni 156

Vlerësimi dhe raportimi

Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit të pagesës duhet të marrë në konsideratë informacionin e munguar ose të paplotë mbi paguesin ose përfituesin e pagesës si një tregues të mundshëm rreziku gjatë vlerësimit nëse një transfertë fondesh ose ndonjë transaksion i lidhur me të është i dyshimtë dhe nëse duhet të raportohet pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare në përputhje me Pjesën I dhe Pjesën II të këtij ligji.

Seksioni 3

Detyrimet për ofruesit ndërmjetës të shërbimeve të pagesave

Neni 157

Ruajtja e informacioneve mbi paguesin dhe përfituesin e pagesës që shoqëron transfertën

Ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të pagesave duhet të sigurojë që i gjithë informacioni i marrë mbi paguesin dhe përfituesin e pagesës, i cili shoqëron transfertën e fondeve, të ruhet së bashku me këtë transfertë.

Neni 158

Identifikimi i rasteve të mungesës së informacionit mbi paguesin ose përfituesin e pagesës

1. Ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të pagesave duhet të zbatojë procedura efektive për të identifikuar nëse fushat që lidhen me informacionin mbi paguesin dhe përfituesin e pagesës në sistemin e mesazheve ose të pagesave dhe shlyerjes të përdorur për kryerjen e transfertës së fondeve janë plotësuar duke përdorur karaktere ose të dhëna të pranueshme në përputhje me rregullat teknike të atij sistemi.

2. Ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të pagesave duhet të zbatojë procedura efektive, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, monitorimin gjatë ose pas transfertave, për të identifikuar nëse mungon informacioni i mëposhtëm mbi paguesin ose përfituesin e pagesës:

a) për transfertat e fondeve kur ofruesit e shërbimeve të pagesave të paguesit dhe përfituesit të pagesës janë të licencuar, regjistruar ose ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, informacionin e parashikuar në nenin 152 të këtij ligji;

b) për transfertat e fondeve në rastet kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ose të përfituesit të pagesave është i licencuar, i regjistruar ose ushtron veprimtari jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, informacionin e parashikuar në nenin 151, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c” dhe në nenin 151, pika 2, germat “a” dhe “b”;

c) për transfertat në grup, në rastet kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ose të përfituesit të pagesave është i licencuar, i regjistruar ose ushtron veprimtari jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, informacionin e parashikuar në nenin 151, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c” dhe në nenin 151, pika 2, germat “a” dhe “b”, në lidhje me transfertën përkatëse të përfshirë në grup.

Neni 159

Transfertat e fondeve për të cilat mungon informacioni mbi paguesin ose përfituesin e pagesës

1. Ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të pagesave duhet të miratojë procedura efektive të bazuara në rrezik për të përcaktuar nëse një transfertë fondesh për të cilën mungon informacioni i kërkuar mbi paguesin ose përfituesin e pagesës duhet të ekzekutohet, refuzohet ose pezullohet dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura pasuese.

Kur ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të pagesave konstaton, në momentin e marrjes së një transferte fondesh, se informacioni i parashikuar në nenin 151, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”, nenin 151 pika 2, germat “a” dhe “b”, nenin 152, pika 1 ose nenin 153 të këtij ligji, mungon ose nuk është plotësuar duke përdorur karaktere ose të dhëna të pranueshme sipas rregullave të

sistemit të mesazheve apo të sistemit të pagesave dhe shlyerjes, sipas përcaktimeve në nenin 154, pika 1, ofruesi ndërmjetës i shërbimit të pagesave, në përputhje me qasjen e bazuar në rrezik, duhet:

- a) të refuzojë transfertën; ose
- b) të kërkojë informacionin e kërkuar mbi paguesin dhe përfituesin e pagesës, përpara ose pas dërgimit të transfertës së fondeve.

2. Kur një ofrues i shërbimeve të pagesave nuk arrin në mënyrë të përsëritur të japë informacionin e kërkuar për paguesin ose përfituesin e pagesës ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të pagesave, duhet:

- a) të marrë masa, të cilat fillimisht mund të përfshijnë dhënien e paralajmërimeve dhe caktimin e afateve për përmbushjen e detyrimit, përpara se të vazhdojë me refuzimin, kufizimin apo ndërprerjen në përputhje me germën “b” të kësaj pike në rast se informacioni i kërkuar ende nuk është dhënë; ose

- b) të refuzojë drejtpërdrejt çdo transfertë të ardhshme të fondeve nga ai ofrues i shërbimeve të pagesave ose të kufizojë ose të ndërpresë marrëdhënien e tij të veprimtarisë me atë ofrues të shërbimit të pagesave.

Ofruesi ndërmjetës i shërbimit të pagesave duhet të raportojë mospërmbushjen e detyrimit për informacion sipas kësaj pike dhe masat e marra pranë autoritetit mbikëqyrës kompetent.

Neni 160

Vlerësimi dhe raportimi

Ofruesi ndërmjetës i shërbimit të pagesave duhet të marrë në konsideratë informacionin që mungon në lidhje me paguesin ose përfituesin e pagesës si një tregues të mundshëm rreziku gjatë vlerësimit nëse një transfertë fondesh ose ndonjë transaksion i lidhur me të është i dyshimtë dhe nëse duhet të raportohet pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare në përputhje me Pjesën I dhe Pjesën II të këtij ligji.

KREU III

DETYRIMET E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË KRIPTO-ASETEVE

Seksioni 1

Detyrimet e ofruesit të shërbimit të krypto-aseteve të nismëtarit

Neni 161

Informacioni që shoqëron transfertat e krypto-aseteve

1. Ofruesi i shërbimit të krypto-aseteve i nismëtarit duhet të sigurojë që transfertat e krypto-aseteve të shoqërohen me informacionin mbi nismëtarin si më poshtë:

- a) emri i nismëtarit;
- b) adresa në regjistrin e shpërndarë të nismëtarit, në rastet kur një transfertë e krypto-aseteve është regjistruar në një rrjet që përdor DLT apo një teknologji të ngjashme, dhe numri

i llogarisë së krypto-aseteve të nismëtarit, në rastet kur një llogari e tillë ekziston dhe përdoret për të përpunuar transaksionin;

c) numri i llogarisë së krypto-aseteve të nismëtarit, në rastet kur një transfertë e krypto-aseteve nuk është regjistruar në një rrjet që përdor DLT apo një teknologji të ngjashme; dhe

d) adresa e nismëtarit, duke përfshirë emrin e shtetit, numrin zyrtar të dokumentit personal dhe numrin e identifikimit të klientit, ose, në mënyrë alternative, datën dhe vendin e lindjes së nismëtarit; dhe

e) në varësi të ekzistencës së fushës së nevojshme në formatin përkatës të mesazhit dhe, kur i jepet nga nismëtari ofruesit të tij të shërbimit të krypto-aseteve, numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS) apo LEI aktual ose, në mungesë të tij, çdo identifikues tjetër zyrtar ekuivalent i disponueshëm nga nismëtari.

2. Ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve i nismëtarit duhet të sigurojë që transfertat e krypto-aseteve të shoqërohen nga informacioni mbi përfituesin si më poshtë:

a) emri i përfituesit;

b) adresa e regjistrimit të shpërndarë të përfituesit, në rastet kur një transfertë e krypto-aseteve është regjistruar në një rrjet që përdor DLT apo një teknologji të ngjashme, dhe numri i llogarisë së krypto-aseteve të përfituesit, në rastet kur një llogari e tillë ekziston dhe përdoret për të përpunuar transaksionin;

c) numri i llogarisë së krypto-aseteve të përfituesit, në rastet kur një transfertë e krypto-aseteve nuk është regjistruar në një rrjet që përdor DLT apo një teknologji të ngjashme; dhe

d) në varësi të ekzistencës së fushës së nevojshme në formatin përkatës të mesazhit, dhe kur i jepet nga nismëtari ofruesit të tij të shërbimit të krypto-aseteve, numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS) apo LEI aktual ose, në mungesë të tij, çdo identifikues tjetër zyrtar ekuivalent i disponueshëm nga përfituesit.

3. Përjashtimisht nga parashikimet e pikës 1, germa “c” dhe pikës 2, germa “c” të këtij neni, në rastin e një transferte të krypto-aseteve të paregjistruara në një rrjet që përdor DLT apo një teknologji të ngjashme dhe që nuk është bërë për në ose nga një llogari krypto-asetesh, ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve i nismëtarit duhet të sigurohet që transfertat e krypto-aseteve të shoqërohet nga një identifikues unik i transaksionit.

4. Informacioni i përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni duhet të dërgohet paraprakisht, njëkohësisht ose paralelisht me transfertën e krypto-aseteve, në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me dispozitat e Pjesës I të këtij ligji dhe me legjislacionin e zbatueshëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Informacioni i përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk kërkohet t’i bashkëlidhet drejtpërdrejt transfertës së krypto-aseteve ose të përfshihet në të.

5. Në rastin e një transferte të krypto-aseteve të kryer drejt një adrese të vetë-hostuar, ofruesi i shërbimit të krypto-aseteve i nismëtarit merr dhe ruan informacionin e përmendur në pikat 1 dhe 2 të këtij neni dhe siguron që transfertat e krypto-aseteve të mund të identifikohet në mënyrë individuale.

Pa cenuar zbatimin e masave specifike për zbutjen e rrezikut të parashikuara në Pjesën I dhe Pjesën II të këtij ligji, në rastin e një transferte me vlerë mbi 100 000 (njëqind mijë) lekë, ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, drejt një adrese të vetë-hostuar, ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve i nismëtarit merr masat e përshtatshme për të vlerësuar nëse kjo adresë është në pronësi apo kontrollohet nga nismëtari.

6. Përpara kryerjes së transfertës së krypto-aseteve, ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve i nismëtarit verifikon saktësinë e informacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, bazuar në dokumentet, të dhënat apo informacionet e përfuara nga një burim i besueshëm dhe i pavarur.

7. Procesi i verifikimit, sipas pikës 6 të këtij neni, konsiderohet i kryer nëse përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

a) identiteti i nismëtarit është verifikuar dhe informacioni i marrë nga ky verifikim është ruajtur, në përputhje me parashikimet e Pjesës II të këtij ligji;

b) për nismëtarin zbatohen parashikimet e Pjesës II të këtij ligji mbi verifikimin e identitetit të tij në një moment të mëvonshëm.

8. Ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve të nismëtarit nuk lejon fillimin, dhe as nuk ekzekuton asnjë transfertë të krypto-aseteve, përpara se të sigurojë pajtueshmërinë e plotë me këtë nen.

Neni 162

Transfertat në grup të krypto-aseteve

Në rastin e një transferte në grup të krypto-aseteve nga një nismëtar i vetëm, neni 161, pika 1 nuk zbatohet për transfertat individuale të grupuara në të, me kusht që transfertat në grup të përmbajë informacionin e parashikuar në nenin 161, sipas pikave 1, 2 dhe 3, që ky informacion të jetë verifikuar në përputhje me nenin 161, pikat 6 dhe 7, dhe që transfertat individuale të përmbajnë adresën e regjistrimit të shpërndarë të nismëtarit, kur zbatohet neni 161, pika 2, germa “b”, numrin e llogarisë së krypto-aseteve të nismëtarit, kur zbatohet neni 161, pika 2, germa “c”, ose identifikuesin unik të transaksionit, kur zbatohet neni 161, pika 3 e këtij ligji.

Seksioni 2

Detyrimet e ofruesit të shërbimeve të krypto-aseteve të përfituesit

Neni 163

Identifikimi i rasteve të mungesës së informacionit rreth nismëtarit ose përfituesit

1. Ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve të përfituesit duhet të zbatojë procedura efektive, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, monitorimin gjatë ose pas transfertës, për të identifikuar nëse informacioni i përcaktuar në nenin 161, pikat 1 dhe 2 mbi nismëtarin dhe përfituesin është i përfshirë ose e shoqëron transfertën apo transfertën në grup të krypto-aseteve.

2. Në rastin e një transferte të krypto-aseteve të kryer nga një adresë e vetë-hostuar, ofruesi i shërbimit të krypto-aseteve të përfituesit duhet të marrë dhe ruajë informacionin e parashikuar në nenin 161, pikat 1 dhe 2 dhe duhet të sigurojë që transfertat e krypto-aseteve të mund të identifikohen në mënyrë individuale.

Pa cenuar zbatimin e masave specifike për zbutjen e rreziqeve të parashikuara në Pjesën I dhe Pjesën II të këtij ligji, në rastin e një transferte me vlerë mbi 100 000 (njëqind mijë) lekë, ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, nga një adresë e vetë-hostuar, ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve të përfituesit duhet të marrë masa të përshtatshme për të vlerësuar nëse kjo adresë është në pronësi ose kontrollon nga përfituesi.

3. Ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve të përfituesit, përpara se t'i vendosë krypto-asetet në dispozicion të përfituesit, duhet të verifikojë saktësinë e informacionit mbi përfituesin sipas përcaktimeve në nenin 161, pika 2 të këtij ligji, në bazë të dokumenteve, të dhënave ose informacionit të marrë nga një burim i besueshëm dhe i pavarur.

4. Procesi i verifikimit i përmendur në pikat 2 dhe 3 të këtij neni konsiderohet se është realizuar kur zbatohet një nga sa vijon:

a) identiteti i përfituesit është verifikuar dhe informacioni i marrë nga ky verifikim është ruajtur, në përputhje me parashikimet e Pjesës II të këtij ligji;

b) për përfituesin zbatohen parashikimet e Pjesës II të këtij ligji mbi verifikimin e identitetit të tij në një moment të mëvonshëm.

Neni 164

Transferrat e krypto-aseteve me informacion të munguar ose të paplotë mbi nismëtarin ose përfituesin

1. Ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve të përfituesit duhet të zbatojë procedura efektive të bazuara në rrezik, duke përfshirë procedurat e përcaktuara në Pjesën II të këtij ligji, për të përcaktuar nëse një transfertë e krypto-aseteve që nuk përmban informacionin e plotë të kërkuar mbi nismëtarin dhe përfituesin duhet të ekzekutohet, refuzohet ose pezullohet dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura të mëtejshme.

Në rastet kur ofruesi i shërbimit të krypto-aseteve të përfituesit konstaton se informacioni i përcaktuar në nenin 161, pikat 1 dhe 2, ose në nenin 162, mungon ose është i paplotë, atëherë ky ofrues, bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe pa vonesa të pajustificuara, duhet:

a) të refuzojë transfertën, ose të kthejë krypto-asetet e transferuara në llogarinë e krypto-aseteve të nismëtarit; ose

b) të kërkojë informacionin mbi nismëtarin dhe përfituesin përpara se t'i vërë krypto-asetet në dispozicion të përfituesit.

2. Në rastet kur një ofrues i shërbimit të krypto-aseteve nuk arrin në mënyrë të përsëritur të japë informacionin e kërkuar mbi nismëtarin ose përfituesin, atëherë ofruesi i shërbimeve të krypto-aseteve të përfituesit duhet:

a) të marrë masa, të cilat fillimisht mund të përfshijnë dhënien e paralajmërimeve dhe caktimin e afateve për përmbushjen e detyrimit, përpara se të vazhdojë me refuzimin, kufizimin apo ndërprerjen në përputhje me germën “b” të kësaj pike, në rast se informacioni i kërkuar ende nuk është dhënë; ose

b) të refuzojë drejtpërdrejt çdo transfertë të ardhshme të krypto-aseteve për ose nga, ose të kufizojë ose të ndërpresë marrëdhënien e tij të veprimtarisë me atë ofrues të shërbimit të krypto-aseteve.

Ofruesi i shërbimit të krypto-aseteve të përfituesit duhet të raportojë pranë autoritetit mbikëqyrës kompetent të gjitha rastet e mos përmbushjes së detyrimit për informacion sipas kësaj pike dhe masat e marra në lidhje me to.

Neni 165

Vlerësimi dhe raportimi

Ofruesi i shërbimit të krypto-aseteve të përfituesit duhet të marrë në konsideratë informacionin që mungon ose është i paplotë mbi nismëtarin ose përfituesin si një tregues të mundshëm rreziku gjatë vlerësimit nëse një transfertë e krypto-aseteve, ose ndonjë transaksion i lidhur me të është i dyshimtë dhe nëse duhet të raportohet pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare në përputhje me Pjesën I dhe Pjesën II të këtij ligji.

Seksioni 3

Detyrimet e ofruesve ndërmjetës të shërbimeve të krypto-aseteve

Neni 166

Ruajtja e informacioneve mbi nismëtarin dhe përfituesin që shoqëron transfertën e krypto-aseteve

Ofruesit ndërmjetës të shërbimeve të krypto-aseteve duhet të sigurojnë që i gjithë informacioni i marrë për nismëtarin dhe përfituesin që shoqëron një transfertë të krypto-aseteve të transmetohet së bashku me transfertën dhe që të dhënat e këtij informacioni të ruhen dhe t'u vihen në dispozicion, sipas kërkesës, autoriteteve kompetente.

Neni 167

Identifikimi i rasteve të mungesës së informacionit rreth nismëtarit ose përfituesit

Ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të krypto-aseteve duhet të zbatojë procedura efektive, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, monitorimin gjatë ose pas transfertave, për të zbuluar nëse informacioni për nismëtarin ose përfituesin, i parashikuar në nenin 161, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”, dhe nenin 161, pika 2, germat “a”, “b” dhe “c”, është transmetuar paraprakisht, njëkohësisht ose paralelisht me transfertën individuale ose transfertën në grup të krypto-aseteve, duke përfshirë edhe rastet kur transfertë është realizuar në drejtim të një adrese të vetë-hostuar ose nga një adresë e vetë-hostuar.

Neni 168

Transfertat e krypto-aseteve për të cilat mungon informacioni mbi nismëtarin ose përfituesin

1. Ofruesi ndërmjetës i shërbimit të krypto-aseteve duhet të miratojë procedura efektive të bazuara në rrezik, duke përfshirë procedurat e përcaktuara në Pjesën II të këtij ligji, për të përcaktuar nëse duhet ekzekutuar, refuzuar, kthyer ose pezulluar një transfertë e krypto-aseteve që nuk përmban informacionin e kërkuar mbi nismëtarin dhe përfituesin dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura pasuese.

Në rastet kur ofruesi ndërmjetës i shërbimit të krypto-aseteve konstaton, kur merr një transfertë të krypto-aseteve, se informacioni i përcaktuar në nenin 161, pikat 1, germat “a”, “b” dhe “c” dhe nenin 161, pika 2, germat “a”, “b” dhe “c”, ose në nenin 162, mungon ose është i

paplotë, atëherë ky ofrues, bazuar në qasjen e bazuar në rrezik dhe pa vonesa të panevojshme, duhet:

- a) të refuzojë transfertën ose t'i kthejë krypto-asetet e transferuara; ose
- b) të kërkojë informacionin mbi nismëtarin dhe përfituesin përpara se të bëjë transmetimin e transfertës së krypto-aseteve.

2. Në rastet kur ofruesi i shërbimit të krypto-aseteve nuk arrin në mënyrë të përsëritur të japë informacionin e kërkuar për nismëtarin ose përfituesin, ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të krypto-aseteve duhet:

a) të marrë masa, të cilat fillimisht mund të përfshijnë dhënien e paralajmërimeve dhe caktimin e afateve për përmbushjen e detyrimit, përpara se të vazhdojë me refuzimin, kufizimin apo ndërprerjen në përputhje me germën “b” të kësaj pike, në rast se informacioni i kërkuar ende nuk është dhënë; ose

b) të refuzojë drejtpërdrejt çdo transfertë të ardhshme të krypto-aseteve për ose nga, ose të kufizojë ose të ndërpresë marrëdhënien e tij të veprimtarisë me atë ofrues të shërbimit të krypto-aseteve.

Ofruesi ndërmjetës i shërbimeve të krypto-aseteve duhet të raportojë pranë autoritetit mbikëqyrës kompetent rastet e mospërmbushjes së përsëritur të detyrimit për informacion, si dhe masat e ndërmarra prej tij.

Neni 169

Vlerësimi dhe raportimi

Ofruesi ndërmjetës i shërbimit të krypto-aseteve duhet të marrë në konsideratë informacionin që mungon mbi nismëtarin ose përfituesin si një tregues të mundshëm rreziku gjatë vlerësimit nëse një transfertë e krypto-aseteve, ose ndonjë transaksion i lidhur me të, është i dyshimtë dhe nëse duhet të raportohet pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare në përputhje me Pjesën I dhe Pjesën II të këtij ligji.

KREU IV

MASAT E PËRBASHKËTA TË ZBATUESHME NGA OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË PAGESAVE DHE OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË KRIPTO-ASETEVE

Neni 170

Politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme për të garantuar zbatimin e masave shtrënguese financiare

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të miratojnë politika, procedura dhe kontrolle të brendshme për të garantuar zbatimin e masave shtrënguese të parashikuara në legjislacionin në fuqi, si dhe në përputhje me përkufizimet e dhëna në Pjesën II të këtij ligji, gjatë kryerjes së transfertave të fondeve dhe krypto-aseteve sipas përcaktimeve të Pjesës III të ligjit.

2. Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, përmes rregulloreve respektive brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, miratojnë rregulla më të detajuara në lidhje

me kërkesat minimale për politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

KREU V

INFORMACIONI, MBROJTJA DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE

Neni 171

Dhënia e informacioneve

Ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të përgjigjen në mënyrë të plotë dhe pa vonesë, duke përfshirë edhe nëpërmjet pikës qendrore të kontaktit në përputhje me përcaktimet në Pjesën I të këtij ligji, si dhe në përputhje me kërkesat procedurale ligjore në fuqi, ndaj kërkesave të paraqitura ekskluzivisht nga autoritetet kompetente për parandalimin dhe luftën ndaj pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, në lidhje me informacionin e kërkuar sipas Pjesës III të këtij ligji.

Neni 172

Mbrojtja e të dhënave

1. Përpunimi i të dhënave personale në zbatim të Pjesës III të këtij ligji kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Të dhënat personale përpunohen nga ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve në bazë të Pjesës III të këtij ligji vetëm për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe nuk përpunohen më tej në një mënyrë që bie në kundërshtim me këto qëllime.

Përpunimi i të dhënave personale në bazë të Pjesës III të këtij ligji për qëllime tregtare është i ndaluar.

3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet t'i japin klientëve të rinj informacionin e kërkuar sipas ligjit mbi mbrojtjen e të dhënave personale përpara se të vendosin një marrëdhënie biznesi ose të kryejnë një transaksion rastësor me ta. Ky informacion duhet të jepet në formë koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe, në veçanti, duhet të përfshijë njoftim të përgjithshëm në lidhje me detyrimet ligjore të ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe ofruesve të shërbimeve të krypto-aseteve sipas Pjesës III të këtij ligji, në rastet kur përpunojnë të dhëna personale për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të sigurojnë në çdo kohë që transmetimi i të dhënave personale mbi palët e përfshira në një transfertë fondesh ose transfertë të krypto-aseteve të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Autoriteti kompetent për mbrojtjen e të dhënave personale, në konsultim me autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e subjekteve të detyruara të Pjesës III të këtij ligji, nxjerr udhëzime mbi zbatimin praktik të kërkesave për mbrojtjen e të dhënave për transferimet e të dhënave personale me shtetet anëtare apo vendet e treta në kontekstin e transfertave të krypto-aseteve.

Autoritetet kompetente për mbikëqyrjen e subjekteve të detyruara të Pjesës III të këtij ligji nxjerrin udhëzime mbi procedurat e përshtatshme për të përcaktuar nëse duhet ekzekutuar, refuzuar, kthyer ose pezulluar një transfertë e krypto-aseteve në situata kur nuk mund të sigurohet përputhshmëria me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave për transferimin e të dhënave personale me shtetet anëtare apo vendet e treta.

Neni 173

Ruajtja e të dhënave

1. Informacioni mbi pagesin dhe përfituesin e pagesës ose mbi nismëtarin dhe përfituesin në rastet e transfertave të krypto-aseteve nuk duhet të ruhet për një periudhë më të gjatë se sa është domosdoshmërisht e nevojshme. Ofruesit e shërbimeve të pagesave të pagesit dhe përfituesit të pagesës duhet të ruajnë të dhënat e informacionit të përcaktuar në nenet 151 deri në 154 të këtij ligji, dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve të nismëtarit dhe përfituesit duhet të ruajnë të dhënat e informacionit të përcaktuar në nenet 161 deri në 163 të këtij ligji, për një periudhë prej 5 vitesh.

2. Pas përfundimit të periudhës së ruajtjes së parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve duhet të sigurojnë që të dhënat personale të fshihen, përveç nëse parashikohet ndryshe nga kuadri ligjor në fuqi i cili përcakton rrethanat në të cilat ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve mund ose do t'i ruajnë më tej të dhënat e tilla.

Ruajtja e mëtejshme e të dhënave lejohet ose kërkohet vetëm kur parashikohet nga kuadri ligjor në fuqi dhe pasi të jetë kryer një vlerësim i plotë i domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të ruajtjes së mëtejshme, dhe kur konsiderohet e justifikuar si e nevojshme për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Kjo periudhë e mëtejshme e ruajtjes nuk duhet të kalojë 5 vjet.

3. Kur janë në proces procedura hetimore ose gjyqësore për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave mban informacion ose dokumente që lidhen me këto procedura në proces, ai mund t'i ruajë këto informacione ose dokumente për një periudhë deri në 5 vjet dhe, në çdo rast, për aq kohë sa është e nevojshme për përfundimin e procedurave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Pa cenuar legjislacionin procedural penal mbi provat dhe administrimin e tyre, për hetimet penale dhe procedurat ligjore në vazhdim, ruajtja e mëtejshme e këtyre informacioneve ose dokumenteve mund të lejohet ose kërkohet për një periudhë tjetër prej 5 vitesh, kur nevoja dhe proporcionaliteti i saj është vlerësuar dhe konsideruar e justifikuar për parandalimin, zbulimin, hetimin ose ndjekjen penale të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

Neni 174

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente

Shkëmbimi i informacionit midis autoriteteve kompetente dhe me autoritetet kompetente të shteteve anëtare dhe të vendeve të treta në zbatim të kësaj pjese të ligjit, kryhet në përputhje me Pjesën I dhe Pjesën II të këtij ligji dhe në përputhje me përcaktimet e lejuara nga ky ligj.

KREU VI
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE MONITORIMI

Neni 175

Kundërvajtjet administrative

1. Në rastet kur shkeljet e dispozitave të Pjesës III të këtij ligji nuk përbëjnë vepër penale, ato përbëjnë kundërvajtje administrative dhe autoritetet mbikëqyrëse vendosin një ose disa nga masat administrative të përcaktuara në nenin 67 të këtij ligji.

2. Masat administrative të përcaktuara në nenin 67 të këtij ligji janë të zbatueshme edhe ndaj anëtarëve të organit drejtues dhe çdo personi fizik të ofruesit të shërbimeve të pagesave dhe ofruesve të shërbimeve të krypto-aseteve që është përgjegjës për kundërvajtjen administrative, në rastet e shkeljes së dispozitave të Pjesës III të këtij ligji.

3. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, autoritetet mbikëqyrëse ushtrojnë të gjitha kompetencat mbikëqyrëse dhe analizuese të nevojshme.

Gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre për vendosjen e gjobave dhe masave administrative, autoritetet mbikëqyrëse bashkëpunojnë ngushtësisht për të garantuar që gjobat ose masat administrative të japin rezultatet e dëshiruara dhe koordinojnë veprimet e tyre kur kanë të bëjnë me raste ndërkufitare.

4. Personat juridikë mbajnë përgjegjësi për shkeljet e parashikuara në nenin 176 të këtij ligji, kur këto shkelje kryhen për përfitim të tyre nga çdo person që vepron individualisht ose si pjesë e një organi të personit juridik, dhe që ushtron funksione drejtuese brenda tij, në bazë të:

- a) kompetencës për ta përfaqësuar personin juridik;
- b) autoritetit për të marrë vendime në emër të personit juridik; ose
- c) autoritetit për të ushtruar kontroll ose mbikëqyrje brenda personit juridik.

5. Personat juridikë janë përgjegjës kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga një person i përmendur në pikën 4 të këtij neni ka bërë të mundur kryerjen e një prej shkeljeve të përmendura në nenin 176 në dobi të atij personi juridik nga një person nën autoritetin e tij.

6. Autoritetet mbikëqyrëse ushtrojnë kompetencat e tyre për vendosjen e gjobave dhe masave administrative, në përputhje me nenet 65 dhe 67 të Pjesës I të këtij ligji, sipas një prej mënyrave të mëposhtme:

- a) në mënyrë të drejtpërdrejtë;
- b) në bashkëpunim me autoritete të tjera kompetente mbikëqyrëse;
- c) nën përgjegjësinë e tyre, duke ua deleguar autoriteteve të tilla të tjera;
- d) me anë të një kërkesë drejtuar autoriteteve gjyqësore kompetente.

Gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre për vendosjen e gjobave dhe masave administrative, autoritetet mbikëqyrëse bashkëpunojnë ngushtësisht për të garantuar që gjobat ose masat administrative të japin rezultatet e dëshiruara dhe koordinojnë veprimet e tyre kur kanë të bëjnë me raste ndërkufitare.

Neni 176

Dispozita specifike

Autoritetet mbikëqyrëse vendosin gjoba dhe masa administrative sipas përcaktimeve në nenet 61, 65, 67 dhe 68 të këtij ligji, në rast të shkeljeve të mëposhtme të Pjesës III të këtij ligji:

a) mospërbushje e përsëritur ose sistematike nga një ofrues i shërbimeve të pagesave për të shoqëruar transfertat e fondeve me informacionin e kërkuar mbi pagesin ose përfituesin e pagesës, në shkelje të neneve 151, 152 ose 153 të kësaj pjese, ose nga një ofrues i shërbimeve të krypto-aseteve për të shoqëruar transfertat e krypto-aseteve me informacionin e kërkuar mbi nismëtarin dhe përfituesin, në shkelje të nenit 161 ose 162;

b) mospërbushje e përsëritur, sistematike ose serioze nga një ofrues i shërbimeve të pagesave ose nga një ofrues i shërbimeve të krypto-aseteve për të ruajtur të dhënat, në shkelje të nenit 173;

c) mospërbushje nga një ofrues i shërbimeve të pagesave për të zbatuar procedura efektive të bazuara në rrezik, në shkelje të nenit 155 ose 159, ose nga një ofrues i shërbimeve të krypto-aseteve për të zbatuar procedura efektive të bazuara në rrezik, në shkelje të nenit 164;

d) mospërbushje serioze nga një ofrues ndërmjetës i shërbimeve të pagesave për të zbatuar nenet 158 ose 159 të këtij ligji ose nga një ofrues ndërmjetës i shërbimeve të krypto-aseteve për të zbatuar nenet 166, 167 ose 168 të këtij ligji.

Neni 177

Publikimi i gjobave dhe masave

Në përputhje me nenin 69 të këtij ligji, autoritetet mbikëqyrëse duhet të publikojnë, pa vonesë, gjobat dhe masat administrative të vendosura sipas neneve 175 dhe 176 të këtij ligji.

Publikimi i gjobave dhe masave administrative përfshin edhe informacionin mbi llojin dhe natyrën e shkeljes dhe identitetin e personave përgjegjës për shkeljen, kur publikimi i këtij informacioni vlerësohet si i nevojshëm dhe proporcional pas një vlerësimi rast pas rasti.

Neni 178

Zbatimi i gjobave dhe masave nga autoritetet mbikëqyrëse

1. Autoritetet mbikëqyrëse, në përcaktimin e llojit të gjobave apo masave administrative dhe të nivelit të tyre, duhet të marrin në konsideratë të gjitha rrethanat përkatëse, duke përfshirë ato të renditura në nenin 61 të këtij ligji.

2. Gjobat dhe masat administrative për shkelje të dispozitave të Pjesës III të këtij ligji vendosen në zbatim të neneve 61, 64, 65, 67 dhe 68 të këtij ligji.

Neni 179

Raportimi i shkeljeve

1. Autoritetet mbikëqyrëse ngrenë mekanizma efektivë për të nxitur raportimet lidhur me shkeljet e Pjesës III të këtij ligji. Këto mekanizma duhet të përfshijnë të paktën elementet e përcaktuara në nenin 73 të këtij ligji.

2. Ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve, në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse, duhet të miratojnë procedura të brendshme të përshtatshme që u mundësojnë punonjësve të tyre ose personave në pozita të ngjashme të

raportojnë, nëpërmjet kanaleve të sigurta, të pavarura, të posaçme dhe anonime, shkelje të Pjesës III të këtij ligji, në përpjesëtim me natyrën dhe madhësinë e ofruesit të shërbimit të pagesave ose ofruesit të shërbimit të krypto-aseteve përkatës.

Neni 180

Mbikëqyrja

1. Autoritetet mbikëqyrëse mbikëqyrin në mënyrë efektive zbatimin e Pjesës III të këtij ligji dhe marrin masat e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me të, si dhe nxisin, nëpërmjet mekanizmave efektivë, raportimin pranë tyre të shkeljeve të dispozitave të kësaj pjese të ligjit.

2. Autoritetet mbikëqyrëse publikojnë, çdo 3 vjet, një raport mbi zbatimin e dispozitave të Kreut VI të Pjesës III të këtij ligji, duke i kushtuar vëmendje të veçantë rasteve ndërkufitare.

KREU VII

PËRJASHTIME

Neni 181

Marrëveshjet me vendet e treta

1. Republika e Shqipërisë mund të lidhë marrëveshje ndërkombëtare me vendet e treta që përmbajnë përjashtime nga zbatimi i Pjesës III të këtij ligji, me qëllim që transfertat e fondeve ndërmjet atij vendi të tretë ose territori dhe Republikës së Shqipërisë të trajtohen si transferta fondesh të kryera brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Marrëveshjet e parashikuara në këtë pikë mund të lidhen vetëm nëse plotësohen njëkohësisht kushtet e mëposhtme:

a) vendi i tretë ose territori përkatës është pjesë e një bashkimi monetar me Republikën e Shqipërisë, bën pjesë në të njëjtën zonë monetare ose ka lidhur një marrëveshje monetare me Republikën e Shqipërisë;

b) ofruesit e shërbimeve të pagesave në vendin e tretë ose territorin përkatës marrin pjesë drejtpërdrejt ose tërthorazi në sistemet e pagesave dhe shlyerjes që veprojnë në Republikën e Shqipërisë;

c) vendi i tretë ose territori përkatës kërkon që ofruesit e shërbimeve të pagesave që veprojnë nën juridiksionin e tij të zbatojnë rregulla të njëjta ose të barasvlershme me ato të përcaktuara sipas Pjesës III të këtij ligji.

2. Përpara lidhjes së një marrëveshjeje sipas pikës 1 të këtij neni, autoriteti kompetent paraqet për shqyrtim informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë nen.

3. Transfertat e fondeve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendit të tretë ose territorit të huaj trajtohen si transferta fondesh të brendshme vetëm pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Përjashtimet e parashikuara në marrëveshjet e lidhura sipas këtij neni nuk mund të ulin standardet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të parashikuara në këtë ligj.

5. Marrëveshjet sipas këtij neni lidhen dhe ratifikohen në përputhje me legjislacionin

në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare dhe procedurat kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

KREU VIII DISPOZITA TË TJERA

Neni 182 Aktet zbatuese

1. Autoritetet mbikëqyrëse, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, sipas përcaktimeve në Pjesën I të ligjit, brenda fushës së përgjegjësisë të tyre, miratojnë akte nënligjore dhe udhëzimet e nevojshme për zbatimin e Pjesës III të ligjit, në veçanti lidhur me:

a) masat që duhet të merren nga ofruesit e shërbimeve të pagesave për zbatimin e neneve 154, 155, 158 dhe 159 të Pjesës III të ligjit;

b) masat që duhet të merren nga ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve për zbatimin e neneve 161 deri në 164 dhe 166 deri në 169 të Pjesës III të ligjit;

c) udhëzime mbi aspektet teknike të zbatimit të kërkesave për debitimet direkte, si dhe masat që duhet të ndërmarrin ofruesit e shërbimeve të inicimit të pagesave, siç përcaktohen në legjislacionin në fuqi për shërbimet e pagesave, duke marrë në konsideratë rolin e tyre të kufizuar në transaksionet e pagesave;

d) udhëzimet për masat që duhet të ndërmarrin autoritetet kompetente lidhur me karakteristikat e qasjes së bazuar në rrezik për mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve të krypto-aseteve dhe hapat që duhet të ndërmerren gjatë ushtrimit të kësaj mbikëqyrjeje.

2. Autoritetet mbikëqyrëse sigurojnë konsultime periodike me palët e interesuara për zhvillimin e zgjidhjeve teknike ndërvepruese që lehtësojnë zbatimin efektiv të kërkesave të këtij ligji.

Neni 183 Zbatimi dhe interpretimi i Pjesës III

1. Dispozitat e Pjesës III të këtij ligji zbatohen dhe interpretohen në përputhje dhe në harmoni me Pjesën I dhe Pjesën II të këtij ligji.

2. Përkufizimet që lidhen me krypto-asetet, ofruesit e shërbimeve të krypto-aseteve, adresat e vetë-hostuara dhe marrëdhëniet korrespondente zbatohen sipas dispozitave të këtij ligji dhe në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi.

PJESA IV

KONTROLI I MJETEVE MONETARE QË HYJNË OSE DALIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 184

Fusha e zbatimit

Pjesa IV e këtij ligji parashikon sistemin e kontrollit të mjeteve monetare që hyjnë ose dalin nga Republika e Shqipërisë, me qëllim plotësimin e kuadrit ligjor për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Neni 185

Përkufizime

Për qëllime të Pjesës IV të këtij ligji zbatohen përkufizimet e përcaktuara në Pjesën I, Pjesën II dhe Pjesën III të këtij ligji, si dhe përkufizimet e mëposhtme:

1. “mjete monetare” nënkupton:

- a) para fizike;
- b) instrumentet e negociueshme në formë mbajtësi;
- c) mallra që përdoren si mbajtës vlere me likuiditet të lartë;
- d) karta të parapaguara.

2. "Para fizike" nënkupton monedha dhe kartëmonedha, kombëtare apo të huaja, që janë në qarkullim si mjet këmbimi ose që kanë qenë në qarkullim si një mjet këmbimi dhe ende mund të këmbehen nëpërmjet institucioneve financiare, të kreditit ose bankare me monedha dhe kartëmonedha që janë në qarkullim si mjet këmbimi;

3. "instrumente të negociueshme në formë mbajtësi" nënkupton instrumente të ndryshme nga monedha që i japin të drejtë mbajtësit për të kërkuar një shumë financiare pas paraqitjes së instrumenteve, pa pasur nevojë të vërtetojë identitetin e tij ose të drejtën e tij për atë shumë.

Këto instrumente janë:

- a) çeqet e udhëtarit; dhe
- b) çeqet, premtim-pagesat ose urdhërpagesat që janë si në formën e mbajtësit, të nënshkruara por pa përfshirë emrin e personit të cilit i paguhet, të miratuara pa kufizim, të paguara për një përfitues fiktiv të pagesës, ose ndryshe në një formë të tillë që pronësia e tyre kalon pas dorëzimit;

4. "mallra që përdoren si mbajtës vlere me likuiditet të lartë" nënkupton një mall, siç është listuar në Aneks I, të Pjesës IV të këtij ligji, që paraqet një raport të lartë ndërmjet vlerës dhe vëllimit të tij dhe që mund të konvertohet lehtësisht në para përmes tregjeve të aksesueshme, që i shtohen vetëm kosto modeste transaksioni;

5. "kartë e parapaguar" nënkupton një kartë jo-emërore, siç është listuar në pikën 2 të Aneksit I, të Pjesës IV të këtij ligji, që ruan ose siguron akses në vlera monetare ose fonde, të cilat mund të përdoren për transaksione pagese, për blerjen e mallrave ose shërbimeve, ose për konvertimin në monedhë, kur një kartë e tillë nuk është e lidhur me një llogari bankare;

6. “hyn ose del nga Republika e Shqipërisë” nënkupton hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një territor jashtë saj ose daljen nga territori i Republikës së Shqipërisë;

7. “autoritetet doganore” nënkupton autoritetet doganore të Republikës së Shqipërisë dhe çdo autoritet tjetër të cilit i është dhënë kompetenca për zbatimin e Pjesës IV të këtij ligji;

8. “mbartës” nënkupton çdo person që hyn ose del nga Republika e Shqipërisë që mban mjete monetare me vete, në bagazhin e tij ose në mjetin e tij të transportit;

9. "mjete monetare të pashoqëruara" nënkupton mjete monetare që përbëjnë pjesë të një dërgese pa mbajtës;

10. "veprimtari kriminale" ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në nenin 85, pika 45, të këtij ligji.

Neni 186

Detyrimi për deklarim të mjeteve monetare të shoqëruara

1. Mbartësit që mbajnë mjete monetare, me vlerë duke filluar nga shuma 10 000 (dhjetë mijë) euro ose kundërvlera e saj në monedha të tjera, duhet t'i deklarojnë ato pranë autoriteteve doganore në hyrje ose dalje nga Republika e Shqipërisë dhe i bëjnë të disponueshme për kontroll. Detyrimi për deklarimin e mjeteve monetare nuk do të konsiderohet i përmbushur nëse informacioni i dhënë është i pasaktë ose i paplotë ose nëse mjetet monetare nuk bëhen të disponueshme për kontroll.

2. Deklarata e përmendur në pikën 1 duhet të japë të dhëna rreth:

a) mbartësit, duke dhënë emrin e plotë, mbiemrin, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, datën dhe vendin e lindjes, kombësinë dhe numrin e dokumentit të identifikimit;

b) pronarit të mjeteve monetare, duke dhënë emrin e plotë, mbiemrin, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, datën dhe vendin e lindjes, kombësinë dhe numrin e dokumentit të identifikimit, kur pronari është një person, ose emrin e plotë, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, numrin e regjistrimit dhe, kur është e mundur, numrin e dokumentit të identifikimit të regjistrimit të personit të tatueshëm (NUIS/NIPT) kur pronari është një person fizik apo person juridik;

c) kur është e mundur, marrësin e synuar të mjeteve monetare, duke dhënë emrin e plotë, mbiemrin, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, datën dhe vendin e lindjes, kombësinë dhe numrin e dokumentit të identifikimit, kur marrësi i synuar është një person, ose emrin e plotë, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, numrin e regjistrimit dhe, kur është e mundur, numrin e dokumentit të identifikimit të regjistrimit të personit të tatueshëm (NUIS/NIPT), kur marrësi i synuar është një person fizik apo person juridik;

ç) natyrën dhe sasinë ose vlerën e mjeteve monetare;

d) burimin ekonomik të mjeteve monetare;

dh) qëllimin e përdorimit të mjeteve monetare;

e) rrugën e transportit; dhe

ë) mjetet e transportit.

3. Të dhënat e përmendura në pikën 2 të këtij neni do të jepen me shkrim ose elektronikisht, duke përdorur formularin e deklarimit të përmendur në nenin 199, pika 4, germa "a" e këtij ligji. Një kopje e miratuar e deklaratës i jepet deklaruesit me kërkesën e tij.

Neni 187

Detyrimi për të dhënë informacion lidhur me mjetet monetare të pashoqëruara

1. Kur mjetet monetare të pashoqëruara me një vlerë duke filluar nga shuma 10 000 (dhjetë mijë) euro ose kundërvleftën e saj në monedha të tjera, hyjnë ose dalin nga Republika e Shqipërisë, autoritetet doganore mund t'i kërkojnë dërguesit ose marrësit të tyre, ose

përfaqësuesit të tyre, sipas rastit, të paraqesë një deklaratë informuese brenda një afati prej 30 ditësh.

Autoriteti doganor bllokoi përkohësisht mjetet monetare derisa dërguesi ose marrësi, ose një përfaqësues i tyre, të paraqesë deklaratën informuese.

Detyrimi për deklarimin e mjeteve monetare të pashoqëruara nuk konsiderohet i përmbushur kur deklarata nuk paraqitet brenda afatit të përcaktuar, informacioni i dhënë është i pasaktë ose i paplotë, ose mjetet monetare nuk vihen në dispozicion për kontroll.

2. Deklarata informuese duhet të përmbajë të dhëna në lidhje me sa vijon:

a) deklaruesin, duke dhënë emrin e plotë, mbiemrin, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, datën dhe vendin e lindjes, kombësinë dhe numrin e dokumentit të identifikimit;

b) pronarin e mjeteve monetare, duke dhënë emrin e plotë, mbiemrin, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, datën dhe vendin e lindjes, kombësinë dhe numrin e dokumentit të identifikimit, kur pronari është një person, ose emrin e plotë, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, numrin e regjistrimit dhe, kur është e mundur, numrin e dokumentit të identifikimit të regjistrimit të personit të tatueshëm (NUIS/NIPT) kur pronari është person fizik apo person juridik;

c) dërguesin e mjeteve monetare, duke dhënë emrin dhe mbiemrin, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, datën dhe vendin e lindjes, kombësinë dhe numrin e dokumentit të identifikimit, kur dërguesi është një person, ose emrin e plotë, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, numrin e regjistrimit dhe kur është e mundur, numrin e dokumentit të identifikimit të regjistrimit të personit të tatueshëm (NUIS/NIPT), kur dërguesi është person fizik apo person juridik;

ç) marrësin ose personin që duhet të marrë mjetet monetare, duke dhënë emrin dhe mbiemrin, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, datën dhe vendin e lindjes, kombësinë dhe numrin e dokumentit të identifikimit, kur marrësi ose marrësi i synuar është person, ose emrin e plotë, të dhënat e kontaktit, përfshirë adresën, numrin e regjistrimit dhe, kur është e mundur, numrin e dokumentit të identifikimit të regjistrimit të personit të tatueshëm (NUIS/NIPT), kur marrësi ose marrësi i synuar është person fizik apo person juridik;

d) natyrën dhe sasinë ose vlerën e mjeteve monetare;

dh) burimin ekonomik të mjeteve monetare; dhe

e) qëllimin e përdorimit të mjeteve monetare.

3. Të dhënat e përmendura në pikën 2 të këtij neni jepen me shkrim ose në formë elektronike, duke përdorur formularin e deklaratës informuese të përmendur në nenin 199, pika 4, germa “a” e këtij ligji. Një kopje e miratuar e deklaratës informuese i jepet deklaruesit me kërkesën e tij.

Neni 188

Kompetencat e autoriteteve doganore

1. Për të verifikuar përmbushjen e detyrimit për deklarimin e mjeteve monetare të shoqëruara, siç përcaktohet në nenin 186, autoritetet doganore kanë të drejtë të kryejnë kontrolle të personit fizik, bagazheve dhe mjetit të tij të transportit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2. Për qëllim të zbatimit të detyrimit të deklarimit të mjeteve monetare të pashoqëruara, siç përcaktohet në nenin 187, autoritetet doganore kanë të drejtë të kryejnë kontrolle mbi çdo

dërgesë, kontejner mbartës ose mjet transporti që mund të ketë mjete monetare të pashoqëruara, në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Nëse detyrimi për të deklaruar mjetet monetare të shoqëruara sipas nenit 186, ose detyrimi për të deklaruar mjetet monetare të pashoqëruara sipas nenit 187, nuk është përmbushur, autoritetet doganore hartojnë me shkrim ose në formë elektronike, një deklaratë *ex officio*, e cila duhet të përmbajë në masën që është e mundur, të dhënat e përmendura në nenin 186 pika 2, apo në nenin 187, pika 2, sipas rastit.

4. Kontrollët duhet të bazohen kryesisht në analizën e rrezikut, me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut dhe marrjen e kundërmasave të nevojshme dhe duhet të kryhen brenda një kornize të përbashkët të menaxhimit të rrezikut, në përputhje me kriteret e përmendura në nenin 199, pika 4, germa “b”, i cili duhet gjithashtu të marrë në konsideratë vlerësimet kombëtare të rrezikut dhe vlerësimet e kryera nga autoriteti përgjegjës.

5. Për qëllime të zbatimit të nenit 189, autoritetet doganore ushtrojnë gjithashtu kompetencat që u janë dhënë sipas këtij neni.

Neni 189

Mjetet monetare nën pragun që dyshohet se kanë të bëjnë me veprimtari kriminale

1. Kur autoritetet doganore zbulojnë një mbartës që mbart mjete monetare në një shumë nën pragun e përmendur në nenin 186 dhe që ka tregues se mjetet monetare janë të lidhura me veprimtari kriminale, ato duhet ta regjistrojnë këtë informacion dhe të dhënat e përmendura në nenin 186, pika 2 e këtij ligji.

2. Kur autoritetet doganore zbulojnë se mjetet monetare nën pragun e përmendur në nenin 187, po hyjnë ose dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë dhe ka të dhëna se janë të lidhura me veprimtari kriminale, ato duhet të regjistrojnë këtë informacion dhe të dhënat e përmendura në nenin 187, pika 2 e këtij ligji.

Neni 190

Blokimi i përkohshëm i mjeteve monetare nga autoritetet doganore

1. Autoritetet doganore mund të bllokojnë përkohësisht mjetet monetare me anë të një vendimi administrativ në përputhje me legjislacionin në fuqi, kur:

a) detyrimi për të deklaruar mjetet monetare sipas nenit 186 ose detyrimi për deklarimin e mjeteve monetare të pashoqëruara sipas nenit 187 nuk është përmbushur; ose

b) ka tregues se mjetet monetare, pavarësisht nga shuma, janë të lidhura me veprimtari kriminale.

2. Vendimi administrativ i përmendur në pikën 1, i nënshtrohet të drejtës së ankimit, në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Autoritetet doganore i njoftojnë arsyet e vendimit administrativ:

a) personit që i kërkohet të bëjë deklaratën në përputhje me nenin 186 ose deklaratën informuese në përputhje me nenin 187; ose

b) personit që i kërkohet të japë informacionin, në përputhje me nenin 189, pikat 1 ose 2 të këtij ligji.

3. Periudha e bllokimit të përkohshëm do të kufizohet vetëm për atë kohë sa kërkohet nga autoritetet doganore për të përcaktuar nëse rrethanat e çështjes kërkojnë bllokim të mëtejshëm. Afati i bllokimit nuk duhet të kalojë 30 ditë.

Autoritetet doganore, pas kryerjes së një vlerësimi të plotë lidhur me nevojën dhe proporcionalitetin e vazhdimin të bllokimit të përkohshëm, mund të vendosin zgjatjen e periudhës së bllokimit deri në 90 ditë.

Kur nuk merret vendim brenda afatit për bllokim të mëtejshëm të mjeteve monetare ose nëse përcaktohet se rrethanat e çështjes nuk e justifikojnë një bllokim të mëtejshëm, mjetet monetare do t'i kthehen menjëherë:

a) personit, të cilit iu bllokuan përkohësisht mjetet monetare në situatat e përmendura në nenin 186 ose 187; ose

b) personit nga i cili mjetet monetare janë bllokuar përkohësisht në situatat e përmendura në nenin 189, pikat 1, ose 2 të këtij ligji.

Neni 191

Fushatat informuese

Autoritetet doganore sigurojnë që personat që hyjnë ose dalin nga Republika e Shqipërisë apo personat që dërgojnë mjete monetare të pashoqëruara nga Republika e Shqipërisë ose që marrin mjete monetare të pashoqëruara në Republikën e Shqipërisë të informohen për të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas Pjesës IV të këtij ligji dhe duhet të hartojnë materiale të përshtatshme informuese për këta persona.

Autoritetet doganore përgjegjëse sigurojnë vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme për realizimin e këtyre fushatave informuese.

Neni 192

Dhënia e informacionit Agjencisë së Inteligjencës Financiare

1. Autoritetet doganore regjistrojnë informacionin e marrë sipas nenit 186 ose 187, nenit 188, pika 3 ose të nenit 189 dhe ia dërgojnë Agjencisë së Inteligjencës Financiare.

2. Agjencia e Inteligjencës Financiare shkëmben informacionin e marrë sipas pikës 1 të këtij neni me autoritetet homologe të njësisë të inteligjencës financiare në përputhje me detyrimet ligjore të përcaktuara në Pjesën I të këtij ligji.

3. Autoritetet doganore duhet ta dërgojnë informacionin e përmendur në pikën 1, sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 15 ditë pune pas datës në të cilën është marrë informacioni.

4. Ministri përgjegjës për financat, me propozimin e autoritetit përgjegjës, nxjerr me udhëzim rregulla të hollësishme mbi mënyrat dhe procedurat e raportimit, dërgimit dhe shkëmbimit të informacionit sipas përcaktimeve të këtij neni.

Neni 193

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente

1. Autoritetet doganore shkëmbejnë në rrugë elektronike informacionin e mëposhtëm me autoritetet kompetente:

- a) deklaratat *ex officio* të hartuara në përputhje me nenin 188, pika 3 të këtij ligji;
 - b) informacionin e marrë në përputhje me nenin 189;
 - c) deklaratat e marra në përputhje me nenet 186 ose 187, kur ka tregues që mjetet monetare janë të lidhura me veprimtari kriminale;
 - d) informacion anonim rreziku dhe rezultatet e analizës së rrezikut.
2. Kur ka tregues se mjetet monetare lidhen me veprimtari kriminale, informacioni i përmendur në pikën 1 të këtij neni, do t'i dërgohet gjithashtu organit kompetent të prokurorisë.
3. Autoriteti doganor e dërgon informacionin e përmendur në pikat 1 dhe 2 në përputhje me rregullat e përmendura në nenin 199, pika 3 dhe duke përdorur formatin e përmendur në nenin 199, pika 4, germa “c” e këtij ligji.
4. Informacioni i përmendur në pikën 1, gjerat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni dhe në pikën 2, dërgohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 15 ditë pune pas datës në të cilën është marrë ky informacion.
5. Informacioni dhe rezultatet e përmendura në pikën 1, germa “d” e këtij neni dërgohen mbi baza gjashtëmujore.

Neni 194

Shkëmbimi i informacionit me vendet e treta

1. Në zbatim të Pjesës IV të këtij ligji, autoritetet doganore shqiptare brenda kuadrit të marrëveshjeve të ndihmës së ndërsjellë administrative, mund t'i transmetojnë informacionin e mëposhtëm një vendi të tretë, pas marrjes së autorizimit me shkrim nga autoriteti kompetent që e ka marrë fillimisht këtë informacion:
- a) deklaratat *ex officio* të hartuara në përputhje me nenin 188, pikën 3 e këtij ligji;
 - b) informacionin e marrë në përputhje me nenin 189;
 - c) deklaratat e marra në përputhje me nenet 186 ose 187, kur ka tregues që mjetet monetare janë të lidhura me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit.
2. Informacioni i transmetuar sipas pikës 1 të këtij neni shkëmbehet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 195

Sekreti profesional, konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

1. Autoritetet doganore sigurojnë mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave të marra në përputhje me nenet 186, 187, 188, pika 3 dhe nenin 189.
2. Informacioni i marrë nga autoritetet kompetente mbulohet nga detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional.

Neni 196

Mbrojtja e të dhënave personale dhe periudha e ruajtjes

1. Autoritetet doganore veprojnë si kontrollues të të dhënave personale që ata marrin, sipas përcaktimeve në nenet 186, 187, 188 pikën 3 dhe nenin 189.
2. Përpunimi i të dhënave personale në bazë të Pjesës IV të këtij ligji kryhet vetëm për qëllime të parandalimit dhe luftës ndaj veprimtarive kriminale.

3. Të dhënat personale që merren sipas neneve 186, 187, 188 pikën 3 dhe nenin 189 aksesohen vetëm nga punonjësit të autorizuar të autoriteteve doganore dhe mbrohen në mënyrë të përshtatshme kundër aksesit apo transmetimit të paautorizuar.

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në nenet 192, 193 dhe 194, të dhënat nuk mund të bëhen të ditura ose të transmetohen pa autorizimin e shprehur të autoritetit doganor prej të cilit janë marrë fillimisht. Ky autorizim nuk është i nevojshëm kur autoritetet doganore duhet t'i zbulojnë ose t'i transmetojnë të dhënat në përputhje me legjislacionin në fuqi, veçanërisht në lidhje me procedimet gjyqësore.

4. Autoritetet doganore dhe Agjencia e Inteligjencës Financiare i ruajnë të dhënat personale të marra sipas neneve 186, 187, 188 pikën 3 dhe nenin 189 për një periudhë 5 vjeçare nga data në të cilën janë marrë të dhënat. Të dhënat personale do të fshihen pas përfundimit të kësaj periudhe.

5. Periudha e ruajtjes mund të zgjatet vetëm një herë për një periudhë shtesë që nuk i kalon 3 vjet, nëse:

a) Agjencia e Inteligjencës Financiare, pasi ka kryer një vlerësim të plotë të nevojës dhe proporcionalitetit për ruajtje të mëtejshme dhe e ka vlerësuar të justifikuar për përmbushjen e detyrave të saj në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përcakton se ruajtja e mëtejshme është e nevojshme; ose

b) Autoritetet doganore përcaktojnë se ruajtja e mëtejshme është e nevojshme, pasi kanë kryer një vlerësim të plotë të nevojës dhe proporcionalitetit të ruajtjes së mëtejshme dhe e kanë vlerësuar atë si të justifikuar për përmbushjen e detyrave të tyre në funksion të ushtrimit të kontrolleve efektive lidhur me detyrimin për deklarimin e mjeteve monetare të shoqëruara ose detyrimin për deklarimin e mjeteve monetare të pashoqëruara.

Neni 197

Gjobat dhe masat administrative

1. Autoritetet doganore vendosin masa administrative me gjobë që zbatohet në rast të mosrespektimit të detyrimit për të deklaruar mjetet monetare të shoqëruara të përcaktuara në nenin 186 ose detyrimit për të deklaruar mjetet monetare të pashoqëruara të përcaktuara në nenin 187.

2. Në rast se autoritetet doganore konstatojnë mosdeklarim, sipas neneve 186 ose 187, vendosin masë administrative me gjobë, e cila llogaritet si përqindje mbi vlerën e parashikuar në këto nene, në masën, si vijon:

a) 30 % të shumës mbi 10 000 (dhjetë mijë) euro kur shuma në total e mjeteve monetare është jo më shumë se 20 000 (njëzetë mijë) euro. Në çdo rast masa administrative me gjobë nuk mund të jetë më pak se 500 (pesëqind) euro;

b) 40 % të shumës mbi 10 000 (dhjetë mijë) euro kur shuma në total e mjeteve monetare është më shumë se 20 000 (njëzetë mijë) euro por jo më shumë se 50 000 (pesëdhjetë mijë) euro;

c) 50 % të shumës mbi 10 000 (dhjetë mijë) euro kur shuma në total e mjeteve monetare është më shumë se 50 000 (pesëdhjetë mijë) euro.

3. Në rast se mjetet monetare nuk janë të ndashme në mënyrën që lejon vjeljen e menjëhershme të shumës së saktë të gjobës, autoriteti doganor mban mjetet monetare në shumë më të madhe se vlera e gjobës, por të përafërt me shumën në fjalë.

4. Kur autoritetet doganore dyshojnë se mosdeklarimi sipas nenit 186 apo 187 përbën vepër penale për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, kallëzimi penal bashkë me dosjen përkatëse, u transferohet autoriteteve gjyqësore kompetente për procedim penal të mëtijshëm, brenda 72 orëve nga çasti i verifikimit të shkeljes. Materialit kallëzues i bashkëlidhet edhe vendimi për dhënien e masës administrative me gjobë.

Neni 198

Transmetimi dhe publikimi i informacionit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave publikon në faqen e saj zyrtare të internetit, të paktën një herë në vit, listën e autoriteteve kompetente për zbatimin e Pjesës IV të këtij ligji, masat administrative të zbatueshme sipas nenit 197 të këtij ligji, si dhe informacionin statistikor të anonimizuar në lidhje me deklaratat, kontrollet dhe shkeljet, duke përdorur formatin e përcaktuar në nenin 199, pika 4, germa “e” e këtij ligji.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mban dhe përditëson çdo ndryshim në lidhje me sa përcaktohet në pikën 1 të këtij neni dhe e publikon në faqen zyrtare të internetit. Çdo ndryshim në informacionin e publikuar sipas pikës 1 të këtij neni publikohet jo më vonë se një muaj nga data e hyrjes në fuqi të ndryshimit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informon përdoruesit, në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme, për kontrollet që kryhen ndaj mjeteve monetare që hyjnë ose dalin nga Republika e Shqipërisë.

Neni 199

Aktet nënligjore

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, miraton me vendim, rregulla të hollësishme për mënyrën e zbatimit të nenit 197 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, përditëson listën e Aneksit I të Pjesës IV të këtij ligji, duke marrë në vlerësim të tipologjive të reja të pastrimit të parave, apo financimit të terrorizmit, praktikat më të mira për parandalimin e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, si dhe për të parandaluar keqpërdorimin dhe anashkalimin e detyrimeve të parashikuara në nenet 186 dhe 187 të këtij ligji për mallrat që përdoren si mbajtës vlere me likuiditet të lartë dhe kartat e parapaguara.

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat, miraton me vendim, rregulla teknike për shkëmbimin efektiv të informacionit sipas nenit 193, të këtij ligji, nëpërmjet Sistemit të Informacionit Doganor (CIS), në zbatim të nenit 23 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 515/97 të 13 marsit 1997 mbi ndihmën e ndërsjellë midis autoriteteve administrative të Shteteve Anëtare dhe bashkëpunimin midis këtyre të fundit dhe Komisionit Evropian, për të siguruar zbatimin e ligjit mbi çështjet doganore dhe bujqësore.

4. Ministri përgjegjës për financat, me propozimin e autoritetit doganor, nxjerr aktet nënligjore për miratimin e masave të mëposhtme për të siguruar zbatimin uniform të kontrolleve nga organet kompetente doganore:

a) modelet e formularit të deklaratës, të përmendur në nenin 186, pika 3 dhe formularit të deklaratës informuese të përmendur në nenin 187, pika 3 e këtij ligji;

b) kriteret për kornizën e përbashkët të menaxhimit të rrezikut të përmendur në nenin 188, pika 4 dhe, më konkretisht, kriteret e rrezikut, standardet dhe fushat prioritare të kontrollit, bazuar në informacionin e shkëmbyer sipas nenit 193, pika 1, germa “d” e këtij ligji si dhe në politikat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira;

c) formatin e formularit për transmetimin e informacionit të përmendur në nenin 193, pika 3 e këtij ligji;

d) rregullat teknike për shkëmbimin efektiv të informacionit sipas nenit 193 dhe 194 të këtij ligji;

e) rregullat dhe formatin që duhet të përdoret për të dhënë informacion statistikor të anonimizuar mbi deklaratimet dhe shkeljet, në përputhje me nenin 198, pika 1, të këtij ligji.

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 200

Dispozita kalimtare

1. Dispozitat e këtij ligji, për subjektet e detyruara të përcaktuara në nenin 86, pika 3, shkronjat "n" dhe "o", fillojnë të zbatohen nga data 10 korrik 2029.

2. Përjashtimisht neni 199, pika 3, i këtij ligji hyn në fuqi pas dhënies akses në sistem Republikës së Shqipërisë nga Bashkimi Evropian.

3. Deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

4. Kundërvajtjet administrative, për të cilat në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë në proces shqyrtimi nga autoritetet mbikëqyrëse ose nga gjykata, trajtohen sipas dispozitave në fuqi të ligjit në kohën e paraqitjes së tyre dhe në kohën e kryerjes së shkeljes.

5. Çdo autoritet publik, brenda një periudhe 3-mujore nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vlerëson përputhshmërinë e ligjeve, të akteve nënligjore ekzistuese dhe rregulloreve me këtë ligj.

6. Kur ka mospërputhje ose boshllëk ligjor me këtë ligj, të identifikuar gjatë vlerësimit, autoriteti publik përkatës duhet të ndryshojë ose të propozojë menjëherë ndryshime në legjislacionin dhe në aktet nënligjore përkatëse për t'i sjellë ato në përputhje me këtë ligj.

7. Përpara datës së anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, dispozitat e neneve 11 pika 4, 30 pika 5, 33 pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6, 35, 44 pikat 2 dhe 3, 45, 48, 49, 53, 54, 55, 57, 58, 63 pika 2, 64, 72, 73 pika 7, 74 pika 2, 75, 76, 77, 78, 79, 80 pika 2 dhe 3, 81, 82 germa “a”, 90, 100 pika 6, 113, 119, 138, 144, 145, 146, 147, 174, zbatohen në masën e parashikuar nga marrëveshjet e bashkëpunimit, marrëveshjet ndërkombëtare, apo kuadri institucional i vendosur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve të Bashkimit Evropian në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe nga detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian.

Neni 201

Vazhdimësia institucionale dhe të drejtat e personelit të Agjencisë së Inteligjencës Financiare

1. Agjencia e Inteligjencës Financiare që është e organizuar dhe funksionuese sipas ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, vijon veprimtarinë si Agjencia e Inteligjencës Financiare sipas këtij ligji.

2. Hyrja në fuqi e këtij ligji nuk sjell ndërprerjen, shuarjen, transferimin ose riorganizimin e të drejtave, detyrimeve, kompetencave, funksioneve, marrëdhënieve juridike, marrëveshjeve, procedurave administrative, analizave, aksesit në baza të dhënash, sistemeve teknologjike, certifikatave të sigurisë dhe dokumentacionit të Agjencisë së Inteligjencës Financiare.

3. Marrëdhëniet e punës së punonjësve ekzistues të Agjencisë së Inteligjencës Financiare vijnë pa ndërprerje. Hyrja në fuqi e këtij ligji nuk përbën shkak për përfundimin, ndryshimin ose ripërtëritjen e marrëdhënies së punës.

4. Punonjësve ekzistues u njihet vazhdimësia e marrëdhënies së punës, vjetërsia në punë, paga, shtesat mbi pagë, lejet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të drejtat e fituara, procedurat në vijim dhe certifikatat ose autorizimet e vlefshme për akses në informacion, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

5. Deri në miratimin e akteve nënligjore, rregullores së brendshme dhe akteve të tjera në zbatim të këtij ligji, aktet ekzistuese nënligjore dhe të brendshme të Agjencisë së Inteligjencës Financiare vazhdojnë të zbatohen, për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 202

Dispozita që zbatohen pas anëtarësimit

1. Nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, autoritetet kompetente, për zbatimin e Pjesës I të këtij ligji, përmbushin detyrimet e njoftimit ndaj Komisionit Evropian, AMLA dhe autoriteteve ose organeve të tjera kompetente të Bashkimit Evropian, në përputhje të plotë me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fuqi.

2. Nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, dispozitat e neneve 11 pika 4, 30 pika 5, 33 pikat 2, 3, 4, 5 dhe 6, 35, 44 pikat 2 dhe 3, 45, 48, 49, 53, 54, 55, 57, 58, 63 pika 2, 64, 72, 73 pika 7, 74 pika 2, 75, 76, 77, 78, 79, 80 pika 2 dhe 3, 81, 82 germa “a”, 90, 100 pika 6, 113, 119, 138, 144, 145, 146, 147, 174 dhe dispozitat e tjera përkatëse të këtij ligji zbatohen në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian në fuqi.

3. Nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, referencat në këtë ligj ndaj dispozitave të Pjesëve II, III dhe IV, të shfuqizuara sipas nenit 203 të këtij ligji, kuptohen si referenca ndaj dispozitave përkatëse të akteve të Bashkimit Evropian drejtpërdrejt të zbatueshme, që rregullojnë të njëjtën çështje.

Neni 203

Shfuqizime në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian

Në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, shfuqizohen dispozitat e pjesëve të mëposhtme:

a) Pjesa II e këtij ligji “Masat për zbatim nga subjektet e detyruara për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, nga neni 84 deri në nenin 147, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të kësaj pjese;

b) Pjesa III e këtij ligji “Masat për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve dhe të disa krypto-aseteve”, nga neni 148 deri në nenin 183, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të kësaj pjese;

c) Pjesa IV e këtij ligji “Mbi kontrollin e mjeteve monetare që hyjnë ose dalin nga Republika e Shqipërisë”, nga neni 184 deri në nenin 199, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të kësaj pjese.

Neni 204

Dispozita shfuqizuese

1. Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Të gjitha aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, vazhdojnë të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në zëvendësimin e tyre me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Neni 205

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 Janar 2028.

ANEKSET E PJESËS II

ANEKS I

Lista treguese e variablave të rrezikut

Më poshtë jepet një listë joshteruese e variablave të rrezikut që subjektet e detyruara duhet të marrin në konsideratë kur përgatisin vlerësimin e tyre të rrezikut në përputhje me nenin 92 të këtij ligji dhe kur përcaktojnë se deri në çfarë mase duhet të zbatojnë masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit në përputhje me nenin 102 të këtij ligji:

a) variablat e rrezikut të klientit:

i. veprimtaria tregtare ose profesionale e klientit dhe e pronarit përfitues;

ii. reputacioni i klientit dhe i pronarit përfitues të klientit;

iii. natyra dhe sjellja e klientit dhe e pronarit përfitues;

iv. juridiksionet ku bazohet klienti dhe pronari përfitues;

v. juridiksionet që përbëjnë vendet kryesore të ushtrimit të veprimtarisë së klientit dhe të pronarit përfitues;

- vi. juridiksionet me të cilat klienti dhe pronari përfitues kanë lidhje personale përkatëse;
- b) variablat e rrezikut të produktit, shërbimit ose transaksionit:
 - i. qëllimi i një llogarie ose marrëdhënieje biznesi;
 - ii. rregullsia ose kohëzgjatja e marrëdhënies të biznesit;
 - iii. niveli i aktiveve që do të depozitohen nga një klient ose madhësia e transaksioneve të ndërmarra;
 - iv. niveli i transparencës ose i mungesës së transparencës së produktit, shërbimit ose transaksionit;
 - v. kompleksiteti i produktit, shërbimit ose transaksionit;
 - vi. vlera ose përmasat e produktit, shërbimit ose transaksionit;
- c) variablat e rrezikut të kanalit të shpërndarjes:
 - i. shkalla në të cilën marrëdhënia e biznesit zhvillohet në distancë;
 - ii. prania e agjentëve ose ndërmjetësve që klienti mund të përdorë dhe natyra e marrëdhënies së tyre me klientin;
- d) variabli i rrezikut për sigurimin e jetës dhe sigurimet e tjera të lidhura me investimet:
 - i. niveli i rrezikut që paraqet përfituesi i policës së sigurimit.

ANEKS II

Faktorët e rrezikut më të ulët

Më poshtë jepet një listë joshteruese që përfshin faktorët dhe llojet e treguesve të rrezikut potencialisht më të ulët, të përmendur në nenin 102 të këtij ligji:

1. Faktorët e rrezikut të klientit:
 - a) shoqëritë publike të listuara në një bursë dhe që u nënshtrohen kërkesave të zbulimit të informacionit (qoftë në bazë të rregullave të bursës apo në bazë të ligjit ose instrumenteve të detyrueshme), të cilat vendosin kërkesa për të garantuar transparencën e duhur të pronësisë përfituese;
 - b) administratat ose ndërmarrjet publike;
 - c) klientët që janë rezidentë në zonat gjeografike me rrezik më të ulët, siç përcaktohen në pikën 3;
2. Faktorët e rrezikut të produktit, shërbimit, transaksionit ose kanalit të shpërndarjes:
 - a) policat e sigurimit të jetës për të cilat primi është i ulët;
 - b) policat e sigurimit për skemat e pensione, nëse nuk ka mundësi dorëzimi të parakohshëm dhe polica nuk mund të përdoret si kolateral;
 - c) një skemë pensioni, pensioni suplementar ose skemë e ngjashme që ofron përfitime pensioni për punëmarrësit, ku kontributet bëhen me anë të zbritjes nga pagat dhe rregullat e skemës nuk lejojnë transferimin e interesit të një anëtarit në bazë të skemës;
 - d) produktet ose shërbimet financiare që ofrojnë shërbime të mirë përcaktuara dhe të kufizuara për lloje të caktuara klientësh, me synim rritjen e aksesit për qëllime të përfshirjes financiare;
 - e) produktet ku rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit menaxhohen nga faktorë të tjerë, si kufizimet e shumës së portofolit ose transparenca e pronësisë (p.sh. lloje të caktuara të parasë elektronike);
3. Faktorët gjeografikë të rrezikut regjistrimi, themelimi, banimi në:

- a) shtetet anëtare;
- b) vendet e treta që kanë sisteme efektive të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- c) vendet e treta të identifikuara nga burime të besueshme si vende me nivel të ulët korrupsioni ose veprimtarish të tjera kriminale;
- d) vendet e treta që, bazuar në burime të besueshme si vlerësimet e ndërsjella, raportet e detajuara të vlerësimit ose raportet e publikuara të monitorimit, kanë kërkesa për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me rekomandimet e rishikuara të FATF dhe i zbatojnë ato kërkesa në mënyrë efektive.

ANEKS III

Faktorët e rrezikut më të lartë

Më poshtë jepet një listë joshteruese që përfshin faktorët dhe llojet e treguesve të rrezikut potencialisht më të lartë të përmendur në nenin 102 të këtij ligji:

1. Faktorët e rrezikut të klientit:
 - a) marrëdhënia e biznesit ose transaksioni rastësor kryhet në rrethana të pazakonta;
 - b) klientët që janë rezidentë në zona gjeografike me rrezik më të lartë, siç përcaktohen në pikën 3 të këtij aneksi;
 - c) personat juridikë ose organizimet ligjore që shërbejnë si mjete për mbajtjen e pasurive personale (*personal asset-holding vehicles*);
 - d) korporatat që kanë aksionarë të emëruar ose aksione në formën e aksioneve të mbajtësit;
 - e) bizneset që operojnë kryesisht në para fizike;
 - f) struktura e pronësisë së shoqërisë duket e pazakontë ose tepër komplekse, duke pasur parasysh natyrën e veprimtarisë së shoqërisë;
 - g) klienti është një shtetas i një vendi të tretë që aplikon për të drejta qëndrimi në Republikën e Shqipërisë në këmbim të çdo lloj investimi, duke përfshirë transferimet e kapitalit, blerjen ose dhënien me qira të pronave, investimet në obligacione qeveritare, investimet në shoqëri tregtare, dhurimin ose financimin e një veprimtarie në interesin publik dhe kontributet në buxhetin e shtetit;
 - h) klienti është person juridik ose organizim ligjor i krijuar ose themeluar në një juridiksion ku nuk ushtron veprimtari reale ekonomike, nuk ka prani të konsiderueshme ekonomike ose nuk ka një arsye të dukshme ekonomike;
 - i) klienti është në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një ose disa subjekteve ose organizimeve sipas gurmës "h" të kësaj pike;
2. Faktorët e rrezikut të produktit, shërbimit, transaksionit ose kanalit të shpërndarjes:
 - a) bankingu privat;
 - b) produktet ose transaksionet që mund të favorizojnë anonimitetin;
 - c) pagesat e marra nga palë të treta të panjohura ose të palidhura me klientin;
 - d) produktet e reja dhe praktikat e reja të biznesit, duke përfshirë mekanizmat e reja të shpërndarjes, dhe përdorimi i teknologjive të reja ose atyre në zhvillim si për produktet e reja ashtu edhe për ato ekzistuese;
 - e) transaksionet e lidhura me naftën, armët, metalet ose gurët e çmuar, produktet e

duhanit, artefaktet kulturore dhe sende të tjera me rëndësi arkeologjike, historike, kulturore dhe fetare ose me vlerë shkencore të rrallë, si dhe me fildishin dhe speciet e mbrojtura;

3. Faktorët gjeografikë të rrezikut:

a) vendet e treta që i nënshtrohen monitorimit të shtuar ose janë identifikuar nga FATF për shkak të mangësive që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë në sistemet e tyre të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

b) vendet e treta të identikuara nga burime të besueshme/procese të njohura, të tilla si vlerësimet e ndërsjella, raportet e detajuara të vlerësimit ose raportet e publikuara të monitorimit, si vende që nuk kanë sisteme efektive të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

c) vende me nivele të larta korrupsioni ose veprimtarish të tjera kriminale;

d) vendet e treta që u nënshtrohen sanksioneve, embargoeve ose masave të ngjashme të marra, për shembull, nga Bashkimi Evropian ose Kombet e Bashkuara;

e) vendet e treta që ofrojnë financim ose mbështetje për veprimtaritë terroriste ose që kanë organizata terroriste që veprojnë brenda tyre;

f) vendet e treta të identikuara nga burime të besueshme ose në zbatim të proceseve të njohura si vende që mundësojnë fshehtësi financiare përmes:

i. vendosjes së pengesave ndaj bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me juridiksione të tjera;

ii. ligjeve rigoroze të fshehtësisë për korporatat ose bankat, të cilat i pengojnë institucionet dhe punonjësit e tyre që t'u japin informacion mbi klientët autoriteteve kompetente, qoftë edhe përmes vendosjes së gjobave dhe sanksioneve;

iii. kontrolleve të dobëta për krijimin e personave juridikë ose krijimin e organizimeve ligjore; ose

iv. mungesës së kërkesave për regjistrim ose ruajtje të informacionit mbi pronësinë përfituese në një bazë të dhënash ose regjistër qendror.

ANEKS IV

Lista e mallrave me vlerë të lartë të përcaktuar në nenin 85, pika 34 e këtij ligji, përfshin:

1. bizhuteri, artikuj floriri ose argjendi me vlerë mbi 1 000 000 (një milion) lek ose kundërvleftën e saj në monedhat e tjera të huaja;

2. orë dhe orë dore me vlerë mbi 1 000 000 (një milion) lek ose shumën e barasvlershme në monedhën kombëtare;

3. mjete motorike me një çmim që tejkalon 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lek ose kundërvleftën e saj në monedhat e tjera të huaja;

4. mjete fluturuese me një çmim që tejkalon 750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lek ose kundërvleftën e saj në monedhat e tjera të huaja;

5. mjete lundruese me një çmim që tejkalon 750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lek ose kundërvleftën e saj në monedhat e tjera të huaja.

ANEKS V

Metalet e çmuara të përcaktuar në nenin 85, pika 35 e këtij ligji, përfshin:

- a) Ari;
- b) Argjendi;
- c) Platin;
- d) Iridiumi;
- e) Osmiumi;
- f) Paladium;
- g) Rodium;
- h) Rutenium.

Gurët e çmuar të përcaktuar në nenin 85, pika 35 e këtij ligji, përfshin:

- a) Diamanti;
- b) Rubini;
- c) Safiri;
- d) Smeraldi.

ANEKSI I PJESËS IV

ANEKS I

Mallra që përdoren si mbajtëse vlere me likuiditet të lartë dhe karta të parapaguara të cilat konsiderohen mjete monetare në përputhje me nenin 185

1. Mallra që përdoren si mbajtëse vlere me likuiditet të lartë:
 - a) monedha me përmbajtje ari jo më pak se 90%; dhe
 - b) lingota ari, shufra, copa ose forma të tjera të papërpunuara me përmbajtje ari jo më pak se 99,5 %.
2. Karta të parapaguara.